



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.legjislacioni.gov.al

Nr. 110

Datë 14 korrik 2014

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM
nr. 438, datë 2.7.2014

Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2014 - 2020.....

4241

VENDIM
Nr. 438, datë 2.7.2014

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR
PËR INTEGRIMIN EVROPIAN, 2014 - 2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Integrimit Evropian, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, 2014 - 2020, (PKIE, 2014 - 2020), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Integrimit Evropian orienton, bashkërendon dhe monitoron zbatimin e PKIE-së, 2014 - 2020, për çdo kapitull, nga grupet ndërinstitucionale të punës (GNP), të ngritura me urdhrin nr.107, datë 28.2.2014, të Kryeministrit, "Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian".

3. Ministria e Integrimit Evropian raporton çdo 3 (tre) muaj në Këshillin e Ministrave për ecurinë e zbatimit të PKIE-së, 2014 - 2020.

4. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore në varësi të Këshillit të Ministrave raportojnë pranë Ministrisë së Integrimit Evropian, çdo 3 (tre) muaj (java e tretë e muajit të fundit), për realizimin e detyrimeve, që rrjedhin nga PKIE-ja, 2014 - 2020.

5. Ngarkohet Ministria e Integrimit Evropian, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të monitorojë përfshirjen, nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, në programin buxhetor afatmesëm, të nevojave financiare për zbatimin e përparësive afatshkurtra dhe afatmesme, të parashikuara në PKIE, 2014 - 2020.

6. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian është përpiluar në të njëjtën linjë me Planin Legjislativ Vjetor të qeverisë, si dhe me Strategjinë për Zhvillim dhe Integrim. PKIE-ja është hartuar në gjuhën shqipe dhe anglisht.

7. Vendimi nr.486, datë 25.7.2012, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit, 2012 - 2015, dhe përcaktimin e përgjegjësisë institucionale për përafrimin në legjislacionin shqiptar të çdo akti të legjislacionit të Bashkimit Evropian", shfuqizohet.

8. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit, për të cilat në PKIE, 2014 - 2020, janë përcaktuar detyra të veçanta, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

Qershor 2014

PJESA 1 - Hyrje dhe Menaxhimi i Procesit të Integrimit Evropian

1. Hyrje

Procesi i Stabilizim-Asociimit për pesë vendet e Evropës Jug-Lindore, përfshi Shqipërinë, ka filluar që gjatë Samitit të Zagrebit të mbajtur në nëntor të vitit 2000. Veç kësaj, Procesi i Stabilizim-Asociimit (SAP) është konfirmuar si politikë e BE-së për Ballkanin Perëndimor në Këshillin Evropian të Selanikut 2003 dhe, në të njëjtin vit, Presidenti i Komisionit filloi procesin e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Republikën e Shqipërisë.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë nga njëra anë dhe Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare të tij nga ana tjetër u nënshkrua në qershor 2006 dhe hyri në fuqi në prill 2009. Qëllimet e Stabilizim-Asociimit, siç parashikohet në Nenin 1 të Marrëveshjes janë të "mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës; për të kontribuar në stabilitetin politik, ekonomik e institucional në Shqipëri, si dhe për stabilizimin e rajonit; të sigurojë një strukturë të përshtatshme për dialogun politik, duke lejuar zhvillimin e marrëdhënieve të ngushta politike ndërmjet Palëve; të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtar, gjithashtu dhe nëpërmjet përafrimit të legjislacionit të saj me atë të Komunitetit; të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për të përfunduar tranzicionin në një ekonomi tregu funksionale, të nxisë marrëdhënie ekonomike të harmonizuara dhe të zhvillojë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë; të nxisë bashkëpunimin rajonal në të gjitha fushat që mbulon kjo Marrëveshje. "

Gjithashtu, Republika e Shqipërisë është e angazhuar për të respektuar parimet e përgjithshme të demokracisë dhe të të drejtave të njeriut siç janë shpallur në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe siç janë përkufizuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në Aktin Final të Helsinkit dhe Kartën e Parisit për një Evropë të Re. Përveç kësaj, Shqipëria angazhohet të vazhdojë dhe të nxisë bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë me vendet e tjera të rajonit, përfshi një nivel të përshtatshëm të marrëveshjeve të ndërsjellta në lidhje me lëvizjen e personave, mallrave, kapitalit dhe shërbimeve, si dhe zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, sidomos ato që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave, migracionit të paligjshëm dhe trafikimit, përfshi në veçanti atë të qenieve njerëzore dhe të drogave të paligjshme. Angazhimet e përmendura më lart janë një faktor kyç që mund të kontribuojë drejt një stabiliteti rajonal dhe bashkëpunimit të mëtejshëm midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian.

Shqipëria paraqiti kërkesën e saj për anëtarësim në Bashkimin Evropian më 28 prill 2009. Pas kërkesës nga Këshilli, Komisioni paraqiti Opinionin e tij mbi aplikimin e Shqipërisë në nëntor 2010. Në Opinionin e tij, Komisioni vlerësoi se para se negociatat e pranimit të mund të hapen zyrtarisht, Shqipëria ende kishte për të arritur një shkallë të nevojshme të përputhshmërisë me kriteret e anëtarësimit dhe në veçanti për të përmbushur 12 prioritetet kyçe të identifikuara në Opinion. Në tetor 2012, Komisioni Evropian rekomandoi që Shqipërisë t'i jepet statusi i kandidatit me kusht plotësimit e masave kyçe në fushat e reformës gjyqësore dhe të administratës publike dhe rishikimin e rregullores së Parlamentit.

Komisioni edhe një herë rekomandoi që Shqipërisë t'i jepet statusi i kandidatit në Raportin e Progresit 2013 dhe duke identifikuar 5 prioritetet kyçe për hapjen e negociatave për anëtarësim. Këto prioritete janë: reforma e administratës publike; pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjshmëria e institucioneve gjyqësore; lufta kundër korrupsionit; lufta kundër krimit të organizuar; mbrojtja e të drejtave të njeriut (përfshi politikën e mos-diskriminimit, komunitetin rom, si dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë).

Më 11 nëntor 2013 filloi Dialogu i Nivelit të Lartë për prioritetet kryesore midis Shqipërisë dhe BE-së. Dialogu i Nivelit të Lartë shërben si një mjet për të strukturuar bashkëpunimin BE-Shqipëri dhe për të ndihmuar Shqipërinë të mbajë fokusin dhe konsensusin për integrimin në BE. Opozita dhe institucionet e pavarura të marrin pjesë në mënyrë aktive në Dialogun e Nivelit të Lartë të mes Komisionit Evropian dhe Shqipërisë.

Duke pasur këtë parasysh, në dritën e detyrimeve që duhet të përmbushen në kuadër të MSA-së, qëllimin strategjik për të arritur anëtarësimin në BE dhe përgjegjësinë që ky qëllim përfshin, si dhe reformat sociale, ekonomike dhe legjislative që tashmë kanë filluar, Shqipëria ka miratuar një qasje strategjike, e cila do të rregullojë detyrimet që ka marrë përsipër në bazë të kapaciteteve të veta dhe interesave kombëtare.

Prioritetet e përcaktuara në Planin Kombëtar për integrimin evropian janë përcaktuar në bazë të një numri burimesh, përfshi Planin Vjetor të Punës të Qeverisë (PVPQ), MSA, Partneritetin Evropian, vlerësimet e progresit të Shqipërisë të përfshira në Raportet Vjetore të Komisionit Evropian.

Prioritete afatshkurtra në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian në pesë fushat kryesore prioritare janë të sinkronizuara plotësisht me Udhërrëfyesin mbi 5 prioritetet kyçe të miratuara nga Qeveria shqiptare më 28 maj 2014.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian sapo të jetë shqyrtuar deri nga fundi i vitit 2014, do të sinkronizohet edhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014 – 2020, që do të miratohet në dhjetor 2014.

Për këtë arsye, Plani Kombëtar reflekton gatishmërinë e Shqipërisë për të arritur qëllimet e saj prioritare afatshkurtra dhe afatmesme në procesin e përafrimit me BE deri në zbatimin e masave konkrete, me theks të veçantë për vitin 2014.

2. Menaxhimi i procesit të Integrit Evropan

2.1 Grupet e Punës për Integrimin Evropian

Për të përmirësuar menaxhimin e koordinimit të procesit të integrit në BE, Kryeministri nxori dy urdhra në fillim të vitit 2014, një për përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian si edhe tjetri për përgatitjen dhe rishikimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2014-2020.

Urdhri nr. 107, datë 28.02.2014 “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës (GNP) për Integrimin Evropian” riorganizoi GNP-të ekzistuese të ngritura për çdo kapitull të *acquis*. Fusha e veprimit e këtyre GNP-ve përfshin këto detyra:

- realizojnë bashkëpunimin dhe komunikimin ndërinstitucional në nivel teknik, me synim zbatimin e angazhimeve në kuadrin e dokumenteve të politikave për integrimin evropian;
- mbikëqyrin zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA);
- kontribuojnë në përgatitjen e takimeve të Komitetit të MSA-së dhe Nënkomiteteve si edhe ndjekin dhe zbatojnë rekomandimet që jepen në këto takime;
- bashkë me Ministrinë e Integrit Evropian, koordinojnë rishikimet vjetore të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2014-2020 në kapitujt përkatës si edhe garantojnë konsistencën e Planit Kombëtar me planin vjetor të punës të Qeverisë si edhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2014-2020) si edhe strategji të tjera kombëtare/sectoriale;

- koordinojnë dhe mbikëqyrin procesin e përafrimit të legjislacionit, duke përfshirë respektimin e afateve të përcaktuara në Planin Kombëtar për Integrim Evropian 2014-2020;
- koordinojnë dhe garantojnë shpërndarje në kohë të *acquis* të BE-së ndërmjet ministrive të linjës dhe autoriteteve të tjera përgjegjëse, si edhe shërbejnë si forum për zgjidhjen e debateve ndërministror mbi shpërndarjen e *acquis*;
- monitorojnë periodikisht zhvillimet në lidhje me legjislacionin e BE-së, duke përfshirë propozimet për legjislacion të ri, legjislacionin e miratuar rishtas si edhe jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian;
- informojnë rregullisht stafin përkatës në ministritë e linjës, shërbimet e ekspertëve pranë parlamentit si edhe autoritetet e tjera përgjegjëse për ndryshimet më të fundit në *acquis* të BE-së;
- analizojnë periodikisht kapacitetet institucionale në fushat relevante dhe bëjnë rekomandimet përkatëse;
- përcaktojnë prioritetet dhe monitorojnë zbatimin e planit për përkthimin e *acquis* të BE-së; identifikojnë prioritetet strategjike dhe nevojat në lidhje me procesin e integritimit evropian për të formuluar propozime për asistencë nga BE-ja dhe donatorë të tjerë, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Integritimit Evropian dhe departamentin përgjegjës pranë Këshillit të Ministrave, si edhe hartojnë dhe i japin rekomandime Komitetit të Koordinimit Ndërinstitucional për Integrimin Evropian (KNIE);

Secili grup kryesohet nga zv/Ministri i ministrisë kryesore për kapitullin përkatës dhe të koordinohet nga Drejtori i Njësisë së Integritimit Evropian e asaj ministrie. Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian përbëhen nga përfaqësues të Kryeministrisë, ministrive të linjës, institucioneve të tyre të varësisë dhe institucioneve publike sipas fushës së *acquis* të BE-së. Pavarësisht nga kapitulli i *acquis*, përfaqësuesit e Ministrisë së Integritimit Evropian dhe të Ministrisë së Financave marrin pjesë në mbledhjet e të gjitha GNP-ve.

Urdhri nr. 107 parashikon se GNP-të për Integrimin Evropian duhet të mbajnë takime të rregullta mujore që të analizojnë zhvillimet dhe të vendosin për kursin e veprimit. Grupet e punës mund të takohen edhe jashtë radhe (*ad hoc*), nëse është nevoja.

Sekretariati i GNP përbëhet nga anëtarët e institucionit kryesor për çdo kapitull të *acquis*. Përgjegjësitë e Sekretariatit të GNP përfshijnë asistencë teknike dhe rrjedhjen e informacionit brenda GNP-së.

2.2 Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2014-2020

Urdhri nr. 108, datë 28.02.2014 “Për hartimin dhe rishikimin e Planit Kombëtar për Integrim Evropian 2014-2020” jep bazën ligjore për përgatitjen e Planit Kombëtar për Integrim Evropian (PKIE). Përgatitja e Planit u nis nga Komiteti Ndërmistror për Integrimin Evropian (KNIE) në mbledhjen e saj të 3 marsit 2014. Më 6 mars 2014, Ministri i Integritimit Evropian thirri KKNIE-n për të dhënë udhëzime të hollësishme mbi hartimin dhe afatet e PKIE-s.

Plani Kombëtar për Integrim Evropian 2014-2020 shërben si bazë për planifikimin e procesit të integritimit evropian të Shqipërisë. Plani është përgatitur në përputhje të plotë me planin vjetor të punës të Qeverisë dhe, kur të përditësohet, do të jetë plotësisht në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim që do të miratohet në dhjetor 2014, si dhe me strategjitë e tjera kombëtare dhe sektoriale.

Përgatitja e Planit Kombëtar për Integrim Evropian 2014-2020 dhe përditësimet vjetore të tij koordinohen nga Ministria e Integritimit Evropian në bashkëpunim me GNP-të. I takon Ministrisë të Integritimit Evropian të japë orientime dhe metodologjinë për përgatitjen dhe përditësimet vjetore të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian zëvendëson Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

PJESA 2 - Kriteret Politike dhe Ekonomike

1. KRITERI POLITIK

Interesi kryesor kombëtar dhe qëllimi strategjik i Qeverisë së Republikës së Shqipërisë është anëtarësimi në BE. Kriteret e anëtarësimit kërkojnë – stabilitetin e institucioneve që garanton demokracinë, shtetin e së drejtës dhe zbatimin e parimeve demokratike dhe të drejtat e njeriut, e drejta ndërkombëtare dhe ekonomia funksionale e tregut - janë themelet e politikës së brendshme dhe të jashtme shqiptare.

Në përmbushjen e detyrimeve të veta të marra përsipër në kuadër të Procesit të Stabilizim-Asociimit, Shqipëria vazhdon të përmbushë parakushtet politike të theksuara nga BE si kriter të gatishmërisë së saj politike dhe dëshirës së saj për t'u bërë anëtare e familjes evropiane.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë është e vetëdijshme se përmbushja e kriterëve kryesore politike është e një rëndësie themelore në procesin për t'u bërë anëtar i BE-së, dhe për këtë arsye është e vendosur të bëjë përpjekje shtesë në reformën e saj gjyqësore, politikat anti- korrupsion, luftën kundër krimit të organizuar, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe në administratën publike.

1.1 Demokracia dhe Shteti i së Drejtës

Qeveria shqiptare është plotësisht e angazhuar të ndërmarrë dhe të zbatojë të gjitha reformat e nevojshme për të forcuar procesin legjislativ, sistemin zgjedhor, qeverinë qendrore dhe lokale, administratën publike, si dhe sistemin e drejtësisë.

Përveç kësaj, Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë janë të angazhuar për marrjen e masave të veçanta për të siguruar funksionimin e duhur të Parlamentit. Këto masa do të bazohen në dialogun politik konstruktiv mes të gjitha partive dhe ndërveprimin me institucionet e pavarura me synimin për të përmirësuar funksionet rregullatore dhe për të siguruar transparencën e procesit legjislativ, si dhe forcimin e kapaciteteve administrative të Parlamentit në mënyrë që të rritet roli i tij mbikëqyrës, për të zbatuar detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja gjatë periudhës para anëtarësimit në BE.

Qeveria shqiptare është e angazhuar për një reformë të vërtetë të administratës publike, për trajtimin dhe vlerësimin bazuar në merita, në krijimin e një rrjeti institucional efektiv dhe eficient për punonjësit e saj, në ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët. Qeveria shqiptare ndjek objektivin përfundimtar të krijimit të një administrate publike eficiente, të aftë për zbatimin e plotë të angazhimeve dhe detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Çdo veprim që duhet të ndërmerret nga Qeveria shqiptare në kuadër të reformimit të sistemit të drejtësisë dhe shtetit të së drejtës, ka për qëllim final krijimin e një sistemi të drejtësisë të pavarur, të përgjegjshëm dhe eficient në Shqipëri, i cili është në gjendje të japë drejtësi në mënyrë të drejtë dhe transparente, si dhe të zbatojë legjislacionin e përafuar me *acquis* të BE-së.

Lufta kundër korrupsionit është prioritet kyç për qeverinë e Shqipërisë. Drejtimet kryesore të politikës anti-korrupsion përfshijnë një seri veprimesh për parandalimin e fenomenit, forcimin e institucioneve, monitorimin e përgjithshëm edhe nga organizatat e shoqërisë civile dhe dënimin administrativ dhe penal të zyrtarëve të korruptuar. Miratimi dhe zbatimi i strategjisë anti-korrupsion kontribuon në reduktimin e qëndrueshëm të fenomenit të korrupsionit.

Veç kësaj, Qeveria shqiptare është e angazhuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë për të zbatuar më tej një strategji të anti-diskriminimit, përmirësimin e gjendjes me të drejtat sociale, me fokus të veçantë te grupet vulnerabel dhe të miturit. Reformat në fushën e të drejtave të pronësisë dhe në veçanti plani i veprimit për zbatimin e vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (ECHR) për kthimin dhe kompensimin e pronave do të jenë pjesë e prioriteteve afatshkurtra dhe afatmesme.

Fokusi i punës së Qeverisë shqiptare ka qenë zbatimi i detyrimit që rrjedh nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe në mënyrë të veçantë adresimi i rekomandimeve të Raportit të Progresit 2013 të

Komisionit Evropian. Qeveria shqiptare është plotësisht e angazhuar për të adresuar 5 prioritetet e tjera kyçe të Opinionit të Komisionit Evropian për të marrë statusin e kandidatit dhe të hapë negociatat e pranimit me BE. Udhërrëfyesi, që do të përmirësojë reformat në fushat e mësipërme kyçe të kriterit politik, u miratua nga Qeveria më 28 maj 2014.

1.1.1 Zgjedhjet

Korniza ligjore për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike në Shqipëri është miratuar me Ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998, ndryshuar me Ligjin Nr. 9904, datë 21.04.2008, dhe Ligjin Nr. 9675, datë 13.01. 2007; së bashku me Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin Nr. 10019, datë 29.12.2008; Ligjin Nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organi kryesor që siguron zbatimin e duhur të kuadrit ligjor të zgjedhjeve dhe aktualisht ka 55 të punësuar, 7 anëtarë dhe 48 punonjës të administratës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ngre Komisionin e Zonës së Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe Komisionin e Qendrës së Votimit (KQV). KZAZ-të dhe KQV-të përbëhen nga shtatë anëtarë, të cilët propozohen nga partitë parlamentare të shumicës dhe opozitës.

Pavarësisht përmirësimeve të bëra gjatë viteve, dhe në veçanti në zgjedhjet e përgjithshme të 2013, procesi zgjedhor në Shqipëri ka nevojë për përmirësime të mëtejshme. Për zgjedhjet e ardhshme vendore të vitit 2015, institucionet relevante janë të angazhuara të adresojnë rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it; rritje e mëtejshme e pavarësisë së administratës zgjedhore në të gjitha nivelet; përmirësimi i efikasitetit dhe transparencës së veprimeve të KQZ-së, të sigurohet botimi i akteve në kohën e duhur; të përmirësohet përputhshmëria e kuadrit ligjor ekzistues; si dhe rritje të kapaciteteve të administratës zgjedhore.

1.1.2 Parlamenti

Shqipëria është Republikë Parlamentare. Parlamenti, si organi më i lartë legjislativ që shqyrton dhe miraton legjislacionin, luan një rol themelor në funksionimin e sistemit demokratik. Përveç funksionit legjislativ, Parlamenti ushtron kontroll politik ndaj qeverisë dhe monitoron zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Përafrimi i legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian është një aspekt kyç i punës së tij.

Funksionimi i Kuvendit rregullohet me Kushtetutë dhe Rregulloren e Punës së këtij institucioni. Komisioni Parlamentar për Integrimin Evropian është organ kyç për monitorimin dhe shtyrjen përpara të reformave të kërkuara dhe plotësimin e rekomandimeve në kuadër të procesit të integritetit evropian të Shqipërisë. Për më tepër, Ministri për Marrëdhëniet me Parlamentin vepron nga ana e qeverisë për të koordinuar më mirë reformat dhe iniciativat legjislative midis pushteteve ekzekutive dhe legjislative.

Pavarësisht përmirësimeve të dukshme në funksionimin e Parlamentit gjatë viteve, ai ende përpaket për forcimin e mëtejshëm institucional, në mënyrë të veçantë në adresimin e vërejtjeve të progres raporteve vjetore të Komisionit Evropian. Puna në këtë drejtim do të përqendrohet kryesisht në prioritetet dhe masat e mëposhtme.

Rritja e transparencës përmes: publikimi i rregullt dhe në kohë i dokumenteve në faqen e internetit pas miratimit nga Konferenca e Kryetarëve; publikimi i rregullt dhe në kohë i agjendave të komisioneve të përhershme të Kuvendit; publikimi i rregullt dhe në kohë i projektligjeve, amendamenteve të propozuara, projektligjeve të miratuara dhe procesverbaleve të takimeve/seancave plenare; organizimi i seancave dëgjimore për projektligjet në interes të palëve të interesuara, si dhe organizimi i takimeve të përbashkëta të komisioneve për të shqyrtuar projektligjet.

Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe grupet e tjera të interesit nëpërmjet: organizimi i takimeve me shoqërinë civile për të identifikuar rrugët dhe mjetet e bashkëpunimit; krijimi dhe përditësimi i një

regjistri unik/gjithëpërfshirës të organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve socialë të akredituar për të ndjekur punimet e Kuvendit; përmirësime të rregullores së punës në lidhje me vendosjen e një afati kohor më të qartë dhe rregullat për qasjen dhe kontributin e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në procesin e konsultimit të Parlamentit; hartimi dhe miratimi i manualit për procedurat dhe mënyrat e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët socialë.

Së fundi, nevojiten përmirësime të mëtejshme të funksionit ligjvënës kushtetues, respektimi në mënyrë rigoroze i afateve dhe dispozitave të tjera të rregullores së punës; forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit, si dhe bashkëpunimi dhe monitorimi i institucioneve të pavarura dhe forcimi i kapaciteteve administrative të Parlamentit.

1.1.3 Qeveria

Qeveria qendrore përcakton vizionin, politikat kryesore dhe propozon legjislacionin për forcimin e demokratizimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e Qeverisë/ Këshillit të Ministrave (i përbërë nga Kryeministri; Zëvendës Kryeministri dhe ministrat e qeverisë) janë të përcaktuara në dispozitat kryesore kushtetuese, si dhe në Ligjin nr. 9000, të datës 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave". Prioriteti kryesor i Qeverisë shqiptare mbetet përsheptimi i reformave dhe përgatitja e vendit për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Kjo do të ndiqet nëpërmjet objektivave dhe masave politike të mëposhtme:

- pjesëmarrje në mënyrë konstruktive në Dialogun e Nivelit të Lartë mes Shqipërisë dhe BE-së për pesë prioritetet e tjera për hapjen e negociatave dhe përsheptimi i reformave përkatëse;
- zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020;
- forcimi i Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj (DPZHFNDH);
- zhvillimi dhe ngritja e strukturave institucionale të nevojshme për fillimin e procesit të shqyrtimit dhe negociatave të pranimit në Bashkimin Evropian;
- garantimi i zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit;
- përmirësimi dhe rritja e efikasitetit të koordinimit dhe monitorimit të procesit të integritit evropian si një element kyç për të përsheptuar procesin e integritit në Bashkimin Evropian;
- përsheptimi i harmonizimit të legjislacionit me *acquis* të BE-së në përputhje me nenin 70 të Stabilizim-Asociimit;
- forcimi i bashkëpunimit me vende dhe vende candidate të rajonit, në kuadër të shkëmbimit të përvojave dhe teknikave për procesin e përafrimit të legjislacionit evropian;
- përsheptimi i përgatitjeve të kapaciteteve njerëzore dhe institucionale për menaxhimin e decentralizuar të fondeve të BE-së;
- zhvillimi i rregullt i takimeve të përbashkëta të institucioneve të BE - Shqipëri, në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (Këshillit të Stabilizim-Asociimit, Komisionit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit për nën-komitetet e Stabilizim-Asociimit);
- përgatitja e një baze të dhënash për legjislacionin e përafruar dhe shkallën e përafrimit, duke siguruar qasje on-line për të gjitha ministratë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore dhe të pavarura;
- seminare për trajnimin dhe forcimin e kapaciteteve për raportimin si dhe përforcimi i njësive të integritit evropian në ministratë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore dhe të pavarura;
- trajnimi i zyrtarëve të administratës publike mbi çështje të integritit evropian;
- trajnimi i mëtejshëm i stafit të Departamentit të Përkthimit dhe Interpretimit të legjislacionit mbi përdorimin e softuerit të specializuar të përkthimit;
- koordinimi i punës për përkthimin e *acquis* të BE-së me autoritetet përkatëse të Qeverisë së Kosovës në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit që është arritur;

- përgatitje për ngritjen dhe akreditimin e strukturave të nevojshme për të përfituar nga asistenca IPA 2014-2020;
- përcjellje të informacionit, ndërgjegjësimi dhe komunikimi me grupet e interesit në lidhje me procesin e integritetit, përfitimet dhe detyrimet që rrjedhin nga marrja e statusit të vendit kandidat dhe të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Qeveria ka rishikuar mekanizmat e koordinimit me synimin për të trajtuar prioritetet e saj kombëtare në kuadrin aktual të marrëdhënieve Shqipëri-BE. Siç është shtjelluar në Pjesën 1 të Planit, me Urdhrin e Kryeministrit nr. 107, datë 28 shkurt 2014, Ministria e Integritetit Evropian, në bashkëpunim me ministritë e tjera të linjës, janë përgjegjëse për përgatitjen në kohë dhe propozimin e masave adekuate që do të sigurojnë zbatimin e shpejtë të kriterëve të tjera politike.

Qeverisja vendore në Shqipëri është e organizuar në dy nivele: a) komunat dhe bashkitë dhe b) qarqet. Baza ligjore për organizimin dhe funksionimin e tij janë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Ligji nr. 8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore"; Ligji nr. 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"; Ligji nr. 8653, datë 31.07.2000, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Njësitet e qeverisjes vendore (NJQV-të) janë përgjegjëse për zbatimin e pjesës më të madhe të legjislacionit të përafër me *acquis* të BE-së, që mbulojnë fusha të rëndësishme të tilla si: infrastruktura dhe shërbimet publike; shërbimet sociale, kulturore dhe sportive; zhvillimi ekonomik lokal; rendi dhe siguria publike; arsimi parashkollor dhe parauniversitar; sistemi i kujdesit shëndetësor parësor dhe mbrojtja e shëndetit publik; kujdesi social; mbrojtja e mjedisit.

Qeveria shqiptare aktualisht është duke kryer një reformë administrative dhe territoriale që ka për synim konsolidimin e administrativ dhe territorial të njësive të qeverisjes vendore, më pak të kushtueshëm dhe më demokratik. Qëllimi është përmirësimi dhe rritja e efikasitetit të shërbimeve publike në nivel vendor, duke ua ofruar ato qytetarëve sa më afër që të jetë e mundur, si dhe forcimi i qeverisjes demokratike vendore. Gjithashtu, për të forcuar njësitet e qeverisjes vendore, qeveria shqiptare është e angazhuar të ndjekë objektivat dhe masat e mëposhtme: të plotësojë dhe të miratojë reformën administrativo-territoriale brenda vitit 2014; të përmirësojë koordinimin ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore, duke krijuar një këshill konsultativ që do të trajtojë në veçanti edhe fushat që lidhen me politikat e BE-së; të thellojë decentralizimin fiskal dhe të miratojë mbështetje buxhetore të synuara për nevojat e zonave të veçanta të vendit; të rrisë performancën dhe transparencën e njësive të qeverisjes vendore dhe të inkurajojë angazhimin në monitorimin dhe raportimin qytetar; të nxisë masat për të luftuar politizimin dhe korrupsionin; të forcojë kapacitetet e stafit të NJQV-ve për politikat dhe legjislacionin që kanë të bëjnë me BE-në në mënyrë që të përmbushin standardet.

1.1.4 Administrata Publike

Reforma e administratës publike është përparësi e lartë për Qeverinë shqiptare, duke përbërë një prioritet kyç për marrjen e statusit të vendit kandidat dhe hapjen e negociatave të pranimit në BE. Në vitet e fundit, administrata publike në Shqipëri ka pësuar reforma të rëndësishme, sidomos nga pikëpamja e bazës institucionale dhe ligjore.

Ligji i ri i Shërbimit Civil i miratuar në vitin 2013 hyri në fuqi më 26 shkurt 2014. Ky ligj përbën një hap të madh përpara për të rritur profesionalizmin dhe meritokracinë dhe për të luftuar politizimin, paaftësinë dhe korrupsionin në një gamë të gjerë të organeve të sektorit publik. Përveç kësaj, që nga shtatori 2013, Qeveria shqiptare ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të hartuar aktet nënligjore të identifikuara si të nevojshme për zbatimin e ligjit të ri të shërbimit civil. Pas një pune intensive dhe procesit konsultativ (me

ndihmën e SIGMA-s dhe Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë), janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi dhjetë akte nënligjore, pas botimit në gazetën zyrtare.

Kanë filluar trajnime intensive për legjislacionin e ri të shërbimit civil për ministritë e linjës, institucionet e pavarura, institucionet vartëse dhe njësitë e qeverisjes vendore. Departamenti i Administratës Publike (DAP) ka përgatitur udhëzimet për zbatimin e rregullave dhe procedurave të procesit, si dhe shqyrtimin e shkëljeve disiplinore (Udhëzimi nr. 01, datë 02.04.2014 "Për elementet kyçe procedurale dhe materiale të procesit dhe shqyrtimi i shkëljeve disiplinore) dhe në hartimin e përshkrimit të punës në shërbimin civil (Udhëzimi nr. 02, datë 07.04.2014 "Për përgatitjen/ hartimin e përshkrimeve të punës në shërbimin civil").

DAP, në bashkëpunim me të gjitha institucionet shtetërore, është duke vlerësuar statusin e shërbimit civil për të gjithë punonjësit publikë. Ky proces po kryhet në lidhje me kërkesat e Ligjit të Shërbimit Civil dhe do të finalizohet në vitin 2014.

Administrata publike ka pësuar reforma institucionale. Një ministri me të drejta të plota për Inovacionin dhe Administratën Publike është themeluar. Ajo është duke punuar për të unifikuar burimet dhe për të ndjekur prioritetet dhe masat kyçe, të tilla si rishikimi dhe miratimi i Strategjisë Ndër-sektoriale për Reformën e Administratës Publike. Gjithashtu, është vendimtar zbatimi i ligjit "Për Shërbimin Civil", që do të mundësohet me miratimin e legjislacionit dytësor. Masat e tjera, në lidhje me kuadrin ligjor, përfshijnë gjithashtu miratimin e ligjit për procedurat e përgjithshme administrative dhe aktet nënligjore për zbatimin e ligjit "Mbi organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore". Do të ndërmerren hapa për përmirësimin e procedurës së rekrutimit në bazë të meritës, emërimit, ngritjes në detyrë në shërbimin civil, dhe shtrirjen e Sistemit informatik të menaxhimit të burimeve njerëzore/HRIMS. Funksionimi i duhur i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) dhe pajisja e saj me burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore, si dhe planifikimi i duhur do të jenë gjithashtu në fokusin e reformës.

Në kontekstin e reformës funksionale - strukturore dhe me synimin për të rritur efektivitetin, reduktimin e kostove të shërbimit, rritjen e besimit dhe stabilitetit të institucioneve publike, dhe me krijimin e strukturave të ministrive të reja, janë paraqitur disa risi/inovacione në mënyrë që të sigurohet një qeveri e qëndrueshme me një mentalitet përparimtar, veçanërisht:

- Forcimi i dimensionit të integritetit në BE dhe thithja e kapaciteteve për çdo ministri dhe mbi të gjitha, forcimi i Ministrisë për Integritetin Evropian me një rritje 20% të numrit të stafit.
- Planifikimi/menaxhimi strategjik është përcaktuar si një funksion bazë i çdo ministrie, duke përfshirë edhe qasjen bazuar në rezultat e financimit.
- Krijimi i një Rrjeti Kombëtar të Anti-korrupsionit, duke përcaktuar një Koordinator Anti-korrupsion në nivel zëvendës/ministri për çdo ministri që drejtohet nga Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore.
- Përvetësimi i konceptit të '*njësive raportuese*' nga Britania e Madhe, duke krijuar një rrjet të njësive raportuese për të siguruar fokus të vazhdueshëm për menaxhimin e performancës dhe rezultateve. Një '*njësi raportuese*' është ngritur në secilën ministri dhe drejtohet nga një zëvendës/ministër. Të gjithë nëpunësit civilë të këtyre njësive do të mbështeten dhe trajnohen në *njësine raportuese* të zyrës së Kryeministrit.
- Krijimi i rrjetit "*zyrtar kryesor i informacionit*" në çdo ministri, për të hartuar plane strategjike dhe të teknologjisë së inovacionit, që drejtohen nga Koordinatori Kombëtar - Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

Pavarësia e administratës publike do të forcohet nga: sigurimi i pavarësisë dhe forcimi i kapaciteteve të institucioneve të tilla si Avokati i Popullit, Komisioneri i Shërbimit Civil, Kontrolli i Lartë i Shtetit nëpërmjet miratimit të ligjit të ri "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", që rrit auditimin e jashtëm; duke

siguruar pavarësi ekonomike për Kontrollin e Lartë të Shtetit, nëpërmjet miratimit të buxhetit vjetor të propozuar nga ky institucion; krijimi i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KSHC), i cili do të zëvendësojë Komisionin përkatës, me cilësinë për mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Një objektiv tjetër në kuadër të kësaj reforme është forcimi i kapaciteteve administrative dhe koordinimi i Departamentit të Administratës Publike për të zbatuar me sukses ligjin e ri për Shërbimin Civil. Plotësimi i vendeve vakante të gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë në Gjirokastrë, Vlorë, Korçë dhe Shkodër dhe përfundimi i strukturës organizative të gjykatave administrative me numrin e nevojshëm të punonjësve të administratës gjyqësore, përfshi edhe asistentët ligjorë, përbën një tjetër masë.

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, ASPA, është themeluar në shkurt të 2013. Përsa i përket trajnimit të nëpunësve civil, ASPA ka kryer aktivitetet e trajnimit gjatë periudhës shtator 2013 – prill 2014. Trajnimet u zhvilluan në përputhje me kalendarin e trajnimit të mbështetur nga buxheti i parashikuar dhe në bashkëpunim me projektet e mbështetura nga Bashkimi Evropian (PPF dhe SMEI III). Për të siguruar funksionimin e saj, ASPA ka hartuar një plan trajnimi për vitin 2014, grupet e synuara të përcaktuara, trajnimin e detyrueshëm dhe periudhën e zhvillimit, duke e bërë funksional ambientin e trajnimit dhe godinën e ASPA-s, duke krijuar partneritetin për hartimin dhe zbatimin e kurrikulave të trajnimit për trupën e nëpunësve të nivelit të lartë të drejtimit.

1.1.5 Avokati i Popullit

Posti i Avokatit të Popullit është krijuar me ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar me ligjin nr. 8600, datë 10.04.2000. Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet e paligjshme dhe aktet e parregullta ose mosveprimi nga aktet e organeve të administratës publike, si dhe palëve të treta që veprojnë për llogari të tyre. Avokati i Popullit në mënyrë aktive promovon të drejtat e njeriut, në veçanti ato të grupeve më vulnerabël, dhe bashkëpunon intensivisht me shoqërinë civile. Për të forcuar rolin e Avokatit të Popullit, parashikohen prioritetet dhe masat e mëposhtme:

- informimi i Avokatit të Popullit në kohën e duhur për propozimet përkatëse legislative në mënyrë që të mundësohet dhënia e komenteve;
- përmirësimi i shqyrtimit nga Kuvendi i raportit të konstatimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit;
- mbështetje për institucionin përmes rritjes buxhetore dhe duke iu përgjigjur nevojave të trajnimit.

1.1.6 Shoqëria Civile

Shoqëria civile në Shqipëri përballet me sfida të rëndësishme për të luajtur rolin e saj të plotë në sferën publike. Politikëbërja tradicionalisht jo-përfshirëse, së bashku me inkurajimin kufizuar të vullnetarizmit dhe angazhimit qytetar në shoqëri pengojnë sektorin civil në këtë mision. Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) janë kryesisht të përqendruara në kryeqytet dhe, rrjetet e përgjithshme të organizatave janë të pazhvilluara. Sindikatat janë të dobëta dhe luajnë vetëm një rol të vogël në dialogun trepalësh. Përsa i përket kapitalit njerëzor, burimet janë të kufizuara. OSHC-të në Shqipëri vazhdojnë më tepër të mbështeten në donatorët e huaj. Korniza tatimore e paqartë për organizatat e shoqërisë civile ende përfshin dispozita që minojnë qëndrueshmërinë e tyre financiare, veçanërisht në rimbursimin e TVSH-së.

Qeveria shqiptare është e angazhuar të mbështesë zhvillimin e shoqërisë civile dhe pjesëmarrjen në proceset politike, si dhe në monitorimin në nivel qendror dhe vendor. Në vitin 2009 u themelua Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, e cila ka përfunduar katër thirrje për projekte për dhënien e granteve. Për më tepër, qeveria shqiptare është e angazhuar për të përfshirë shoqërinë civile në mënyrë efektive në procesin e integritetit në BE. Prioritetet dhe masat e mëposhtme parashikohen për të mundësuar konsolidimin e shoqërisë civile në sferën publike shqiptare:

- rishikimi/sqarimi i dispozitave legislative lidhur me kuadrin e taksave dhe TVSH;

- miratimi i projekt-ligjeve për qasjen në informimin dhe konsultimin publik;
- institucionalizimi i rolit të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në procesin e integritetit në BE përmes krijimit të konventës kombëtare për shoqërinë civile;
- rritje e transparencës dhe meritës në mbështetje të projektit nga ana e ASCS;
- asistencë për rritjen e kapaciteteve të OSHC-ve përmes trajnimeve online ASCS;
- asistencë për njësitë e qeverisjes vendore për të siguruar kapacitetet e përshtatshme për bashkëpunimin e duhur dhe financimin e shoqërisë civile.

1.1.7 Sistemi Gjyqësor - (shih gjithashtu kapitullin 23 të PKIE)

Çdo veprim i ndërmarrë nga qeveria shqiptare në kuadër të reformës së sistemit të drejtësisë është i shtyrë nga qëllimi final dhe objektivi për të krijuar një sistem modern të drejtësisë, të aftë për të respektuar parimet e një gjykimi të drejtë dhe të barabartë, për të kontribuar në administrimin e drejtësisë penale, dhe për të zbatuar legjislacionin shqiptar të përafëruar me *acquis* të BE.

Qeveria shqiptare është plotësisht e angazhuar për të zbatuar reformat në sistemin e drejtësisë, të sugjeruara dhe të mbështetura nga partnerët ndërkombëtarë, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e përfshira dhe në përputhje me angazhimet dhe detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (nenet 1, 2, 13, 70 dhe 78 i MSA).

Në vitet e fundit, reforma gjyqësore është udhëhequr nga një Strategji Sektoriale e Drejtësisë i cila do të rishikohet dhe përmirësohet gjatë këtij viti (strategjia e re ndërsektoriale 2014-2020). Një grup-pune është ngritur dhe ka filluar puna për rishikimin e strategjisë sektoriale të drejtësisë. Për të adresuar çështjet kushtetuese të reformës në drejtësi, Ministria e Drejtësisë ka angazhuar Komisionin e Venecias dhe është rënë dakord për një sërë masash që kanë për synim rritjen e pavarësisë, llogaridhënien dhe profesionalizmin e sistemit gjyqësor.

Një nga objektivat në këtë reformë është përmirësimi i sistemit për emërimin, vlerësimin, ngritjen në detyrë dhe transferimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Do të hartohet dhe miratohet një ligj i ri për vlerësimin e gjyqtarëve. Do të bëhen përpjekje për të zvogëluar ngarkesën e çështjeve me anë të ndryshimeve ligjore (rishikimi i procedurës civile dhe kodeve të procedurës penale), si dhe përmirësimi i infrastrukturës dhe burimeve njerëzore të të gjitha gjykatave në Shqipëri. Do të merren masa për të rritur efikasitetin e gjykatës nëpërmjet riorganizimit të brendshëm dhe emërimit në mënyrë transparente të një stafi gjyqësor të trajnuar më mirë, si dhe vendosja e rregullave të qarta për kryerjen e procedurës së përzgjedhjes të stafit gjyqësor, duke marrë parasysh dispozitat përkatëse të Ligjit të Shërbimit Civil. Bërja e Gjykatave Administrative plotësisht funksionale është një nga prioritetet afat-shkurtër, që do të adresohet nga një numër masash të parashikuara për këtë qëllim (kryesisht investim në mjediset e punës së gjykatave administrative të sapo-themelura, së bashku me masat për rritjen e luftës kundër korrupsionit në gjyqësor).

1.1.8 Politikat Anti – Korrupsion - (shih gjithashtu kapitullin 23 të PKIE)

Lufta kundër korrupsionit është një nga prioritetet kryesore të Qeverisë shqiptare. Politikat anti-korrupsion synojnë reduktimin e korrupsionit në mënyrë progresive, duke rritur integritetin e institucioneve dhe promovimin e qeverisjes përmes përmirësimit të shërbimeve publike ndaj qytetarëve, zbatimit të ligjit dhe transparencës. Për shkak të reformave të ndërmarra, Shqipëria ka plotësuar rekomandimet e vlerësimit të tretë të GRECO-s dhe ka pasur një nivel në rritje të vetëdijes për korrupsionin. Pavarësisht të gjitha masave të marra për të reduktuar korrupsionin dhe për të rritur transparencën dhe hetimet, korrupsioni vazhdon të jetë një fenomen i përhapur gjerësisht. Mangësi janë identifikuar përsa i përket bashkëpunimit midis institucioneve dhe në krijimin e mekanizmave të monitorimit dhe hetimeve proaktive bazuar në vlerësimin sistematik të rrezikut, si një parakusht për krijimin e një historiku rezultatesh (*track record*) të ndjekjes efektive penale në të gjitha nivelet,

veçanërisht në ato zona ku ekziston një perceptim i fortë publik për korrupsion. Veç kësaj, qeveria vendore identifikohet si e zbuluar nga politikat anti-korrupsion.

Në këtë kuadër, gjatë gjashtëmujorit të fundit të 2013, janë ndërmarrë një numër masash konkrete për të siguruar llogaridhënien në vullnetin e fortë politik të Qeverisë për të adresuar fenomenin e korrupsionit në vend. Është krijuar institucioni i Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit (Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore¹) si një organ i rëndësishëm në nivel ministror, që do të koordinojë përpjekjet kundër korrupsionit dhe politikave në nivel kombëtar. Forumi konsultativ mbi politikat kundër korrupsionit, i përbërë nga koordinatorët anti-korrupsion në nivel ministror, pikat e kontaktit në institucionet e pavarura, si dhe përfaqësues të nivelit vendor, OJQ-të, komuniteti i biznesit dhe bashkësia ndërkombëtare do të shërbejnë si organ i politikave dhe monitorimit të dokumenteve, si dhe veprimet e ndërmarra nga KKK. Krahas krijimit të KKK dhe organit konsultativ, kanë filluar të zhvillohen dy procese të rëndësishme: a) hartimi i strategjisë kombëtare kundër korrupsionit 2014 -2017 dhe plani përkatës i veprimit dhe, b) rrjeti i koordinatorëve dhe pikat e kontaktit anti-korrupsion si në institucionet e pavarura ashtu dhe ato ekzekutive (përfshi qeverisjen vendore, në nivel prefekturë). Strategjia përfshin një qasje tre-aspektëshe që përfshin: **parandalimin, bindjen dhe ndërgjegjësimin**. Janë parashikuar disa masa legjislative, përfshi atë për mbrojtjen e informatorëve të rasteve të korrupsionit. Në lidhje me statistikën e harmonizuar dhe historikun e rezultateve (*track record*) për çështjet e korrupsionit, grupet e punës të kryesura nga Ministria e Drejtësisë kanë siguruar të dhëna për gjithë vitin 2013 si dhe për tremujorin e parë të vitit 2014. Gjithashtu, do të merren masa konkrete për të përforcuar strukturën institucionale anti-korrupsion dhe koordinimin ndër-institucional, për të përmirësuar efikasitetin e hetimeve dhe kapacitetet e stafit të organeve të zbatimit të ligjit, për të forcuar sistemin e deklarimit dhe kontrollit të pasurive, për të kryer vlerësime sistematike të rrezikut duke u përqendruar në zonat vulnerabel në strategjinë kundër korrupsionit, si dhe për të forcuar rolin e shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit.

Për të rritur kompetencat e Gjykatës së Krimeve të Rënda për të përfshirë luftën kundër korrupsionit, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 21/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, i cili ndryshon nenin 75 (a) duke zgjeruar kompetencën e Gjykatës së Krimeve të Rënda për të përfshirë veprat penale të korrupsionit. Miratimi i amendamenteve të Kodit të Procedurës Penale ka për qëllim finalizimin e reformës për imunitetin dhe kufizimin e kompetencave të Gjykatës së Lartë (për çështjet penale).

1.1.9 Lufta Kundër Krimit të Organizuar

Sfera e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikëve të paligjshme është një nga fushat prioritare të qeverisë shqiptare, si dhe një element shumë i rëndësishëm në përmbushjen e standardeve në kuadër të integritetit të Shqipërisë dhe për marrjen e statusit të vendit kandidat. Lufta kundër krimit të organizuar ka qenë pjesë e 5 prioritetëve kyç të adresuara nga Udhërrëfyesi dhe Raporti i Progresit të Komisionit Evropian të qershorit 2014. Dispozitat MSA-së e detyrojnë Shqipërinë të angazhohet në promovimin e bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët për çështjet që kanë të bëjnë me luftën kundër krimit të organizuar, emigrimit të paligjshëm dhe trafikimit, duke përfshirë në veçanti atë të qenieve njerëzore, kontrabandës, trafikimit të paligjshëm të armëve dhe automjeteve, e të tjera si stabiliteti.

Shqipëria është e angazhuar për të çuar përpara rezultatet pozitive të arritura dhe për të adresuar rekomandimet e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian të vitit 2013. Rezultatet e arritura në vitet e

¹ Krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 1012, datë 22.11.2013 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore"

fundit demonstrojnë përparimin e bërë në bashkëpunim me policinë dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ngritja e kapaciteteve të agjencive të zbatimit të ligjit për të siguruar zbatimin e rreptë të ligjit është prioritet i adresuar në planin e veprimit në vijim. Bashkëpunimi ndër-institucional, si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar i policisë ka vazhduar të japë rezultate të mira në aspektin e operacioneve, arrestimeve dhe hetimeve të përbashkëta, përfshi edhe hetimin e pasurive kriminale. Koordinimi i përpjekjeve anti-trafik në nivel kombëtar është adresuar në një qasje gjithëpërfshirëse, duke përfshirë jo vetëm institucionet shtetërore, por edhe institucionet e pavarura shtetërore, shoqërinë civile dhe publikun e gjerë.

Strukturat shtetërore shqiptare janë plotësisht të angazhuara në forcimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme, duke synuar arritjen e standardeve të kërkuara. Ndryshimet strukturore dhe ligjore në policinë e shtetit dhe në prokurori kanë ndodhur në kuadër të intensifikimit të luftës kundër krimit të organizuar. Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe protokolle me Europol-in, me Italinë dhe Greqinë. Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik (ZKKA) e ka rigjallëruar këtë mekanizëm kombëtar referimi, për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore me një intensifikim të aktiviteteve në fushën e parandalimit dhe rritjes së ndërgjegjësimit të publikut, dhe është duke finalizuar strategjinë e re kombëtare dhe planin e veprimit për 2014-2016. Tre njësi të lëvizshme janë krijuar në Tiranë, Vlorë dhe Elbasan, që ka çuar në rritjen e identifikimeve të viktimave dhe viktimave të mundshme. Janë intensifikuar hetimet për veprat penale kundër pastrimit të parave dhe krimit ekonomik. Qeveria shqiptare po zbaton me sukses planin kombëtar kundër lëndëve narkotike dhe, bashkëpunimi me vendet e tjera ka çuar në rezultate të suksesshme edhe në këtë fushë. Megjithatë, qeverisë shqiptare do t'i duhet të ndërmarrë veprime të mëtejshme për të rritur rezultatet në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar, të tilla si rritja e hetimeve proaktive, duke përdorur teknika të veçanta të hetimit, rritjen e ndërgjegjësimit ndërmjet institucioneve të ndryshme, intensifikimin e bashkëpunimit me vendet fqinje dhe vendet e tjera të BE-së për këto çështje.

1.1.10 Të Drejtat e Njeriut dhe Mbrojtja e Minoriteteve

Shqipëria ka pasur dhe vazhdon të ketë një angazhim të përhershëm në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të standardeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të drejtat e pakicave. Qeveria shqiptare është e angazhuar të marrë të gjitha reformat e nevojshme që do të shërbejnë për trajtimin më të mirë të personave të privuar nga liria, shtetin e së drejtës në vendin e vuajtjes së dënimit, rehabilitimin dhe ri-integrimin e të burgosurve në shoqëri dhe krijimin e një sistemi të sigurtë dhe të efektshëm për të gjithë shoqërinë. Legjislacioni shqiptar, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, ka krijuar ligje dhe rregullore me një numër dispozitash që kanë të bëjnë me trajtimin e të burgosurve dhe të ndaluarve, si dhe zhvillimin e programeve të rehabilitimit social dhe aktivitetet prodhuese për të burgosurit. Në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave sociale, fokusi kryesor i qeverisë në fushën e mbrojtjes sociale, në termin afatshkurtër, është zbatimi i sistemit të mbrojtjes sociale dhe standardeve, duke luftuar përjashtimin social dhe diskriminimin, përmirësimin e legjislacionit në fushën e ndihmës dhe shërbimeve sociale, monitorimin e zbatimit të legjislacionit aktual, si dhe forcimin e kapaciteteve të strukturave të zbatimit të legjislacionit.

Është krijuar posti i Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe po zbatohet një strategji dhe ligj kundër diskriminimit në Shqipëri.

Në fushën e të drejtave të njeriut do të ndërmerren më shumë veprime për të siguruar: zbatimin efektiv dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut mbi ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi; marrja e legjislacionit përkatës për klauzolat e mos-diskriminimit dhe harmonizimi me dispozitat ekzistuese ligjore; forcimi i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, duke krijuar mekanizma të rregullta të kontrollit për Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve (NJMF-të) dhe, duke siguruar alokimin e duhur të buxhetit për funksionimin e NJMF-ve; forcimi i mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje; përmirësimi i koordinimit ndërmjet autoriteteve vendore dhe qendrore, dhe i mekanizmave të monitorimit në kuadër të zbatimit të angazhimeve të

Dekadës Rome dhe rekomandimeve operacionale, si dhe Planin e Masave në vijim të Seminarit për Përfshirjen e komuniteteve rome dhe egjiptiane; Zbatimi efektiv i kuadrit ligjor për të drejtat ekonomike dhe sociale, veçanërisht në lidhje me personat me aftësi të kufizuar dhe masat konkrete lidhur me respektimin dhe mbrojtjen e pakicave. Ndërsa objektivi afatgjatë i qeverisë shqiptare mbetet skema e sigurimeve shoqërore duke reformuar shtyllën e pensioneve publike për të krijuar një lidhje më të drejtpërdrejtë midis kontributeve të paguara dhe përfitimeve të ardhshme, futjen graduale të planeve të përfitimeve suplementare të menaxhuara nga entitetet/njësitë jo publike, krijimi i llogarive personale për secilin kontribuues dhe marrës, duke arritur transparencë maksimale, një skemë dhe sistem që përgatitet për bashkëpunimin me vendet e BE-së (në përputhje me Nenin 99 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit).

Në lidhje me monitorimin dhe raportimin, Shqipëria, veçanërisht MIE do të raportojë në kontekstin e Dialogut të Nivelit të Lartë. Përveç kësaj, raportimi shtesë do të jetë në dispozicion në kuadrin e Këshillit të SA, mbledhjeve të Komitetit dhe kontakteve të rregullta në nivel pune.

1.2 Çështjet Rajonale dhe Obligimet Ndërkombëtare

Shqipëria luan një rol të rëndësishëm dhe konstruktiv në rajon. Interesi i saj kryesor është një rajon i qëndrueshëm ku paqja, marrëdhëniet social-ekonomike dhe kulturore, si dhe marrëdhëniet e qëndrueshme të përfitimit të ndërsjellë me fqinjët të mbizotërojnë. Marrëdhëniet e mira të fqinjësisë dhe bashkëpunimi me vendet e rajonit dhe, në veçanti, me vendet e Ballkanit Perëndimor vazhdon të jetë një nga prioritetet e politikës së jashtme shqiptare, sidomos, pasi është edhe një nga kërkesat kryesore të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit me BE-në. Pas marrjes së detyrës në vitin 2013, qeveria shqiptare theksoi të ketë zero probleme me fqinjët. Qeveria shqiptare do të angazhohet plotësisht në bashkëpunimin me institucionet e specializuara ndërkombëtare dhe vendet e tjera të rajonit, duke qenë shumë aktive në zbatimin e angazhimeve në kuadër të këtij bashkëpunimi.

Gjithashtu, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare, qeveria shqiptare do të angazhohet plotësisht për të rritur bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar, duke iu përgjigjur programeve të partnerëve rajonalë dhe ndërkombëtarë në këtë fushë, në përputhje dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (nenet 1, 2, 4, 13 dhe 81 i MSA-së). Veç kësaj, ajo do të marrë të gjitha hapat e nevojshëm, si në kuadrin ligjor dhe institucional për ta bërë bashkëpunimin më efektiv dhe të plotë në këtë fushë.

Objektivi strategjik i Shqipërisë është që nëpërmjet angazhimit aktiv në të gjitha forumet dhe nismat rajonale të kontribuojë me qëndrime parimore dhe të balancuara për çështje të ndryshme. Nëpërmjet aktivitetit të saj në këto forume rajonale, Shqipëria synon promovimin e zhvillimit ekonomik rajonal përmes projekteve të përbashkëta në fusha të tilla si energjia dhe transporti. Shqipëria vazhdon të llobojë për përfaqësimin e Kosovës në organizatat rajonale dhe nismat që kontribuojnë për paqen, stabilitetin dhe sigurinë në rajon.

Sa i përket bashkëpunimit rajonal, Shqipëria kontribuon në mënyrë aktive për bashkëpunimin rajonal dhe luan një rol të rëndësishëm drejt procesit të pajtimit në rajon. Shqipëria ka marrë pjesë në takimet e të gjitha niveleve në kuadër të nismave rajonale, dmth: SEECp - Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, CEI - Iniciativa e Evropës Qendrore, AII - Iniciativa Adriatik dhe Jon, KBR - Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, BEDZ - Bashkëpunimi Ekonomik i Detit të Zi, MARRI – Iniciativa Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë, dhe më tej, duke qenë e përfshirë në mënyrë aktive në procesin e bashkëpunimit rajonal.

Plotësisht e angazhuar në procesin e bashkëpunimit rajonal, me 1 qershor 2013, Shqipëria mori kryesimin njëvjeçar të Iniciativës Adriatik dhe Jon (AII), e cila përkon me një periudhë vendimtare të procesit të finalizimit dhe shpresojmë miratimin e Strategjisë së re të BE-së për rajonin makro Adriatikut dhe Jon, deri në vitin 2014. Gjatë presidencës prej një viti të IAJ, janë organizuar disa takime dhe tryeza të rrumbullakëta në Shqipëri, me qëllim prodhimin e sinergjive midis IAJ dhe EUSAIR.

Që nga 1 qershor 2014, Shqipëria ka marrë kryesimin një vjeçar të SEECP. Në kryesimin e ardhshëm, së bashku me Rumaninë dhe Maqedoninë, Shqipëria faktikisht përmbush anëtarësimin e Trojkës të SEECP.

Shqipëria do të marrë përgjegjësi më tepër në aspektin e bashkëpunimit rajonal dhe do të rrisë praninë e saj aktive dhe kontributin në iniciativat rajonale.

Qeveria shqiptare do të vazhdojë të marrë pjesë aktive në të gjitha ngjarjet që lidhen me zbatimin e suksesshëm të projekteve (TAP) Gazsjellësit Trans Adriatik - dhe (IAP) Ionian Adriatic Pipeline.

Kur është fjala për marrëdhëniet dypalëshe, Shqipëria do të vazhdojë të marrë në konsideratë marrëdhëniet me Republikën e Kosovës si një prioritet dhe një partneritet strategjik me synimin e rritjes ekonomike, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe përshpejtimin e procesit të integrimit evropian. Do të jetë në fokus zbatimi i efektshëm i marrëveshjeve në shumë aspekte si kulturore, integrimin ekonomik në BE dhe në fusha të tjera midis dy vendeve. Shqipëria do të vazhdojë të mbështesë plotësisht dialogun e vazhdueshëm të nivelit të lartë në mes të Kosovës dhe Serbisë, si dhe promovimin e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së Kosovës në të gjitha nismat rajonale dhe ndërkombëtare.

Marrëdhëniet me **Maqedoninë** karakterizohen nga një nivel shumë i mirë i dialogut politik dhe me kontaktet e shpeshta të nivelit të lartë politik, i cili do të forcohet edhe më tej në frymën e dialogut konstruktiv politik.

Marrëdhëniet me **Malin e Zi** do të vazhdojnë të përbëjnë një bazë solide për marrëdhënie të mira fqinjësore, të zhvilluara përmes një dialogu intensiv politik dhe të bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar.

Progresi pozitiv i marrëdhënieve me **Republikën e Kroacisë** do të vazhdojë edhe në të ardhmen në drejtim të dialogut politik në rritje dhe një bashkëpunimi shumë të mirë dypalësh, veçanërisht në çështje të integrimit evropian.

Shqipëria mbetet e angazhuar për avancimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me **Republikën e Serbisë**, dhe forcimin e bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes të përbashkët.

Zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me **Bosnjë - Hercegovinën**, intensifikimi i dialogut politik dhe kontakte në çdo nivel në të ardhmen është prioritet i politikës rajonale të Shqipërisë.

Përfundimisht, Shqipëria do të vazhdojë të ndjekë intensifikimin e marrëdhënieve me partnerë të tjerë në rajon. Përmirësimi i mëtejshëm dhe zgjidhja e çështjeve të hapura me **Greqinë** do të jetë prioritet për të ardhmen. Intensifikimi i marrëdhënieve ekonomike dhe shkëmbimeve me **Italinë dhe Turqinë** mbeten gjithashtu vendimtare për zhvillimin e Shqipërisë.

2. KRITERI EKONOMIK

Ky seksion i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian jep një vlerësim dhe tablo të punës, arritjeve dhe përparimit të Shqipërisë në zbatimin e reformave ekonomike, si parakusht për përmbushjen e kriterëve të Kopenhagenit. Gjithashtu, këtu vihet theksi te prioritetet për periudhën në vijim, me qëllim forcimin e konkurrueshmërisë dhe funksionimit të ekonomisë së tregut. Që Shqipëria të integrohet me sukses në BE, është tepër e rëndësishme që të zbatohen plotësisht reformat e nevojshme ekonomike, politike dhe institucionale.

Aderimi në Bashkimin Evropian kërkon përgatitje efikase dhe përshtatje të ekonomisë shqiptare. Reforma e sistemit ekonomik bazohet në një numër dokumentesh strategjike të hartuara në sinkronizim me rekomandimet dhe konstatimet e Komisionit Evropian. Kështu, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020 që është planifikuar të miratohet në dhjetor 2014, përcakton përmirësimin e infrastrukturës bazë dhe krijimin e një kuadri biznesi favorizues si parakushte për forcimin e konkurrueshmërisë. Strategjia konfirmon objektivin e Qeverisë shqiptare për krijimin e një ekonomike më dinamike dhe konkurruese, e aftë të garantojë rritje ekonomike të qëndrueshme dhe kohezion social. Një ekonomi moderne dhe, rrjedhimisht, zhvillimi ekonomik në vetvete, kërkojnë investime në kapital njerëzor, zbatimin e suksesshëm të reformave në sistemin arsimor dhe lidhje më të mirë shkencore me

reformat e tregut të punës, si edhe nxitjen e sipërmarrjes dhe novacionit për të forcuar konkurrueshmërinë.

Objektivat makroekonomikë kryesorë të Qeverisë në planin afatmesëm janë:

- Rritja dhe zhvillimi ekonomik shoqëruar me rritjen e standardit të jetesës;
- Rritja e punësimit dhe kohezionit social
- Rritja e konkurrueshmërisë së ekonomisë për të garantuar pjesëmarrje të barabartë të Shqipërisë në tregun evropian.

Parakushtet kryesore për arritjen e këtyre objektivave janë vijimi i rritjes ekonomike dhe përmirësimi i kushteve për rritje të qëndrueshme në planin afatgjatë. Një tjetër çështje e rëndësishme është edhe realizimi i reformave strukturore në ekonomi, përkrah ruajtjes së stabilitetit të çmimeve dhe të kursit të këmbimit. Këto objektivat arrihen me investime në infrastrukturë, vazhdimin e procesit të liberalizimit dhe privatizimeve, uljen e deficitit fiskal dhe borxhit publik (të brendshëm dhe të jashtëm), mbështetjen e sektorëve eksportues dhe investimeve të huaja direkte, si edhe me një politikë fiskale të favorshme për biznesin. Sidoqoftë, zbatim i reformave ekonomike duhet të shoqërohet me reforma cilësore në administratën publike dhe sistemin ligjor.

2.1 Ekonomia e tregut funksionale

Ekonomia e tregut funksionale është e para mes kritereve ekonomike të Kopenhagenit dhe përfshin:

- arritjen e stabilitetit makroekonomik, duke përfshirë stabilitetin adekuat të çmimeve dhe qëndrueshmëri të financave publike dhe bilancit të jashtëm të pagesave;
- ekuilibrin mes kërkesës dhe ofertës bazuar në ndërveprimin e lirë të forcave të tregut, çmimeve dhe liberalizimin të tregtisë;
- eliminimin e barrierave të qenësishme ndaj hyrjes dhe daljes nga tregu (në aspektin e krijimit të shoqërive të reja ose falimentimit të atyre ekzistuese);
- ekzistencën e sistemit ligjor, duke përfshirë edhe rregullimin e të drejtave të pronësisë, si edhe imponimin e zbatimit të ligjeve dhe kontratave;
- konsensusin e gjerë për çështje kyçe të politikave ekonomike;
- sektorin financiar të zhvilluar mjaftueshëm për të kanalizuar kursimet drejt investimeve produktive.

Vlerësimi fillestar i Ministrisë së Financave në 2013-n konfirmoi rritjen ekonomike të dobët dhe presionin e ulët inflacionist. Kërkesa agregate e dobët pasqyron pasigurinë e përgjithshme, rikuperimin e ngadaltë të kredive, shkallën e lartë të papunësisë, si edhe ndikimin e mjedisit të jashtëm. Sipas Bankës Botërore (prill 2014), rritja reale e kërkesës së brendshme ka qenë -0.6% gjatë vitit 2013.

Ekonomia shqiptare ka themele të shëndosha ekonomike dhe financiare, pavarësisht kontekstit sfidues makroekonomik. Inflacioni ka qëndruar në nivele të ulëta gjatë gjysmës së parë të këtij viti, për shkak të presioneve inflacioniste të dobëta dhe pritjeve të ankoruara për inflacion. Duke pasur parasysh mjedisin me inflacion të ulët, Banka e Shqipërisë pati hapësira manovrimi për politikën e saj monetare. Për të rritur aksesin në financim dhe likuiditetin, Banka e Shqipërisë e moderoi politikën monetare duke ulur normat e interesit në 2.75% në shkurt 2014.

Sipas publikimit të fundit të INSTAT-it, rritja ekonomike në tremujorin e katërt të 2013 ka qenë 11%. Ekonomia shqiptare pritet të rimëkëmbet gradualisht gjatë vitit 2014. Rritja ekonomike për vitin 2014 është parashikuar të jetë 2.1%, ndërsa parashikimi për 2015 është 3.3% (Banka Botërore). Me pagesat e

detyrimeve të prapambetura ndaj biznesit, qeveria po injekton likuiditet në ekonomi dhe po nxit rritjen ekonomike.

2.1.1 Prodhimi i brendshëm bruto

Prodhimi i brendshëm bruto (PBB) u rrit me 1.1% gjatë tremujorit të fundit të vitit 2013, pas rënien prej 2.5% në tremujorin e tretë. Rritja tremujore ishte 2.3%, duke kapur vlera pozitive pas tkurrjes prej 2.1% që pësoi gjatë tremujorit të tretë të 2013.

Kjo rritje i atribuohet kryesisht sektorit të industrisë dhe tregtisë, performancës së hotelërisë dhe restoranteve që kontribuuan me 0.8 pikë përqindjeje secila në normën vjetore të rritjes së PBB-së. Sektori i shërbimeve vazhdoi ngadalësimin, duke kontribuar negativisht me 0.7 pikë përqindjeje në rritjen ekonomike. Performanca e fortë e sektorit të industrisë është mbështetur kryesisht nga industria përpunuese. Bujqësia shënoi rritje prej 1.2%, duke kontribuar me 0.2 pikë përqindjeje në rritjen ekonomike, ndërsa sektori i ndërtimit u rrit me një normë prej 3.7%, duke iu kthyer vlerave pozitive pas rënies me 11.0% në tremujorin pararendës. Rënia e dinamizmit të sektorit të shërbimeve u pasqyrua në ngadalësim të aktivitetet në grupet “Shërbime të tjera” dhe “Transporti”.

Qeveria nënshkroi marrëveshje me FMN-në e Bankën Botërore. Këto marrëveshje jo vetëm injektojnë likuiditet në ekonomi, por kontribuojnë edhe në konsolidimin fiskal dhe menaxhimin e shëndoshë të financave publike, si edhe mbështetin reformat strukturore në sektorë kyçë si energjetika, ndërkohë që monitorojnë qëndrueshmërinë e borxhit publik. Programi trevjeçar me FMN-në përqendrohet në rritjen ekonomike dhe konsolidimin fiskal. Gjatë këtyre tre viteve, qeveria shqiptare do të fillojë uljen e borxhit publik nga 73% që është aktualisht, në 65% të PBB-së deri në vitin 2017.

Në vlerësimin e fundit, FMN theksoi se programi është në rrugën e duhur. Bazuar në këto premisa, *Standard and Poor's* e përmirësoi vlerësimin për borxhin e Shqipërisë nga “negativ” në “stabël”.

Kërkesa agregate e dobët rezultoi në normë të ulët të rritjes ekonomike dhe mbeti nën potencialin e ekonomisë shqiptare. Kjo u shoqërua edhe me rritje të dobët të punësimit dhe pagave, gjë që ushtroi më pak presion inflacioniste. Inflacioni mesatar vjetor ishte 1.9% në vitin 2013. Pritshmëria për inflacionin mbetën të ankoruara, duke pasqyruar politikën monetare të matur dhe transparente që ka ndjekur Banka e Shqipërisë, si edhe përmirësimin e komunikimit të BSh-së me publikun. Gjithashtu, masat e ndërmarra kanë ndikuar në monitorimin e primeve të rrezikut të likuiditetit dhe në uljen e normave të interesit në ekonomi. Përmirësimi i deficitit të llogarisë korrente, stabiliteti i monedhës vendase dhe sektori i shëndoshë financiar e forcuan ndjeshëm stabilitetin financiar.

Kërkesa agregate do të vazhdojë të mbështetet nga rritja e eksporteve dhe performanca e përmirësuar e konsumit dhe e investimeve. Politika monetare do të mbështetë kërkesën e brendshme duke ruajtur stabilitetin makroekonomik dhe duke injektuar stimul monetar në ekonomi. Në reflektim të dinamikës së dobët ekonomike dhe monetare në vend, presionet inflacioniste pritet të jenë të dobëta. kjo gjë do të kërkojë ruajtjen e kahut stimulues të politikës monetare edhe gjatë periudhës afatmesme.

2.1.2 Zhvillimet në lidhje me bilancin e pagesave

Bilanci i përgjithshëm i pagesave në vitin 2013 rezultoi me rritje të mjeteve të rezervës valutore me 104.4 milion EUR (14643.1 milion Lek)². Gjatë kësaj periudhe, llogaria korrente regjistroi një deficit prej

² Të dhënat zyrtare për Bilancin e Pagesave, Rezervat në Valutë të Huaj dhe Borxhin e Jashtëm janë publikuar në euro. Në kllapa, janë të dhënat në monedhën shqiptare. Për të dhënat e Bilancit të Pagesave, është përdorur kursi i këmbimit vjetor Euro/Lek.

1,026.2 milion EUR (143,934.8 milion Lek), duke shënuar rritje me rreth 4.9% në terma vjetorë. Deficiti i llogarisë korrente (pa trasfertat zyrtare) vlerësohet të jetë 10.9% ndaj PBB-së nominale, ose rreth 0.1 pikë përqindje më e lartë sesa viti pararendës. Flukset neto në llogarinë kapitale dhe financiare shënuan rritje dhe financuan 79.4% të deficitit të llogarisë korrente të regjistruar gjatë kësaj periudhe.

Flukset kapitale dhe financiare shënuan bilanc pozitiv me 815.3 milion EUR (114,631.2 milion Lek) gjatë vitit 2013. Suficiti i regjistruar në këtë llogari ishte 4.7% më i lartë sesa në 2012 dhe u vlerësua në rreth 8.4% ndaj PBB nominale. Investimet e huaja direkte (IHD) neto arritën në 893 milion EUR (125,252.2 milion Lek), me 37.8% rritje në terma vjetorë. Kjo performancë u ndihmua nga prurja e IHD-së nga privatizimet e kryera prej qeverisë. Pa të ardhurat nga privatizimet, rritja vjetore në IHD neto ishte 22.2%. Investimet e portofolit rritën aktivet tona të investuara jashtë shtetit me 103.7 milion EUR (14,580.2 milion Lek) gjatë 2013. Llogaria neto e investimeve të tjera regjistroi bilanc negativ prej 21.7 milion EUR (3,043.6 milion Lek) në 2013, nga një bilanc pozitiv prej 83.4 milion EUR (11,697.7 milion Lek). Në total, huamarrja ka rënë me 7.3% në terma vjetorë.

Qeveria po ndjek një politikë të hapur për tërheqjen e investimeve të huaja direkte. Mjaft konferenca promovimesh dhe investimesh janë organizuar në qytetet kryesore të Evropës. Qeveria po harton Ligjin për Investimet Strategjike, me qëllimin kryesor që të investitorët strategjikë, qofshin privatë, publikë apo partneritete publik-privat, që mund të japin ndikim të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit përmes investimeve në sektorë kyç të ekonomisë. Objektivi afatmesëm është rritja e investimeve me rreth 1-1.2 miliard EUR.

2.1.3 Klima e biznesit

- Këshilli Kombëtar i ekonomik është një platformë plotësisht funksionale që institucionalizon diskutimet dhe bashkëveprimet midis institucioneve shtetërore dhe komunitetit të biznesit.
- Memorandum Mirëkuptimi është nënshkruar me BERZH-in për krijimin e Këshillit të Investimeve.
- Procesi i pagimit të detyrimeve të prapambetura ndaj biznesit po ecën normalisht. Është paguar me sukses shuma e borxheve e planifikuar për gjysmën e parë të vitit 2014.
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes po reformohet me mbështetjen e IFC-së, në bazë të treguesve të raportit “Doing Business”, së, me qëllim që të adresojë problematikat që kanë ndikuar në renditjen e vendit në fusha të caktuara. Shqipëria renditej në vendin e 82-të në raportin “Doing Business” të vitit 2013 dhe në vendin e 90-të në vitin 2014.
- *One stop shop për biznesin* po ngrihet në kuadrin e Agjencisë Shqipërisë e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), me qëllim që të lehtësohet më tej hapja e biznesit dhe të ofrohen shërbimet përmes një sporteli të vetëm.
- Drejtoria e Planifikimit dhe Prioritizimit të Investimeve Publike në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, falë bashkëpunimit të ngushtë me Ministrinë e Financave dhe koordinimit me ministritë e linjës, po harton një strategji monitorimi dhe një instrument për investimet publike, në mënyrë që të ketë raporte javore për investime me vlerë mbi 5 milionë euro dhe raporte mujore për investime me vlerë nën 5 milionë euro.

2.1.4 Reformat sektoriale

Reformat sektoriale janë ndërmarrë në bazë të nevojave specifike të sektorëve. Nisur nga rritja e jashtëzakonshme e industrisë së tekstilit dhe këpucëve gjatë 2009-2012, duke u bërë një nga sektorët më të rëndësishëm, Qeveria hartoi një paketë mbështetëse për sektorin e përpunimit të brendshëm (*fason*) pas konsultimit të ngushtë me palët e interesuara (përfaqësues të ministrive të linjës dhe sipërmarrës që punojnë në këtë sektor). Ky sektor punëson rreth 70,000 punonjës dhe përbën gati 30% të totalit të

eksporteve. Ky shembull i suksesshëm i përjasjes nga poshtë-lart do të ndiqet në sektorë të tjerë të ekonomisë me potencial zhvillimi.

2.1.5 Rezervat ndërkombëtare dhe borxhi i jashtëm

Në fund të vitit 2013, stoku i borxhit të jashtëm bruto ishte 5,692.1 milion EUR (798,032.4 milion Lek) në total. Stoku i borxhit u rrit me 175.6 milion EUR (24,619.1 milion Lek) krahasuar me vitin 2012 dhe afërsisht me 30.8 milion EUR (4,318.2 milion Lek) krahasuar me nivelin e shënuar në T3 2013. Në terma vjetorë, borxhi i jashtëm bruto u rrit me 3.2%. Rritja e stokut të borxhit në fund të vitit 2013 u shkaktua kryesisht nga rritja e huamarrjes së qeverisë dhe huaja ndërkompani e lidhur me IHD-në. Të dhënat për 2013 tregojnë se sektori qeveritar përbënte 40.4% të totalit të borxhit të jashtëm. Pjesën tjetër e përbëjnë sektorët e tjerë me 19.0%; bankat 19.6%; investimet e huaja direkte dhe huat ndërkompani 19.6% dhe autoriteti monetar 1.4%.

Në fund të vitit 2013, stoku i rezervave ndërkombëtare (bruto) shënoi 2,015.2 milion EUR (282,531 milion Lek), me rritje 2.2% në terma vjetorë. Për sa i përket mjaftueshmërisë së rezervave, ky nivel rezerve mbulon 4.7 muaj importe dhe 170% të borxhit të jashtëm afatshkurtër.

Të dhënat paraprake tregojnë se, në fund të shkurtit 2014, rezervat e huaja ishin 1,986.5 milion EUR (278,388 milion Lek) dhe mbulojnë vetëm rreth 4.7 muaj importe mallrash dhe shërbimesh.

2.1.6 Kuadri i kursit të këmbimit dhe zhvillimet e fundit

Norma nominale efektive e këmbimit ka shfaqur trend vlerësimi në rritje gjatë vitit 2013. Gjatë kësaj periudhe, kjo normë (NEER) është mbiçmuar mesatarisht me 1.4% në vit, duke pasqyruar kryesisht zhvlerësimin e lehtë të Lekut shqiptar (Lek) kundrejt Euros dhe mbiçmimin e theksuar ndaj Dollarit amerikan (USD).

2.1.7 Papunësia

Gjatë vitit 2013, fuqia punëtore ra me 5.9 pikë përqindje, punësimi u tkurr me po aq, ndërsa numri i të papunëve u rrit me 2.8 pikë përqindje në terma vjetorë. Rritja e punësimit në ekonomi vazhdoi të udhëhiqet nga rritja e punësimit në sektorin privat jobujqësor (+12.1%), ndërsa punësimi në sektorin publik ruajti të njëjtin nivel si në këtë periudhë të vitit pararendës. Punësimi në sektorin e bujqësisë vazhdoi të bjerë në bazë tremujore dhe vjetore, përkatësisht me 14.1 dhe 15%. Statistikat afatshkurtra tregojnë rritje të punësimit në industri dhe shërbime. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2014, shkalla e papunësisë për 15-64 vjeçarët ishte 18.3%, ndërsa papunësia e të rinjve të moshës 15-29 vjeç ishte 31.3%. Shkalla e papunësisë është më e lartë për meshkujt sesa për femrat, përkatësisht 19.6% dhe 16.4% (për grupin 15-64 vjeç).

Papunësia sipas sektorëve të ekonomisë:

Bujqësia, Pyje, Peshkimi	43%
Industria përpunuese	• 8.4%
Ndërtimi	• 6%
Industria nxjerrëse, Uji dhe Energjia	• 2.7%
Shërbime të tregut	• 22.2%
Shërbime jo të tregut	• 17.6%

2.1.8 Pagat

Pagat në ekonomi janë rritur gjatë tremujorit të tretë të vitit 2013. Në krahasim me vitin 2012, ky tregues ishte rreth 2.6% dhe 3.6% më i lartë gjatë 2013. Ecuria e pagave nuk ka qenë e njëjtë në të gjithë sektorët. Rritja reale e pagave është mbështetur kryesisht nga rritja me 3.8% në sektorin e industrisë, nxitur nga nënsektorët e industrisë nxjerrëse dhe prodhimit të energjisë. Pagat reale mbetën të pandryshuara në sektorin e shërbimeve, ndërsa u ulën në sektorin e ndërtimit.

2.1.9 Inflacioni

Trendet e inflacionit pasqyruan mjedisin e përgjithshëm makroekonomik me presione të dobëta inflacioniste dhe pritshmëri të ankoruar për inflacionin. Norma vjetore e inflacionit gjatë vitit 2013 ka qenë mesatarisht 1.5% gjysmën e dytë të vitin 2013 dhe 1.9% në T1 2014, duke qëndruar nën kufirin e poshtëm të tolerancës së Bankës së Shqipërisë.

Dobësia ekzistuese e kërkesës agregate vazhdoi të pasqyrohet në luhatje më të kufizuara të inflacionit. Inflacioni afatgjatë dhe i brendshëm në ekonomi, i matur me komponentët bazë dhe të patregtueshëm neto, ka qenë përkatësisht -0.21% dhe 0.9%, gjatë tremujorit të parë të vitit 2014. Që nga shkurti 2014, inflacioni total³ e ndaloj kurbën rënëse. Të dy komponentët qëndruan në nivele të ulëta dhe nën mesataren historike.

Inflacioni afatshkurtër i materializuar në komponentët jobazë rezultoi në 6.7% në T1 2014, duke pasqyruar paparashikueshmërinë e lartë të çmimeve të produkteve bujqësore dhe kontributin në rritje të disa çmimeve në inflacionin bazë, për shkak të paketës së re fiskale.

Performanca e çmimeve të artikujve ushqimore, kryesisht të papërpunuara, përcaktuan zhvillimet e inflacionit gjatë gjysmës së dytë të 2013 dhe T1 2014. Paparashikueshmëria e çmimeve të artikujve të tjerë të shportës së IÇK kontribuoi lehtë në normën e inflacionit total.

Në tremujorin e parë të 2014, çmimet e ushqimeve të papërpunuara kontribuan me 1.6 pikë përqindje në inflacionin total, duke përbërë rreth 85% të tij. Kjo rritje kontributi në inflacionin e përgjithshëm ka pasqyruar rritjen e çmimeve e nxitur nga kërkesa për eksporte prej tregut të huaj. Ndërkohë, niveli i ulët i inflacionit të ushqimeve të papërpunuara në vendet e rajonit është pasqyruar në inflacion të importuar më të ulët për këtë grup.

Inflacioni vjetër i ushqimeve të përpunuara dhe kontributi i tij në inflacionin total ka qenë negativ, duke shënuar vlerat më të ulëta që në vitin 2009, i ndikuar nga ndërveprimi i favorshëm i çmimeve globale për këto mallra si edhe kursi i këmbimit stabil gjatë kësaj periudhe.

2.1.10 Politika monetare

Norma bazë e interesit u ul gradualisht me 75 pikë bazë në total gjatë fundit të vitit 2013 dhe fillimit të 2014, ku ndërhyrja e fundit në shkurt 2014 shënoi ulje rekord në 2.75%. Vendimet për këto ulje të njëpasnjëshme të normës bazë u nisën nga dobësia dhe trendi rënës i presioneve, si edhe aktiviteti i dobët ekonomik dhe hendeku i prodhimit në vlera negativ gjatë horizontit afatmesëm. Banka e Shqipërisë ka

³ Inflacioni bazë llogaritet si mesatare e thjeshtë matematikore të dy matjeve: përfashtimi permanent i disa artikujve dhe mesatarja e reduktuar (30%).

vazhduar ta furnizojë sistemin bankar me likuiditet të bollshëm përmes instrumenteve kryesorë (REPO) për të garantuar përcjelljen e politikës monetare dhe efëncën e vendimeve të saj në tregjet financiare dhe sektorin real të ekonomisë.

2.1.11 Vlerësimi i miksit të politikës makroekonomike

Gjatë vitit 2013, rritja ekonomike është ngadalësuar ndjeshëm me një vlerësim të rritjes së PBB-së në 0.4%. Politikat makroekonomike janë shtyrë nga nevoja për të mbështetur rritjen ekonomike të qëndrueshme afatmesme. Në procesin e përgatitjes së politikave të përshtatshme, çështjet kyçe kanë qenë ruajtja e stabilitetit të çmimeve të konsumit, borxhit publik dhe sistemit financiar. Duke pasur parasysh se pritshmëria për inflacionin mbetet e ankoruara mirë, politika monetare është lehtësuar me qëllim që të mbështetë rimëkëmbjen ekonomike. Në gjashtë muajt e fundit, norma bazë e interesit është ulur tri herë radhazi nga 3.5% në 2.75%, në përpjekje për të stimuluar kërkesën agregate. Cikli lehtësues është shoqëruar me disa masa të kujdesshme makro të cilat synonin të nxisin kreditimin e ekonomisë. Politikat monetare dhe makro kanë dhënë rezultate pozitive, duke ulur koston e kreditimit në monedhën vendase, si dhe ngadalësim të shtimit të kredive me probleme. Efekti në rritjen e kërkesës agregate ka qenë i dobët, ndërsa përmirësimi këtij komponenti pritet gjatë vitit 2014. Këto vendime kanë peshuar me kujdes ekuilibrin mes riskut dhe stabilitetit financiar. Përveç kësaj, autoritetet janë të angazhuara për zbatimin e rekomandimeve në vijim të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar me FMN-në dhe BB-së, me qëllimin për të forcuar rregullimin mbikëqyrës dhe sistemin financiar në përgjithësi.

2.1.12 Politika fiskale

Politika fiskale ka qenë e shtrënguar. Borxhi i lartë publik imponoi konsolidim fiskal për të ulur borxhin publik nën 60% të PBB-së në planin afatmesëm. Qeveria ka futur tashmë një paketë fiskale që prek kryesisht të ardhurat tatimore dhe administrimin tatimor. Autoritetet janë angazhuar fort për të paguar borxhet e akumuluar gjatë viteve të fundit, duke injektuar likuiditet të freskët në ekonomi. Njëkohësisht, po merren masat e duhura për të parandaluar akumulimin e detyrimeve në të ardhmen. Shqipëria ka nënshkruar me FMN-në një marrëveshje trevjeçare huaje, që pritet ta ndihmojë vendin të plotësojë nevojat financiare, ndërkohë që siguron mbështetjen e duhur për zbatimin me sukses të reformave strukturore. Në këtë aspekt, reformat e planifikuara dhe masat fiskale synojnë të përmirësojnë klimën e investimeve në vend. Të ardhurat pritet të rriten për shkak të ndryshimeve të politikës tatimore dhe përpjekjeve për të përmirësuar performancën e mbledhjes së taksave. Të ardhurat fiskale në maj 2014 ishin 12,748,514 Lek. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2013, të ardhurat fiskale shënuan rritje me 16.49%.

2.1.13 Borxhi publik

Për sa i përket *borxhit publik*, viti 2013 ka qenë vit shumë dinamik dhe sfidues për tregun e brendshëm të letrave me vlerë, në lidhje me financimin e suksesshëm të deficitit të buxhetit relativisht të lartë. Huamarrja e brendshme për vitin 2013 u realizua në nivelin 46,2 miliard Lek, që duhet thënë se ishte tërësisht me instrumente afatgjata. Kjo rezultoi në përmirësim të dukshëm të treguesve të borxhit të brendshëm si dhe në profilin e maturimit. Treguesi i ditëve mesatare të maturimit është vlerësuar 560 ditë krahasuar me 386 ditë në fund të vitit pararendës, duke bërë kështu të mundur uljen e riskut të rifinancimit.

Gjatë vitit 2013, vlen të përmendet diversifikimi i instrumenteve dhe i burimeve të financimit. Për herë të parë është realizuar me sukses emetimi i obligacioneve 10-vjeçare (8.2 miliard Lek) dhe 2-vjeçare në

euro.

Pas sa i përket huamarrjes së huaj, marrëdhëniet me kreditorët ndërkombëtarë kanë qenë mjaft dinamike gjatë vitit 2013 dhe e njëjta pritshmëri ekziston edhe për vitin 2014.

2.1.14 Privatizimi

Procesi i *privatizimit* mbetet prioritet, sidomos në sektorë strategjikë që synojnë tërheqjen e kapitalit të huaj dhe vendas që do të ketë impakt pozitiv në zhvillimin ekonomik. Inventari i pronave publike është verifikuar dhe shpejt do të hidhen *online*, me qëllim që të përmirësohet menaxhimi, transparenca dhe lufta kundër korrupsionit. Procesi i privatizimit konsiston në dy lloje: privatizimet strategjike dhe privatizimet jo-strategjike. Plani i privatizimit për vitin 2014 përfshin shitjen e 10 ndërmarrjeve shtetërore ose shoqëri aksionare me kuota shtetërore, me të dhëna negative ekonomike dhe financiare që vlerësohet të jenë me vlerë rreth 8,34 milion EUR; shitja e paketës shtetërore në 10 ndërmarrje sh.a.; në të cilët shteti zotëron më pak se 50% të aksioneve; privatizimi i aksioneve të mbetura shtetërore të Albtelekom, që planifikohet të ndodhë në tremujorin e katërt të 2014; dhe shitja e paketës së parë të 40 pasurive shtetërore të papërdorura.

2.1.15 Sektori bankar

Për shkak të klimës së dobët ekonomike, institucionet financiare vazhdojnë të përballen me sfida të mëdha që tkurrin përfitueshmërinë dhe rritin riskun e kreditimit. Në të njëjtën kohë, pozita e aftësisë paguese të sektorit bankar ka vazhduar të përmirësohet, si rezultat i rritjes së kapitalit bazë *Tier 1* dhe uljes së aktiveve të ponderuara me risk. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është përmirësuar ndjeshëm. Niveli i mjaftueshmërisë së kapitalit ka arritur 17.96% në dhjetor 2013, nga 16.2% në fund të vitit 2012.

Sektori bankar mbetet segmenti kryesor i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, duke përbërë 91.3% të aktiveve totale të sistemit financiar në fund të vitit 2013.. Sektori financiar jobankar e rriti pjesën e vet në sistemin financiar total, duke përbërë rreth 8.7% në fund të vitit 2013, kundrejt 6.4% në fund të vitit 2012.

Huat: Kreditimi ka vazhduar tkurrjen gjatë vitit 2013 dhe në muajt e parë të 2014, duke ndjekur trendin e ekonomisë dhe ngurrimin e bankave për të kredituar më shumë. Normat vjetore të kredisë ngadalësuan ndjeshëm, duke vazhduar trendin e krijuar nga kombinimi i faktorëve të kërkesës dhe ofertës: në anën e ofertës, bankat kanë qenë më të kujdesshme nisur nga përkeqësimi i cilësisë së kredisë; nga ana e kërkesës, zhvillimet në ekonomi, me ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi gjendjen financiare të bizneseve dhe ekonomive familjare, çuan në rënie të kërkesës për kreditim nga sistemi bankar.

Situata e likuiditetit ka qenë e mirë gjatë vitit 2013 dhe në fillim të vitit 2014, pasi depozitat publike vazhduan të jenë në nivele të kënaqshme. Ato mbulojnë gati gjysmën e shumës të kredisë dhe huamarrja nga jorezidentët është në nivele të ulëta. Depozitat u rritën me 3.4% në bazë vjetore në fund të vitit 2013 dhe me 3.1% në shkurt 2014, duke pasqyruar kthimin e besimit të publikut te sektori bankar.

Sektori bankar duket më i mbrojtur nga risku direkt i tregut, por mbetet i ekspozuar ndaj cilësisë së kreditimit që ndikohet nga lëvizjet e pafavorshme të kursit të këmbimit dhe normave të interesit. Burimi kryesor i riskut për sektorin bankar mbetet risku i kreditit. Banka e Shqipërisë, u ka kërkuar në vazhdimësi bankave adoptimin e strategjive dhe vënien në funksionim të strukturave të përshtatshme për menaxhimin e kredive me probleme. Banka e Shqipërisë ka filuar një projekt, në bashkëpunim me Bankën Botërore për adresimin e kredive me problem, ky projekt konsiston në hartimin e planeve të rimëkëmbjes e të zgjidhjes për kredimarrës apo grupe kredimarrësish individualë, të ekspozuar në disa

banka njëkohësisht, nëpërmjet asistencës së marrë nga kompani të konsulencës me eksperiencë ndërkombëtare në këtë drejtim.

Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë edhe ndryshime ligjore të cilat kanë synuar menaxhim më të plotë të ekspozimeve të mëdha të bankave si dhe fshirjen e kredive të humbura nga portofolet.

Sistemi bankar vazhdoi të shfaqë trend stabil në drejtim të alokimit dhe përdorimit të burimeve financiare. Kjo u reflektua edhe në Indeksin Herfindahl⁴, i cili mat nivelin e përqendrimit në sistemin bankar. Treguesit e përqendrimit për totalin e aktiveve, depozitave dhe kredive - të matur me Indeksin e Herfindahlit - ka mbetur afër zeros, gjë që dëshmon përqendrimin e ulët në sistemin bankar për sa i përket aktiveve, depozitave dhe kredive.

2.2 Aftësia për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda BE-së

Aftësia për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian përbën kriterin e dytë të Kopenhagenit, që përfshin:

- ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale, ku stabiliteti makroekonomik mundëson vendimmarrjen në klimë stabiliteti dhe parashikueshmërie;
- ekzistenca e kapitalit të nevojshëm njerëzor dhe natyror, me kosto të përballueshme, duke përfshirë infrastrukturën (energjetikën, telekomunikacionin, transportin, etj.), arsimin dhe kërkimin shkencor;
- impakti i politikave shtetërore për konkurrueshmërinë përmes tregtisë, konkurrencës, ndihmës shtetërore, si dhe mbështetjes për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
- rritja e përqindjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në marrëdhëniet tregtare me BE-në;
- niveli i integritetit tregtar me Bashkimin Evropian para aderimit (vëllimi dhe struktura e produkteve që tregtohen).

Për të rritur kapacitetin për të përballuar presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda BE-së, forcimi i konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare përbën një nga objektivat kryesorë strategjikë të politikës ekonomike. Prioritetet e Shqipërisë në këtë drejtim janë:

- harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit me *acquis*;
- vijimi i konsolidimit fiskal;
- zhvillimi i mëtejshëm i sektorit financiar;
- promovimi i konkurrencës së lirë dhe sensibilizimi dhe informimi i sipërmarrësve, konsumatorëve, organeve shtetërore dhe autoriteteve të tjera publike, sistemit gjyqësor dhe publikut në përgjithësi;
- zhvillimi uniform dhe i harmonizuar në mbarë territorin e Shqipërisë, rritja e numrit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) si edhe shkalla e impaktit të tyre në PBB;
- harmonizimi i mëtejshëm i politikave dhe programeve të ndihmës shtetërore me legjislacionin evropian në këtë fushë;
- shfrytëzimi i avantazheve krahasuese të Shqipërisë në fushën e turizmit;
- përmirësimi i infrastrukturës energjetike, transportit dhe sistemit të kanalizimeve;
- stimulimi i aplikimit efikas të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare;
- realizimin e reformave kyçe në sistemin e drejtësisë;
- reformimin e sistemit ligjor për çështjet ekonomike (të drejtat e pronësisë, sundimi i ligjit dhe ekzekutimi i kontratave; efektiviteti i gjyqësorit).

⁴ Indeksi varion nga 0 në 1. Vlera e lartë e indeksit (afër 1-shit) do të thotë konkurrueshmëri e ulët dhe anasjelltas.

2.2.1 Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale

Ekonomia e tregut funksionale kërkon që Shqipëria të ruajë stabilitetin e vet makroekonomik, përfshi qëndrueshmërinë e financave publike, të mbajë stabilitetin e çmimeve dhe të bilancit të pagesave, të ketë ekuilibër ndërmjet kërkesës dhe ofertës, të eliminojë barrierat ekzistuese dhe të sigurojë sundimin e ligjit dhe ekzekutimit të kontratave dhe të titujve të pronësisë.

Në vitet e fundit, Shqipëria e ruajti stabilitetin makroekonomik, por ngadalësimi ekonomik rezultoi në tkurrje të deficitit të llogarisë korrente, por disbalancat në sektorin e jashtëm janë ende të mëdha, duke pasqyruar bazën e ngushtë të prodhimit. Shqipëria ka marrë disa masa për të realizuar procesin e privatizimit dhe ka nisur reforma për të adresuar çështjen e të drejtave pronësore.

Edhe pse janë bërë disa përparime në krijimin e një ekonomie tregu funksionale, Shqipëria ka nevojë të konsolidojë financat publike të ulë nivelin relativisht të lartë të borxhit publik, të forcojë më tej qeverisjen, të rritë performancën e tregut të punës, të garantojë të drejtat e pronësisë dhe të forcojnë sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit.

Kapitali njerëzor: Zhvillimi i kapitalit njerëzor dhe tregu i punës funksional janë faktorë kyç që kontribuojnë në rritjen ekonomike, konkurrueshmërinë dhe pozicionin e sistemit ekonomik shqiptar si pjesëmarrës në tregun evropian dhe global. Problemet kryesore me të cilat përballlet Shqipëria dhe që pengojnë realizimin e plotë të kapitalit njerëzor janë: ndryshimet në sistemin e ekonomisë, “bjerrja e trurit” në vitet e fundit, informaliteti dhe mungesa e arsimit dhe sistemit të formimit profesional. Si rezultat, bizneset shpesh përballen me mungesë aftësish që kufizon rritjen e tyre. Megjithatë, kohët e fundit ka pasur disa reforma për të modernizuar sistemin e arsimit dhe forcimit profesional (AFP) dhe për të rritur nivelin e llogaridhënies dhe respektimit të ndryshimeve në tregun e punës.

Në 2013, qendrat publike të formimit profesional ofruan kurse profesionale për punëkërkuesit e papunë dhe njerëzit që kërkonin zgjerim të aftësive profesionale. Në 2013, 9.254 kursantë morën pjesë në 996 kurse trajnimi. Nga këto, 3,896 ishin femra, ose përafërsisht 42%. 5,007 njerëz, ose rreth 54% e pjesëmarrësve ishin të papunë. Në fund të vitit 2013, ishin pajisur me certifikatë 8,884 persona ose 96% e personave të regjistruar. MMSR përfundoi Strategjinë për Punësim dhe Aftësi 2014-2020, e cila u shpall më 26 shkurt 2014. Në të njëjtën kohë, MMSR hartoi edhe planin përkatës të veprimit. Strategjia synon përmirësimin dhe reformimin e sistemit AFP për t’iu përgjigjur më së miri kërkesës së tregut të punës. MMSR në bashkëpunim me Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve hartoi kurrikulat e reja për kurset profesionale bazuar në analizë e tregut.

Shpenzimet publike në arsim llogariten në rreth 3.2% të PBB-së në vitin 2012 dhe mbetën të pandryshuara në buxhetin e 2013. Në fund të T3 2013, shkalla e papunësisë ishte 16.9%, siç është raportuar nga INSTAT. Numri i punëkërkuesve të papunë të regjistruar në zyrat e punësimit ishte 143,901 persona. 51.8% e tyre ishin femra, dhe 60.6% ishin të papunë afatgjatë. Në vitin 2013, numri i të punësuarve nëpërmjet shërbimeve të punësimit ka qenë 12,241, nga të cilët 10,804 ishin të punësuar me ndërmjetësim.

Kapitali fizik: Investimet në infrastrukturë dhe në kapital për NVM-të mbeten parakushtet kryesore për rritjen e konkurrueshmërisë dhe rritjen afatgjatë. Për të arritur konkurrueshmërinë, vëmendje i është kushtuar zhvillimit të sektorit privat. Shqipëria ka ndërmarrë një sërë masash për të promovuar zhvillimin dhe modernizimin e sektorit privat dhe zgjerimin e bizneseve të reja. Me kontribut prej 80% të PBB-së dhe rreth 82% të punësimit, sektori privat përbën lokomotivën kryesore të rritjes ekonomike. Nisur nga struktura dhe përbërja industriale e sistemit ekonomik shqiptar, prioritet i është dhënë zhvillimit të NVM-

ve, kryesisht në promovimin dhe zhvillimin e industrive nxjerrëse dhe përpunuese, si edhe industrisë joushqimore, duke u mbështetur në përdorimin më racional të burimeve vendore.

Raporti i Konkurrueshmërisë Globale (GCR) 2013-2014 i Forumit Ekonomik Botëror e rendit Shqipërinë në pozicionin e 95-të nga 148 vende / ekonomi, me një rënie prej 6 pozicionesh krahasuar me vitin pararendës.

Shqipërinë e përfshinte në grupin e vendeve që janë në fazën e dytë të zhvillimit të konkurrueshmërisë (e quajtur edhe "faza e ekonomive të shtyra nga efikasiteti"). Nisur nga tre dimensionet kryesore (kërkesat bazë, forcuesit e efikasitetit dhe faktorët e novacionit dhe sofistikimit) të Indeksit, Shqipëria mori rezultatin më të lartë në dimensionin e parë "kërkesat bazë" (4.2 pikë) që e renditën në vendin e 94-t. Por, në përgjithësi, Shqipëria renditet poshtë në të tre këto dimensione.

Si faktorët më problematikë për të bërë biznes, ky raport identifikon aksesin në financim, normat e tatimit, korrupsionin dhe rregullimin fiskal.

2.2.2 Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve

Situata aktuale e NVM-ve: Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) luajnë një rol shumë të rëndësishëm në ekonomi, duke siguruar 71% të punësimit zyrtar, edhe pse vazhdojnë dobësitë në mjedisin operacional të tyre. Në sektorin jobujqësor, NVM-të përbëjnë 47% të eksporteve dhe 68% të vlerës së shtuar. Sektori informal i konsiderueshëm mbetet problem dhe pengesë thelbësore për mjedisin e biznesit. Është rritur numri i pajisjeve fiskale (kasat) të instaluar nga bizneset, por duhet të forcohet sistemi për monitorimin e përdorimit të tyre në praktikë. Gjithashtu, është rritur numri i rasteve të dyshuara për korrupsionit të denoncuar në prokurori nga njësitë e hetimit tatimor dhe doganor.

"Doing Business" 2013-2014 e rendit Shqipërinë në vendin e 23-të në botë për lehtësinë e kreditimit. Bazuar në të dhënat e Bankës së Shqipërisë, raporti i kreditimit të sektorit privat ndaj PBB-së ishte 40.2% në dhjetor 2012. Norma vjetore e rritjes së portofolit të huave është rreth 14%.

Sektori bankar përbën mbi 95% të sektorit financiar dhe bankat janë dhënësit kryesorë të fondeve në ekonomi. Për të përmirësuar mjedisin financiar për NVM-të, vitet e fundit janë marrë disa masa në lidhje me futjen e skemave të garancisë së kredive për NVM-të.

Zbatimi i Programit Strategjik për Inovacionin dhe Zhvillimin Teknologjik të NVM-ve, miratuar me VKM nr. 795, datë 7.11.2007, synon të plotësojë hendekun ekzistues në fushën e novacionit duke ndihmuar shoqëritë në procesit e novacionit, duke përmirësuar kapacitetet teknologjike dhe novacionin për të krijuar një sistem që forcon bashkërendimin e institucioneve në mbështetjet të ndërmarrjeve.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe ndërmjetëson për platformën e transferimit ndërkombëtar të teknologjisë për shoqëritë përmes databazës rrjet EEN, me qëllim përmirësimin e konkurrueshmërisë. Shoqëritë zhvillojnë një profil të bazuar në modelin e rrjetit ku ata dorëzojnë një aplikim për një teknologji ose novacion, që të plotësojnë nevojat e tyre për një proces biznesit, hulumtim ose zbatim komercial. Në 2013, AIDA ndihmoi një shoqëri tregtare në përgatitjen e një profili për kërkimin e teknologjisë.

Fondi i Konkurrueshmërisë: Bazuar në VKM nr. 419, datë 15.05.2013 "Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë 2013 – 2015", për këtë program do të përdoren 20 milion ALL në vit për të dhënë grante shoqërive deri në 1 milion ALL, duke mbuluar vetëm 50% të kostos së projektit. Fondi i Konkurrueshmërisë që është pjesë e granteve publike për NVM-të, synon të zhvillojë sektorin e

eksporteve, të përmirësojë cilësinë e produkteve të eksportuara dhe të rritë konkurrueshmërinë e tyre në treg. Ky Fund menaxhohet nga AIDA. Deri në nëntor 2013, janë miratuar gjashtë projekte me një total prej 4.8 milion ALL.

Fondi i Novacionit: VKM nr. 667, datë 28.09.2011 krijoi Fondin e Novacionit me buxhet 40 milion ALL për periudhën 2011-2014. Fondi i zbatuar nga AIDA në formë grantesh që mbulojnë pjesërisht koston, do të ndihmojnë bizneset me 400,000 ALL si subvencione, duke mbuluar 30%-50% të koston së pranuar për ekspertin që auditon nevojat për novacion dhe teknologji, si edhe të evidentojë dhe të inspektojë partnerët teknologjikë të ndërmarrjeve në vendet e tjera. Fondi i Novacionit mbështet shoqëritë që synojnë të identifikojnë dhe të ndërmarrin praktika dhe teknologji të reja. Deri në nëntor 2013 u miratuan shtatë projekte me buxhet total 1.8 milion EUR. Nga këto, gjashtë projekte janë për ekspertin auditues për Teknologjinë dhe Novacionin, si edhe një projekt për teknologjinë e identifikimit dhe inspektimit.

Fondi i Ekonomisë Kreative: VKM nr. 954, datë 9.05.2012 “Për krijimin e Fondit të Ekonomisë Krijues” akordoi 40 milion ALL për periudhën 2013-2016, me synim forcimin e aktiviteteve ekonomike të qëndrueshme dhe hapjen e vendeve të punës, kryesisht në sektorin e artizanatit, duke adresuar këta elementë:

- Zhvillimi i produkteve të reja;
- Marketingu;
- Kualifikimi dhe forcimi i kapaciteteve në sektorin e artizanatit.

Një ndërmarrje mund të përfitojë deri në 500,000 Lek për një projekt. Skema mbulon 60% -80% të shpenzimeve brenda limitit të përcaktuar më lart. Ky fond pritet të ekzekutohet gjatë vitit 2014.

Projekti EDIF: Në kuadrin e projektit EDIF, në vitin 2014 u ngrit EDIF për Ballkanin Perëndimor, me qëllim që të shërbejë si mekanizëm gjithëpërfshirës që promovon NVM-të novatore me potencial rritjeje në rajon, të lehtësojë aksesin në financim dhe të nxitë mobilizimin e investimeve kapitale. Projekti ka katër komponentë:

- Fondi i Novacionit (ENIF) që fokusohet te NVM-të novatore në fazën fillestare të krijimit të tyre;
- Fondi i Zgjerimit (ENEF) që fokusohet në zgjerimin e kapitalit për NVM-të me potencial për rritje dhe zhvillim;
- Instrumenti i Garancisë (GF) në mbështetje të eksessit në kreditim bankar për NVM-të vendore me akses të kufizuar në financim;
- Asistencë Teknike për të mbështetur NVM-të novatore me potencial për rritje dhe për të promovuar krijimin e kapitalit investues (kapitalit të përbashkët).

Shumica e fondeve të projektit do të vijnë nga Programi IPA me Shumë Përfitues (MIPD) 2011-2013, kontributi i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Evropiane e Investimeve (BEI) / Fondi Evropian i Investimeve (EIF) dhe kontributi i secilit vend përfitues.

OECD do të jetë institucioni zbatues i komponentit të asistencës teknike. Në konsultim me OECD-në, prioritetet janë diskutuar në kontekstin e mjedisit rregullator për NVM-të dhe fushat e asistencës teknike, që konsiderohen ndërhyrje të nevojshme dhe që do të prekin zbatimin e Fondit Evropian për Zhvillimin e Ndërmarrjeve dhe Novacionit (EDIF).

2.2.3 Integrimi ekonomik me BE-në

Vëllimi tregtar i Shqipërisë në vitin 2013 arriti vlerën 761,503 milion Lek, me rritje prej 2.7%. Në vitin 2013, vëllimi i përgjithshëm tregtar përbëhej 67.6% nga importet dhe 32.4% nga eksportet. Gjatë kësaj periudhe, eksportet arritën vlerën 246,359 milion Lek, me rritje prej 15.7% dhe importet arritën vlerën 515,143 milion Lek, me rënie 2.5% krahasuar me vitin 2012. Eksportet në fund të marsit 2014 u rritën me 19.14% krahasuar me janarin 2014, ndërsa importet mars 2014 u rritën me 21.26% krahasuar me importet në janar 2014. Përsa i përket volumit të tregtisë, ka rritje më të lartë të eksporteve (rritje 22.51% krahasuar me vëllimin e janarit) krahasuar me importet (rritje 3.13% krahasuar me vëllimin e janarit).

Që me futjen në CEFTA, aktiviteti tregtar i Shqipërisë me vendet anëtare është intensifikuar nga rreth 3% e totalit para vitit 2007, në 8.7% në vitin 2013.

Kategoria “Minerale, naftë dhe energji elektrike” përbën 40.35% të totalit të eksporteve, me rritje rreth 12.9% krahasuar me vitin pararendës. *“Tekstilet dhe veshjet për këmbën”* mbeten një kategori e rëndësishme që zë 28.15% të eksporteve totale, me rritje rreth 3.4% kundrejt vitit pararendës. *“Materialet e ndërtimit dhe metalet”* përbëjnë rreth 14.7% të totalit të eksporteve, me rënie rreth 22.2%, dhe *artikujt ushqimorë, pijet dhe duhani* që përbëjnë 5.9% të totalit të eksporteve, me rënie të lehtë me 1% krahasuar me vitin 2012.

Eksportet e mallrave drejt BE-28 arritën vlerën 188,716 milion Lek, ose 76.6% të totalit të eksporteve, me rritje prej 17.3% në krahasim me vitin pararendës. Importet e mallrave nga BE-28 arritën vlerën prej 330,753 milion Lek, ose 64.2% të totalit të importeve, me rënie prej 1.0 krahasuar me vitin pararendës. Sipas Bankës Botërore, eksportet e Shqipërisë drejt BE-së llogariten të jenë 40% nën potencial. Importet prej BE-së vlerësohet të jenë 33% nën potencial.

Një nga prioritetet kryesore të Shqipërisë në këtë fushë është vijimi i negociatave për të lidhur marrëveshje dypalëshe për mbrojtjen shoqërore, sidomos me Shtetet Anëtare të BE-së. Kuadri ligjor në fushën e sigurimeve shoqërore, për sa i përket lëvizjes së lirë të personave, konsiston në

marrëveshje dypalëshe që bashkërendojnë sistemet e sigurimeve shoqërore të vendeve nënshkruese. Marrëveshjet me Hungarinë, Rumaninë dhe Luksemburgun do të miratohen nga Këshilli i Ministrave gjatë vitit 2014 dhe do të vijohet me procedurën e ratifikimit nga Kuvendi.

MMSR ka shprehur interesin dhe po punon për të shtuar numrin e marrëveshjeve dypalëshe për mbrojtjen shoqërore, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe misionet diplomatike, kryesisht në Itali dhe Greqi, ku jetojnë një numër i lartë emigrantësh shqiptarë.

Negociatat për marrëveshjet me Kanadanë, Republikën Çeke dhe Maqedoninë janë përcaktuar si prioritet afatmesme dhe pritet të finalizohen në tremujorin e parë të 2015-ës.

Edhe Qeveria spanjolle ka shprehur interesin për të nisur negociatat për marrëveshje dypalëshe, propozim ky që është pritur pozitivisht nga Qeveria shqiptare. Shqipëria është e interesuar që të nisë bashkëpunimin me Bullgarinë në këtë fushë. Gjithashtu, Shqipëria po punon që të lidhë marrëveshje edhe me të tjera Shtete Anëtare të BE-së dhe vende evropiane jashtë BE-së, siç është Zvicra.

Janë bërë disa përparime në fushën e lëvizjes së lirë të punëtorëve, sidomos në përmirësimin e aksesit të qytetarëve të BE-së në tregun shqiptar të punës. Në tërësi, përgatitjet në fushën e lëvizjes së lirë të punëtorëve janë në fazë të hershme.

Shqipëria do të vazhdojë përpjekjet për të përafruar më tej legjislacionin me *acquis* dhe ta zbatojë plotësisht. Nismat që synojnë forcimin e kapaciteteve dhe të bashkërendimit ndërinstitucional do të zbatohen më mënyrë konsistente.

IV. Plani i masave për periudhën 2014 – 2016

IV.1 Aksesin në tregun e punës

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	2014-2020

Inventari i masave ligjore ekzistuese

Acquis e BE-së	Legjislacioni shqiptar	Institucioni kryesor	Shkalla e përafrimi	Data e miratimit (legjislacioni shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacioni shqiptar)
Direktiva 2009/50/KE	Ligji nr. 108/2013 “Për të huajt”	Ministria e Punëve të Brendshme	E papërafruar	28.03.2013	20.4.2013

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	2014-2020	Tremujori i tretë, 2014	Tremujori i tretë, 2014

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

Acquis e BE-së	Statusi i përkthimit në shqip (po/jo)	Legjislacioni shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Statusi i përkthimit në anglisht (po/jo)	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Shkalla e synuar e përafrimit (e plotë/ pjesëshme)	Data e planifikuar për miratim	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
s’ka	s’ka	s’ka	s’ka	s’ka	s’ka	s’ka	s’ka
<u>AFAT MESEM (2015 – 2016)</u>							
s’ka	s’ka	s’ka	s’ka	s’ka	s’ka	s’ka	s’ka

IV.2 Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore

IV.2.1 Legjislacioni

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
s'ka	s'ka	s'ka

Inventari i masave ligjore ekzistuese

Acquis e BE-së	Legjislacioni shqiptar	Institucioni kryesor	Shkalla e përafrimit	Data e miratimit (Legjislacioni shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacion shqiptar)
Rregullorja (KE) nr. 883/2004	-	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	E papërafruar	s'ka	s'ka
Rregullorja (KE) nr. 987/2009	-	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	E papërafruar	s'ka	s'ka

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
s'ka	s'ka	s'ka	s'ka	s'ka

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

Acquis e BE-së	Statusi i përkthimit në shqip (po/jo)	Legjislacioni shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Statusi i përkthimit në anglisht (po/jo)	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Shkalla e synuar e përafrimit (e plotë/ e pjesshme)	Data e planifikuar për miratim	Hyrja në fuqi

<u>AFATSHKURTËR (2014)</u>							
s'ka	s'ka	s'ka	s'ka	s'ka	s'ka	s'ka	s'ka
<u>AFATMESEËM (2015 – 2016)</u>							
s'ka	s'ka	s'ka	s'ka	s'ka	s'ka	s'ka	s'ka

KAPITULLI 3: E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e Kapitullit

Legjislacioni i BE-së **për të drejtën e vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime** është i një natyre horizontale i cili mbulon një larmi të madhe të fushave dhe profesioneve si edhe përfshirjen e shumë institucioneve dhe organeve publike. Në përputhje me legjislacionin e BE-së që mbulon këtë kapitull, legjislacioni kombëtar nuk duhet të cenojë të drejtat e përcaktuara të neneve 49 dhe 56 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, me përjashtim të atyre të përcaktuara në Traktat. Pjesa kryesore e *acquis* në këtë fushë është Direktiva 2006/123 (KE) datë 12.12.2006 "Për shërbimet në tregun e brendshëm (Direktiva e Shërbimeve)" e amenduar, e cila përbën masën më të madhe, dhe është e bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës e Drejtësisë e Bashkimit Evropian.

Në fushën e **shërbimeve postare**, është Direktiva 97/67/KE datë 15.12.1997 "Mbi rregullat e përbashkëta për zhvillimin e tregut të brendshëm të shërbimeve postare të Komunitetit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit" e amenduar, dhe përcakton parimet për të siguruar ofrimin e një shërbimi universal postar, krijimin e një tregu të brendshëm për shërbimet postare dhe të shërbimit postar me cilësi të lartë për përdoruesit fundorë.

Në fushën e **njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale**, është Direktiva 2005/36/KE datë 7.09.2005 "Mbi njohjen e kualifikimeve profesionale" e amenduar, që përcakton rregullat në lidhje me njohjen e diplomave dhe kualifikimeve të tjera midis vendeve anëtare. Direktiva gjithashtu lehtëson masat dhe shërbimet e rastit të profesionistëve për disa profesione të tjera të rregulluara që kërkojnë program të përbashkët trajnimi.

I.2 Situata në Shqipëri

Në fushën e **të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve**, Shqipëria garanton të drejtën e vendosjes për kompanitë e themeluara në BE duke u ofruar atyre trajtim të njëjtë si kompanive shqiptare. Në këtë drejtim, është krijuar një grup pune ndërministror si edhe është miratuar një udhërrëfyes për përafrimin e legjislacionit me Direktivën e Shërbimeve. Me qëllim përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së **në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime**, është zhvilluar një plan veprimi, i cili përcakton termat afat shkurtra, afat mesme, afatet e gjata si edhe metodologjinë për shqyrtimin e legjislacionit si dhe mjete të tjera të tilla si pyetësorët, listë kontrolli të

kërkesave të detyrueshme. Për më tepër, janë kryer në mënyrë të vazhdueshme trajnime të rregullta intensive për administratën publike përmes Shkollës Shqiptare për Administratën publike.

Në fushën e **shërbimeve postare** legjislacioni përafrohet pjesërisht me Direktivën 97/67/KE.

Në fushën e **njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale**, Ministria e Arsimit dhe Sporteve është duke punuar për të zbatuar detyrimet e Direktivës 2013/55/EU e cila ndryshon me Direktivën 2005/36/KE “Për Njohjen e Kualifikimeve Profesionale”. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 952 datë 12.12.2012 "Për përjashtimin nga përgjegjësia profesionale për provimin shtetëror në profesionet", përcakton përjashtimin nga përgjegjësia për provimin e shtetit, profesional, i cili ka fituar të drejtën për të ushtruar ndonjë nga profesionet e rregulluara të BE, EFTA dhe vendet me të cilat Shqipëria ka një marrëveshje dypalëshe për këtë qëllim.

I.3 Struktura e kapitullit

1. E DREJTA E THEMELIMIT
2. LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME NDËR KUFITARE
3. SHËRBIMI POSTAR
4. NJOHJA RECIPROKE E KUALIFIKIMET PROFESIONALE

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të BE

Nenet e MSA-së me rëndësi për këtë kapitull janë: 50, 57, 58, 70, 100.

Acquis të BE-së në këtë kapitull përfshijnë, *ndër të tjera*:

- Direktiva 2006/123/KE datë 12.12.2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit “Për shërbimet në tregun e brendshëm”;
- Vendimi i Komisionit 2009/767/KE i 16 tetor 2009 që “Përcakton masat që lehtësojnë përdorimin e procedurave me mjete elektronike përmes pikave të kontaktit të vetëm nën Direktivën 2006/123/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për shërbimet në tregun e brendshëm”;

- Vendimi i Komisionit 2010/425/EU të 28.07.2010 i cili ndryshon “Vendimin 2009/767/KE datë 16.12.2009 përcakton masat që lehtësojnë përdorimin e procedurave me anë të mjeteve elektronike përmes 'pikave të kontaktit të vetëm sipas Direktivës 2006/123/KE të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për shërbimet në tregun e brendshëm, në lidhje me krijimin, mirëmbajtjen dhe publikimin e listave të besuara të ofruesve të shërbimeve të certifikimit të mbikëqyrur / akredituar nga Shtetet Anëtare”;
- Direktiva 2005/36/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 7 tetor 2005 “Mbi njohjen e kualifikimeve profesionale”;
- Direktiva 96/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 dhjetor 1996 “Mbi zhvendosjen e punëtorëve në kuadër të ofrimit të shërbimeve”;
- Direktiva 98/5/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 shkurt 1998 “Për lehtësimin e praktikës së profesionit të avokatit në mënyrë të përhershme në një Shtet Anëtar tjetër nga ai në të cilin është marrë kualifikimi”;
- Direktiva e Këshillit 77/249/KEE e 22 mars 1977 “Për të lehtësuar ushtrimin efektiv nga avokatët lidhur me lirinë për të ofruar shërbime”;
- Direktiva e Këshillit 86/653/KEE e 18 dhjetor 1986 “Mbi koordinimin e ligjeve të Shteteve Anëtare në lidhje me agjentët e vetëpunësuar të nivelit të dytë”;
- Direktiva 97/67/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15 dhjetor 1997 “Mbi rregullat e përbashkëta për zhvillimin e tregut të brendshëm të shërbimeve postare të Komunitetit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit”;
- Direktiva e Këshillit 63/474/KEE e 30 korrik 1963 “Për liberalizimin e transfertave në lidhje me transaksionet e padukshme që nuk janë të lidhura me lëvizjen e mallrave, shërbimeve, kapitalit ose personave”.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore legjislative

1 & 2 E DREJTA E VENDOSJES DHE LIRIA PËR TË OFRUAR SHËRBIME NDËRKUFITARE

Nënkapitujt 1 dhe 2 janë në këtë fazë së bashku për shkak të lehtësisë për t'u kuptuar, në veçanti në lidhje me shfaqjen e legjislacionit sektorial, që do të mbulojë monitorimin për të dy sektorët (1) të drejtën e vendosjes dhe (2) lirinë për të ofruar shërbime.

Sa i përket fushës së të drejtës së themelimit, duhet të theksohet se ka progres në përgatitjet për thjeshtimin e procedurave dhe shkurtimin e procesit për marrjen e lejeve të ndërtimit. Shqipëria nuk ka pjesë horizontale të legjislacionit për të adresuar tërësisht lirinë e lëvizjes së shërbimeve. Progres është bërë në drejtim të krijimit të një kuadri institucional për këtë pjesë të *acquis*. Sa i përket lirisë për të ofruar shërbime ndërkufitare, është ngritur një grup pune ndërministror. Për më tepër, Urdhri i Kryeministrit Nr. 39 të 2013/04/02 "Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e kuadrit institucional për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve " ka ofruar një udhëzues për përshtatjen e legjislacionit të shërbimeve ndërkufitare me Direktivën e Shërbimeve. Për më tepër,

VKM Nr. 264 të 2013/04/03 " Për organizimin e punës për përafrimin e legjislacionit në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve " ka krijuar një metodologji për rishikimin e legjislacionit sektorial në fushën e të drejtës së themelimit dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve. Kjo përfshin një listë të plotë dhe pyetësorët që do të përdoren për shfaqjen e legjislacionit kombëtar .

3. SHËRBIMI POSTAR

Në zbatim të angazhimeve të marra të MSA-së dhe të programit qeveritar për shërbimet postare, me fokus në përafrimin e legjislacionit me *acquis* e Bashkimit Evropian në këtë fushë, është përfunduar kuadri ligjor në fushën e shërbimeve postare. Dokumenti strategjik: Politika e Zhvillimit në Shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë, e miratuar me vendimin Nr. 625, datë 24/07/2013, përcakton liberalizimin e mëtejshëm të tregut të shërbimeve postare nëpërmjet reduktimit të menjëhershëm të zonës së rezervuar nga 100 gram në 50 gram dhe heqjen e zonës së plotë të rezervuar në vitin 2014. Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 711, datë 21/08/2013, zona e rezervuar është reduktuar nga 100 gram në 50 gram. Me Vendimin Nr. 11, datë 20/02/2014 Parlamenti miratoi një strukturë të re të AKEP-it dhe strukturat që përfshijnë rregullimin e sektorit postar.

4. NJOHJA RECIPROKE E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE

Praktikat profesionale të mësuesve të rinj u pasqyruan me Ligjin Nr. 69/2012 të datës 21.06.2012 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligjit nr. 10.171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë". Rreth 855 studentë që kishin mbaruar "Master Profesional" ose "Master Shkencor" në profile të ndryshme të mësuesve, kanë zhvilluar praktikat profesionale.

Provimi i Shtetit është i digjitalizuar tërësisht (kompjuterizuar). Agjencia Kombëtare e Ekzaminimit (AKE), përmes Departamentit të Provimit të Shtetit, është subjekti përgjegjës në nivel kombëtar për zbatimin e provimit të Shtetit. Provimet shtetërore për profesionin e mësimdhënies janë zhvilluar gjatë kësaj periudhe. Për më tepër gjatë tetor-dhjetor 2013 janë zhvilluar provimet e shtetit për profesionet e teknikëve të laboratorëve, mamitë, terapi për të folur, imazheve, infermieri e përgjithshme, stomatologji, fizioterapi, farmaci dhe mjekësi e përgjithshme.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është institucioni kryesor që drejton. Për ta përafruar legjislacionin shqiptar me *acquis* e BE-së mbi të drejtën e vendosjes dhe të lëvizjes së lirë të shërbimeve, është ngritur një grup pune ndër-institucional sipas Urdhrit të Kryeministrit Nr. 39, datë 2013/02/04.

Ajo është e përbërë nga përfaqësues të këtyre institucioneve:

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;

2. Ministria e Energjisë dhe Industrisë;
3. Ministria e Integrimit Evropian
4. Ministria e Arsimit dhe e Sporteve;
5. Ministria për Inovacionin dhe Administratën Publike;
6. Ministria e Drejtësisë;
7. Ministria e Financave;
8. Ministria e Mbrojtjes;
9. Ministria e Brendshme;
10. Ministria e Shëndetësisë;
11. Ministria e Transportit dhe e Infrastrukturës;
12. Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit;
13. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
14. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;
15. Ministria e Mjedisit;
16. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;
17. Autoriteti i Medias Audio-vizuale ;
18. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
19. Banka e Shqipërisë;
20. Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
21. Qendra Kombëtare e Licencimit;
22. Enti Rregullator i Energjisë;
23. Agjencia e Prokurimit Publik;
24. Njësia Monitorimi të Lojërave të Fatit;
25. Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
26. Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
27. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Organizimi institucional në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve përfshin shumë institucione dhe ka tri fusha kryesore: (i) ekipet sektoriale në terren, (ii) ekipi bazë që vërteton çdo raport të sektorit, (iii) grupi ndër-ministral i punës

II.4 Ndarja buxhetore

	2012	2013	2014	2015
Kosto totale	202.233.000	197.000.000	2,083,500	14,000
Mbuluar nga buxheti i shtetit	193.000.000	197.000.000		14,000
Donatorët	9.233.000	0	2,083,500	
Diferenca				

III. Prioritetet

Prioritetet kryesore të kapitullit përfshijnë:

- Përgatitja e një ligji horizontal të përafrimit me Direktivën 2006/123/KE dhe rishikimi i legjislacionit ekzistues sektorial;
- Ekzaminimi i legjislacionit sektorial në përputhje me *acquis* të BE në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime;
- Forcimi i kapaciteteve administrative për të siguruar zbatimin e vazhdueshëm të dispozitave themelore të Direktivës 2006/123/KE;
- Hartimi i një ligji të ri: "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë", i cili do të përafrohet plotësisht me *acquis* të BE-së për shërbimet postare;
- Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë duke e bërë atë në përputhje me standardet evropiane, të qëndrueshme për të fituar besimin e shoqërisë dhe institucioneve kombëtare.

IV. Plani i veprimit për periudhën 2014 – 2016

Kuadri ligjor ekzistues

IV.1 E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime ndërkufitare

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha e referuar
Strategjia e Zhvillimit të Investimeve dhe Biznesit 2014-2020	MZHETS	2014-2020
Plani Kombëtar për zbatimin e MSA-së	MZHETS	2014-2020

Inventari i masave ekzistuese ligjore

<i>Acquis i BE</i>	Legjislacioni shqiptar	Institucioni drejtues	Shkalla e përafrimit (të plotë / të pjesshme / jo e-përafruar	Data e miratimit (legjislacionit shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacioni shqiptar)
Direktiva 2006/123/KE	1. Ligji Nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara”	MAS	I pjesshëm	22.10.2009	22.10.2009
	2. Ligji Nr. 10081 datë 23.02.2009 për licencat, autorizimet dhe lejet	MZHETS	I pjesshëm	23.02.2009	23.02.2009
	3. Ligji Nr. 9723, datë 03.05.2007 për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit	MZHETS	I pjesshëm	03.05.2007	07.06.2007

Korniza e kuadrit ligjori e planifikuar në periudhën 2014 – 2016

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Plani Kombëtar i zbatimit të MSA-së 2020	MZHETS	2014-2020	Tremujori i parë 2014	Tremujori i dytë 2014

Masat ligjore e planifikuara në 2014 – 2016

<i>Acquis të BE</i>	Statusi i përkthimit në shqip (po/jo)	Legjislacioni shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Statusi i përkthimit në shqip	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (e plotë / përafrim i pjesshëm)	Data planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
Direktiva 2006/123/KE	PO	Ligji për ofrimin e shërbimeve në Shqipëri	JO	MZHETS	I pjesshëm	Tremujori i III i 2014	Tremujori i II i 2015
<u>AFAT MESME (2015 – 2016)</u>							

n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.2 Shërbimi postar

Kuadri ligjor ekzistues

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha
Politika e Zhvillimit në Shërbimin Postar në Republikën e Shqipërisë	MIAP	2013-2017

Korniza ligjore ekzistuese

Acquis e BE	Legjislacioni shqiptar	Institucioni drejtues	Niveli i përafrimit (i plotë/pjesor/ jo i përafuar)	Data e miratimit (legjislacioni shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacioni shqiptar)
Direktiva 97/67/KE	Ligji Nr. 8530, datë 23.09.1999 "Në shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë"	MIAP	I pjesshëm	23.9.1999	05.10.1999

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore për periudhën 2014 – 2016

Acquis të BE-së	Statusi i përkthimit në shqip (y/n)	Legjislacioni shqiptar	Statusi i përkthimit në shqip (y/n)	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (përputhja e plotë / e pjesshme)	Data planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi

<u>AFATSHKURTËR (2014)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
<u>AFATMESME (2015 – 2016)</u>							
Direktiva 2008/6/KE	N	Ligji "Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë"	N	MIAP	I plotë	Tremujori I II i 2015	Tremujori I III i 2015

IV.3 Njohja reciproke e kualifikimeve profesionale

Kuadri ligjor ekzistues

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha
Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar	MAS	2009-2013
Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë	MAS	2008-2013

Kuadri ligjor ekzistues

Acquis i BE	Legjislacioni shqiptar	Institucioni drejtues	Niveli i synuar i përafrimit (përputhja e plotë / e pjesshme)	Data e miratimit (legjislacioni shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacioni shqiptar)
Direktiva 2005/36/KE	Ligji Nr. 10171 datë 22.10.2009 " Për rregullimin e profesioneve, i ndryshuar".	MAS/ Agjencia Kombëtare e Provimeve	I pjesshëm	22.10.2009	22.11.2009
Direktiva 2013/55/BE	Vendimi Nr. 952, datë 12.12.2012 " Për përjashtimin nga përgjegjësia profesionale për provimin e shtetit për profesionet".	MAS / Agjencia Kombëtare e Provimeve	I pjesshëm	12.12.2012	12.12.2012

Masat ligjore për periudhën 2014 – 2016

Titulli (strategji, AP, dokument)	Institucioni drejtues	Periudha	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar	MAS	2014-2020	tremujori i II 2014	tremujori i II 2014

Masat ligjore të planifikuara në 2014 – 2016

<i>Acquis të BE</i>	Statusi i përkthimit në shqip (y/n)	Legjislacioni shqiptar	Statusi përkthimit në anglisht (y/n)	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (përputhja e plotë / e pjesshme)	Data e planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
<u>AFAT MESME (2015 – 2016)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

KAPITULLI 4: LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Shtetet Anëtare pritet të heqin të gjitha kufizimet ndaj lëvizjes së kapitalit dhe pagesave, si brenda BE-së, ashtu edhe mes Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta. *Acquis* përfshin gjithashtu, edhe rregullat për pagesat ndërkufitare dhe ekzekutimin e urdhrave të transferimit në lidhje me letrat me vlerë. Direktiva për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kërkon që bankat dhe operatorët e tjerë ekonomikë të identifikojnë klientët dhe të raportojnë disa transaksione, sidomos kur bëhet fjalë për objekte me vlerë të lartë dhe për transaksione me para në dorë me vlera të mëdha. Një kërkesë kyçe në luftën kundër krimit financiar është krijimi i kapaciteteve efektive administrative dhe zbatuese, përfshi edhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve që merren me mbikëqyrjen, zbatimin dhe ndjekjen penale.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) përcakton kalendarin për liberalizimin e kapitalit. Gjithashtu, parashikon lirinë dhe konvertueshmërinë e pagesave të llogarive korrente dhe të transfertave.

I.2 Situata në Shqipëri

Në fushën e lëvizjeve të kapitalit, Shqipëria ka bërë progres sa i përket, liberalizimit të transfertave dhe transaksioneve të llogarive korrente dhe kapitale, dhe transfertave unilaterale ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve. Parashikohen flukse hyrëse dhe dalëse për kapitalin pa kufizime. Gjithashtu, ajo shfuqizoi të drejtat ekskluzive të Bankës së Shqipërisë për kontrollin e flukseve dalëse të kapitalit.

Aktet kryesore ligjore që rregullojnë parandalimin e pastrimit të parave janë Ligji i vitit 2008 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, i ndryshuar dhe rregulloret e tij zbatuese.

Blerja e pronave të paluajtshme nga të huajt është objekt kufizimesh: të huajt nuk lejohen të blejnë tokë bujqësore, pyje, lëndina dhe kullota. MSA parashikon përshtatjen progresive të legjislacionit në këtë fushë, me synimin që deri në 1 prill 2016 të garantohet që trajtimi i shtetasve të BE-së të jetë jo më pak i favorshëm sesa trajtimi që u akordohet shtetasve shqiptarë. Kjo kërkon rritje të kapaciteteve administrative. Gjithashtu, Shqipëria duhet të zgjidhë pasiguritë aktuale për të drejtat e pronësisë mbi pronat e paluajtshme.

I.3 Struktura e kapitullit

1. REGJIMI I LËVIZJEVE TË KAPITALIT DHE PAGESAVE AKTUALE
2. SISTEMI I PAGESAVE
3. PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE
4. IMPLEMENTIMI I MASAVE KUFIZUESE DHE SANKSIONEVE EKONOMIKE

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE.

Detyrimet për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian në fushën e liberalizimit të lëvizjeve të kapitalit rrjedhin nga Nenet 70 dhe Nenet 60-62 të MSA-së. Në fushën e pastrimit të parave rrjedhin nga Neni 4 dhe Neni 82 i MSA-së.

Siç duket qartë nga kjo dispozitë, Shqipëria ka jo vetëm detyrimin të përafrojtë teknikisht legjislacion e saj kombëtar me atë të Bashkimit Evropian, por edhe të sigurojë zbatimin e duhur të tij. Në këtë etapë të procesit para-anëtarësimit, autoritete të ndryshme shtetërore duhet të përfshihen në ushtrimin për anëtarësimin. Për më tepër, meqenëse ligji i BE-së është subjekt zhvillimi të vazhdueshëm, përafrimi i ligjeve nuk përfundon me përshtatjen e ligjit shqiptar ndaj *acquis* aktualisht në fuqi. Është i domosdoshëm monitorimi i vazhdueshëm i zhvillimeve në BE, si për përpjekjen para anëtarësimit ashtu edhe për përgatitjen e Shqipërisë për realitetin e përditshëm të anëtarësimit të ardhshëm në BE. Duket qartë se përafrimi me *acquis* të BE-së mbi lëvizjen e lirë të kapitalit nuk është një ndër fushat e prioriteteve në Nenin 70 të MSA-së. Arsyeimi vetëkuptohet, pasi ligji i BE-së në këtë fushë do të zbatohet vetëm në lidhje me Shqipërinë nga data e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Duhet të vihet në dukje se MSA nuk parashikon ndonjë dispozitë të posaçme për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së në këtë fushë.

Acquis e BE-së në fushën e lëvizjes së kapitalit përbëhet nga aktet e mëposhtme ligjore:

- Nenet 63-66 të Traktatit mbi Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU);
- Direktiva 88/361/KEE, datë 24 qershor 1988 për zbatimin e Nenit 63 të Traktatit ;
- Direktiva 2007/64/ KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 Nëntor 2007, mbi shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm; Direktiva 2009/44/ KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 6 maj 2009 që amendon Direktivën 98/26/EC mbi finalitetin e shlyerjes së pagesave në sistemet e shlyerjes së pagesave dhe të letrave me vlerë dhe Direktivën 2002/47/ KE mbi marrëveshjet për kolateralin financiar.

- Direktiva 2009/110/ KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 shtator 2009 “Për sipërmarrjen, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të veprimtarisë së institucioneve të parasë elektronike” amendim i Direktivës 2005/60/ KE dhe 2006/48/ KE dhe shfuqizim i Direktivës 2000/46/ KE
- Rregullorja (KE), Nr. 924/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 shtator 2009 mbi pagesat ndërkufitare në Komunitet dhe shfuqizim i Rregullores (KE), Nr. 2560/2001.
- Rregullorja (KE) nr. 1781/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 nëntor 2006 mbi informacionin për pagesin, që shoqëron transfertat e fondeve.
- Direktiva 2005/60/ KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 tetor 2005 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit (Direktiva kundër Pastrimit të Parave).
- Direktiva 2005/60/ KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 tetor 2005 mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit (Direktiva kundër Pastrimit të Parave).
- Direktiva e Komisionit 2006/70/ KE, datë 1 gusht 2006 e cila parashtrohet zbatimin e masave për Direktivën 2005/60/ KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit lidhur me përkufizimin e „personave të ekspozuar politikisht” dhe kriteret teknike për procedurat e thjeshtuara të kujdesit të duhur ndaj klientit (customer due diligence) dhe për përjashtimin në rastin e një aktiviteti financiar të kryer në bazë rastësore ose shumë të kufizuar.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion në Shqipëri

Në përgjithësi, Shqipëria ka vepruar në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja në këtë fushë:

- Ligji shqiptar Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Mbi taksën ndaj të ardhurave” është përafruar pjesërisht me Nenin 65 të TFEU. Ligji Nr. 7764, datë 02.11.1993 “Mbi investimet e huaja” është përafruar pjesërisht me Nenin 63 të TFEU.

Ligjet dhe rregulloret e mëposhtme shqiptare janë përafruar pjesërisht me Direktivën 2007/64/ KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 nëntor 2007 “Mbi shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm”:

- Ligji Nr. 8269, datë 23.12.1997 “Mbi Bankën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 9662, datë 18.12.2006 “Mbi bankat në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 9902, datë 17.04.2008 “Mbi Mbrojtjen e Konsumatorit”;

Ligji Nr. 133, datë 29.04.2013 “Mbi sistemin e pagesave” është përafruar pjesërisht me Direktivën 98/26/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 19 maj 1998 “Mbi finalitetin e shlyerjes së pagesave në sistemet e shlyerjes së pagesave dhe të letrave me vlerë”; Direktivën 2002/47/ KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 6 qershor 2002, mbi marrëveshjet për kolateralin financiar; dokumenti i BIS “Mbi Parimet Themelore për Sistemet e Pagesave me Rëndësi Sistemike” dhe Protokollin nr. 4 “Mbi Statutin Evropian të Bankave Qendrore”;

Ligji nr. 9917, date 19.05.2008 “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, i ndryshuar dhe rregulloret në zbatim të tij, është në përputhje me Direktivën 2005/60 EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi parandalimin e përdorimit të sistemeve financiare për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Rregullorja nr. 70, date 30.09.2009 “Mbi veprimtarinë e këmbimit valutor” është përafëruar pjesërisht me Direktivën 88/361/KEE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 24 qershor 1988 mbi zbatimin e Nenit 67 të Traktatit.

II.3 Institucionet përgjegjëse

- Banka e Shqipërisë.
- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP)
- Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian në kuadër të Kapitullit 4 “Lëvizja e lirë e kapitalit” kryesohet nga Banka e Shqipërisë dhe përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Ministria e Bujqësisë. Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

II.4 Sqarim në lidhje me parashikimet financiare

	2012	2013	2014	2015
Kosto totale	140,000,000		70,000,000	
Buxheti i Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës	-	-	-	-
Asistencë e huaj	140,000,000		70,000,000	-

III. Prioritetet

Dokumenti i Partneritetit Evropian

Lëvizja e lirë e kapitalit

Si prioritet afatshkurtër, Partneriteti Evropian rekomandon të autorizohet blerja e pasurive të paluajtshme nga ana e qytetarëve të BE-së brenda kufijve të përcaktuar në Kalendarin e Angazhimeve Specifike në kuadrin e Marrëveshjes së Përgjithshme Tregtare për Tregtinë dhe Shërbimet. (GATS). Në periudhën afatmesme, Shqipëria duhet të bëjë progres në përmbushjen e angazhimeve në kuadrin e MSA-së në lidhje me liberalizimin e plotë të lëvizjes së kapitalit, përfshi trajtimin e barabartë të qytetarëve të BE-së dhe Shqipërisë për sa i përket investimeve në portofol dhe kreditë dhe huadhëniet financiare me maturim më pak se një vit.

Pastrimi i parave

Prioritet afatshkurtër

- Të merren masa për zbatimin më të mirë të legjislacionit kundër pastrimit të parave, për sa i takon parandalimit, dënimeve, konfiskimit, sekuestrimit dhe ngrirjes së aseteve.
- Të rriten kapacitetet e Njesisë së Inteligjencës Financiare (FIU), prokurorive dhe Njesisë policore të Krimit Ekonomik, duke iu siguruar burimet e përshtatshme financiare dhe IT, si dhe të përmirësohet bashkëpunimi midis niveleve të ndryshme.
- Të sigurohet përputhshmëria e ligjit ekzistues për parandalimin e pastrimit të parave në linjë me *acquis* dhe me rekomandimet e Task Forcës për Ndërhyrjen Financiare dhe ato të Monejvalit të Këshillit të Evropës.
- Të forcohen kapacitetet e Agjencisë së administrimit të aseteve të sekuestruara dhe të konfiskuara.
- Të përmirësohet më tej bashkëpunimi me autoritetet e vendeve të tjera.
- Të sigurohet zbatim i duhur i detyrimeve të raportimit dhe të shqyrtohen pragjet e raportimit të transaksionit.
- Të merren masa më efikase për reduktimin e përdorimit të parasë së thatë (*cash*) në ekonomi.

Si prioritete afatmesme, në fushën e *Pastrimi i parave*, Shqipëria duhet të forcojë luftën kundër krimit ekonomik dhe financiar, përfshirë pastrimin e parave dhe falsifikimin e kartëmonedhave, dhe të arrijë rezultate të dukshme në luftën kundër pastrimit të parave, si brenda ashtu edhe jashtë sektorit financiar.

Takimi i Nën komitetit Çështjet Ekonomike dhe Financiare, dhe Statistikat, 2013

Ligji ekzistues për Sistemin e Pagesave është pjesërisht në përputhje me *acquis* e BE-së. Shqipëria do të përparojë në zbatimin e Ligjit për Sistemin e Pagesave, duke pasur parasysh nevojën për të vendosur në mënyrë progresive një kuadër ligjor, i cili të përfshijë të gjitha detyrimet sipas Direktivave 2007/64/EC dhe 2009/110/EC.

Raport Progres

Komisioni Evropian deklaroi se ka pasur progres në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit me miratimin e ligjit për sistemin e pagesave dhe masat e mëtejshme ligjore dhe raportuese të ndërmarra në kuadër të luftës për parandalimin e pastrimit të parave. Megjithatë, rekomandohet përafrim i mëtejshëm për të siguruar përputhshmëri të plotë me *acquis* e BE-së.

IV. Plan i veprimeve për periudhën 2014-2016

IV.1 Regjimi i lëvizjeve të kapitalit dhe pagesave aktuale

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia Ndërsektorale për Reformën në Fushën e të Drejtave të Pronësisë, 2012-2020” dhe të Planit të saj të Veprimit”	Ministria e Drejtësisë	2012-2020
Strategjia Afatmesme e Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2013-2015;	Banka e Shqipërisë	2013-2015
Politikat e mbikëqyrjes së sistemeve të Pagesave dhe të Shlyerjes, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 38, datë 18.06.2008	Banka e Shqipërisë	2014

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Nenet 63-66 TFEU	Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998“Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar	Ministria e Financave; Banka e Shqipërisë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	Pjesshëm	6.01.1999	21.01.1999
	Ligji nr. 7764, datë 02.11.1993”Për investimet e huaja” i ndryshuar	Ministria e Financave; Banka e Shqipërisë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	Pjesshëm	02.11.1993	25.11.1993
	Rregullore nr. 70, datë 30.09.2009 “Për veprimtarinë valutore”	Ministria e Financave Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	14.10.2009	07.12.2009

		Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes			
Direktiva 88/361/KEE	Ligji nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ; Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Burimeve Ujore; Banka e Shqipërisë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	E pjesshme	21.02.2008	27.03.2008
	Ligji nr. 8337, datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore,pyjore, livadheve dhe kullotave”;	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ; Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Burimeve Ujore; Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	30.04.1998	23.05.1998

		Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;			
	Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar:	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ; Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Burimeve Ujore; Banka e Shqipërisë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;	Pjesshëm	18.12.2006	01.06.2007
	Ligji nr. 7764, datë 02.11.1993”Për investimet e huaja” i ndryshuar	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ; Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Burimeve Ujore; Banka e Shqipërisë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe	Pjesshëm	02.11.1993	25.11.1993

		Sipërmarrjes;;			
	Vendimi Nr. 12 Shkurt 23 2011 i Këshillit Mbikëqyrës se Bankës se Shqipërisë për Adoptimin e disa mendimeve ne Rregullimin e Sistemit te Pagesave Nderbankare	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ; Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Burimeve Ujore; Banka e Shqipërisë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;;	Pjesshëm	23.02.2011	07.03.2011
	Rregullore Nr. 70 i 30.09.2009 “Për Veprimtarinë e Këmbimit Valutor	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ; Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Burimeve Ujore; Banka e Shqipërisë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe	Pjesshëm	14.10.2009	07.12.2009

		Sipërmarrjes			
Direktive 2007/64/KE	Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar”	Banka e Shqipërisë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ;	Pjesshëm	23.12.1997	22.01.1998
	Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”	Banka e Shqipërisë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;	Pjesshëm	18.12.2006	01.06.2007
	Ligji Nr. 9902, i datës 17.04.2008 “Mbi Mbrojtjen e Klientit	Banka e Shqipërisë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;	Pjesshëm	17.04.2008	22.05.2008
	Rregullore nr. 1, datë 17.01.2013. “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka”;	Banka e Shqipërisë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;	Pjesshëm	17.01.2013	21.02.2013

	Rregullore nr. 28, datë 30.03.2005 “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”	Banka e Shqipërisë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;	Pjesshëm	30.03.2005	30.03.2005
	Rregullore nr. 11, datë 06.02.2008 “Për instrumentet e pagesave elektronike”.	Banka e Shqipërisë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;	Pjesshëm	06.02.2008	21.02.2013

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Rishikimi i dokumentit “Politikat e mbikëqyrjes së sistemeve të Pagesave dhe të Shlyerjes”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 38, datë 18.06.2008	Banka e Shqipërisë	2014	T2 2014	T2 2014

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
<u>AFAT MESËM (2015 – 2016)</u>							
Neni 61(2) i MSA	Po	Rishikimi i rregullores nr. 70, datë 30.09.2009 “Për veprimtarinë valutore” me qëllim adresimin e rekomandimit të Nënkomitetit për çështjet ekonomiko-financiare dhe statistikat dhe detyrimeve që rrjedhin nga Artikulli VIII i FMN-së.	Jo	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	T2 2015	T3 2015

IV.2 Sistemi i pagesave

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia Afatmesme e Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2013-2015;	Banka e Shqipërisë	2013-2015
Dokumenti “Politikat e mbikëqyrjes së Sistemeve të Pagesave dhe të Shlyerjes”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës” nr. 38, datë 18.06.2008	Banka e Shqipërisë	E pa përcaktuar, dokumenti do të rishikohet në varësi të zhvillimeve të tregut.

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 98/26/KE	Ligji nr. 133, datë 29.04.2013 “Për sistemin e pagesave	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	29.04.2013	29.05.2013
Direktiva 2002/47/KE	Ligji nr. 9974, datë 28.07.2008 “Për kontratën e riblerjes së titujve”;	Banka e Shqipërisë; Ministria e Financave	Pjesshëm	28.07.2008	19.08.2008
	Ligji nr 8537, datë 18. 10.1999 “Për barrët siguruese”;	Banka e Shqipërisë; Ministria e Financave	Pjesshëm	18. 10.1999	04.12.1999
	Ligji nr. 133, datë 29.04.2013 “Për sistemin e pagesave”	Banka e Shqipërisë; Ministria e Financave	Pjesshëm	29.04.2013	29.05.2013
	Ligji nr. 8901, datë 23.05.2002 “Për falimentimin”;	Banka e Shqipërisë; Ministria e Financave	Pjesshëm	23.05.2002	18.07.2002
	Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.	Banka e Shqipërisë; Ministria e Financave	Pjesshëm	18.12.2006	01.06.2007
Direktiva 2009/110/KE	Rregullore nr..11, date 06.02.2008 " Për instrumentet e pagesave elektronike"payment instruments"	Banka e Shqipërisë; Ministria e Financave	Pjesshëm	06.02.2008	21.02.2008
	Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar	Banka e Shqipërisë; Ministria e Financave	Pjesshëm	18.12.2006	01.06.2007
	Rregullore nr. 14 datë 11.03.2009 “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në	Banka e Shqipërisë; Ministria e Financave	Pjesshëm	11.03.2009	08.05.2009

	Republikën e Shqipërisë”;				
	Rregullore nr. 2 datë 17.01.2013 “Për administrimin e rrezikut në aktivitetin e subjekteve jo-banka”.	Banka e Shqipërisë; Ministria e Financave	Pjesshëm	17.01.2013	21.02.2013
Direktiva 2007/64/KE	Rregullore nr. 11, date 06.02.2008 " Për instrumentet e pagesave elektronike";	Banka e Shqipërisë;	Pjesshëm	06.02.200	21.02.2013
	Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	18.12.2006	01.06.200
	Rregullore nr. 14 datë 11.03.2009 “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”;	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	11.03.2009	08.05.2009
	Rregullore nr. 28, datë 30.03.2005 “Për mbikëqyrjen e transaksioneve bankare në rrugë elektronike”	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	30.03.2005	30.03.2005
	Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	18.12.2006	01.06.2007
	Ligji nr. 8269 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	23.12.1997	22.01.1998

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Rishikimi i dokumentit	Banka e Shqipërisë	2014	T2 2014	T2 2014

“Politikat e mbikëqyrjes së sistemeve të Pagesave dhe të Shlyerjes”, miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 38, datë 18.06.2008				
---	--	--	--	--

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
Kuadri i politikës së mbikëqyrjes së Eurosistemit, korrik 2011	Po	Rishikimi i dokumentit 38, datë 18.06.2008 “Politikat e mbikëqyrjes së sistemeve të Pagesave dhe të Shlyerjes”	Po	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	T2 2014	T2 2014
<u>AFAT MESEM (2015 – 2016)</u>							
Direktiva 2007/64/EC	Po	Implementimi i Direktivës 2007/64/KE “Për shërbimet e pagesave në tregun e brendshëm” në kuadrin ligjor ose rregullator	Jo	Banka e Shqipërisë	Pjesshëm	T3 2015	T3 2015

		Shqiptar					
--	--	----------	--	--	--	--	--

IV.3 Parandalimi i pastrimit të parave

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Dokumenti strategjik kombëtar “Për hetimin e krimit financiar”	DPPPP	2009-2015

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2005/60/ KE	Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008 “ Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit”, i ndryshuar	DPPPP	I Plotë	21.05.2008	21.08.2008

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjeshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
<u>AFAT MESEM (2015 – 2016)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

KAPITULLI 5: PROKURIMI PUBLIK

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni i BE për prokurimin publik bazohet në parimet e përgjithshme që rrjedhin nga Traktati për Bashkimin Evropian dhe Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian, si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Këto parime përfshijnë transparencën, trajtimin e barabartë, konkurrencën e lirë dhe mos-diskriminimin. Parimet e lartpërmendura aplikohen në të gjitha procedurat e prokurimit, përfshirë edhe ato jashtë fushës së veprimit të direktivave evropiane për prokurimin, për shembull, procedurat e prokurimeve nën kufijtë monetarë të parashikuar nga këto direktiva, apo procedurat e koncesioneve për shërbimet. Prokurimi publik rregullohet plotësisht në legjislacionin dytësor të BE.

I.2 Situata në Shqipëri

Në fushën e prokurimit publik ka pasur progres të mirë në procesin e përafrimit me legjislacionin respektiv të BE. Legjislacioni i prokurimit publik pësoi disa ndryshime me qëllim përafrimin e mëtejshëm të tij me parimet e përgjithshme dhe legjislacionin e BE për dhënien e kontratave publike. Gjatë vitit të kaluar u miratua edhe Ligji i ri për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat, i ndjekur nga miratimi i legjislacionit dytësor respektiv. Në këtë kuadër të përafrimit të legjislacionit punë e mëtejshme duhet të ndërmerret me qëllim përafrimin e legjislacionit, përkatësisht të prokurimeve dhe koncesioneve, me direktivat e reja respektive të BE, të miratuara në fillim të vitit 2014.

Agjencia e Prokurimit Publik ka marrë masa për të siguruar transparencën e procedurave të prokurimit publik dhe zbatimin e legjislacionit në këtë fushë.

Institucioni i Avokatit të Prokurimeve u mbyll, dhe funksioni i shqyrtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë është përqendruar vetëm te Komisioni i Prokurimit Publik.

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit shqiptar në fushën e prokurimit publik me legjislacionin e BE në këtë fushë rrjedh nga Nenet 70 dhe 74 të MSA.

Legjislacioni i BE në fushën e prokurimit publik përbëhet nga aktet e mëposhtme ligjore:

- Direktiva 2004/18/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 31 Mars 2004, për koordinimin e procedurave të prokurimit për shpalljen fituese të kontratave publike për punë, furnizime dhe shërbime, Gazeta Zyrtare nr. 134, Seria L e datës 30.4.2004.
- Direktiva 2004/17/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 31 Mars 2004, që koordinon procedurat e prokurimit të subjekteve që veprojnë në sektorin e shërbimit ujor, energjetik, të transportit dhe postar, Gazeta Zyrtare nr. 134, Seria L e datës 30.4.2004.
- Direktiva 2014/24/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 Shkurt 2014 për prokurimin publik dhe që shfuqizon Direktivën 2004/18/EC, Gazeta Zyrtare nr. 94, Seria L e datës 28.3.2014.
- Direktiva 2014/25/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 Shkurt 2014 për prokurimin nga entet që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare dhe që shfuqizon Direktivën 2004/17/EC, Gazeta Zyrtare nr. 94, Seria L e datës 28.3.2014.
- Direktiva 2014/23/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 Shkurt 2014 për dhënien e kontratave të koncesioneve, Gazeta Zyrtare nr. 94, Seria L e datës 28.3.2014.
- Direktiva 2014/55/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 Prill 2014 për faturimin elektronik në prokurimin publik.
- Direktiva 2009/81/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 Korrik 2009, për koordinimin e procedurave për dhënien e disa kontratave për punë, furnizime dhe shërbime nga autoritete kontraktore apo ente në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë, dhe që ndryshon Direktivat 2004/17/EC dhe 2004/18/EC, Gazeta Zyrtare nr. 216, Seria L e datës 20.8.2009.
- Direktiva e Këshillit 92/13/EEC, datë 25 Shkurt 1992, që koordinon ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative në lidhje me zbatimin e rregullave komunitare për procedurat e prokurimit të subjekteve që veprojnë në sektorin e shërbimit ujor, energjetik, të transportit dhe të telekomunikacionit, Gazeta Zyrtare nr. 76, Seria L e datës 23.3.1992.
- Direktiva 89/665/EEC e Këshillit, datë 21 Dhjetor 1989, për koordinimin e ligjeve, rregullave dhe dispozitave administrative në lidhje me aplikimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave publike të furnizimit dhe të punëve publike, Gazeta Zyrtare nr. 395, Seria L e datës 30.12.1989.

- Rregullore (EC) Nr. 2195/2002 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 5 Nëntor 2002, për Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit, Gazeta Zyrtare nr. 340, Seria L e datës 16.12.2002.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Në përgjithësi, detyrimet që rrjedhin nga MSA, në fushën e prokurimit publik, janë përmbushur. Kuadri rregullator në këtë fushë është në përgjithësi i pajtueshëm, por jo plotësisht i përafruar me *acquis*. Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është pjesërisht i përafruar me direktivat e mëposhtme të BE:

Direktiva 2004/18/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 31 Mars 2004, për koordinimin e procedurave të prokurimit për shpalljen fituese të kontratave publike për punë, furnizime dhe shërbime (e ndryshuar), Direktiva 2004/17/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 31 Mars 2004, që koordinon procedurat e prokurimit të subjekteve që veprojnë në sektorin e shërbimit ujor, energjetik, të transportit dhe postar (e ndryshuar), Direktiva 89/665/EEC e Këshillit, datë 21 Dhjetor 1989, për koordinimin e ligjeve, rregullave dhe dispozitave administrative në lidhje me aplikimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave publike të furnizimit dhe të punëve publike (e ndryshuar me Direktivën 2007/66/EC).

Përsa i përket koncesioneve, në reflektim të progres raporteve, në këtë fushë, të BE, në muajin Prill 2013 u miratua Ligji Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”. Ky ligj është pjesërisht i përafruar me Direktivën 2004/18/EC për koordinimin e procedurave të prokurimit për shpalljen fituese të kontratave publike për punë, furnizime dhe shërbime.

Ndryshime të mëtejshme në ligjin Shqiptar do të nevojiten për të përafruar kuadrin ligjor kombëtar me Direktivat e reja të miratuara, 2014/24/EU dhe 2014/25/EU.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Kuadri institucional rregullator në fushën e prokurimit publik përbëhet nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP) dhe Komisioni i Prokurimit Publik (KPP).

Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) përfshihet përsa i përket kompetencave të saj ligjore në lidhje me koncesionet.

APP është organi qendror për mbikëqyrjen dhe monitorimin e procedurave të prokurimit publik, koncesioneve/partneritetit publik privat dhe ankandeve publike. APP ka disa kompetenca, të cilat përfshijnë paraqitjen e propozimeve për ndryshime legjislative në fushat e lartpërmendura, dhe dhënien e këshillave dhe asistencës ligjore (sipas kërkesës) për autoritetet kontraktore, që ndërmarrin procedura prokurimi publik, koncesionesh/PPP dhe ankande publike.

APP ka në total 23 punonjës.

KPP është organi i rishikimit, i cili trajton ankesat e operatorëve ekonomikë për procedurat e prokurimit publik, koncesioneve/partneritetit publik privat dhe ankandit publik. Vendimet e KPP janë përfundimtare administrativisht. KPP përbëhet nga 20 punonjës.

Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian përgjegjës për kapitullin 5 (Prokurimi publik) drejtohet nga APP.

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare 2012 – 2015

Parashikimet financiare të APP, në lidhje me aktivitetet trajnuese që ndërmerr, në zbatim të detyrave ligjore, jepen si më poshtë:

	2012	2013	2014	2015
Total cost	34.250.000	650.000	0	650.000
State budget support	650.000	650.000	0	650.000
Foreign assistance	33.600.000	0	0	0

III. Prioritetet

Ligji aktual i prokurimit publik është pjesërisht i përafuar me legjislacionin përkatës të BE. Megjithatë disa dispozita janë plotësisht ose pjesërisht të përafuara, punë e mëtejshme legjislative nevojitet me qëllim përafrimin e plotë, sikurse përcaktuar në MSA, për këtë fushë.

Në fillim të vitit 2014 u miratuan Direktivat e reja të BE, në fushën e prokurimit publik, dhe legjislacioni shqiptar në këtë fushë duhet t'i nënshtrohet ndryshimeve të nevojshme, me qëllim përafrimin me këto direktiva. Përsa i përket koncesioneve/PPP, duke qenë se legjislacioni shqiptar është relativisht i ri, APP nuk mund të parashikojë ndonjë ndryshim në këtë legjislacion, në një të ardhme të afërt. Ndryshimet e

nevojshme do të bëhen pas përfundimit të procesit *screening* të legjislacionit të BE për koncesionet, çka do të theksojë ndryshimet e nevojshme për përafrim të mëtejshëm.

Masa duhet të merren për përmirësimin e profesionalizmit të autoriteteve kontraktore, dhe reduktimin e shkeljeve financiare, në këtë fushë. Një strategji kombëtare për sistemin e prokurimit publik do të përgatitet, për të përcaktuar qëllimet kryesore në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimeve dhe masat e nevojshme për realizueshmërinë e tyre.

IV. Plan i veprimeve për periudhën 2014 – 2016

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
n/a	n/a	n/a

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Legjislacioni i BE	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e miratimit (legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2004/18/EC	Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar)	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	20.11.2006	01.01.2007
	Ligji Nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	25.04.2013	25.05.2013
Direktiva 2004/17/EC	Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar)	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	20.11.2006	01.01.2007
Direktiva 2014/24/EU	Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar)	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	20.11.2006	01.01.2007
Direktiva 2014/25/EU	Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar)	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	20.11.2006	01.01.2007

Direktiva 89/665/EEC	Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar)	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	20.11.2006	01.01.2007
Direktiva 92/13/EEC	Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar)	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	20.11.2006	01.01.2007
Direktiva 2009/81/EC	-	Agjencia e Prokurimit Publik	Mospërputhje	-	-
Rregullore 2195/2002/EC	-	Agjencia e Prokurimit Publik	Mospërputhje	-	-

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Strategji për zhvillimin e sistemit të prokurimit publik në Republikën e Shqipërisë	Agjencia e Prokurimit Publik	3 vjet	3-mujori i fundit 2014	3-mujori i fundit 2014

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

Legjislacioni i BE	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për miratim	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
<u>AFAT MESËM (2015 – 2016)</u>							
Direktiva 2004/24/EU	Jo	-Ligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006,	Jo	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	3-mujori i fundit 2016	3-mujori i fundit 2016

		“Për prokurimin publik”, të ndryshuar.					
	Jo	-Vendim i Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 1, datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.	Jo	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	3-mujori i fundit 2016	3-mujori i fundit 2016
Direktiva 89/665/EEC	Jo	-Ligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.	Jo	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	3-mujori i fundit 2016	3-mujori i fundit 2016
	Jo	-Vendim i Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 1, datë 10.01.2007,	Jo	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	3-mujori i fundit 2016	3-mujori i fundit 2016

		“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.					
Direktiva 2009/81/EC	Jo	-Ligj “Për koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave për punë, furnizime, dhe shërbime nga autoritete kontraktore apo ente në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë”.	Jo	Agjencia e Prokurimit Publik	I pjesshëm	3-mujori i fundit 2016	3-mujori i fundit 2016
	Jo	-Vendim i Këshillit të Ministrave “Për koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave për punë, furnizime, dhe shërbime nga autoritete kontraktore apo ente në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë”.	Jo	Ministria e Mbrojtjes	I pjesshëm	3-mujori i fundit 2016	3-mujori i fundit 2016

KAPITULLI 6: LEGJISLACIONI TREGTAR

I. Hyrja

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni i BE-së për këtë kapitull përmban rregulla të harmonizuara në fushën e legjislacionit tregtar, të ligjit për shoqëritë tregtare, duke përfshirë edhe kërkesat e raportimit financiar, të destinuara për të lehtësuar ushtrimin e të drejtës së themelimit. Pjesa kryesore e *acquis* në këtë fushë të ligjit, janë direktivat për rregullimin e kompanive të cilat përfshijnë kërkesat e detyrueshme për falimentimin, për përcaktimin e rregullave për kompanitë publike, rregullat kombëtare për mbrojtjen e aksionarëve dhe kreditorëve, rregullat dhe procedurat për të lehtësuar bashkimet ndërkufitare të kompanive, etj. Gjithashtu ky kapitulli përfshin rekomandimet e Komisionit të cilat adresojnë parimet e qeverisjes së korporatave dhe direktivën për të drejtat e aksionarëve.

Acquis e BE-së në fushën e rregullave të kontabilitetit dhe auditimit përfshijnë vlerësimin e ekspozimit dhe bilancet, llogaritë vjetore të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar publike dhe private, kërkesat e auditimit, si dhe sigurimin e informacionit dhe publikimin e detyrimeve. Ekzistojnë dhe rregullore që i detyrojnë kompanitë të cilat janë të listuara në një treg të rregulluar, në mënyrë që llogaritë e tyre të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të adoptuara nga Komisioni Evropian. Së fundi, Direktiva 2006/43/KE "Për Auditimin Ligjor" harmonizon rregullat duke përfshirë mes të tjerash, miratimin dhe regjistrimin e auditorëve ligjor, sigurimin e jashtëm, mbikëqyrjen publike, pavarësinë e auditorit dhe zbatimin e mundshëm të standardeve ndërkombëtare të auditimit.

I.2 Situata në Shqipëri

Shqipëria ka bërë progres në përafrimin me *acquis* në fushën e legjislacionit tregtar duke miratuar në vitin 2008 ligjin e shoqërive tregtare, si dhe në vitin 2012 ligjin për bashkimin ndërkufitare të kompanive. Përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* në lidhje me raportimin dhe dokumentacionin për bashkimet ndërkufitare është në proces miratimi nga Këshilli i Ministrave. Ka përfunduar infrastruktura teknike për aplikimin e nënshkrimit elektronik. Gjithashtu janë akredituar dy ente për lëshimin e certifikatave, një publik, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), dhe një privat, Aleat shkp. AKSHI është duke lëshuar certifikata të kualifikuara për punonjësit e administratës publike, ndërsa Aleat shkp, është në fazën e testimit dhe pritet të lëshojë certifikata të kualifikuara për qytetarët nga qershori 2014.

Në fushën e kontabilitetit të korporatave, kanë filluar përgatitjet për përafrimin e legjislacionit mbi standardet e kontabilitetit dhe të kontabilitetit kombëtar me *acquis*. Ndërsa në fushën e auditimit, Organi i Mbikëqyrjes Publike ka vazhduar me aktivitetet monitoruese dhe përfshirjen në auditim të drejtpërdrejtë të entiteteve me interes publik. Me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr. 35, datë 02.08.2013 është miratuar “Udhërrëfyese për reformën e kontabilitetit dhe auditimit për periudhën 2013-2015”.

I.3 Struktura e kapitullit

1. LEGJISLACIONI TREGTAR
2. KONTABILITETI DHE AUDITIMI

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhja e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të BE-së

Përafrimi i legjislacionit shqiptar për të drejtën tregtare buron nga neni 70 i MSA-së në bazë të së cilës Shqipëria ka jo vetëm detyrimin për të sjellë legjislacionin e saj kombëtar në përputhje me të drejtën e BE-së, por gjithashtu për të siguruar edhe zbatimin e saj.

Acquis të BE-së që përfshihen në këtë kapitull janë :

- Direktiva 2009/101/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 16 shtator 2009 “Mbi koordinimin e masave mbrojtëse” të cilat, për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe palëve të treta, shtetet anëtare kërkojnë nga kompanitë që t’i bëjnë këto masa ekuivalente sipas paragrafit të dytë të nenit 48-të të Traktatit, e ndryshuar;
- Direktiva 2009/109/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 16 shtator 2009, “Që ndryshon” Direktivat e Këshillit 77/91/KE, 78/855/KEE dhe 82/891/KEE, Direktivën 2005/56/KE dhe sa i përket kushteve për raportim dhe dokumentacion në rastin e bashkimeve dhe ndarjes;
- Direktiva 2005/56/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 tetor 2005 “Për bashkimet ndërkufitare të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar”;
- Direktiva 89/666/KEE e 21 dhjetor 1989 “Mbi kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese për degët e hapura në një shtet anëtar nga lloje të caktuara të shoqërive të qeverisura nga ligji i një shteti tjetër”;
- Direktiva 2011/35/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 prill 2011 “Mbi bashkimet e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar publike”;

- Direktiva 2004/25/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 prill 2004 “Mbi tentativat për blerje”;
- Direktiva 2009/102/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 shtator 2009 “Në fushën e ligjit të kompanive për kompanitë me përgjegjësi të kufizuar private njëemërore”;
- Direktiva 2012/30/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 tetorit 2012 “Mbi koordinimin e masave mbrojtëse ose mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerëve, të cilat janë kërkuar nga shtetet anëtare të kompanive sipas paragrafit të dytë të nenit 54 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, në lidhje me formimin e kompanive publike me përgjegjësi të kufizuar, për mbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit të tyre, me synimin për ti bërë ekuivalente masat mbrojtëse”;
- Direktiva 2007/36/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 korrik 2007 “Mbi ushtrimin e të drejtave të caktuara të aksionarëve të kompanive të listuara”;
- Rregullorja (KE) Nr 1606/2002 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 19 korrik 2002 “Mbi zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit”;
- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 1126/2008 e 3 nëntor 2008 “Mbi adoptimin e standardeve të caktuara ndërkombëtare të kontabilitetit në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 1606/2002 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit”;
- Direktiva 2013/34/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 26 qershor 2013 “Lidhur me pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet që kanë të bëjnë me lloje të caktuara të ndërmarrjeve, që ndryshon Direktivën 2006/43/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshilli dhe shfuqizon Direktivat e Këshillit 78/660/KEE dhe 83/349/KEE”;
- Direktiva 2006/43/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 maj 2006 "Për auditim ligjor të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara".

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore legjislative

1. LEGJISLACIONI TREGTAR

Shqipëria ka bërë progres në fushën e ligjit të shoqërive tregtare, përmes miratimit të legjislacionit në fushën e bashkimeve ndërkufitare. Ligji Nr 110, datë 15/11/2012 "Për bashkimet ndërkufitare", i cili siguron drejtimin e bashkimeve ndërkufitare bazuar në Direktivën 2005/56/KE mbi kompanitë me përgjegjësi të kufizuar. Është përgatitur një komentari i ligjit si dhe janë planifikuar programet e trajnimit për noterët dhe grupet përkatëse të punës.

Harmonizimi me kërkesat e Direktivës 2009/101/KE mbi koordinimin e masave për të mbrojtur interesat e anëtarëve dhe palëve të treta, si dhe Direktiva 2009/109/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 shtator 2009 që ndryshon Direktivat e Këshillit 77/ 91/KEE, 78/855/KEE

dhe 82/891/KEE dhe Direktivën 2005/56/KE në lidhje me kërkesat e raportimit dhe të informacionit në rastin e bashkimit dhe ndarjeve, janë transpozuar në ligjin "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për ligjin e kompanive", i cili është në proces miratimi.

Kodi i Qeverisjes së Korporatave është përgatitur dhe është në dispozicion të biznesit që nga viti 2011. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes do të vlerësojë ndikimin e zbatimit të këtij Kodi gjatë vitit 2014. Pyetësorët do t'i dorëzohen bizneseve të zgjedhura dhe pas informacioneve të marra do të përgatitet raporti i vlerësimit brenda vitit 2014.

2. KONTABILITETI DHE AUDITIMI

Ligji shqiptar nr 10091, datë 05.03.2009 "Për Auditimin Ligjor dhe Organizmit e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga Direktiva e auditimit të vitit 2006. Janë të përkthyer në gjuhën shqipe të gjitha Standardet e Kontabilitetit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (e fundit përkthyer mars 2014), duke përfshirë ato bëra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Londër deri në dhjetor 2013.

Në lidhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, është miratuar Urdhri i Ministrit të Financave Nr. 86 të 2013/12/18 "Për shpalljen e amendamenteve të Kontabilitetit Ndërkombëtar dhe standardet e raportimit financiar". Urdhri i Ministrit ndryshohet çdo vit. Amendimet kanë hyr në fuqi më 01.01.2014.

Të gjitha përditësimet janë të publikuara në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për këtë kapitull janë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Financave, Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë Informatike, Instituti i Kontabilistëve të Autorizuar, Agjencia për Komunikimin Elektronik dhe Postar dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

II.4 Ndarja buxhetore

	2012	2013	2014	2015
Kosto totale	596.685.000	599.385.000	3.094.700	
Mbuluar nga Buxheti i Shtetit	582.480.000	596.400.000	136.000	
Donatorët	14.205.000	2.985.000	2.913.700	
Diferenca	0	0	136.000	

III. Prioritetet

Legjislacioni tregtar mbetet një nga fushat më të rëndësishme të ligjit të BE. Megjithatë, mbetet një sfidë për të përmbushur të gjitha kërkesat e *acquis* për shkak të rritjes së vëllimit të *acquis* në këtë fushë, si dhe ndryshimet e përhershme ligjore. Edhe pse disa pjesë të ligjit shqiptar mund të jetë në pajtueshmëri të plotë, ka fusha të tjera ku rishikimi më tej është i nevojshëm, sidomos në fushën e kontabilitetit dhe auditimit.

IV. Plani i veprimit për 2014 – 2016

IV.1 Legjislacioni tregtar

Kuadri ligjor ekzistues

Titulli	Institucioni	Periudha e referuar
Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2014-2020	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	2014-2020
Strategjia e Evropës Juglindore 2020	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	2014-2020

Kuadri ligjor ekzistues

Acquis e BE	Legjislacioni shqiptar	Institucioni	Shkalla e përafrimit (të plotë / të pjesshme / jo e përafruar	Data e miratimit (legjislacionit shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacioni shqiptar)
Direktiva 2009/102/KE	Ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar	MZHETS	I pjesshëm	14.04.2008	14.04.2008
	Ligji nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"	MZHETS	I pjesshëm	03.05.2007	07.06.2007
Direktiva 89/666/KEE	Ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar	MZHETS	I pjesshëm	14.04.2008	14.04.2008
	Ligji nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"	MZHETS	I pjesshëm	03.05.2007	07.06.2007
Direktiva 2009/109/KE	Ligji Nr. 9901 date 14.04. 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare",	MZHETS	I pjesshëm	14.04.2008	14.04.2008

	i ndryshuar				
	Ligji nr. 9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”	MZHETS	I pjesshëm	03.05.2007	07.06.2007
	Ligji Nr. 110, date 15.11.2012 "Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare”	MZHETS	I pjesshëm	15.11.2012	15.11.2012
Direktiva 2011/35/BE	Ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar	MZHETS	I pjesshëm	14.04.2008	14.04.2008
Direktiva 2005/56/BE	Ligji Nr. 110, date 15.11.2012 "Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare”	MZHETS	I pjesshëm	15.11.2012	15.11.2012
Direktiva 2001/86/KE	Ligji Nr. 110, date 15.11.2012 Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare”	MZHETS	I pjesshëm	15.11.2012	15.11.2012
Direktiva 2004/25/KE	Ligji Nr. 10236 date 18.02.2010 "Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike"	MZHETS	I plotë	18.02.2010	18.02.2010

Masat ligjore për periudhën 2014 – 2016

Titulli	Institucioni drejtues	Periudha e referuar	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Plani kombëtar i zbatimit të SEE 2020	MZHETS	2014	Tremujori i dytë 2014	Tremujori i dytë 2014

Masat ligjore të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Acquis e BE	Statusi i përkthimit në shqip (Y/N)	Legjislacioni shqiptar	Statusi i përkthimit në anglisht (Y/N)	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar I përafrimit (përputhja e plotë/ e pjesshme)	Data e planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi
<u>AFAT-SHKURTËR (2014)</u>							
Direktiva 2009/101/KE, e ndryshuar	Po	Disa amendime në Ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar	Po	MZHETS/QK R	I plotë	Tremujori parë 2014	Tremujori i dytë 2014
Direktiva 2009/101/ KE,	Po	Ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar	Po	MZHETS	I plotë	Tremujor i tretë 2014	Tremujori i katërt 2014
Direktiva 2009/109/KE, e		Ligji Nr. 9901 date 14.04.2008	Po	MZHETS	I plotë	Tremujori tretë 2014	Tremujori i katërt 2014

ndryshuar		Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar					
<u>AFAT-MEËM (2015 – 2016)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.2 Kontabiliteti dhe auditimi

Kuadri ligjor ekzistues

Titulli	Institucioni	Periodha e referuar
Urdhri i Ministrit të Financave Nr. 35, date 02.08.2013 “ Për Udhërrëfyesit për reformën e kontabilitetit dhe auditimit”	MF	2013-2015

Kuadri ligjor ekzistues

Acquis e BE	Legjislacioni shqiptar	Institucioni	Shkalla e përafrimit (të plotë / të pjesshme / jo e-përafruar	Data e miratimit (legjislacionit shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacioni shqiptar)
Direktiva 2006/43/KE	Ligji Nr. 10091 date 05/03/2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të autorizuar	MF Bordi i Mbikëqyrjes Publike i Auditorëve dhe Kontabilistëve IEKA	I pjesshëm	05.03.2009	20.03.2009

Masat ligjore për periudhën 2014 – 2016

Titulli	Institucioni	Periudha e referuar	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të planifikuara në 2014 – 2016

Acquis e BE	Statusi i përkthimit në shqip (Y/N)	Legjislacioni shqiptar	Statusi i përkthimit në anglisht (Y/N)	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (përputhja e plotë/ e pjesshme)	Data e planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi
<u>AFAT-SHKURTER (2014)</u>							
Direktiva 2013/34/BE	Jo	Urdhri i Ministrit të Financave për standardet shqiptare të kontabilitetit	Jo	MF IEKA	I pjesshëm	Tremujori i katërt 2014	Tremujori i parë 2015
<u>AFAT-MESME (2015 – 2016)</u>							
Direktiva 2013/34/BE	Jo	Amendimi i ligjit Nr. 9228, date 29.04.2004	Jo	MF IEKA	I pjesshëm	Tremujori i katërt 2015	Tremujori i parë 2016

Shënim: Kostoja për përkthimin e direktivën 2013/34 është parashikuar për vitin 2014

KAPITULLI 7: E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli paraqet një vështrim të situatës aktuale të Pronësisë Intelektuale në Shqipëri, duke përfshirë njohjen me legjislacionin në fuqi dhe ndryshimet përkatëse. Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave dhe Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit janë institucionet kryesore përgjegjëse, të angazhuar direkt me çështjet e Pronësisë Intelektuale në Shqipëri. Ato bashkëpunojnë me një sërë institucionesh të tjera, të cilat janë pjesë e mekanizmit zbatues të këtyre të drejtave në Republikën e Shqipërisë.

Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Industriale dhe sigurimi i një niveli mbrojtje të tyre në Shqipëri, të njëjtë me atë të vendeve të BE, ka qenë një nga angazhimet e marra përsipër nga qeveria shqiptare në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, neni 73 i saj. Në zbatim të këtij angazhimi, janë ndërmarrë masa legjislative dhe aktivitete zbatuese, si në drejtim të përafrimit të legjislacionit kombëtar në fushën e pronësisë industriale me *acquis*, ashtu edhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve administrative të institucioneve përgjegjëse në këtë fushë.

I.2 Situata aktuale në Shqipëri

Në lidhje me të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura, objektivi kryesor i politikave për mbrojtjen e pronësisë intelektuale në Shqipëri ka qenë garantimi i mbrojtjes së këtyre të drejtave, si dhe zbatimi efikas i tyre. Organizimi dhe struktura aktuale institucionale dhe ligjore kërkon reforma të mëtijshme në mënyrë që të jenë në përputhje me praktikën më të mirë të vendeve të BE. Një ligj i ri për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e lidhura me to është planifikuar për miratim në tremujorin e tretë të vitit 2014. Shqipëria ka bërë progres të mirë në mënyrë që të përshtasë legjislacionin e saj në fushën e Pronësisë Industriale me *acquis* e BE-së. Dokumenti kryesor politik është Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2010-2015. Shqipëria është palë në shumë marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e Pronësisë Intelektuale. Shqipëria është anëtare e Organizatës Evropiane të Patentave që nga 01 Maj 2010.

Gjithashtu DPPM-ja ka punuar për të krijuar dhe forcuar kapacitetin e saj administrativ. Ndërgjegjësimi i publikut ka qenë një nga objektivat e saj kryesorë. DPPM-ja gjithashtu është duke bashkëpunuar me mbajtësit e drejtave jo vetëm duke kërkuar mbështetje prej tyre, por edhe duke i ofruar mbështetje atyre për zgjidhjen e problemeve të tyre. Infrastruktura e teknologjisë së informacionit të DPPM, ka pësuar ndryshime, në përmirësimin e programeve kompjuterike që automatizojnë procedurat e regjistrimit të Objekteve të PI, si edhe përmirësojnë shërbimet elektronike që DPPM ofron.

Institucionet shqiptare kanë relativisht përvojë të kufizuar në fushën e PI, pasi i gjithë procesi është i fokusuar në ato institucione të cilat merren me çështje të tilla, si dhe në krijimin e institucioneve të tjera të nevojshme të cilat nuk kanë ekzistuar më parë. Është e vetëkuptueshme se çështja e të drejtave të PI ka një dimension më të gjerë, e cila duhet të adresohet në mënyrë strategjike me programe specifike në fushën e arsimit, mediave, ndërgjegjësimit, promovimin, etj. Të gjitha këto kërkojnë politika të qarta në nivelin qendror dhe rajonal. Niveli i inspektimit dhe monitorimit të kapaciteteve të institucioneve shqiptare që merren me të drejtat e PI është thelbësor në lidhje me çështjet e të drejtave të PI. Prandaj, është e nevojshme që vlerësimi i nevojave për të rritur personelin përkatës të institucioneve të ndryshme të konceptohet si një proces gradual dhe afatgjatë, duke respektuar në të njëjtën kohë burimet ekzistuese njerëzore dhe duke e konsideruar suksesin si një pjesë e ndërhyrjes së kombinuar të veprimeve të institucioneve dhe subjekteve të ndryshme. Gjithashtu është parë si një proces i kombinuar kualifikues i institucioneve të ndryshme, duke garantuar zbatimin e integruar dhe të suksesshëm të funksionimit në të ardhmen të çdo institucioni në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të PI në Shqipëri.

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe EU *acquis*

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar në fushën e Pronësisë Intelektuale me atë të Bashkimit Evropian buron nga neni 73 i MSA-së.

Neni 73

Pronësia Intelektuale, Industriale dhe Tregtare

1. Në përputhje me dispozitat e këtij Neni dhe Shtojcën V, palët konfirmojnë rëndësinë që i japin sigurimit të mbrojtjes së përshtatshme dhe efikase si edhe imponimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare.
2. Shqipëria merr masat e nevojshme për të garantuar brenda katër viteve pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje një nivel mbrojtjeje të të drejtave të pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të njëjtë me atë që ekziston në Komunitet, përfshirë mjetet e efektshme për realizimin e këtyre të drejtave.
3. Shqipëria merr përsipër të bëhet palë brenda periudhës së përcaktuar më lart në konventat shumëpalëshe për të drejtat e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare të përmendura në Shtojcën VI, paragrafi 1. Këshilli i Stabilizim-Asociimit mund të vendosë për të detyruar Shqipërinë të bëhet palë në Konventa të veçanta shumëpalëshe në këtë fushë.

4. Nëse ndodhin probleme në fushën e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare që ndikojnë në kushtet e tregtisë, me kërkesë të një Pale, problemet i dërgohen urgjentisht Këshillit të Stabilizim-Asociimit, me synim arritjen e zgjidhjeve të kënaqshme për palët.

Acquis e BE-së mbi Pronësisë Intelektuale përbëhen nga disa direktiva të miratuara nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian. Kjo përfshin, ndër të tjera:

- Direktiva 2001/29/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 22 Majit 2001 mbi “Harmonizimin e disa aspekteve të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në Shoqërinë e Informacionit;
- Direktiva 2001/84 EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 Shtatorit 2001 mbi “Të drejtën e rishitjes për përfitimin e autorit të një veprë origjinale arti”;
- Direktiva 2006/115 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 Dhjetorit 2006 mbi “Të drejtën e rishitjes dhe të drejtën e hua-qerasë mbi disa aspekte të caktuara të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në fushën e pronësisë intelektuale”;
- Direktiva 2006/116/ EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 Dhjetorit 2006 mbi “Kohëzgjatjen e mbrojtjes të së drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të”;
- Direktiva 96/9/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 11 Marsit 1996 mbi “Mbrojtjen ligjore të bazës së të dhënave”;
- Direktiva 91/250/EEC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 14 maj 1991, "Për mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike";
- Direktiva 93/83/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 Shtatorit 1993 “Mbi koordinimin e rregullave të caktuara lidhur me të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura e zbatueshme për transmetimet satelitore dhe kablllore”;
- Direktiva 2012/28/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 tetorit 2012 “Mbi përdorimet e lejuara të veprave të caktuara të jetimëve”;
- Direktiva 2014/26/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 26 shkurt 2014 “Mbi administrimin kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura dhe licencimin e të drejtave multi-territoriale të veprave muzikore për përdorim online në tregun e brendshëm”;
- Direktiva 2008/95/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 22 Tetor 2008 për të përafruar ligjet e Shteteve Anëtare në lidhje me markat tregtare;
- Direktiva 98/44/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 6 korrik 1998 mbi “Mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike”;
- Direktiva 98/71/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 13 Tetor 1998 mbi “Mbrojtjen ligjore të disenjave industriale”;
- Direktiva 2004/48/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 29 prill 2004 mbi “Zbatimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale”;
- Rregullorja e Këshillit (EEC) nr. 1768/92 të datës 18 qershor 1992 "Për krijimin e certifikatës shtesë për mbrojtjen e produkteve mjekësore";
- Rregullorja (KE) nr. 1610/96 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 23 korrik 1996 "Për krijimin e certifikatës shtesë për mbrojtjen e produkteve për mbrojtjen e bimëve";

- Rregullorja e Këshillit (EEC) nr. 2081/92 të datës 14 korrik 1992 "Për mbrojtjen e të dhënave gjeografike dhe emërtimet e origjinës së produkteve bujqësore dhe produkteve ushqimore".

II.2 Përmbledhja e arritjeve në legjislacion

Legjislacioni Shqiptar në fushën e të drejtës së autorit përbëhet nga aktet e mëposhtme ligjore:

- Ligji Nr. 9380, datë 28.04.2005 Mbi të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të (publikuar në fletoren Zyrtare nr. 42, datë 13.06.2006 fq-1493-1528) është pjesërisht i përputhur me Acquis e Bashkimit Evropian.
- Direktiva 2001/29/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 22 Majit 2001 mbi "Harmonizimin e disa aspekteve të të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në Shoqërinë e Informacionit;
- Direktiva 2001/84 EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 Shtatorit 2001 mbi "Të drejtën e rishitjes për përfitimin e autorit të një vepre origjinale arti";
- Direktiva 2006/115 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 Dhjetorit 2006 mbi "Të drejtën e rishitjes dhe të drejtën e huqerës mbi disa aspekte të caktuara të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në fushën e pronësisë intelektuale";
- Direktiva 2006/116/ EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 12 Dhjetorit 2006 mbi "Kohëzgjatjen e mbrojtjes të së drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të";
- Direktiva 96/9/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 11 Marsit 1996 mbi "Mbrojtjen ligjore të bazës së të dhënave";
- Direktiva 91/250/EEC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 14 maj 1991, "Për mbrojtjen ligjore të programeve kompjuterike";
- Direktiva 93/83/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 27 Shtatorit 1993 mbi "Koordinimin e rregullave të caktuara lidhur me të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura e zbatueshme për transmetimet satelitore dhe kabllorë".

Pjesë e kuadrit ligjor për funksionim e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit janë dhe:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 232, datë 19.4.2006 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit",
- VKM 343 datë 06.06.2007 "Për miratimin e tarifave që ofron Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit".

Aktet e mëposhtme nënligjore dalë në zbatim të ligjit nr. 9947 datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale" janë:

- VKM Nr. 1707, datë 29.12.2008, "Për miratimin e rregullores për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit" ndryshuar me VKM Nr. 618 datë 07.09.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 1707 datë 29.12.2008 "Për miratimin e rregullores për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit";
- VKM Nr. 1706, datë 29.12.2008, "Për miratimin e rregullores për regjistrimin e markave tregtare dhe të shërbimit;

- VKM Nr. 1705 dt. 29.12.2008, “Për miratimin e rregullores për regjistrimin e treguesve gjeografikë;
- VKM Nr. 381 datë 08.04.2009, “Për miratimin e rregullores për regjistrimin e disenjove industriale”;
- VKM Nr. 883 datë 13.05.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të Pronësisë Industriale” ndryshuar me VKM Nr. 433 datë 16.06.2011 “Për një ndryshim në VKM Nr. 883 datë 13.05.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”.

Ligji Nr. 8488 datë 13.05.1999 “Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara” i cili synon harmonizimin e plotë të legjislacionit kombëtar me Direktivën Nr. 87/54 “Për mbrojtjen ligjore të topografisë së qarqeve të integruara”.

II.3 Institucionet përgjegjëse

II.3.1 Të drejtat e autorit dhe të drejtat tjera të lidhura me të

Institucionet qendrore, përgjegjëse për këtë kapitull janë Ministria e Kulturës si dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, konkretisht Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Markave dhe Patentave. Institucione të tjera, të përfshira në procesin e zbatimit, janë si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- Autoriteti i Mediave Audiovizive;
- Inspektorati i Tregut (pas krijimit të këtij organi);
- Policia e Shtetit – Drejtoria e Krimit Ekonomik;
- Ministria e Drejtësisë;
- Ministria e Arsimit;
- Shkolla e Magjistraturës;
- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
- Shoqëritë e menaxhimit kolektiv mbi copyright dhe të drejtat e lidhura me to.

II.3.2 Të drejtat e pronësisë industriale

Institucionet kryesore për zbatimin e këtij kapitulli janë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Kulturës, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave dhe Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit.

Institucionet drejtpërdrejt përgjegjëse për zbatimin e të drejtave të pronësisë industriale janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- Prokuroria;
- Policia e Krimit Ekonomik;
- Sistemi gjyqësor që ka të bëjë kryesisht me Gjykatën e Tiranës;
- Ministria e Arsimit;
- Ministria e Drejtësisë;
- Inspektoriati i Tregut (pas krijimit të tij);
- Shkolla e Magjistraturës.

Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian që merret me kapitullin 7 "Pronësia Intelektuale", udhëhiqet dhe koordinohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe përbëhet nga:

- Ministria e Kulturës
- Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave
- Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit

II.4 Treguesit e burimit financiar

II.4.1 E drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura me të

	2012	2013	2014	2015
SHUMA TOTALE	934.000	31.590	116 029 510	810 30.500
Mbështetja nga buxheti i shtetit	134.000	31.590	29.510	30.500
Ndihma e huaj	800 000	0	116 000 000	81 000 000

II.4.2 Te drejtat e pronësisë industriale

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	75.888.000	44.640.000	20.000.000	23.000.000
Mbulohen nga buxheti i shtetit	20.000.000	20.000.000	20.000.000	23.000.000
Ndihma e huaj	55.888.000	24.640.000	0	0
	0	0	0	0

III. Prioritetet

Rekomandimet e Komisionit Evropian (Raporti i Progresit 2013) janë si më poshtë:

- Shqipëria duhet të rrisë përpjekjet e saj për t'i kaluar problemet ekzistuese në përputhje me angazhimet e saj në kuadër të Nenit 73 të MSA-së.
- Shqipëria duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar zbatimin efikas të Strategjisë Kombëtare mbi Pronësinë Intelektuale, duke rritur bashkëveprimin ndër-institucional si çështje prioritare dhe për një monitorim më të mirë të kësaj strategjie.
- Shqipëria duhet të marrë hapa urgjentë për krijimin dhe funksionimin e plotë të Inspektoriatit të Tregut, me qëllim zbatimin e kornizës ligjore në fuqi, lidhur me Pronësinë Intelektuale.
- Shqipëria duhet të miratojë sa më shpejt të jetë e mundur, Ligjin e ri mbi të drejtën e autorit si dhe amendimet e ligjit mbi pronësinë industriale.
- Shqipëria duhet të rrisë ndërgjegjësimin për të drejtat e Pronësisë Intelektuale midis publikut të gjerë, grupeve të interesit, përfshirë këtu edhe gjykatat.

Prioritetet e ZSHDA-së janë:

Prioritetet afatshkurtra:

- Përmirësimi i burimeve njerëzore, duke përfshirë trajnimin dhe shtimin e stafit të ZSHDA-së;
- Konsolidimi dhe forcimi i rrjetit të zyrave rajonale të të drejtave të autorit;
- Bashkëpunimi dhe koordinimi ndër-institucional i organeve shtetërore të cilat janë pjesë e zbatimit të të drejtave të PI-së;
- Trajnimi i autoriteteve shtetërore përgjegjëse për zbatimin më drejtave të PI-së;
- Trajnimi, në veçanti i autoriteteve gjyqësore për çështjet e PI-së;
- Zhvillimi i aktiviteteve promovuese për rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë dhe të bizneseve;
- Zbatimi i Strategjisë së PI-së si dhe i planit të veprimit.

Prioritet afat-shkurtër:

- Përmirësimi i burimeve njerëzore duke përfshirë trajnimet dhe shtimin e stafit të ZSHDA-së;
- Konsolidimi dhe forcimi i rrjetit të zyrave rajonale të të drejtës së autorit;
- Bashkëpunimi dhe koordinimi ndër-institucional i institucioneve shtetërore të cilat janë pjesë e zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale;
- Trajnimi i institucioneve përgjegjëse për zbatimin e të drejtave të PI-së;
- Trajnimi, në veçanti i autoriteteve gjyqësore mbi çështjet e PI-së;
- Organizimi i aktiviteteve promionale dhe ndërgjegjëse për të rritur ndërgjegjësimin e publikut në përgjithësi dhe të biznesit;
- Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të PI-së si dhe i planit të veprimit.

Prioritete afat-mesme:

- Krijimi i një mekanizmi të vazhdueshëm për të forcuar bashkëpunimin me agjencitë e administrimit kolektiv;
- Krijimi i grupit të punës për shkeljet në internet me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe Autoriteti i Medias Audiovizuale (AAM)
- Zyra Shqiptare e të Drejtës së Autorit do të ofrojë mbështetje për AKEP-in, AKSHI-n dhe AMA-n për të monitoruar zonat e tyre të tregut;
- Organizimi dhe zbatimi i fushatave të ndërgjegjësimit publik mbi çështjet e pronësisë intelektuale;
- Forcimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit;
- Aplikimi i regjistrimit on-line (e-registration) të të drejtave të autorit;
- Futja në kurrikulat mësimore, të koncepteve dhe leksioneve të të drejtave të PI-së, për arsimin e sistemit para- universitar.

Prioritetet e DPPM-se në periudhë afatshkurtër:

- Aprovimi nga Parlamenti i draft Ligjit “Për Pronësinë Industriale”;
- Aprovimi nga Parlamenti i draft Ligjit “Për Topografinë dhe Qarqet e Integruar”;
- Forcimin e kapaciteteve administrative të saj dhe të infrastrukturës së TI-së;
- Forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe organizatave të përfshira në sistemin e mbrojtjes së Pronësisë Industriale;
- Trajnimin e autoriteteve shtetërore në drejtim të zbatimit të ligjit;
- Trajnimin e autoriteteve gjyqësore në lidhje me PI-së;
- Fuqizimin e qendrës së informacionit teknik dhe shkencor;
- Zhvillimin e aktiviteteve promovuese me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë dhe biznesit;

- Krijimi i Arkivës on-line;
- Zbatimin e Strategjisë së PI-së.

Prioritetet e DPPM-se në periudhe afat-mesme:

- Trajnimin e biznesit lidhur me rëndësinë e të drejtave të Pronësisë Industriale.
- Trajnimin e autoriteteve të zbatimit të ligjit për PI-në;
- Trajnimin e autoriteteve gjyqësore me çështjet e PI-së;
- Zbatimin e aplikimit on-line;
- Trajnimi i stafit të DPPM-së, përfaqësuesve të autorizuar dhe grupeve të interesit;
- Futjen e kurrikulave mësimore si koncept dhe si lëndë në shkollat e mesme dhe universitet.

IV. Plani i veprimit për vitet 2014 – 2016

IV.1 E drejta e autorit dhe të drejta të lidhura me të

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni përgjegjës	Periudha e referencës
Strategjia Kombëtare për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, (Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave) në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën shqiptare për të Drejtat e Autorit	2010-2015

Inventari i masave ligjore ekzistuese

Acquis i BE	Legjislacioni shqiptar	Institucioni përgjegjës	Niveli i përshtatjes (i plotë/ i pjesshëm/ jo në përputhje)	Data e miratimit (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 93/83/EC	Ligji Nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të”	Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit	Pjesërisht i përputhur	28.04.2005	28.06.2005
Direktiva 2001/84 EC	Ligji Nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të	Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit	Pjesërisht i përputhur	28.04.2005	28.06.2005

	Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të”				
Direktiva 2006/115 EC	Ligji Nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të”	Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit	Pjesërisht i përputhur	28.04.2005	28.06.2005
Direktiva 2006/116 EC	Ligji Nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të”	Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit	Pjesërisht i përputhur	28.04.2005	28.06.2005
Direktiva 96/9/EC	Ligji Nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të”	Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit	Pjesërisht i përputhur	28.04.2005	28.06.2005
Direktiva 2009/24/EC	Ligji Nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të”	Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit	Pjesërisht i përputhur	28.04.2005	28.06.2005
Direktiva 2001/29/EC	Ligji Nr. 9380, datë 28.04.2005 “Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të tjera të Lidhura me të”	Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit	Pjesërisht i përputhur	28.04.2005	28.06.2005

Korniza Politike e planifikuar në 2014 – 2016

Titulli	Institucioni përgjegjës	Periudha e referencës	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Strategjia Kombëtare për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, e rishikuar	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, DPPM, ZSHDA	2016-2020	3 maji i katërt 2015	3 maji i parë 2016

Masat ligjore e planifikuara në 2014 – 2016

Acquis i BE	Statusi i përkthimit në shqip	Legjislacioni shqiptar (Ligjet dhe aktet nënligjore)	Statusi i përkthimit në anglisht	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përshtatjes (përshtatje e plotë / e pjesshme)	Data e planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
Direktiva 2006/116/EC	Jo	Ligji “Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të”	Jo	Ministria e Kulturës, ZSHDA	I plotë	3 muji 3 /2014	3 muji 4/2014
Direktiva 2006/116/EC	Jo	Ligji “Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të”.	Jo	Ministria e Kulturës, ZSHDA	I plotë	3 muji 3 /2014	3 muji 4/2014
Direktiva 2004/48/EC	Jo	Ligji “Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të”.	Jo	Ministria e Kulturës, ZSHDA	I plotë	3 muji 3 /2014	3 muji 4/2014
Direktiva 96/6/EC	Jo	Ligji “Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të”.	Jo	Ministria e Kulturës, ZSHDA	I plotë	3 muji 3 /2014	3 muji 4/2014
Direktiva 2001/84/EC	Jo	Ligji “Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të”.	Jo	Ministria e Kulturës, ZSHDA	I pjesshëm	3 muji 3 /2014	3 muji 4/2014
Direktiva 2009/24/EC	Jo	Ligji “Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të”.	Jo	Ministria e Kulturës, ZSHDA	I pjesshëm	3 muji 3 /2014	3 muji 4/2014
Direktiva 2001/29/EC	Jo	Ligji “Për të Drejtën e Autorit dhe të drejta të Tjera të Lidhura me të”.	Jo	Ministria e Kulturës, ZSHDA	I pjesshëm	3 muji 3 /2014	3 muji 4/2014

AFAT MESEM (2015 – 2016)							
Direktiva 2014/26 / BE	Jo	Projekt ligji mbi “Të drejtën e Autorit dhe të Drejta të tjera të Lidhura me Të”	Jo	Ministria e Kulturës, Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit.	I pjesshëm	3 muhori i tretë 2016	3 muhori i katërt 2016

Plan i veprimeve për periudhën 2014 – 2016

IV.2 E drejta e pronësisë industriale

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia Kombëtare për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, DPPM	2010-2015

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Acquis e BE	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 98/44/EC	Ligji nr 9947 i 2008/07/07 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar	DPPM	I pjesshëm	7.7.2008	1.11.2008
Direktiva 98/71/EC	Ligji nr 9947 i 2008/07/07 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar	DPPM	I pjesshëm	7.7.2008	1.11.2008
Direktiva 2008/95/EC	Ligji nr 9947 i 2008/07/07 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar	DPPM	I pjesshëm	7.7.2008	1.11.2008
Direktiva 2004/48/EC	Ligji nr 9947 i 2008/07/07 "Për pronësinë industriale", i	DPPM	I pjesshëm	7.7.2008	1.11.2008

	ndryshuar				
Direktiva 87/54/EEC	Ligji nr 8488 i 1999/05/13 "Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara", i ndryshuar	DPPM	I pjesshëm	13.5.1999	3.8.1999

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Strategjia Kombëtare për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale e rishikuar.	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes; DPPM.	2016-2020	3 majori i 4/2015	3 majori i I/ 2016

Masat ligjore të planifikuara 2014 – 2016

Acquis i BE	Statusi i përkthimit në shqip	Legjislacioni shqiptar (Ligjet dhe aktet nënligjore)	Statusi i përkthimit në anglisht	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përshtatjes (përshtatje e plotë / e pjesshme)	Data e planifikuar e miratimit	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2014)							
Direktiva 98/44/EC	Jo	Projektligji për disa ndryshime në ligjin Nr. 9947 të 07/07/2008 "Për Pronësinë industriale" që ka për qëllim përafrimin e plotë me aktet e mëposhtme të BE-së.	Po	DPPM	E plotë	3 majori 2/2014	3majori i II/2014
Direktiva 98/71/EC	Jo	Projektligji për disa ndryshime në ligjin Nr. 9947 të 07/07/2008 "Për Pronësinë industriale" që ka për qëllim përafrimin e plotë me aktet e mëposhtme të BE-së.	Po	DPPM	E plotë	3 majori 2/2014	3majori i II/2014

Direktiva 2008/95/EC	Jo	Projektligji për disa ndryshime në ligjin Nr. 9947 të 07/07/2008 "Për Pronësinë industriale" që ka për qëllim përafrimin e plotë me aktet e mëposhtme të BE-së.	Po	DPPM	E plotë	3 mujori 2/2014	3mujori i II/2014
Direktiva 2004/48/EC	Jo	Projektligji për disa ndryshime në ligjin Nr. 9947 të 07/07/2008 "Për Pronësinë industriale" që ka për qëllim përafrimin e plotë me aktet e mëposhtme të BE-së.	Po	DPPM	E plotë	3 mujori 2/2014	3mujori i II/2014
Direktiva 87/54/EEC	Jo	Projektligji për disa ndryshime në ligjin nr 8488 të 1999/05/13 "Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara".	Po	DPPM	E plotë	3 mujori 2/2014	3mujori i II/2014
<u>AFAT MESËM (2015 – 2016)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Plani i veprimit për vitet 2014 – 2016

IV.3 Zbatimi i të drejtave të pronësisë intelektuale

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periodha e referuar
Strategjia Kombëtare për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, DPPM	2010-2015
Strategjia e Doganës për të drejtat e PI	DPD (Drejtoria e PI)	2013-2015

Inventari i masave ligjore ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2004/48/EC	Ligji nr. 23/2012, datë 01.03.2012 "Për disa ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon sanksione penale kundër atyre që shkelin të drejtat e pronësisë industriale".	Ministria e Drejtësisë	E plotë	01.03. 2012	11.04.2012
- Sistemi për certifikimin e energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme, bazuar në garancitë e origjinës, duhet zbatuar nga ERE si institucioni përgjegjës.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2014 – 2016

IV.1 Siguria e furnizimit

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periodha e referuar
Strategjia Kombëtare e Energjisë 2015	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	2003 – 2015

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2005/89/KE	Ligji Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë elektrike”	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I pjesshëm	22.05.2003	18.07.2003
	Ligji Nr. 10362, datë 16.12.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 9072, datë 22.05.2003 „Për sektorin e energjisë”	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I pjesshëm	16.12.2010	24.01.2011
Rregullorja 714/2009	Ligji Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë”	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I pjesshëm	22.05.2003	18.07.2003
	Ligji Nr. 10362, datë 16.12.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9072, datë 22.05.2003	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I pjesshëm	16.12.2010	24.01.2011

	“Për sektorin e energjisë”				
--	----------------------------	--	--	--	--

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Strategjia në sektorin e energjisë	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	2015-2030	Tremujori i II-të 2014	Tremujori II-të 2014

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/ përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
Direktiva 2005/89/KE	Po	Ligji i sektorit të energjisë elektrike	Po	Ministria e Energjisë dhe industrisë	I plotë	Tremujori IV, 2014	Tremujori IV, 2014
Rregullorja 714/2009	Po	Ligji i sektorit të energjisë elektrike	Po	Ministria e Energjisë dhe industrisë	I plotë	Tremujori IV, 2014	Tremujori IV, 2014
<u>AFAT MESEM (2015 – 2016)</u>							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

IV.2 Tregu i energjisë

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia Kombëtare e Energjisë 2015	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	2003 – 2015

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2009/72/KE	Ligji Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë”	Ministria e Energjisë dhe Industriës	I pjesshëm	22.05.2003	18.07.2003
	Ligj Nr. 10362 datë 16.12.2010 “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 9072, datë 22.05.2003 „Për Sektorin e Energjisë”	Ministria e Energjisë dhe Industriës	I pjesshëm	16.12.2010	24.01.2011
Rregullorja 714/2009	Ligji Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë”	Ministria e Energjisë dhe Industriës	I pjesshëm	22.05.2013	18.07.2003
	Ligj Nr. 10362 datë 16.12.2010 “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 9072, datë 22.05.2003 „Për Sektorin e Energjisë”	Ministria e Energjisë dhe Industriës	I pjesshëm	16.12.2010	24.01.2011
Traktati i krijimit të Komunitetit të Energjisë	Ligji Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë”	Ministria e Energjisë dhe Industriës	I pjesshëm	22.05.2003	18.07.2003
	Ligj Nr. 10362 datë	Ministria e Energjisë dhe			

	16.12.2010 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9072, datë 22.05.2003 „Për Sektorin e Energjisë”	Industrië	I pjesshëm	16.12.2010	24.01.2011
--	---	-----------	------------	------------	------------

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Strategjia e Sektorit të Energjisë	Ministria e Energjisë dhe Industrië	2015-2030	Tremujori i II-të 2014	Tremujori i II-të 2014

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFATSHKURTËR (2014)</u>							
<u>AFATMESEËM (2015 – 2016)</u>							
Direktiva 2009/72/KE	Po	Modeli i Tregut të energjisë elektrike	Po	Ministria e Energjisë dhe industrië	I plotë	Tremujori II, 2015	Tremujori II, 2015
Rregullorja 714/2009	Po	Modeli i Tregut të energjisë elektrike	Po	Ministria e Energjisë dhe industrië	I plotë	Tremujori II, 2015	Tremujori II, 2015

IV.3 Eficenca e energjisë dhe burimet e rinovueshme të energjisë

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia Kombëtare e Energjisë 2015	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	2003 – 2015

Inventari i masave ligjore ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2009/28/KE	Ligji 138/2013	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	E pjesshme	8.02.2013	2.05.2013
Direktiva 2010/30/EC	Ligji 68/2012	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	E plotë	10.04.2012	21.06.2012

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Strategjia e Sektorit të Energjisë	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	2015-2030	Tremujori i II-të 2014	Tremujori i II-të 2014

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
Direktiva 2009/28/KE	Po	Amendimi i Ligjit 138/2013, datë 05.05.2013 “Për Energjitë e	Po	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plote	Tremujori i I-rë 2015	Tremujori i II-të 2015

		Rinovueshme”					
	Po	Projekt VKM për Planin Kombëtar i veprimit për Energjitë e Rinovueshme 2014-2020	Jo	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	Tremujori i I-rë 2015	Tremujori i II-të 2015
	Po	Projekt VKM për një përmbledhje të rregullave kombëtare lidhur me autorizimet, certifikimet dhe procedurat e licencimit që janë aplikuar për të ndërtuar një impiant energjetik nga BRE të shoqëruara me infrastrukturën e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes për prodhimin e energjisë elektrike.	Jo	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	Tremujori i I-rë 2015	Tremujori i II-të 2015
	Po	Projekt VKM për miratimin e strategjisë 2014-2020 për prodhimin e energjisë nga impiante energjetike të decentralizuara me Burime të Rinovueshme.	Jo	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plote	Tremujori i I-rë 2015	Tremujori i II-të 2015

Direktiva 2012/27/KE	Po	Projektligji për Eficencën e Energjisë	Po	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	Tremujori i II-të 2014	Tremujori i III-të 2014
	Po	Projekt VKM për Targetet Kombëtare 2 vjeçare për Investimet në fushën e Eficencës së Energjisë	Po	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	Tremujori i II-të 2014	Tremujori i IV-të 2014
	Po	Projekt VKM për Planin e 2 ^{te} vjetor Kombëtar për Eficencën e Energjisë	Po	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	Tremujori i II-të 2014	Tremujori i IV-të 2014
		VKM për përmbledhjen e rregullave kombëtare për autorizimet, certifikimin dhe procedurat e licencimit për audituesit e energjisë, mënyrës së marrjes së informacionit energjetik të konsumatorëve fundore.	Po	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	Tremujori i III-të 2014	Tremujori i I-rë 2015
	Po	VKM për fondin e Eficencës së Energjisë.	Po	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	Tremujori i IV-të 2014	Tremujori i I-rë 2015
	Po	VKM për zyrat rajonale të mbledhjes së informacionit nga	Po	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	Tremujori i IV-të 2014	Tremujori i I-rë 2015

		auditues energjetike dhe funksionimit të regjistrit kombëtar të Eficencës së Energjisë					
Po	VKM për miratimin e Software-it kombëtar për vlerësimin e potencialit energjetik.	Po	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	Tremujori i IV-të 2014	Tremujori i I-rë 2015	
Po	VKM për Inspektimin e Impianteve që përdorin energjinë dhe klasifikimi i tyre	Po	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	Tremujori i IV-të 2014	Tremujori i I-rë 2015	
Po	VKM për Kodin Energjetik të Ndërtesave në funksion të kostos së ndërtimit dhe rinovimit me qëllim eficientë e energjisë.	Po	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	Tremujori i IV-të 2014	Tremujori i I-rë 2015	
Po	VKM për metodikën e Kostos Optimale të vendosjes për impiantet që konsumojnë energji	Po	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	Tremujori i IV-të 2014	Tremujori i I-rë 2015	
Po	VKM për heqjen nga tregu i llambave inkandeshente dhe	Po	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I plotë	Tremujori i IV-të 2014	Tremujori i I-rë 2015	

		zëvendësimin me llambat ekonomike.					
--	--	------------------------------------	--	--	--	--	--

IV.4 Siguria bërthamore dhe mbrojtja nga rrezatimet

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periodha e referuar
n/a	n/a	n/a

Inventari i masave ligjore ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
1999/519/EC: Rekomandim i Këshillit i datës 12 korrik 1999 mbi kufizimet në ekspozimin e publikut ndaj fushave elektromagnetike (0 Hz deri në 300 GHz)	Ligji Nr. 10469, datë 13.10.2011 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”.	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	13.10.2011	15.11.2011
	Ligji Nr. 27/2013 “Mbi disa ndryshime në Ligjin Nr. 10469, datë 13.10.2011 „Mbi mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	14.02.2013	
	Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 743, datë 16.10.2012 “Për miratimin e Rregullores për mbrojtjen e publikut nga rrezatimet jojonizuese	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	16.10.2012	16.10.2012
Direktiva 96/29/KE	Ligji Nr. 8025, datë	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	9.11.1995	20.12.1995

	9.11.1995 “Mbi mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”				
	Ligji Nr. 9973, datë 28.07.2008 “Mbi disa ndryshime në Ligjin Nr. 8025, datë 9.11.1995 „Mbi mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	28.07.2008	19.08.2008
	Ligji Nr. 26, datë 14.02.2013 “Mbi disa ndryshime në Ligjin Nr. 8025, datë 9.11.1995 „Mbi mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	14.02.2013	
	Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 10, datë 7.01.2010 “Mbi miratimin e Rregullores mbi licencimin dhe inspektimin e aktiviteteve me rrezatim jonizues”	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	7.01.2010	7.01.2010
	Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 543, datë 7.07.2010 “Mbi miratimin e Rregullores mbi punën e sigurtë të burimeve të rrezatimeve jonizuese”	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	7.07.2010	19.08.2010
	Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 590, datë	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	18.08.2011	22.09.2011

	18.08.2011 “Mbi miratimin e Rregullores për mbrojtjen e punëtorëve të profesioneve të ekspozuar ndaj rrezatimit jonizues” Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 591, datë 18.08.2011 “Për miratimin e Rregullores mbi nivelet e lejuara të përqendrimit të radonit në ndërtesa dhe ujë, nivelet udhëzuese të radionuklideve në materialet e ndërtimit, si dhe mbi nivelet e lejuara të radionuklidëve në ushqime dhe produkte kozmetike” Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 481, datë 25.07.2012 “Mbi miratimin e Rregullores për sigurinë e publikut ndaj ekspozimeve që shkaktohen nga burimet e rrezatimit jonizues”	Ministria e Shëndetësisë Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm I pjesshëm	18.08.2011 25.07.2012	22.09.2011 30.08.2012
Direktiva 2003/122/Euratom	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 344, datë 29.04.2011 “Mbi sigurinë fizike të materialeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	29.04.2011	31.05.2011
Rekomandimi	Vendimi i Këshillit të	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	9.05.2012	13.06.2012

2000/473/Euratom	Ministrave Nr. 313, datë 9.05.2012 “Mbi miratimin e Rregullores për mbrojtjen e publikut nga shkarkimet në mjedis, përcaktimin e mostrave, rajoneve dhe frekuencës së matjeve”				
Direktiva e Këshillit 97/43/Euratom	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 229, datë 20.03.2013 “Mbi miratimin e Rregullores për sigurinë ndaj ekspozimeve mjekësore me burime të rrezatimit jonizues”	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	20.03.2013	16.04.2013

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Strategjia mbi menaxhimin e sigurtë të mbetjeve radioaktive	Ministria e Shëndetësisë	Shumëvjeçare	Tremujori i IV-të 2014	Tremujori i IV-të 2014
Strategjia mbi mbrojtjen dhe sigurinë nga rrezatimet	Ministria e Shëndetësisë	Shumëvjeçare	Tremujori i IV-të 2016	Tremujori i IV-të 2016
Politika dhe strategjia e edukimit dhe trajnimit	Ministria e Shëndetësisë	Shumëvjeçare	Tremujori i IV-të 2016	Tremujori i IV-të 2016

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFATSHKURTËR (2014)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

AFATMESME (2015 – 2016)

Direktiva 90/641/Euratom	Jo	Projekt vendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores për mbrojtjen e punëtorëve të profesioneve të ekspozuar gjatë procesit të punës ndaj rrezatimit jonizues”	Jo	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	Tremujori i IV-të 2015	Tremujori i IV-të 2015
-----------------------------	----	--	----	-----------------------------	------------	---------------------------	---------------------------

KAPITULLI 16: TATIMET

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Objektivi kryesor lidhur me politikat tatimore është përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian si edhe përmirësimi i administrimit të tatimeve në rritjen e bazës së taksueshme. Ky objektiv strategjik do të realizohet nëpërmjet:

- harmonizimit të politikave tatimore me *acquis* e BE-së;
- krijimit të klimës së biznesit të favorshme për zhvillimin dinamik të sipërmarrjes private dhe tërheqjen e investimeve të huaja;
- formulimit të politikave tatimore që mbështesin zhvillimin ekonomik dhe social në Shqipëri dhe nxisin formalizimin e ekonomisë;
- përmirësimit të menaxhimit të administratës tatimore, duke u bazuar në realizimin e të ardhurave me profesionalizëm, integritet dhe ndershmëri, me një standard që krijon besueshmëri tek qytetarët dhe kredibilitet me partnerët ndërkombëtarë dhe komunitetin e biznesit, vendas dhe të huaj.

I.2 Situata në Shqipëri

Shqipëria ka bërë progres në përafrimin e legjislacionit të saj me *acquis*. Për vitin 2014, është planifikuar një ligj i ri i TVSH-së, i cili harmonizon legjislacionin e Shqipërisë me Direktivat e ndryshuara të BE-së. Ndryshimet janë bërë në legjislacionin e akcizës për të arritur një lidhje të mëtijshme me *acquis* e BE për sa i përket nivelit dhe strukturës së akcizës së cigareve dhe birrës.

Shqipëria ka nënshkruar një marrëveshje me FMN-në për të arritur konsolidimin fiskal nëpërmjet përmirësimit të administratës tatimore dhe forcimin e menaxhimit të financave publike. Një komponent i rëndësishëm i marrëveshjes është shlyerja e borxheve, duke përfshirë këtu edhe borxhet për TVSH-në.

I.3 Struktura e Kapitullit

1. POLITIKAT TATIMORE
2. TATIMI DIREKT
3. TATIMI INDIREKT
4. NDIHMA E NDËRSJELLË

II. Situata Aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe e legjislacionit të BE-së.

Neni 98 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit parashikon se, Shqipëria dhe BE-ja do të vendosin bashkëpunimin në fushën e tatimeve, duke përfshirë masat që synojnë reformimin e mëtejshëm të sistemit fiskal dhe ristrukturimin e administratës tatimore, me qëllim që të sigurohet efikasitet në mbledhjen e taksave dhe luftën kundër evazionit fiskal. Për më tepër, ky bashkëpunim duhet të marrë në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* e BE-së në fushën e tatimeve dhe të luftës kundër konkurrencës së dëmshme të tatimeve. Në këtë drejtim, Shqipëria dhe BE-ja e njohin rëndësinë e përmirësimit të transparencës dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i masave që parandalojnë mospagimin ose evazionin tatimor. Neni 98 i MSA gjithashtu, kërkon konsultime ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së me qëllim që të eliminohet konkurrenca e dëmshme e tatimeve ndërmjet Shteteve Anëtare të BE-së dhe Shqipërisë, për të siguruar një nivel të barabartë përsa i përket tatimit të biznesit.

Ligji i BE-së në fushën e tatimeve përbëhet nga disa akte ligjore. Në nivelin e ligjit primar, neni 110 i TFBE (Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian), i cili ndalon diskriminimin e taksave është i një rëndësie vendimtare. Legjislacioni sekondar ndër të tjera përfshin:

- Direktivën e Këshillit 2008/118/EC, e datës 16 dhjetor 2008, “në lidhje me masat e përgjithshme për akcizën dhe shfuqizimin e Direktivës 92/12/KEE”;
- Direktivën e Këshillit 2006/112/KE, 28 nëntor 2006, “Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar”;
- Direktivën e Këshillit 2003/48/KE, 3 qershor 2003, “Mbi tatimin nga të ardhurat e kursimeve në formën e pagesave të interesit”;
- Direktivën e Këshillit 2009/133/KE, 19 tetor 2009, “Në sistemin e përbashkët të taksimit, të zbatueshëm për bashkimet, ndarjet, ndarjet e pjesshme, transfertat e aktiveve dhe shkëmbimet e aksioneve në lidhje me kompanitë e Shteteve të ndryshme Anëtare dhe për transferimin e zyrës regjistruese të një Kompanie Evropiane ose Shoqërie të Bashkuar Evropiane ndërmjet Shteteve Anëtare”;
- Direktivën e Këshillit 2010/24/EU, 16 mars 2010, “Mbi asistencën e ndërsjellë për rimëkëmbjen e kërkesave lidhur me taksat, detyrimet dhe masat e tjera”;
- Direktivën e Këshillit 2011/16/BE, të datës 15 shkurt 2011, “Për bashkëpunimin administrativ në fushën e tatimeve”;
- Rregulloren e Këshillit (BE) Nr. 904/2010, 7 tetor 2010, “Mbi bashkëpunimin administrativ dhe luftën e mashtrimit në fushën e tatimit mbi vlerën e shtuar”;
- Rregulloren e Këshillit (BE) Nr. 2073/2004, 16 nëntor 2004, “Mbi bashkëpunimin administrativ në fushën e detyrimeve të akcizës”;
- Rregulloren e Këshillit 2004/106/KE, 16 nëntor 2004 “Që amendon Direktivën 77/799/KEE, në lidhje me ndihmën reciproke nga autoritetet kompetente të Shteteve Anëtare në fushën e tatimeve direkte, detyrimeve të caktuara të akcizës dhe tatimit mbi primet e

sigurimit dhe 92/12/KEE mbi masat e përgjithshme për produktet që i nënshtrohen akcizës dhe të mbajtjes, lëvizjes dhe monitorimit të këtyre produkteve”.

II. 2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve janë fokusuar në përafrimin e legjislacionit fiskal me *acquis* duke synuar uljen e barrës tatimore për biznesin dhe individët, duke rritur bazën e taksueshme, hartimin e politikave tatimore që mbështesin zhvillimin ekonomik dhe social në Shqipëri dhe nxisin formalizimin e ekonomisë. Zëvendësimi i sistemit aktual informatik me një sistem të ri më modern, nëpërmjet projektit “E-Taxation” do të ridizenjojë brenda një kohe shumë të shkurtër të gjitha proceset e Administratës Tatimore, duke zëvendësuar transaksionet kyçe të sistemeve të vjetruara. Projekti E-Taxation ka për qëllim të njësojë operacionet e administratës tatimore me praktikën më të mira të Bashkimit Evropian dhe projektet tatimore. Bashkëpunimi administrativ dhe asistencë e ndërsjellë, si edhe efikasiteti i sistemit të brendshëm antikorupsion dhe të hetimit tatimor janë rritur.

Që nga viti 2013 janë miratuar aktet ligjore vijim:

- Ligji Nr. 178/2013, datë 2013/12/28 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 9975, datë 28.07.2008, "Për Taksat Kombëtare" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 177/2013, datë 2013/12/28 "Për disa ndryshime në ligjin nr 8438", datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat ", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 181/2013, datë 2013/12/28 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 184/2013, datë 2013/12/28 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10383, datë 24.02.2011, "Për kujdesin shëndetësor të detyrueshëm në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji Nr. 182/2013, datë 2013/12/28 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995, "Për TVSH-në ", i ndryshuar;

Furnizimi i mjekësisë dhe kujdesit shëndetësor përjashtohen nga TVSH-ja duke filluar nga data 1 prill 2014. Kjo është një politikë e re e taksave në fushën e TVSH-së për sa i përket mjekësisë dhe shërbimeve shëndetësore. Përjashtimi nga TVSH-ja i shërbimit të kujdesit shëndetësor është në përputhje me Direktivën e Këshillit 2006/112/KE.

Në sektorin e hidrokarbureve, përjashtimi nga TVSH-ja për importin e mallrave dhe furnizimet vendore nga kontraktorët dhe nënkontraktorët në fazën e zhvillimit është hequr (por jo importet dhe furnizimet e brendshme për fazën e kërkimit). Kjo është relevante për përafrimin me Direktivën e Këshillit 2006/112/KE.

- Ligji Nr. 179/2013, datë 2013/12/28 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 180/2013, datë 2013/12/28 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë".

Ndryshimet në këtë ligj, rishikojnë nivelin e akcizës për një gamë të gjerë të produktesh, përkatësisht: cigare, duhan, birrë, pije alkoolike me rritje graduale të normës me qëllim arritjen e normave të Direktivës së Këshillit 2008/118/KE. Në Sektorin e Hidrokarbureve, përjashtimi nga akciza për importet e produkteve të naftës të përdorura për nevojat e tyre nga kompanitë e kërkimit të naftës u hoq. Ky ndryshim u bë me qëllim përafrimin me Direktivën e Këshillit 2008/118/KE.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për këtë kapitull janë Ministria e Financave (Përfaqësuar nga Drejtoria e Politikave dhe Marrëdhënieve Fiskale) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Ministria e Financave është institucioni kryesor.

Drejtoria e Politikave dhe Marrëdhënieve Fiskale harton ligjet fiskale, duke respektuar programin ekonomik dhe bën një analizë të thellë të ekonomisë në rajon.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) është institucioni kryesor tatimor në Republikën e Shqipërisë dhe autoriteti që ka të drejtën e implementimit të ligjeve fiskale, administrimit të taksave dhe tarifave ndërkombëtare. Qëllimi kryesor i DPT-së është të ndihmojë tatimpaguesit të paguajnë detyrimet e tyre tatimore në përputhje me ligjet e zbatueshme tatimore dhe të sigurojë që të ardhurat nga taksat të shkojnë në llogaritë e buxhetit të shtetit, duke i ofruar Tatimpaguesve një sistem efektiv pagesash.

Grupi Ndër-Institucional i Punës për Integrimin Evropian, i krijuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 107, datë 28.02.2014, "Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndër-Institucionale të Punës për Integrimin Evropian", për Kapitullin 16 "Tatimet" kryesohet nga Ministria e Financave dhe përbëhet nga përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare kind contribution

Në kuadër të Projektit IFC në lidhje me rishikimin e procedurave tatimore, ndarja e fondeve është si më poshtë:

	2012	2013	2014	2015
Kosto totale		600.000 \$	600.000 \$	600.000 \$
Ministria e Financave (Kontributi Cash)		50.000 \$		
IFC		450.000 \$		
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (Kontributi në natyrë)		100.000 \$		

Kostoja totale e projektit është 600.000 \$ për periudhën mars 2013-2015.

III. Prioritetet

Aktualisht, legjislacioni fiskal shqiptar është pjesërisht në përputhje me *acquis* e BE-së. Ligji 61/2012 "Për akcizën në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është pjesërisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Shqipëria filloi zbatimin e ligjit të ri të akcizës në 1 tetor 2012. Në një periudhë afat-mesme, fokusi ynë kryesor do të jetë përafrimi i mëtejshëm i strukturës dhe normave të akcizës me *acquis* lidhur me akcizën e alkooleve. Për vitin 2014, prioritet kryesor është përafrimi i legjislacionit vendas me *acquis* për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Një ligj i ri për TVSH-në është planifikuar të hyjë në fuqi në tre-mujorin e parë të vitit 2015. Ky ligj do të përafrojë legjislacionin shqiptar me Direktivën 2006/112/KE. Lidhur me transferimin e çmimit, ligji ka hyrë në fuqi në qershor 2014, duke përcaktuar parimet e zbatimit të transferimit të çmimit.

IV. Plani

IV.1 Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Plani Strategjik i Administratës Tatimore	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	2014-2016

IV. 2 Inventari i masave ligjore ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjeshëm/mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2008/118/KE	Ligji nr. 61/2012, "Ligji për akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	E pjeshme	1.07.2012	1.10.2012
Direktiva 2009/133/KE	Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar	Ministria e Financave	Nuk ka përafrim	28.12.1998	3.06.1998
Direktiva 2006/112/KE	Ligji nr. 7928 datë 27.04.1995 "Për TVSH-në", i ndryshuar	Ministria e Financave	Nuk ka përafrim	27.04.1995	31.07.1995

IV.3 Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Kuadri i politikave ekzistuese	Periudha e referuar
Nuk ka përgjigje	Nuk ka përgjigje	Nuk ka përgjigje

IV.4 Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjeshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFAT - SHKURTËR (2014)</u>							
Direktiva e Këshillit 2006/112/KE	Po	Ligji "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë"	Po	Ministria e Financave	E pjeshme	3 - muji i tretë 2014	3 - muji i parë 2015
Direktiva 2003/48/KE	Po	Ligji "Për të ardhurat" i	Jo	Ministria e	E plotë	Tre-muji i parë	Data e

		ndryshuar nr. 8438, datë 28.12.1998, në lidhje me shkrirjet dhe bashkimin.		Financave		2015	anëtarësimit në BE
AFAT- MESHËM (2015 – 2016)							
-	-	-	-	-	-	-	-

2. TATIMI DIREKT

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Memorandumi i Politikave Ekonomike dhe Financiare midis FMN-së dhe Ministrisë së Financave të Shqipërisë dhe Bankës së Shqipërisë	Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë	2014-2016

Inventari i masave ligjore ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2003/48/KE	Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar	Ministria e Financave	Nuk ka përafrim	28.12.1998	3.06.1998
Direktiva 2009/133/KE	Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar	Ministria e Financave	Nuk ka përafrim	28.12.1998	3.06.1998

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Strategjia e Financave Publike 2014-2020	Ministria e Financave	2014-2020	3 muhori i tretë 2014	3 muhori i tretë 2014

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFAT - SHKURTËR (2014)</u>							
Direktiva 2003/48/KE	Po	Ligji “Mbi të ardhurat” i ndryshuar, nr. 8438, datë 28.12.1998, në lidhje me Shkrirjen dhe Bashkimin	Po	Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	E plotë	Tre-muhori i parë 2015	Data e anëtarësimit në BE
Direktiva 2009/133/KE	Po	Ligji “Mbi të ardhurat” i ndryshuar, nr. 8438, datë 28.12.1998, në lidhje me Shkrirjen dhe Bashkimin	Jo	Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	E plotë	Tre-muhori i parë 2015	Data e anëtarësimit në BE
<u>AFAT- MESËM (2015 – 2016)</u>							
-	-	-	-	-	-	-	-

3. TATIMI INDIREKT

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Memorandumi i Politikave Ekonomike dhe Financiare midis FMN-së dhe Ministrisë së Financave të Shqipërisë dhe Bankës së Shqipërisë	Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë	2014-2016

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2006/112/KE	Ligji nr. 7928 datë 27.04.1995 "Mbi TVSH-në", i ndryshuar	Ministria e Financave	E pjesshme	27.04.1995	31.07.1995
Direktiva 2008/118/KE	Ligji nr. 61/2012, "Ligji për akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	E pjesshme	1.10.2012	1.10.2012

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Strategjia e Financave Publike 2014-2020	Ministria e Financave	2014-2020	3 majori i tretë 2014	3 majori i tretë 2014

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFAT - SHKURTËR (2014)</u>							
Direktiva 2006/112/KE	Po	Ligji "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" në Republikën e	Po	Ministria e Financave,	E pjesshme	3 majori i tretë	3 majori i parë

		Shqipërisë		Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve		2014	2015
<u>AFAT- MESËM (2015 – 2016)</u>							
Direktiva 2008/118/KE	Po	Ligji nr. 61/2012, "Ligji për akcizat në Republikën e Shqipërisë"	Po	Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	E pjesshme	Tre-mujori i parë 2015	Tre-mujori i parë 2015

4. NDIHMA E NDËRSJELLTË

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periodha e referuar
-	-	-

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Rregullorja e Këshillit (EU) Nr. 904/2010	-	-	Nuk ka përafrim	-	-
Rregullorja (EC) Nr. 2073/2004	-	-	Nuk ka përafrim	-	-
Rregullorja (EC) Nr. 2073/2004	-	-	Nuk ka përafrim	-	-
Direktiva 2011/16/BE	-	-	Nuk ka përafrim	-	-

Direktiva 2010/24/BE	-	-	Nuk ka përafrim	-	-
----------------------	---	---	-----------------	---	---

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
-	-	-	-	-

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFAT - SHKURTËR (2014)</u>							
-	-	-	-	-	-	-	-
<u>AFAT- MESEM (2015 – 2016)</u>							
-	-	-	-	-	-	-	-

KAPITULLI 17: POLITIKA EKONOMIKE DHE MONETARE

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni i BE-së në fushën e politikës ekonomike dhe monetare përmban kritere që kërkojnë pavarësinë e bankave qendrore të Shteteve Anëtare dhe ndalimin e financimit direkt të sektorit publik nga ana e bankave qendrore, ashtu si dhe aksesin e privilegjuar të sektorit publik në institucionet financiare. Shtetet Anëtare priten që të koordinojnë politikat e tyre ekonomike dhe janë subjekt i rregullave të Paktit të Stabilitetit dhe Rritjes, si dhe procedurave të monitorimit të deficitit. Shtetet Anëtare të sapo-anëtarësuara angazhohen edhe në drejtim të përmbushjes së kritereve për adoptimin e euros. Para se këto Shtete të anëtarësohen në eurozonë, do të marrin pjesë në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar si Shtete Anëtare me *derogation*, dhe duhet të trajtojnë politikën e tyre të kursit të këmbimit si një çështje të përbashkët me Bashkimin Evropian.

I.2 Situata në Shqipëri

Ka pasur pak progres në lidhje me përmirësimin e cilësisë së dokumenteve të politikës ekonomike. Përpjekje të tjera kërkohen në drejtim të planifikimit të politikës dhe procesit të zbatimit. Kapaciteti politikë- hartues i institucioneve të përfshira në përgatitjen e Programit Ekonomik dhe Fiskal duhet të rritet. Përgjithësisht, përgatitjet nuk janë ende të mjaftueshme.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë u zhvillua në një kontekst të vështirë makroekonomik të brendshëm dhe të jashtëm gjatë vitit 2013. Viti 2013 u karakterizua nga ngadalësimi i aktivitetit ekonomik, nga kërkesa e dobët agregate dhe nga presione të ulëta inflacioniste. Ekonomia shqiptare vijoi të rritet nën potencial gjatë vitit 2013, duke shënuar ritme më të ulëta nga viti i kaluar. Ajo u mbështet pozitivisht nga kërkesa e huaj dhe stimuli fiskal, ndërkohë që konsumi dhe investimet private rezultuan të dobëta.

Inflacioni mesatar vjetor rezultoi 1.9%, duke qenë pranë kufirit të poshtëm të tolerancës së Bankës së Shqipërisë. Presionet e dobëta nga kërkesa e brendshme dhe reduktimi i inflacionit të importuar ishin faktorët kryesorë që përcaktuan ecurinë e inflacionit. Në këtë ambient me dinamikë të dobët ekonomike dhe monetare Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë monetare stimuluese. Norma bazë e interesit është ulur me 1 pikë përqindje gjatë vitit, duke zbritur nga 4.00% në 3.00%. Vijueshmëria e kësaj tendence edhe për tremujorin e parë të vitit 2014 ka ndikuar në uljen e mëtejshme të normës bazë të interesit me 0.25 pikë përqindje në muajin shkurt 2014, duke shënuar nivelin minimum historik prej 2.75%. Ndjekja e një politike të tillë ka mundur kontrollin e prirjes rënëse të inflacionit dhe administrimin e pritjeve inflacioniste. Transmetimi i saj u

reflektua në reduktimin e normave të interesit në të gjitha segmentet e tregut. Megjithatë, stimujt monetarë patën një efekt jo të plotë në aktivitetin ekonomik, si pasojë e primeve të larta të rrezikut në ekonomi dhe oreksit të ulët të sektorit privat për të rritur konsumin, dhe për të ndërmarrë investime afatgjata.

Banka e Shqipërisë ka adoptuar një përjasje të re në komunikimin e politikës monetare, duke deklaruar edhe drejtimin e pritur të saj në të ardhmen. Komunikimi në këtë formë rrit sigurinë tek bizneset dhe individët, duke bërë lidhjen midis kursit të pritshëm të politikës monetare dhe kushteve ekonomike të vendit. Ky komunikim ka ndikuar në njërën anë në forcimin e ankorimit të pritjeve inflacioniste, dhe në anën tjetër në rritjen e besueshmërisë tek Banka e Shqipërisë.

Në një situatë të tillë Banka e Shqipërisë ka synuar që, nëpërmjet politikës së saj monetare, administrimit të likuiditetit, masave makroprudenciale dhe mbikëqyrjes së kujdesshme të sistemit bankar, të krijojë një ambient ekonomik dhe financiar të sigurt e të qëndrueshëm. Në hartimin e tyre, Banka e Shqipërisë është kujdesur që politikat e ndjekura të jenë të harmoni me politikat e tjera makroekonomike në vend.

Deficiti fiskal në vitin 2013 ishte rreth 4.8% e PBB-së, dukshëm më i ulët se objektivi buxhetor prej 6.2%. Kjo ndodhi kryesisht për shkak të rritjes së të ardhurave, shpenzimeve kapitale të huaja më të ulëta se ato të parashikuara dhe rritjes më të ulët të shpenzimeve korente gjatë tremujorit të katërt, krahasuar me nëntë muajt e parë të vitit. Deficiti i përgjithshëm fiskal ishte rreth 1.9% në tremujorin e fundit të vitit 2013 nga 5.8% e PBB-së vlerësuar për nëntë muajt e parë të vitit. Deficiti fiskal i vitit 2013 u financua kryesisht nëpërmjet huamarrjes neto të re dhe rreth 1% e GDP-së është financuar nëpërmjet të ardhurave nga privatizimi (të përfituara financiarisht dhe të përdorura gjatë gjysmës së parë të vitit 2013).

Ecuria e të ardhurave dhe shpenzimeve në tremujorin e fundit të vitit 2013 solli një rezultat fiskal të përmirësuar edhe në termat e balancës fiskale korente. Në fund të muajit shtator balanca fiskale korente shënonte një deficit prej 0.6% të PBB-së, ndërsa në tremujorin e fundit ajo kaloi në një suficit prej rreth 1.8% të PBB-së dhe arriti të jetë në ekuilibër për gjithë vitin 2013, në përputhje edhe me *rregullin e artë fiskal*, parashikuar në Ligjin Organik të Buxhetit.

Bilanci primar gjithashtu kaloi në një suficit prej rreth 1.8% të PBB-së në tremujorin e fundit dhe deficiti primar u reduktua në 1.6% të PBB-së për gjithë vitin 2013, nga një deficit prej 2.8% të PBB-së në nëntë muajt e parë të vitit 2013.

Borxhi publik në fund të vitit 2013 (duke përfshirë stokun e detyrimeve të papaguara) është vlerësuar në 70.5% të PBB-së (nga i cili 5.3% e PBB-së është vlera totale e vlerësuar nga FMN e stokut të detyrimeve të papaguara).

I.3 Struktura e kapitullit

1. POLITIKA MONETARE
2. POLITIKA EKONOMIKE

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Detyrimet kryesore të Shqipërisë në kuadër të përafrimit të legjislacionit të saj me atë të Bashkimit Evropian rrjedhin nga Neni 70 i MSA-së.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Aktualisht, ligji për Bankën e Shqipërisë është pjesërisht në përputhje me *acquis*-në e Bashkimit Evropian. Megjithëse shumë dispozita janë të përafruara, nevojiten përpjekje të tjera legjislative me qëllim përputhjen me parimet e përgjithshme të *acquis* së Bashkimit Evropian, në lidhje me forcimin e pavarësisë së saj. Në kontekstin e sigurimit të garancive të përshtatshme dhe mjeteve financiare për Bankën e Shqipërisë, me qëllim arritjen e objektivave të saj, dhe për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian, Banka e Shqipërisë do të synojë ndryshimin e dispozitave të ligjit aktual në lidhje me ndalimin e huadhënies për qeverinë. Banka e Shqipërisë, në konsultë me Ministrinë e Financave, në periudhën afatmesme do të shkojë drejt një regjimi që së fundmi ndalon huatë për qeverinë, duke përfshirë çdo instrument huaje në tregun primar. Deri sa të arrihet kjo marrëveshje me qeverinë, ndryshimet ligjore duhet të parashikojnë vetëm zbatimin e dispozitave të ligjit aktual të Bankës së Shqipërisë në lidhje me kreditimin vetëm për periudhën transitorë, duke specifikuar se kjo kredi nuk do të jetë më shumë se 5 përqind e të ardhurave vjetore të zakonshme të qeverisë si dhe detyrimin për të mos pasur asnjë tepricë huaje në fund të vitit financiar.

Programi Ekonomik e Fiskal 2014 – 2016 paraqet prioritetet kryesore të institucioneve të shtetit Shqiptar në fushën e ekonomisë. Ai është i bazuar dhe në përputhje me ligjin nr. 185, dt. 2.12.2013 “Për Buxhetin e Vitit 2014” dhe me Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për Kuadrin Makroekonomik e Fiskal 2015 – 2017”, nr. 34, dt. 29.01.2014. Ky dokument është hartuar nga një grup ndër-institucional pune me përfaqësues dhe ekspertë nga një seri institucionesh të shtetit shqiptar. Ky dokument paraqet një informacion të qartë të politikave ekonomike dhe prioritetëve afatmesme të vendit në kuadrin e reformave strukturore që parashikohen të zbatohen gjatë periudhës 2014-2016. Ato, kanë për qëllim stabilitetin makroekonomik dhe sigurimin e një rritje ekonomike relativisht të lartë e të qëndrueshme, si dhe ngritjen e një kuadri rregullator dhe politikave sektoriale në përputhje me standardet evropiane.

II.3 Institucionet përgjegjëse

- Banka e Shqipërisë;
- Ministria e Financave.

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

	2012	2013	2014	2015
Kosto totale				
<i>Mbështetje nga Buxheti i Shtetit</i>	-	-	N/A	-
<i>Asistencë e huaj</i>			70,000,000 Lek (Projekti “Analiza e Nevojave” me Bankën Qendrore Evropiane	
				0

III. Prioritetet

Në fushën e politikës monetare, ligji mbi Bankën e Shqipërisë është gjerësisht në përputhje me *acquis*. Ai siguron një shkallë të lartë pavarësie për Bankën Qendrore dhe përcakton si objektivin e tij kryesor ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Ligji përcakton se Banka nuk duhet të kërkojë ose të marrë instruksione nga autoritete të tjera dhe se është institucioni i vetëm përgjegjës për politikën monetare dhe atë të këmbimit valutor në vend.

Menaxhimi efektiv i politikës monetare nga Banka e Shqipërisë duhet të ruhet, dhe Ligji mbi Bankën e Shqipërisë duhet të përafrohet më tej me *acquis* në drejtim të rritjes së pavarësisë së saj.

Politika monetare pengohet nga shkalla relativisht e lartë e “euroizimit” e sistemit financiar. Menaxhimi efektiv i politikës monetare nga Banka e Shqipërisë duhet të ruhet, dhe Ligji mbi Bankën e Shqipërisë duhet të përafrohet më tej me *acquis* në drejtim të rritjes së pavarësisë së saj.

Duke filluar nga viti 2006, Shqipëria ka marrë pjesë në monitorimin e politikës ekonomike të para-anëtarësimit, e cila ka për qëllim përforcimin e kapacitetit të parashikimit ekonomik në vend për ta përgatitur atë për një pjesëmarrje të mundshme në mekanizmat e koordinimit të politikës ekonomike dhe parashikimeve buxhetore të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar (EMU). Në këtë kontekst, Shqipëria ka përgatitur programe të rregullta ekonomike dhe fiskale (EFP).

Shqipëria miratoi programin e saj ekonomik-fiskal 2013 -2015 në muajin janar. Ai bazohet në Ligjin për Buxhetin 2013 të miratuar në muajin dhjetor dhe në programimin makroekonomik dhe fiskal për vitet 2013 -2015, i cili u miratua në muajin janar. Të dhënat fiskale nuk janë në përputhje të plotë me standardet ESA95.

Kuadri makroekonomik dhe fiskal duken shumë optimist dhe projeksionet makroekonomike nuk janë të plotësuara me skenarë alternativë në rast pasigurie. Pothuajse të gjitha të dhënat kryesore janë të mbuluara në përputhje me metodologjinë EFP, por dobësitë vazhdojnë, veçanërisht në lidhje me tregun e punës dhe statistikat e pagave. Lidhjet midis skenarit makroekonomik dhe reformave strukturore nuk janë mjaftueshmërisht eksplicite. Kuadri për reformat strukturore nuk është koherent dhe gjithëpërfshirës, dhe në të mungon ndarja e qartë e periudhave dhe drejtimi buxhetor për zbatim. Kapaciteti për bashkërendimin e politikës ekonomike dhe zbatimin e saj mbetet i pamjaftueshëm.

Përpyqje të tjera kërkohen në lidhje me planifikimin e politikës dhe zbatimin e saj. Kapaciteti hartues i institucioneve të përfshira në përgatitjen e EFP-së duhet të rritet.

IV. Plan i Veprimeve për periudhën 2014 – 2016

IV.1 Politika monetare

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia Afatmesme e Bankës së Shqipërisë për 2013-15	Banka e Shqipërisë	2013 - 2015
Dokumenti i Politikës Monetare për 2012-2014	Banka e Shqipërisë	2012 - 2014

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Versionet e konsoliduara të Traktatit të Bashkimit Evropian dhe Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (2012/C326/01)	Ligji për Bankën e Shqipërisë	Banka e Shqipërisë	I Pjesshëm	23.12.1997	22.01.1998
Protokolli (nr. 4) mbi statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe Bankës Qendrore Evropiane të Traktatit të Bashkimit Evropian dhe Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian	Ligji për Bankën e Shqipërisë	Banka e Shqipërisë	I Pjesshëm	23.12.1997	22.01.1998

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Dokumenti i Politikës monetare 2015 -2017	Banka e Shqipërisë	2015 -2017	Tremujori i Parë 2015	Tremujori i Parë 2015

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/ përputhje)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi

					e pjesshme)		
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
<u>AFAT MESEM (2015 – 2016)</u>							
Protokolli (nr. 4) mbi statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe Bankës Qendrore Evropiane të Traktatit të Bashkimit Evropian dhe Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian	Jo	Ndryshime në Ligjin për Bankën e Shqipërisë	Jo	Banka e Shqipërisë	I Pjesshëm	T4 2016	T4 2016

IV.2 Politika ekonomike

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Programi Ekonomik dhe Fiskal 2014	Ministria e Financës	2014-2016
Kuadri Makroekonomik e Fiskal 2015 - 2017	Ministria e Financës	2015 - 2017

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
------------------	------------------------	----------------------	---------------------	--------------------	---------------

			(i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	(Legjislacioni Shqiptar)	(Legjislacioni Shqiptar)
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Programi Ekonomik dhe Fiskal 2015	Ministria e Financës	2015-2017	T1 2015	T1 2015
Programi Ekonomik dhe Fiskal 2016	Ministria e Financës	2016-2018	T1 2016	T1 2016

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/ përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFAT-SHKURTËR (2014)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
<u>AFAT-MESËM (2015 – 2016)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

KAPITULLI 18: STATISTIKAT

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Ky kapitull paraqet *acquis*-të në fushën e statistikave që do të zbatohen nga çdo aktor i përfshirë në Sistemin Kombëtar të Statistikave në Shqipëri me qëllim përmirësimin e infrastrukturës statistikore të bazuar në parime si paanshmëria, besueshmëria, transparenca, fshehtësinë e të dhënave individuale dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare. Këto parime janë të përmendura në nenet 4 dhe 4/ 1 të ligjit për statistikat zyrtare dhe janë të detyrueshme të respektohen nga INSTAT dhe të gjitha agjencitë statistikore të cilat zbatojnë aktivitete statistikore sipas Programit statistikor shumëvjeçar.

Zbatimi i *acquis* në statistika siguron INSTAT për të vepruar si pika reference dhe si spirancë për metodologjinë, prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor.

Acquis-të mbulojnë metodologjinë, klasifikimet dhe procedurat për mbledhjen e të dhënave në fusha të ndryshme siç janë statistikat demografike dhe sociale, statistikat e mjedisit, biznesit, statistikat makroekonomike, monetare dhe financiare, statistikat e tregtisë dhe bilancit të pagesave, statistikat rajonale, tregtia e jashtme, bujqësia, si dhe statistikat e teknologjisë dhe shkencave.

INSTAT dhe agjencitë e tjera statistikore në Shqipëri, veprojnë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9180, datë 5.02.2004 "Për statistikat zyrtare", i ndryshuar si dhe nga Programi 5 -vjeçar për statistikat zyrtare i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Programi 5 vjeçar për Statistikat Zyrtare, i cili është në përputhje me Compendiumin e Eurostat, dhe me programin shumëvjeçar është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në përputhje me nenin 6 të ligjit për statistikat zyrtare. Ai siguron zbatimin e metodologjisë dhe standardeve të përmendura në rregulloret e BE-së në fushën e statistikave.

I.2 Situata në Shqipëri

Direktiva 92/85 EEC	Ligji Nr. 10237 datë 18.2. 2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë”,	MF MMSR ISSH	E pjesshme	11.5.1993	27.06.1993

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Rishikim i strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore, reduktimit të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje	MMSR	2011-2015	Tremujori i I 2015	Tremujori i I 2015
Strategjia e re e Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje dhe Plani I Veprimi	MMSR	2016-2020	Tremujori i 2 2016	Tremujori i 2 2016

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
Direktiva 2006/54/EC	Jo	Ndryshime në Kodin e Punës lidhur me ndryshimin e barrës së provës, mbrojtjen e mëmësisë	Po	MMSR	E pjesshme	Tremujori i 3, 2014	Tremujori i 3, 2014
Direktiva 92/85 EEC	Jo	Ndryshime në Kodin e Punës lidhur me ndryshimin e barrës së provës, mbrojtjen e mëmësisë	Po	MMSR	E pjesshme	Tremujori i 3, 2014	Tremujori i 3, 2014
<u>AFAT MESEM (2015 – 2016)</u>							
Direktiva 92/85 EEC	JO	VKM “Mbi paraqitjen e masave për të inkurajuar përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë për punëtorët shtatzëna dhe punëtorët të cilat sapo kanë lindur ose janë me fëmijë në gj”	PO	MMSR	pjesshme	Tremujori i 2, 2015	Tremujori i 2, 2015
Direktiva 92/85 EEC	Jo	VKM "Për masat e veçanta për punën e natës për gratë"	Po	MMSR	Pjesshme	Tremujori i 2, 2015	Tremujori i 2, 2015

Direktiva 92/85 EEC	Jo	VKM "Për përcaktimin e listës së subjekteve për punët e vështira që dëmtojnë shëndetin e grave"	Po	MMSR	Pjesshme	Tremujori i 2, 2015	Tremujori i 2, 2015
Direktiva 86/378/EEC	Po	Ligji 7703, date 11.05.1993.	Po	MMSR ISSH	pjesshme	Tremujori i I, 2015	Tremujori i I, 2015
Direktiva 86/378/EEC	Po	Akte nënligjore për zbatimin e ligjit të ri për sigurimet shoqërore	Po	MMSR ISSH	pjesshme	Tremujori i 2 2015	Tremujori i 2 2015
Direktiva 86/378/EEC	Po	Aktet nënligjore për përfitimet nga sigurimet shoqërore	Po	MMSR ISSH	Pjesshme	Tremujori i 2 2015, 2016	Tremujori i 2 2015,2016

IV.7.3 Antidiskriminimi

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
“Plan masash për mosdiskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor”	MMSR	2012-2014
Plani Strategjik i Komisionerit Për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	2012-2015

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2000/43/KE	Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”	Komisioneri “Për mbrojtjen nga diskriminimi”	Plotë	4.2.2010	14.3.2010
Direktiva 2000/78/KE	Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”	Komisioneri “Për mbrojtjen nga diskriminimi”	Plotë	4.2.2010	14.3.2010
Direktiva 2004/113/KE	Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”	Komisioneri “Për mbrojtjen nga diskriminimi”	Plotë	4.2.2010	14.3.2010
Direktiva 2006/54/KE	Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”	Komisioneri “Për mbrojtjen nga diskriminimi”	Plotë	4.2.2010	14.3.2010

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
Rekomandimi CM/Rec (2010)5, i Komitetit	Jo	Ndryshim ne Kodin e Punës Neni 9, lidhur me përkufizimin për orientimin seksual	Nr	MMSR	Pjeshtëm	Tre mujori i 3 2014	Tremujori i 3 2014
Rekomandimi CM/Rec (2010) 5, i Komitetit të Ministrave Paragrafi 23	Jo	Ndryshime ne Kodin e Familjes Nenet 163, 164 Bashkëjetesa	Nr	MD me propozim nga MMSR	Pjeshtëm	Tre mujori i 3 2014	Tremujori i 3 2014
<u>AFAT MEËM (2015 – 2016)</u>							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

KAPITULLI 20: NDËRMARRJET DHE POLITIKAT INDUSTRIALE

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Ndërmarrjet dhe politikat industriale përbëhen nga instrumentet e politikave, duke përfshirë mbështetjen financiare dhe masat rregullatore, si dhe politikat sektoriale. Ai përfshin privatizimin dhe ristrukturimin dhe inkurajon mjedisin e favorshëm për krijimin e biznesit, investimet e brendshme dhe investimet e huaja direkte, promovimin e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME), sipërmarrjen dhe inovacionin. Akti i Biznesit të Vogël, miratuar në qershor 2008, përmban një sërë parimesh të përbashkëta dhe veprimesh konkrete për të mbështetur SME-të, ofron kornizën për politikën e SME-të së bashku me një përkufizim të përbashkët të SME-të.

Zbatimi i këtij kapitulli kërkon konsultime efikase dhe mekanizma bashkëpunimi për formulimin dhe zbatimin me cilësi dhe efikasitet të politikave.

I.2. Situata në Shqipëri

Në bazë të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian 2013, janë bërë disa përparime në zbatimin e politikave të SME-ve dhe konvergjencën e politikave drejt standardeve dhe praktikave të BE-së, veçanërisht në lidhje me regjistrimin e kompanive dhe hapjen e biznesit. Janë marrë disa hapa për të zbatuar reformën e inspektorateve duke miratuar ndryshime në ligjet sektoriale, zbatimin e legjislacionit për organizimin dhe strukturën e Inspektoratit Qendror dhe Kodit të Etikës të punonjësve të saj. Në fushën e ndërmarrjeve dhe politikave industriale, instrumentet e financimit të SME-ve vazhdojnë përmes fondit të garantimit të kredive dhe Fondit Evropian për Evropën Juglindore, por qasja e SME-ve në kreditim mbetet për t'u përmirësuar.

Komisioni Evropian rekomandoi se Shqipëria duhet të fokusohet në përmirësimin e klimës së biznesit, duke lëvizur në drejtim të futjes së vlerësimit të plotë të ndikimit rregullator për të gjithë legjislacionin me implikime të drejtpërdrejta në operacionet e biznesit.

I.3 Struktura e kapitullit

1. POLITIKA INDUSTRIALE – OPERACIONET SEKTORIALE
2. PRIVATIZIMI DHE RISTRUKTURIMI
3. MJEDISI I BIZNESIT
4. POLITIKAT PËR SME-të

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Detyrimet për kapitullin 20 nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit buron nga nenet: 70, 86, 87, 92, 93, 94.

Acquis në kuadër të kapitullit për ndërmarrjet dhe politikat industriale përbëhet kryesisht nga parime dhe rekomandime për politikat, të cilat janë pasqyruar në komunikatat, rekomandimet dhe konkluzionet e Këshillit. Ato përfshijnë, ndër të tjera, Rekomandimin e Komisionit të 6 majit 2003 në lidhje me përkufizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Relevante janë edhe pjesë të tjera të legjislacionit, të cilat janë të përfshirë në kapitujt e tjerë të *acquis* së BE-së:

- Direktiva 2000/31/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 8 qershor 2000 mbi disa aspekte ligjore të shërbimeve të shoqërisë së informacionit, dhe veçanërisht tregtisë elektronike, në Tregun e Përbashkët (Direktiva mbi tregtinë elektronike),
- Direktiva 1999/93/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 13 dhjetor 1999 mbi kuadrin komunitar për nënshkrimin elektronik,
- Direktiva 2004/18/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 31 mars 2004 mbi koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave për punë publike, kontratat për furnizim publik dhe kontratat e shërbimit publik.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Bazuar në Nenin 93 të MSA-së si dhe në prioritetet afatshkurtra në lidhje me politikat **për përmirësimin e mjedisit të biznesit** të përcaktuara në Partneritetin Evropian 2007, Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë një sërë reformash rregullatore, ku ndër më të rëndësishmet është reforma rregullatore në fushën e biznesit. Kjo reformë ka si qëllim përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative

ndaj nismës së lirë në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, ose përdorimin e të mirave publike, duke garantuar, njëkohësisht, mbrojtjen e interesit publik në ushtrimin e këtyre veprimtarive dhe në përdorimin e të mirave publike.

Me ngritjen e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit (QKR) dhe Qendrës Kombëtare të Licencimit ofrohet shërbimi në „one-stop-shop“ për biznesin. Grupi Ndërmintor për përmirësimin e indikatorëve të të bërit biznes, është funksional dhe hartimi i masave konkrete është në proces. Rishikimi tërësor i autorizimeve është në proces ndërkohë që po rishikohet edhe sistemi aktual i licencave dhe lejeve për të reduktuar më tej kërkesat e panevojshme për biznesin.

Në përputhje me politikat **në mbështetje të SME-ve**, Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve përcakton objektivat kryesore strategjike në sektorin e ekonomisë, rritjes së produktivitetit dhe konkurrueshmërisë, nëpërmjet zhvillimit dinamik të sipërmarrjes, nxitjes së investimeve, shfrytëzimit më të mirë të burimeve natyrore, njerëzore dhe financiare. Përshtatja e objektivave dhe prioriteteve në këtë fushë po shihet e ndërthurur edhe me strategjinë SEE 2020, për të cilën po hartohet edhe plani kombëtar i masave.

Arritje të tjera legjislative:

Procesi i privatizimit vepron në bazë të Ligjit Nr. 8306, datë 14.03.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve të veçantë, me rëndësi”, të ndryshuar. Qendra Kombëtare e Licencimit vepron në bazë të Ligjit Nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, lejet dhe autorizimet në Republikën e Shqipërisë”. Qendra Kombëtare e Regjistrimit operon nëpërmjet Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare e Regjistrimit”. Ligji Nr. 9527 dhe 9528, datë 11.05.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjeve qeveritare dhe financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e „Programit për zhvillimin e sektorit privat përmes një kredie për të ndihmuar mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme për sigurimin e asistencës teknike për to”, kanë për qëllim të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë duke përmirësuar aksesin e SME-ve shqiptare në kredi bankare.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes,
Qendra Kombëtare e Licencimit,
Qendra Kombëtare e Regjistrimit,
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës,
Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit,

Ministria e Integrimit Evropian,
 Ministria e Financave,
 Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
 Ministria e Shëndetësisë,
 Ministria e Energjisë dhe Industrisë,
 Ministria e Drejtësisë,
 Ministria e Mjedisit,
 Agjencia e Prokurimit Publik/KM,
 INSTAT

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	0	0		
Mbulohen nga buxheti i shtetit	0	0	0	0
Mbuluar nga ndihma e huaj	0	0	420.000	0
Ndryshim	0	0	420.000	0

Nuk ka *acquis* të BE-së që të transpozohet në këtë fazë dhe për këtë arsye nuk janë alokuar fonde për 2015.

III. Prioritetet

Shqipëria do të vazhdojë me përpjekjet për të zbatuar masat për të përmirësuar kuadrin rregullator për biznesin, duke përfshirë edhe hyrjen dhe daljen nga tregu, me një fokus të veçantë në përmirësimin e vazhdueshëm të treguesve të Bësh Biznes. Sipas Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve për 2014-2020, prioritetet janë:

- Vazhdimi i implementimit të SBA për SME-të,

- Forcimi i kapaciteteve teknologjike të SME-ve,
- Ideimi dhe zbatimi i politikave të integruara të kërkimit shkencor dhe zhvillimi më tej i masave për të nxitur inovacionin dhe konkurrueshmërinë e kompanive të vogla.

IV. Plani i veprimit 2014 – 2016

IV.1 Politikat industriale-operacionet sektoriale

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni	Periudha e referuar
Strategjia e industrisë jo-ushqimore	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	1990 – 2004 e në vijim

Kuadri i politikave të planifikuara 2014 – 2016

Titulli	Institucioni	Periudha referuese	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Strategjia e industrisë jo-ushqimore	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	2014-2025	Tremujori 2, 2014	Tremujori 3, 2014

IV.2 Privatizimi dhe ristrukturimi

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni	Periudha e referuar
Strategjia e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë	MZHETS	1998 –e në vijim
Plani i veprimit për zbatimin e privatizimit në 300 ditët e para Një pjesë e objektivave të MZHETS për 300 ditët e para të qeverisjes	MZHETS	Shtator 2013 – Qershor 2014

Kuadri i politikave të planifikuara 2014 – 2016

Titulli	Institucioni	Periudha e referuar	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Plani i veprimt për privatizimet strategjike për periudhën 2015-2020	MZHETS	2014 - 2020	Tremujori 2, 2015	Tremujori 3, 2015

IV.3 Mjedisi i biznesit**Kuadri i politikave ekzistuese**

Titulli	Institucioni	Periudha e referuar

Kuadri i politikave të planifikuara 2014 – 2016

Titulli	Institucioni	Periudha e referuar	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Strategjia për zhvillimin e biznesit dhe investimeve 2014-2020	MZHETS	2014-2020	Tremujori 2, 2014	Tremujori 2, 2014
Plani i veprimt për Strategjinë SEE 2020	MZHETS – koordinator kombëtar	2014-2020	Tremujori 2, 2014	Tremujori 2, 2014

IV.4 Politikat për SME-të**Kuadri i politikave ekzistuese**

Titulli	Institucioni	Periudha e referuar

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Rekomandimi i Komisionit C(2003) 1422	Ligji për SME Nr. 8957, datë 17.10.2002, i ndryshuar me Ligjin Nr. 10042, datë 22.12.2008	MZHETS	I pjesshëm	22.12.2008	5.01.2009

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli	Institucioni	Periudha e referuar	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFATSHKURTËR (2014)</u>							
Direktiva 2011/7/EC	Po	Ligji ”Për pagesat e vonuara”	Po	MZHETS	I plotë	Tremujori 2, 2014	Tremujori 2, 2014
<u>AFATMESEM (2015 – 2016)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

KAPITULLI 21: RRJETET TRANS-EUROPIANE

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Ky kapitull mbulon politikën e rrjeteve trans-evropiane në fushat e infrastrukturës së transportit dhe së energjisë, duke përfshirë udhëzimet e BE për zhvillimin e Rrjeteve Trans-Evropiane dhe masat mbështetëse për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët. Krijimi dhe zhvillimi i rrjeteve trans-evropiane dhe promovimi i interkoneksionit dhe ndërveprimit në rrjetet kombëtare, synojnë përfitimin e plotë nga tregu i brendshëm, si dhe kontribuojnë në rritjen ekonomike dhe krijimin e punësimit në Bashkimin Evropian.

I.2 Situata në Shqipëri

Në rastin e *rrjetit kryesor rrugor* progres është bërë në drejtim të cilësisë dhe densitetit të tij. Disa projekte janë kryer vitet e fundit me qëllim reduktimin e kohës dhe distancës midis Tiranës dhe qyteteve të mëdha, dhe/ose ndërmjet qyteteve të mëdha. Investimet kanë pasur për qëllim dhe përmirësimin e sigurisë rrugore. Projektet janë hartuar të tilla për të integruar rrjetin rrugor kombëtar në rrjetin rajonal dhe Pan-Evropiane. Objektivat kryesore të qeverisë shqiptare në infrastrukturën rrugore janë: përfundimi i ndërtimit të akseve rrugore kryesore, (si segmenti Tiranë – Elbasan, ndërtimi i të cilit lehtëson ndjeshëm trafikun në drejtim të Greqisë dhe Maqedonisë) dhe përmirësimi i mirëmbajtjes dhe sigurisë rrugore, duke alokuar më shumë fonde edhe nëpërmjet formave të partneritetit publik privat, si dhe hartimin e planeve konkrete të masave për përmirësimin e situatës.

Rrjeti hekurudhor shqiptar është i përfshirë pothuaj tërësisht, në Rrjetin kryesor rajonal të transportit. Gjatësia e përgjithshme e linjës kryesore është rreth 420 km. Krahas saj ka dhe 200 km linja të dyta dhe degëzime hekurudhore.

Për sa i përket *Infrastrukturës portuale*, në vitin 2013 përfundoi ndërtimi i terminalit të pasagjereve në Portin e Durrësit dhe aktualisht po funksionon me kapacitet të plotë. Rehabilitimi i kalatave nr. 7 dhe nr. 8, bashkëfinancim i BEI-t dhe BERZH-it, KE dhe Qeverisë Shqiptare prej rreth 40 Milion Euro, është në proces dhe parashikohet të përfundojë brenda vitit 2015.

Në Portin e Vlorës është firmosur kontrata për rehabilitimin e infrastrukturës dhe superstrukturës portuale, ndërtimin e kalatës së re të përpunimit të anijeve traget si dhe të kalatës së përpunimit të mallrave. I tërë projekti kushton rreth 15,3 milion euro dhe do të financohet nga Kooperacioni Italian. Punimet priten të fillojnë shumë shpejt.

Në Portin e Sarandës ka filluar ndërtimi i kalatës për anijet turistike Kruiz, me financimin e Bankës Botërore prej rreth 4,7 milion USD. Projekti parashikohet të përfundojë brenda vitit 2014. Ky investim do të rritë ndjeshëm kapacitetin akostues dhe përpunues të këtij Porti, si një port pasagjeresh dhe turistik.

Në Portin e Shëngjinit, ka përfunduar projekti IPA 2008 “Përmirësimi i Sektorit Detar Shqiptar, Rehabilitimi i Portit të Shëngjinit”, me financim prej 3,6 milion Euro. Një projekt i ri “Thellimi i Basenit” do të fillojë, me vlerë rreth 1 milion Euro, financim i Qeverisë Shqiptare.

Shqipëria ka marrë pjesë aktive në Observatorin e Transportit të Evropës Jug-Lindore (SEETO), dhe synon të vazhdojë bashkëpunimin me vendet fqinje, me qëllim përcaktimin së bashku të projekteve me interes rajonal, shkëmbimin e informacionit mbi projektet aktuale infrastrukturore dhe projekteve prioritare për të ardhmen.

Përsa i përket rrjeteve të energjisë elektrike, sistemi energjetik shqiptar deri në fund të vitit 2011, ka qenë i lidhur me vendet fqinje, Greqi me linjë 400 kV, Kosovë me linjë 220 kV, dhe Malin e Zi me 220 kV, dhe për këtë arsye edhe me rrjetet Trans - energjetike evropiane.

Ka përfunduar në vitin 2011 dhe është vënë në punë linja e interkonjeksionit 400 kV Elbasan-Tiranë-Podgoricë (Mali i Zi). Ka pasur progres në ndërtimin e linjës së re të interkoneksionit 400 kV Tiranë - Kosovë, për të cilën ka filluar puna në terren dhe që parashikohet të vihet në punë brenda vitit 2016. Qendra e re Kombëtare Dispeçer është në ndërtim.

Në lidhje me sistemin e transmissioinit të energjisë elektrike në Shqipëri, profili i tensionit në rrjetin kryesor të 400kV dhe 220kV është pothuajse në përputhje me kriteret e UCTE. Rrjeti 220 kV është i lidhur plotësisht në rrjet unazor dhe lidh hidrocentralet kryesore në veri të Shqipërisë me qendrat e ngarkesës në rajonet e Tiranës, Elbasanit dhe Fierit. Rrjeti 110 kV është përdorur për furnizimin e sistemit të shpërndarjes.

Shqipëria nuk është e lidhur me rrjetet rajonale dhe evropiane të gazit natyror. Rrjeti ekzistues i tubacionit të gazit (që administrohet nga Albpetrol Sh.A.), është përkeqësuar dhe nuk është përdorur.

Gazsjellësi Trans-Adriatik (TAP) është përzgjedhur në 28.06.2013 për të transportuar gazin nga fushat gazmbajtëse Shah Deniz II në Itali, përmes Turqisë dhe Greqisë. Në kuadër të këtij projekti, janë miratuar “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Republikës së Italisë për projektin Trans Adriatik Pipeline (projekti TAP)”, ratifikuar me Ligjin Nr. 104/2013 të 25.03.2014 dhe “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Gazsjellësit Trans Adriatik AG, në lidhje me projektin e Trans Adriatic Pipeline (projekti TAP)”, ratifikuar me Ligjin Nr. 116/2013 të 15.04.2013. Në 8.04.2014, TAP ka marrë lejen zhvillimore komplekse nga Këshilli Kombëtar i Territorit. Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr. 1081, datë 18.12.2013, ka ngritur një komision ndërinstitucional për të koordinuar institucionet shqiptare lidhur me zbatimin e projektit TAP.

Shqipëria ka shprehur gjithashtu interesin e saj në një tjetër projekt rajonal të gazit, Gazsjellësin Adriatik Jon (Projekti IAP). Me një financim nga IPA 2008, është përfunduar studimi i fizibilitetit, si dhe ai Mjedisor dhe i Ndikimit Social me vlerë 3.5 milionë euro.

Shqipëria është pjesë e Studimit Rajonal të gazifikimit, dhe në këtë kontekst, si pjesë e rajonit të Evropës juglindore dhe anëtar i Traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë, ka mbështetur konceptin e Unazës së gazit të Ballkanit Perëndimor (Unaza e Gazit të Komunitetit të Energjisë), propozuar nga konkluzionet e këtij studimi.

I.3 Struktura e kapitullit

1. Rrjetet Evropiane të Transportit
2. Rrjetet Evropiane të Energjisë

1. RRJETET TRANS-EUROPIANE TË TRANSPORTIT

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Në *fushën e Transportit*, përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian është një detyrim në zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe Protokollit 5, më konkretisht **neni 70, neni 106 i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe neneve 4 dhe 5** të protokollit 5, “Mbi transportin tokësor”. Në *fushën e rrjeteve të energjisë* përafrimi i legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian, parashikohet në nenet 70 dhe 71 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Legjislacioni i BE-së në këtë kapitull përfshin, ndër të tjera:

- Rregullore (BE) Nr 1315/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 dhjetor 2013 Mbi udhëzimet e Bashkimit për zhvillimin e rrjetit të transportit trans-evropian, që shfuqizon Vendimin Nr 661/2010/BE;
- Rregullore (BE) Nr 1316/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 dhjetor 2013 për krijimin e “Connecting Europe Facility”, që ndryshon Rregulloren (BE) Nr 913/2010, që shfuqizon Rregulloret (EC) Nr 680/2007 dhe (EC) Nr 67/2010;
- Rregullore (BE) Nr 347/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 17 prill 2013 Mbi udhëzimet për infrastrukturën energjetike trans-evropiane, që shfuqizon Vendimin Nr 1364/2006/EC dhe ndryshon Rregulloret (EC) Nr 713/2009, (EC) Nr 714/2009 dhe (EC) Nr 715/2009;
- Rregullore (KE) Nr 714/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 korrik 2009 Mbi kushtet për qasjen në rrjet për shkëmbime ndërkufitare të energjisë elektrike, që shfuqizon Rregulloren (KE) Nr 1228/2003,
- Rregullorja (KE) Nr 715/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 korrik 2009 Mbi kushtet për qasje në rrjetet e transmetimit të gazit natyror, që shfuqizon Rregulloren (EC) Nr 1775/2005.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

- Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është i harmonizuar me Direktivën e Këshillit 96/53/EC të 25 Korrikut 1996, “Përcaktimi, për disa mjete rrugore që qarkullojnë në Komunitetin Evropian, i përmasave maksimale të autorizuara, në trafikun kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe peshave maksimale të autorizuara në trafikun ndërkombëtar”;
- Ligji nr. 9501, datë 3.04.2006 “Për ratifikimin e Traktatit të themelimit të Komunitetit të Energjisë”.

II.3 Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
- Autoriteti Rrugor Shqiptar
- Drejtoria e Përgjithshme Detare
- Ministria e Energjisë dhe Industrisë
- Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
- Enti Rregullator i Energjisë

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

Alokimet financiare në fushën e transportit dhe energjisë janë paraqitur respektivisht në Kapitullin 14 dhe 15.

III. Prioritetet

Prioritetet në kapitullin 21 janë:

- Ndërtimi i korridoreve kryesore rrugore të transportit me parametrat teknike të autostradave interurbane, duke përfshirë Korridorin 8 Pan-Evropian, Korridorin Durrës-Morinë, që bën të mundur lidhjen me Korridorin 10, Korridorin Rrugor Veri-Jug, Rrugën e Arbrit, si një degë e Korridorit 8 dhe Aksin Qendror Jugor;
- Mirëmbajtja e infrastrukturës ekzistuese rrugore dhe eliminimi i pikave të zeza;
- Më shumë vëmendje i duhet kushtuar Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor për projektet rrugore që janë zbatuar;
- Integrimi i mëtejshëm i rrjetit hekurudhor shqiptar në rrjetin rajonal të Evropës Juglindore, si dhe ndërtimi i lidhjes hekurudhore me Maqedoninë;
- Përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës portuale në Shqipëri;
- Pjesëmarrje aktive në Observatorin e Transportit të Evropës Juglindore (SEETO) dhe bashkëpunimi i mirë me fqinjët në rajon, duke synuar përcaktimin e projekteve prioritare me interes rajonal;
- Rritja e sigurisë energjetike nëpërmjet diversifikimit të furnizimit dhe integritetit të mëtejshëm të rrjetit shqiptar të energjisë elektrike në rrjetet rajonale dhe evropiane, energjia e rinovueshme;
- Kuadri ligjor i përmirësuar, i përafruar me *acquis* përkatëse të BE-së në këtë fushë, sidomos përputhja me Paketën e Tretë të Energjisë të BE-së nga 1 janari 2015;
- Rritja e investimeve në sektorin e energjisë;
- Gazifikimi i Shqipërisë, duke përfituar nga ndërtimi i TAP.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2014 – 2016

IV.1 Rrjetet Trans-Evropiane të Transportit

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Plani Kombëtar i Transportit (Rishikimi i parë pesëvjeçar)	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	2010 - 2015 Do të rishikohet çdo 5vjet
Plani i Veprimit për zbatimin e Planit Kombëtar të Transportit (Rishikimi i parë pesëvjeçar)	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës Instituti i Transportit	2010 - 2015 Rishikimi çdo vit

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Acquis e BE	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 96/53/BE	Ligji nr. 8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	i pjesshëm	22.07.1998	21.7.1999

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Kuadri i Politikave të Planifikuara	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Strategjia Sektoriale e Transportit 2015-2020	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	2015-2020	Tremujori III 2015	Tremujori IV 2015

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

Acquis e BE	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
AFAT SHKURTËR (2014)							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

<u>AFAT MESEM (2015 – 2016)</u>							
Rregullore (BE) Nr. 1315/2013	Jo	VKM “Mbi Udhëzimet e Bashkimit Evropian për Rrjetin Trans evropian TEN-T”	Jo	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës Autoriteti Rrugor Shqiptar	I pjesshëm	Tremujori III 2015	Tremujori IV 2015

IV.2 Rrjetet Trans-Evropiane të Energjisë

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor përgjegjës	Periudha kryesore e referencës
Strategjia Kombëtare e Energjisë, miratuar me VKM Nr 424 datë 26.6.2003	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	2006 – 2015

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Acquis e BE	Legjislacioni shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e rregullimit (legjislacioni shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacioni shqiptar)
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Kuadri i Politikave të Planifikuara	Institucioni kryesor	Periudha e referencës	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Strategjia e Energjisë e Republikës së Shqipërisë	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	2015 - 2030	Tremujori IV 2014	Tremujori IV 2014

Masat ligjore për periudhën 2014 – 2016

Acquis e BE	Statusi përkthimi anglisht (po / jo)	Legjislacioni shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Statusi përkthimi anglisht (po / jo)	Pika Përgjegjëse dhe kontaktet	Shkalla e përafrimit	Data e planifikuar për adaptim	Hyrja në fuqi

<u>AFATSHKURTËR (2014)</u>							
Direktiva 2009/73/(KE)	Jo	Projektligji për ndryshimin e ligjit nr. 9946 e 30.06.2008 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar.	Jo	Ministria e Energjisë dhe Industrisë SPZHG (DPZHH) Bashkëpunimi me ERE	I pjesshëm	Tremujori III 2014	Tremujori IV 2014
Rregullorja (KE) Nr 715/2009	Jo	Projektligji për ndryshimin e ligjit nr. 9946 e 30.06.2008 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar.	Jo	Ministria e Energjisë dhe Industrisë SPZHG (DPZHH) Bashkëpunimi me ERE	I pjesshëm	Tremujori III 2014	Tremujori IV 2014
<u>AFATMESEM (2015 - 2016)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

KAPITULLI 22: POLITIKA RAJONALE DHE BASHKËRENDIMI I INSTRUMENTEVE STRUKTURE

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 22 "Politika rajonale dhe bashkërendimi i instrumenteve strukturore" fokusohet në zhvillimin e politikave rajonale, zhvillimin vendor dhe asistencën financiare që BE-ja i jep Shqipërisë. *Acquis* i këtij kapitull konsiston kryesisht në akte normative kuadër dhe zbatuese, që përcaktojnë rregullat për përgatitjen, miratimin dhe zbatimin e kësaj asistence financiare në kuadrin e programit IPA. Fushat e ndërhyrjes negociohen dhe miratohen me Komisionin Evropian, ndërsa programimi dhe zbatimi janë përgjegjësi e Shqipërisë dhe Delegacionit të BE-së në Shqipëri. Shqipëria ka ngritur kuadrin institucional dhe kapacitetet administrative adekuate për programim, zbatim, monitorim dhe vlerësim të shëndoshë dhe kosto-efikas nga pikëpamja e menaxhimit dhe kontrollit financiar. Neni 110 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) përcakton që palët do të përpiqen të forcojnë bashkëpunimin në zhvillimin rajonal dhe lokal, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e pabarazive rajonale. Asistenca financiare e ofruar nga Bashkimi parashikohet nga nenet 112-115 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA).

Objekti i Qeverisë shqiptare në këtë fushë është eliminimi i pabarazive ekonomike si dhe zhvillimi social i rajoneve dhe, rrjedhimisht, zhvillimi ekonomik dhe social i vendit në përputhje me standardet e BE-së.

I.2 Situata në Shqipëri

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve (FZhR) konsiderohet instrument i rëndësishëm i Qeverisë që do t'i nënshtrohet procesit të reformave që qeveria e re ka ndërmarrë për të adresuar sfidat e vendit. FZhR është pjesë e modelit të ri të zhvillimit që Qeveria po zbaton për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Shqipërisë.

Në vizionin e qeverisë së re, FZhR-ja nuk do të shërbejë më si ndihmë financiare për Njësitë e Qeverisjes Vendore (NjQV), por si instrument për të promovuar zhvillimin e potencialeve ekonomike dhe si një mekanizëm që gjeneron rritje, si dhe për të rritur konkurrenshmërinë e ekonomisë sonë në mesin e ekonomive rajonale. Qëllimi është që Shqipëria të përgatitet nëpërmjet reformimit të mekanizmit ekzistues, dhe të jetë në një linjë me politikat e zhvillimit rajonal të BE-së, në mënyrë që të përthithim fonde strukturore.

Kjo përjasje e re e FZhR-së synon të shtrijë zhvillimin në një rreze më të gjerë dhe ta shohë Shqipërinë si një e tërë, jo të fragmentuara në njësi të vogla në konkurrencë mes tyre. Gjithashtu, ofron mundësi për zhvillim partneritetesh ndërkufitare dhe bashkëfinancim për projekte

donatorësh, me qëllim që të tërhiqen fonde dhe investime në zona ndërkufitare dhe më tej. Në këtë kontekst, FZhR-ja sinkronizon platformat ekzistuese operuese si dhe bashkon energjitë e fragmentuara dhe mjete e zhvillimit (Fondi i Zhvillimit të Rajoneve dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit).

Aktualisht, Shqipëria përfiton prej BE-së fonde para-anëtarësimi (Instrumenti për Asistencën e Para-anëtarësimit - IPA) të programit të kaluar financiar 2007-2013 dhe ka filluar perspektivën e re financiare 2014-2020. Prioritetet e vendit në perspektivën e re janë përcaktuar në Dokumentin Strategjik të vendit, që përcakton prioritetet në sektorët e përzgjedhur për asistencë të IPA-s. Sektorët dhe fushat prioritare për financim brenda sektorëve janë identifikuar bashkërisht nga BE dhe Shqipërisë, në përputhje me prioritetet politike të përcaktuara në Strategjinë e Zgjerimit dhe Progres-Raportin Vjetor të Komisionit. Janë marrë parasysh edhe strategjitë dhe politikat kyçe kombëtare të Shqipërisë.

Një tjetër dokument strategjik është Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020. Ky dokument përbën instrumentin kryesor që orienton zhvillimin e vendit si dhe pasqyron lidhjen logjike mes zhvillimit të vendit dhe procesit të integrimit evropian.

Qeveria e Shqipërisë ka adresuar çështjet kryesore dhe ka përmbushur një sërë parakushtesh për menaxhimin e decentralizuar të Komponentit I të IPA-s. Janë ngritur dhe funksionojnë autoritetet dhe strukturat e nevojshme për menaxhimin e decentralizuar: Koordinatori Kombëtar IPA (KKIPA/NIPAC), Zyrtari Kompetent Akreditues (ZPA/CAO), Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA/NAO), Zyrtarët e Lartë të Programit (ZLP/SPOs) në ministritë e linjës, Fondi Kombëtar, Zyra e ZKA-së/NAO, Njësia Qendrore e Financimit dhe Kontraktimit (NjQFK/CFCU) dhe Autoriteti i Auditimit. Komisioni Evropian miratoi vendimin për dhënien e kompetencave menaxhuese për Komponentin I me kontroll *ex-ante* dhe, për këtë arsye, disa projekte do të zbatohen nën përgjegjësinë e qeverisë shqiptare, duke marrë kështu më shumë autorësi. Objektivi i Shqipërisë është të arrijë gradualisht decentralizimin e plotë për të gjithë komponentët e IPA-s në të ardhmen.

Në lidhje me Komponentin II (Bashkëpunimi ndërkufitar), duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme dhe procesi i decentralizimit ka nevojë për më shumë kohë. Përgatitjet për menaxhimin e decentralizuar në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural janë në proces.

Gjithashtu, institucionet shqiptare po ndjekin hapat e nevojshëm për pjesëmarrjen në Programet e reja të BE-së.

Është ngritur Komiteti Ndërmnistror për Bashkërendimin e Programit IPA si mekanizëm bashkërendimi që monitoron zbatimin e projekteve dhe programeve IPA.

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE-së

Në lidhje me zhvillimin rajonal dhe vendor, neni 110 i MSA-së parashikon se palët do të forcojnë bashkëpunimin për zhvillimin rajonal dhe vendor, me objektivin për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e pabarazive rajonale, konkretisht palët do të përpiqen të forcojnë bashkëpunimin në zhvillimin rajonal dhe lokal, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe reduktimin e pabarazive rajonale. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit ndërkufitar, transkombëtar dhe interrajonat. Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në fushën e zhvillimit rajonal.

Asistenca financiare që jep BE-ja përcaktohet në nenet 112-115 të **MSA**-së. Këto nene shprehen qartë se Shqipëria mund të përfitojë nga BE-ja asistence financiare në formën e granteve dhe huave, por së pari, Shqipëria duhet të përcaktojë prioritetet dhe të garantojë kapacitetet e duhura për përthithjen e kësaj asistence. MSA-ja kërkon që kontributet e Komunitetit të jepen në bashkërendim të ngushtë me kontributet prej burimeve të tjera si Shtetet Anëtare, vende të tjera dhe institucione financiare ndërkombëtare, konkretisht:

Në përputhje me Nenin 112 të MSA, Shqipëria mund të marrë asistencë financiare nga Komuniteti në formë granti dhe huaje, duke përfshirë hua nga Banka Evropiane e Investimeve. Ndihma e BE varet nga përmbushja e parimeve dhe kushteve të parashikuara në konkluzionet e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme më 29 prill 1997, duke marrë parasysh rezultatet e raporteve vjetore të vendeve në Procesin e Stabilizim Asociimit, Partneriteteve Evropiane, dhe të konkluzioneve të tjera të Këshillit, të cilat i përkasin në mënyrë të veçantë respektimit të programeve rregulluese. Sipas MSA, ndihma që i jepet Shqipërisë do të orientohet drejt nevojave të konstatuara, përparësive të zgjedhura dhe kapacitetit për të thithur dhe për të dhënë rezultate, si edhe masave të marra për reformimin dhe ristrukturimin e ekonomisë.

Përsa i përket Nenit 113 të MSA, Asistenca financiare, në formën e granteve, duhet të trajtohet nga masat operationale të parashikuara në Rregulloren përkatëse të Këshillit brenda kuadrit indikativ shumëvjeçar të caktuar nga Unioni pas konsultimeve me Shqipërinë.

Asistenca financiare mund të mbulojë të gjithë sektorët e bashkëpunimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, përafrimit të legjislacionit dhe zhvillimit ekonomik.

Neni 114 i MSA sanksionon se, me kërkesë të Palës shqiptare dhe në rastet e nevojës së veçantë, Unioni, duke u koordinuar me institucionet ndërkombëtare financiare, mund të shqyrtojë mundësinë, duke bërë përjashtim,, e dhënies së asistencës makro-financiare, e cila varet nga kushte

të caktuara dhe duke marrë parasysh disponimin e të gjitha burimeve financiare. Kjo asistencë mund të jepet vetëm kur përmbushen kushtet që do të vendosin në kontekstin e një programi për të cilin është rënë dakord mes Shqipërisë dhe FMN-së.

Sa i përket nenit 115 të MSA BE dhe Shqipëria garantojnë që kontributet e BE të bëhen në bashkëpunim të ngushtë me ato kontribute të ardhura nga burime të tjera si prej Shteteve Anëtare, vendeve të tjera dhe institucioneve financiare ndërkombëtare. Në këtë drejtim, informacioni për çdo burim të asistencës shkëmbehet rregullisht ndërmjet Palëve.

E drejta e BE-së në fushën e bashkëpunimit financiar konsiston, ndër të tjera, nga këto akte ligjore:

- Rregullorja (BE) nr. 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 Mars 2014 që përcakton Instrumentin për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA II);
- Rregullorja Zbatuese (BE) e Komisionit nr. 447/2014 e datës 2 maj 2014 për rregullat specifike për zbatimin e Rregullores (BE) nr. 231/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit që përcakton Instrumentin për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA II);
- Rregullorja (BE) nr. 236/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 mars 2014 që përcakton rregulla dhe procedura të përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të BE-së për financimin e masave të jashtme;
- Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1085/2006 e datës 17 korrik 2006 që përcakton instrumentin për asistencën e para-anëtarësimit (IPA);
- Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 718/2007 e datës 12 qershor 2007 që zbaton Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1085/2006 që përcakton instrumentin për asistencën e para-anëtarësimit (IPA).

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore normative

Në përgjithësi, Shqipëria i ka realizuar detyrimet që rrjedhin nga MSA-ja në këtë fushë. Në tetor 2007, Qeveria nënshkroi Marrëveshjen Kuadër me Komisionin e Komuniteteve Evropiane "Për rregullat e bashkëpunimit për asistencën financiare të KE-së për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të zbatimit të asistencës IPA", dhe në dhjetor 2007 u miratua Ligji nr. 9840, datë 10.12.2007 "Për ratifikimin e Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të para-anëtarësimit", duke e bërë kështu Marrëveshjen pjesë të legjislacionit të brendshëm.

Një tjetër arritje e rëndësishme normative ishte Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 23, datë 12.01.2011 "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësi dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në

kuadër të Instrumentit të Para-anëtarësimit (IPA), Komponenti I: Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional", ndryshuar me VKM nr. 850, datë 14.12.2011 dhe me VKM nr. 707, datë 2013.08.21.

Autoriteti i Auditit vepron në përputhje me VKM nr. 1020, datë 14.10.2009 "Për ngritjen e Agjencisë së Auditimit të Programeve të BE-së". Ky Vendim është ndryshuar me VKM nr. 328, datë 13.05.2011 dhe me VKM nr. 235, datë 04.04.2012.

Aktet normative më lart përcaktojnë autoritetet dhe strukturat përgjegjëse për menaxhimin e decentralizuar të fondeve IPA, në kuadrin e Komponentit I, që janë: Koordinatori Kombëtar IPA (KKIPA/NIPAC); Zyrtari Përgjegjës Akreditues (ZPA/CAO); Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA/NAO); Zyrtari Autorizues i Programit (ZAP/PAO); Zyrtarët e lartë të programit në ministritë e linjës (ZLP/SPOs); Fondi Kombëtar (FK/NF); Zyra e ZKA-së/NAO; Njësia Qendrore e Financimit dhe Kontraktimit (NjQKF/CFCU) dhe Autoriteti i Auditit.

Aktet normative përshkruajnë funksionet, përgjegjësitë dhe marrëdhëniet ndërmjet këtyre autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit të decentralizuar të IPA-s.

Komiteti Ndërmnistror për Bashkërendimin e Programeve IPA u ngrit në zbatim të VKM-së N. 707, datë 21.8.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 23, datë 12.1.2011 të Këshillit të Ministrave 'Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjëseve dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të instrumentit të para-anëtarësimit (IPA), Komponenti I "Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional", i ndryshuar. Ky Komitet do të shërbejë si mekanizëm bashkërendimi për të monitoruar zbatimin e projekteve dhe programeve IPA.

Pas rekomandimeve të audituesve të KE-së mbi forcimin e rolit monitorues të KKIPA-s, Kryeministri nxori Urdhrin nr. 183, datë 18.10.2013 "Për miratimin e strukturës dhe organizimin e Ministrisë së Integrimit Evropian", në bazë të të cilit u ngrit Drejtoria e Monitorimit të Projekteve të Asistencës së BE-së në Ministrinë e Integrimit Evropian. Kjo drejtori përbëhet nga dy sektorë: Sektori i Monitorimit dhe Vlerësimit të IPA1, si dhe Sektori i Monitorimit dhe Vlerësimit për Bashkëpunimin Ndërkufitar.

Lidhur me strukturat drejtuese të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar, detajet janë parashikuar në VKM nr. 525, datë 16.08.2012 "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjëseve e të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të instrumentit të para-anëtarësimit (IPA), Komponenti II - "Bashkëpunimi ndërkufitar".

II.3 Institucionet përgjegjëse

Kuadri institucional përgjegjës për bashkërendimin e instrumenteve strukturorë në Shqipëri përbëhet nga këto institucione:

- i. Ministria e Integrimit Evropian
- ii. Ministria e Financave
- iii. Kryeministria (DZhPFNH)

i. Ministria e Integrimit Evropian (MIE) është institucioni qendror përgjegjës për programimin, monitorimin dhe vlerësimin e asistencës financiare të BE-së dhe i është besuar bashkërendimi i pjesëmarrjes së institucioneve shqiptare në programet e BE-së, si edhe bashkërendimi i procesit të aplikimit të institucioneve shqiptare në programet Kuadri i Investimeve të Ballkanit Perëndimor si dhe IPA me Shumë Përfitues. Ministria është përgjegjëse edhe për programimin dhe monitorimin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar ku Shqipëria merr pjesë. Ministri i Integrimit emërohet Koordinatori Kombëtar i IPA-s (KKIPA). KKIPA siguron bashkërendimin e përgjithshëm të asistencës IPA, garanton bashkëpunimin normal mes Qeverisë e Komisionit Evropian si dhe identifikon prioritetet e vendit për financim. Zyra KKIPA udhëhiqet nga Sekretari i Përgjithshëm - i emëruar si Shef i Zyrës KKIPA - dhe ka 11 të punësuar.

Në Ministri, janë dy drejtori merren me asistencën financiare të BE-së: (i) Drejtoria e Monitorimit të Projekteve të Asistencës së BE-së, që përbëhet nga dy sektorë: Sektori i Monitorimit dhe Vlerësimit IPA1, si dhe Sektori i Monitorimit dhe Vlerësimit për Bashkëpunimin Ndërkufitar (ii) Drejtoria e Programimit të Asistencës së BE-së, që përbëhet nga Sektori KKIPA dhe Sektori i Bashkëpunimit Ndërkufitar.

ii. Ministria e Financave është përgjegjëse për menaxhimin e asistencës financiare të BE-së përmes modalitetit të decentralizuar.

Zv.Ministri i Financave, në cilësinë e Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZKA), mbart përgjegjësinë kryesore për menaxhimin financiar të fondeve të BE-së në Republikën e Shqipërisë. Ai është përgjegjës për ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve përkatëse, si edhe për funksionimin efikas të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, siç përcakton rregullorja e IPA-s.

Në ushtrimin e këtyre dy funksioneve, ai mbështetet nga:

- Fondi Kombëtar (FK) i ngarkuar me funksionin e parë, është sidomos përgjegjës për detyrat e menaxhimit financiar, organizimin dhe hapjen e llogarive bankare, kërkimin e fondeve nga Komisioni, autorizon transferimin e fondeve nga Komisioni te strukturat operuese

(Agjencia Zbatuese NjQFK për Komponentët I-IV IPA, si dhe Agjencia IPARD për Komponentin V), duke siguruar elementet e bashkëfinancimit dhe raportimin financiar për Komisionin.

- Zyra ZKA, e ngarkuar me funksionon e dytë, është përgjegjëse për funksionimin efikas të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, si edhe zyra koordinuese për ZKA, në përputhje me aktivitetet e menaxhimit të decentralizuar.

Në Ministrinë e Financave, CFCU (Njësia Qendrore e Financimit dhe Kontraktimit) është organi drejtues i strukturës operuese për Komponentët I-IV. CFCU kryesohet nga Zyrtari Autorizues i Programit (ZAP)/Kreu i Strukturës Operuese (KSO) dhe mban përgjegjësinë e plotë për realizimin e procedurave të tenderimit, kontraktimit dhe ekzekutimit të pagesave për kontraktorët/përfituesit e granatit, si edhe për kontabilitetin e projekteve të financuara në kuadrin e IPA-s.

CFCU është përgjegjëse edhe për monitorimin e zbatimit të kontratave/programit, si edhe për operacionet e Strukturës Operuese për Komponentët I-IV të IPA-s.

Struktura ZLP ngrihet në ministritë e linjës. Në Ministrinë e Financave, kjo strukturë është ngritur brenda Sektorit të Integritimit Evropian. Përgjegjësia kryesore e ZLP-së është të mbështetë stafin dhe nëpunësit e programimit/zbatimit për të siguruar programin, zbatim dhe monitorim të duhur të projekteve të Ministrisë së Financave financuar nga IPA. Në bashkëpunim me CFCU, ZLP përgatit dokumentet e tenderit dhe raporton te CFCU për do mospërputhje.

Grupi Ndërinstitucional i Punës për Integrimin Evropian përgjegjës për Kapitullin 22 (Politika Rajonale dhe Bashkërendimi i Instrumenteve Strukturore) kryesohet nga Ministria e Integritimit Evropian me këtë përbërje:

- i. Ministrinë e Financave
- ii. Kryeministrinë (Departamenti për Zhvillim, Programin, Financim dhe Ndihmën e Huaj)

II.4 Parashikimet financiare indikative (ALL)

	2012	2013	2014	2015
Kostoja totale	242.400.278	163.200.735	280.585.231	360.202.431
Buxheti i Shtetit	37.316.278	35.158.735	60.378.231	68.802.431
Asistencë e Huaj	205.084.000	128.042.000	220.207.000	291.400.000

III. Prioritetet

- Forcimi i mëtejshëm i kuadrit institucional, d.m.th. strukturat dhe autoritetet kombëtare të ngarkuara me menaxhimin e decentralizuar të komponentit IPA I;
- Përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit normativ, për të siguruar programim sektorial shumëvjeçar, fleksibilitet buxheti dhe kapacitetet bashkëfinancimi për projektet e BE-së në nivel kombëtar dhe vendor;
- Objektivi i Shqipërisë është që të arrijë gradualisht decentralizimin e plotë të fondeve IPA, në mënyrë që Qeveria të ketë më shumë autorësi;
- Në lidhje me Komponentin II – Bashkëpunimi Ndërkufitar, do të avancohet procesi i decentralizimit si edhe do të miratohen dokumentet e nevojshme si p.sh. marrëveshjet zbatuese dhe operacionale ndërmjet ZKA-së, Kreut të Strukturës Operuese dhe ZAP-it;
- Finalizimi i përgatitjeve për menaxhimin e decentralizuar në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Strukturat kryesuese (ZKA, Zyra ZKA dhe FK) për Akreditimin e Zhvillimit Rajonal duhet të mbështeten me ekspertizë ndërkombëtare. Staf i këtyre strukturave duhet të forcohet më tej dhe nevojiten kapacitete të dedikuara, sidomos për zbatimin e Komponentit për Zhvillimin Rural.
- Në lidhje me procesin e programimit, kapacitetet administrative duhet të rriten ndjeshëm, me qëllim që të hartohen dhe të zbatohen politika dhe strategji sektoriale realiste. Përgatitja e një liste projektsh prioritare mbetet një çështje e rëndësishme që duhet adresuar, sidomos në lidhje me perspektivën financiare në kuadrin e IPA2.

IV. Plani

IV.1 Kuadri i Politikave Ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim	Kryeministria	2007-2013
Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së	Ministria e Integritimit Evropian	2009-2014
Plani i Veprimit i MIE-s për sensibilizimin mbi procesin e integrimit evropian	Ministria e Integritimit Evropian	2012-2013

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Acquis e BE-së	Legjislacioni shqiptar	Institucioni kryesor	Shkalla e përafrimit (e plotë/e pjesshme/ mospërputhje)	Data e miratimit (legjislacion shqiptar)	Hyrja në fuqi (legjislacion shqiptar)
E paaplikueshme	Ligji nr. 9840, datë 10.12.2007 "Për ratifikimin e Marrëveshjes kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të instrumentit të para-anëtarësimit (IPA)"	Ministria e Integrimit Evropian, Ministria e Financave	E paaplikueshme	10.12.2007	27. 12.2007
E paaplikueshme	VKM nr. 23, datë 12.01.2011 "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisë dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Para-anëtarësimit (IPA), Komponenti I"	Ministria e Financave dhe Ministria e Integrimit Evropian	E paaplikueshme	12.01.2011	12.01.2011
E paaplikueshme	VKM nr. 850, datë 14.12.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 23, datë 12.01.2011 ' Për	Ministria e Financave dhe Ministria e Integrimit Evropian	E paaplikueshme	14.12.2011	14.12.2011

	përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Para-anëtarësimit (IPA), Komponenti I”				
E paaplikueshme	VKM nr. 707, datë 21.08.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 23, datë 12.01.2011 'Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të Instrumentit të Para-anëtarësimit (IPA), Komponenti I”, i ndryshuar	Ministria e Financave dhe Ministria e Integritimit Evropian	E paaplikueshme	21.08.2013	21.08.2013
E paaplikueshme	VKM nr. 1020, datë 14.10.2009 "Për ngritjen e Agjencisë së Auditimit të Programeve të BE-së"	Ministria e Financave	E paaplikueshme	14.10.2009	14.10.2009
E paaplikueshme	VKM nr. 328, datë 13.05.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 1020, datë 14.10.2009 "Për ngritjen e Agjencisë së Auditimit të Programeve të BE-së"	Ministria e Financave	E paaplikueshme	13.05.2011	13.05.2011

E paaplikueshme	VKM nr. 235, datë 04.04.2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 1020, datë 14.10.2009 "Për ngritjen e Agjencisë së Auditimit të Programeve të BE-së", i ndryshuar	Ministria e Financave	E paaplikueshme	04.04.2012	04.04.2012
E paaplikueshme	VKM nr. 525, datë 16.08.2012 "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisë e të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të instrumentit të para-anëtarësimit (IPA), Komponenti II - "Bashkëpunimi ndërkufitar".	Ministria e Financave dhe Ministria e Integrimit Evropian	E paaplikueshme	16.08.2012	16.08.2012
E paaplikueshme	VKM nr. 283, datë 14.05.2014 "Për miratimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, përfaqësuar nga Komisioni Evropian, për programin kombëtar për vitin 2013 në kuadrin e IPA – Komponenti I "Asistenca e Tranzicionit dhe Forcimi Institucional (menaxhim i decentralizuar)	Ministria e Integrimit Evropian	E paaplikueshme	14.05.2014	14.05.2014

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZhI)	Kryeministria/ Departamenti i Zhvillimit, Programimit, Financimit dhe Ndihmës së Huaj	2014-2020	Dhjetor 2014	Dhjetor 2014
Plani Kombëtar për Integrimin Evropian	Kryeministria/Ministria e Integrit Evropian	2014-2020	Qershor 2014	Qershor 2014
Dokumenti i Politikave - CSP	Komisioni Evropian; Ministria e Integrit Evropian	2014-2020	Shtator 2014	Shtator 2014
Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike	Ministria e Financës	2014-2020	Qershor 2014	2014

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU acquis	Legjislati oni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislati oni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislati oni Shqiptar)	EU acquis	Legjislati oni Shqiptar
<u>AFATSHKURTËR (2014)</u>							
Rregullorja (BE) nr. 231/2014	Jo	Projektligji "Për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian "Për rregullat e bashkëpunimit për asistencën financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të zbatimit të asistencës IPA (IIPA II)"	Jo	Ministria e Integrit Evropian dhe Ministria e Financave		Tetor 2014	Tetor 2014

<u>AFATMESME (2015 – 2016)</u>							
E paaplikueshme	E paaplikueshme	Projekt-VKM për zbatimin e IPA II	Jo	Ministria e Financave	E paaplikueshme	2015	

KAPITULLI 23: BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E GJYQËSORIT DHE TË DREJTAVE THEMELORE

I. Hyrje

I.1. Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli 23 mbulon disa fusha të cilat janë në ombrellën e e përgjithshme të Gjyqësorit dhe të Drejtave Themelore. Është një kapitull thelbësor për përpjekjet e para aderimit dhe ka një rëndësi të veçantë gjatë negociatave për antarësim, ku vendosen kushtëzime strikte dhe etapa të caktuara së bashku me monitorimin nga Bashkimi Evropian.

I.2. Situata në Shqipëri

Sistemi gjyqësor

Strategjia 2011-13 e reformës gjyqësore, një prioritet kyç i Opinionit, është duke u zbatuar. Janë miratuar Ligji për Gjykatën e Lartë, një prej masave kryesore në këtë fushë, si edhe ndryshimet në Kodin Penal, Kodin Civil dhe Kodin e Procedurës Civile. Ligji për Administratën Gjyqësore u miratua për të siguruar një kuadër ligjor për punën e gjykatave dhe stafit të gjykatës; pavarësia e kancelarëve të gjykatave mbetet një çështje shqetësuese. Ligji për Konferencën Kombëtare Gjyqësore dhe Ligji për Profesionin e Avokatit ka filluar të zbatohet. Memorandumi i mirëkuptimit për inspektimet e Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili synon të reduktojë rrezikun e mbivendosjes së përgjegjësive ka vazhduar të zbatohet. Janë planifikuar për t'u miratuar apo finalizuar ndryshimet kushtetuese dhe legjislacioni thelbësor për të siguruar pavarësinë, transparencën dhe efikasitetin e gjyqësorit. Procedura e emërimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë është planifikuar për tu ndryshuar gjithashtu. Një nga prioritetet është të kemi një organizim efikas të gjykatave, ndarje të qartë dhe efektive e buxhetit, procedura gjyqësore të unifikuara, të shpejta dhe transparente dhe një sistem i emërimit të gjyqtarëve bazuar në një vlerësim të shëndoshë të performancës së kandidatëve.

Politika anti-korrupsion

Ka pasur përmirësime në luftën kundër korrupsionit, si një prioritet kyç i Opinionit. Të gjitha rekomandimet e raundit të tretë të vlerësimit të GRECO-s kanë përfunduar në mënyrë të kënaqshme. Kjo ka prekur sidomos financimin partive politike. Të dhënat fillestare të rezultateve mbulojnë një shumëllojshmëri të sektorëve dhe niveleve, duke përfshirë korrupsionin e nivelit të lartë dhe tregojnë një rritje në dënime. Disa nga masat e marra në sektorët kyç dëshmojnë për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj korrupsionit, një përmirësim të përgjithshëm organizimi dhe një bashkëpunim më të efektshëm standardizues ndërmjet organeve të zbatimit të ligjit. Ofrimi i shërbimeve publike në internet dhe masat ndërgjegjëse në sektorë të ndryshëm kanë krijuar kushte për më shumë transparencë dhe llogaridhënie të administratës publike. Korrupsioni mbetet një problem serioz dhe është i përhapur në shumë fusha, përfshi institucionet e zbatimit të ligjit. Ka ende boshllëqe serioze, p.sh. në monitorimin e korrupsionit të qeverisjes vendore. Duhet të ndërmerret një vlerësim edhe në lidhje me rolin dhe funksionimin e institucioneve përkatëse dhe koordinimin e tyre për të forcuar më tej organizimin e përgjithshëm anti-korrupsion. Duhet të caktohet një koordinator anti - korrupsion me një mandat të fortë për të kryer këtë. Ekziston gjithashtu një nevojë për të përmirësuar bashkëpunimin me organet e pavarura të kontrollit si Kontrolli i Lartë i Shtetit. Pas ndryshimeve kushtetuese për kufizimin e imunitetit të gjyqtarëve dhe zyrtarëve të lartë janë të nevojshme masat për të sqaruar procedurat hetimore. Sfidë afatshkurtër është që të ngrihen hetime proaktive bazuar në vlerësimin sistematik të rrezikut, si parakusht për vijueshmërinë e rezultateve të ndjekjes efektive penale në të gjitha nivelet, veçanërisht në ato fusha ku ekziston një perceptim i fortë publik për korrupsion.

Të drejtat themelore

Shqipëria ratifikoi Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokollin e saj Opsional, Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve në lidhje me një procedurë të komunikimit. Vonesat në zbatim dhe mos-përputhja me gjykimet e **Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut**, në veçanti në lidhje me të drejtat pronësore dhe e drejta për një gjykim të drejtë, mbetën një shqetësim. Gjykata ka dorëzuar gjykimet për 6 kërkesa duke gjetur se Shqipëria kishte shkelur të drejtat e garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Shteti i së drejtës

Forcimi i sundimit të ligjit është kushti më themelor për konsolidimin e demokracisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm politik, ekonomik dhe shoqëror në vend. Suksesi i reformave në drejtësi varet në një shkallë të lartë nga bashkëveprimi mes disa institucioneve të pavarura, duke përfshirë Presidentin e Republikës, Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë.

Qeveria Shqiptare është e angazhuar plotësisht në zbatimin në gjerësi dhe thellësi të reformave në sistemin e drejtësisë, të sugjeruara dhe të mbështetura nga partneret ndërkombëtare, në bashkëpunim me institucionet e tjera kushtetuese që përfshihen në çështjet e reformave dhe

performancës së sistemit të drejtësisë si dhe në përputhje me angazhimet dhe detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (Neni 1, 2, 13, 70 dhe 78 i MSA-së).

Çdo veprim që do të ndërmerret Qeveria shqiptare në kuadrin e reformës në sistemin e drejtësisë dhe forcimit të shtetit të së drejtës, ka si qëllim dhe objektiv final krijimin e një sistemi drejtësie bashkëkohor, të aftë të sigurojë garantimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë, ndershmërisë dhe efektivitetit të drejtësisë shqiptare, të respektojë parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, duke mbrojtur të drejtat, interesat dhe liritë e ligjshme të njeriut, të kontribuojë në administrimin e drejtësisë penale, të zgjidhë mosmarrëveshjet në mënyrë efektive dhe të drejtë si dhe të implementojë legjislacionin e BE dhe të pasqyrojë standardet e Bashkimit Evropian në fushën e drejtësisë.

Në kuadër të krijimit të një sistemi drejtësie bashkëkohor, Qeveria shqiptare synon rritjen e cilësisë në dhënien e drejtësisë si shërbim ndaj qytetarëve dhe forcimin e shtetit ligjor nëpërmjet formimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve me integritet, aftësi dhe cilësi të larta profesionale dhe etike. Ky objektiv përcakton si prioritet rritjen e aksesit në drejtësi, rritjen e profesionalizmit të aktorëve kryesorë të sistemit të drejtësisë përmes një programi trajnimi të niveleve bashkëkohore dhe standardeve evropiane dhe përmirësimit të sistemit të drejtësisë shqiptare duke siguruar një trajnim profesional pas universitar për gjyqtarë dhe prokurorë.

I.3 Struktura e kapitullit

1. SISTEMI GJYQËSOR
2. POLITIKAT KUNDËR KORRUPSIONIT
3. TË DREJTAT THEMELORE

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Nenet 1, 2, 13, 70 dhe 78 të MSA-së janë me rëndësi të veçantë për këtë kapitull. Sipas Neni 78 të MSA-së rëndësi të veçantë duhet ti kushtohet forcimit të shtetit të së drejtës, dhe forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet në fushën e administratës në përgjithësi, si edhe imponimit të ligjeve e administrimit të drejtësisë në veçanti. Bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian duhet të synojë veçanërisht në fuqizimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe në përmirësimin e efikasitetit të tij, në përmirësimin e funksionimit të policisë dhe organeve të tjera të imponimit të ligjeve duke siguruar trajnime të mjaftueshme dhe duke luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Instrumentet e BE dhe Ndërkombëtarë në fushën e gjyqësorit përfshijnë, ndër të tjera:

- Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian (Neni 47 – e drejta për një zgjidhje efektive)
- Tabela e Pikëzimit të Drejtësisë së BE: një mjet për të promovuar drejtësinë efektive dhe rritjen
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Neni 6 – e drejta për një gjykim të drejtë)
- Rekomandimi CM/Rec(2010)12 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi gjyqtarët: pavarësia, eficienta dhe përgjegjësitë.
- Raporti i Komisionit të Venecias mbi pavarësinë e sistemit gjyqësor (2010) – Pjesa I: pavarësia e gjyqtarëve.
- Opinioni Konsultativ Nr 1 (2001) i Këshillit të Gjyqtarëve Evropian mbi standardet në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit dhe pandërrueshmërinë e gjyqtarëve
- Karta Evropiane dhe statute për gjyqtarët, 1998,
- Rekomandimi R(94) 12 i Komitetit të Ministrave mbi pavarësinë, eficientën dhe rolin e gjyqtarit, 1994.
- Rekomandimi Nr R(86) i Këshillit të Evropës mbi Masat për të Parandaluar dhe të Zvogëluar Ngarkesën e Tepërt të Punës në Gjykata.
- Principet e Bangalore mbi Sjelljen në Gjyqësor (“Principet e Bangalore”), miratuar nga Kombet e Bashkuara, Komisioni i të Drejtave të Njeriut në 23 Prill 2003.
- Principet Bazike të Kombeve të Bashkuara mbi Pavarësinë e Gjyqësorit, 29 Nëntor 1985, A/RES/40/32.

II.2 Institucionet përgjegjëse

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Punëve të Brendshme

Këshilli i Lartë i Drejtësisë

Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor

Gjykata Kushtetuese

Gjykata e Lartë

Konferenca Gjyqësore Kombëtare

Prokuroria

Avokati i Popullit

Shkolla e Magjistraturës

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë, është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës për Kapitullin 23, Nr. 770, datë 10.12.2013.

II.2. Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

Tabela në Lekë

Kosto totale	2014	2015	2016	2017
• Buxheti i shtetit	• 2,685,970,000	• 1,218,970,000	• 1,218,970,000	• 818,970,000

III. Prioritetet

Në përputhje me Progres Raportin e Komisionit Evropian prioritetet janë:

- Shqipëria duhet të përditësojë strategjinë e reformës gjyqësore dhe të rritë pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore.
- Ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale, sidomos në lidhje me miratimin e dispozitave që synojnë racionalizimin e kompetencave dhe procedurave të Gjykatës së Lartë si edhe reduktimin e ngarkesës së punës.
- Nevojitet të miratohen akte ligjore të rëndësishme për reformën e Gjykatës Kushtetuese dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë.
- Roli i Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë duhet të shqyrtohet.
- Pavarësia dhe paanësia e Gjykatës së Lartë dhe të anëtarëve të saj duhet garantuar plotësisht.
- Vlerësimi i gjyqtarëve si kriter vendimtar për të pasur proces emërimesh, transferimesh dhe ngritjesh në detyrë të bazuar në merita dhe transparencë duhet të përfundohet.
- Procedura për emërimin e gjyqtarëve administrative duhet finalizuar.
- Buxheti i Shkollës së Magjistraturës duhet të rritet.
- Publikimi i vendimeve gjyqësore, duhet të marrë parasysh të gjitha aspektet që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale. Duhet të ndiqen rekomandimet përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale
- Ndryshimi i Ligjit për Këshillin e Lartë të Drejtësisë.
- Luftën kundër korrupsionit në gjyqësor duhet të vazhdojë.
- Reforma kushtetuese që nisi në 2012, duhet të përfundohet.

- Ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale që mundësojnë arrestimin e gjyqtarëve si edhe kontrollin e tyre personal dhe shtëpiak, duhet të miratohen.
- Zbatimi i plotë i Kodit të etikës duhet garantuar
- Duhet bërë një analizë mbi impaktin e procedurave on-line, të cilat bëjnë të mundur për qytetarët të ankohen për gjyqtarët dhe procedurat gjyqësore.
- Arsytim në hartimin e vendimeve gjyqësore duhet përmirësuar.
- Prokuroria e Përgjithshme duhet të ketë me shumë llogaridhënie. Procedurat për emërimin dhe shkarkimin e personelit kyç të Prokurorisë duhet të jenë transparence dhe të paanshme, ndërsa roli i Këshillit të Prokurorëve duhet të përforcohet.
- Riorganizimit territorial të gjykatave dhe rialokimit të numrit të gjyqtarëve, me propozim të Ministrisë së Drejtësisë dhe pëlqim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë duhet të zbatohet.
- Pavarësia e kancelarëve të gjykatës dhe njohja e tyre si nëpunës civil duhet të garantohet. Duhet të hartohen dhe të miratohen aktet nënligjore.
- Nevojitet trajnim adekuat i stafit të gjykatave dhe përmirësimi në kushtet e punës së gjykatave.
- Buxheti i akorduar për gjykatat dhe stafin e gjykatave duhet të rritet.
- Duhet të hartohet një regjistër civil i saktë me sistem adresash.
- Një Plan Veprimi duhet të miratohet për ngritjen e një mekanizimi efektiv kompensimi, në mënyrë që vendimet në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronave të shtetëzuara gjatë regjimit komunist të mund të ekzekutohen.
- Përmirësimi i kapaciteteve dhe infrastrukturës së institucioneve penitenciare;
- Hetimi në rastet e shkeljes së ligjit;
- Ulja e mbipopullimit në institucionet e paraburgimit.
- Përmirësimi i përgatitjes profesionale të punonjësve të institucioneve të vuajtjes së dënimit;
- Forcimi i luftës kundër korrupsionit në burgje.

KSA dhe Nënkomitete

Reforma Gjyqësore

- Shqipëria është e inkurajuar të vazhdojë me zbatimin e Strategjisë Ndër Sektorale për Reformën në Drejtësi, në kuadër të forcimit të sundimit të ligjit duke marrë masa konkrete për të promovuar një gjyqësor të paanshëm, të pavarur, transparent, llogaridhënës dhe efektiv. Për këtë, zhvillimi i një analize për të evidentuar mangësitë e kuadrit ligjor të sistemit gjyqësor, duhet marrë në konsideratë.
- Shqipëria do të zbatojë masat e planifikuara për përmirësimin e kushteve të punës dhe të jetesës së gjyqtarëve (si rritja e pagës), dhe do të përfundojë procesin e vlerësimit në kontekstin e zhvillimit të karrierës së tyre.

- Një trak-rekord mbi inspektimet gjyqësore, gjykimet dhe masat disiplinore duhet të hartohet, ashtu sikurse dhe një trak-rekord mbi ankesat.
- Regjistrimi audio i seancave gjyqësore do të shtrihet në të gjitha gjykatat, dhe botimi i vendimeve do të sigurohet në zbatim të plotë të legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale.
- Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike do të konsolidojë një trak-rekord mbi zbatimin e Ligjit Për Ndihmën Juridike dhe do të përmirësojë aksesin në ndihmën juridike për kategoritë e aplikantëve vulnerabël.
- Menaxhimi i çështjeve duhet të përmirësohet duke zhvilluar një sistem të vetëm dhe të harmonizuar për menaxhimin e çështjeve që të mbulojë të gjitha gjykatat e vendit.
- Ligji për Profesionin e Avokatit duhet të zbatohet në mënyrë rigoroze, që të sigurojë, veçanërisht, punën në mënyrë efektive të komitetit disiplinor të sapo krijuar dhe të rrisë llogaridhënien e avokatëve.

Politikat Kundër Korrupsionit

- Shqipëria duhet të vazhdojë në zhvillimin e një track rekordi të hetimeve, gjykimeve dhe dënimeve në çështjet e korrupsionit në të gjitha nivelet, përfshirë dhe çështje me profil të lartë.
- Autoritetet duhet të ekzaminojnë funksionimin e kuadrit të përgjithshëm ligjor duke përfshirë dhe politikat eficiente për parandalimin dhe goditjen e korrupsionit.
- Agjensitë ligj zbatuese shqiptare inkurajohen të ndjekin hetimet në mënyrë pro-aktive, duke përdorur analizën e riskut, burimet e inteligjencës dhe metodat speciale të hetimit. Kujdes i veçantë i duhet kushtuar financimeve të partive politike, PEPs, dhe në fusha ku ka perceptim publik për korrupsion.
- Reforma Kushtetuese në lidhje me imunitetet e zyrtarëve publik të lartë dhe gjyqtarëve duhet të përfundohet duke hartuar amendimet e nevojshme të Kodit të Procedurës Penale.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2014 – 2016

IV.1 Sistemi gjyqësor

Kuadri i politikave ekzistuese

Strategji ose PV ose dokument politikash	Prioriteti (referenca tek Udhërrëfyesi)	Institucioni Përgjegjës	Periudha e referuar
Plani i masave të Udhërrëfyesit për Prioritetin nr. 2 “Të merren masa të mëtejshme për të përforcuar pavarësinë, efencën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore”	Prioriteti 2: “Të merren masa të mëtejshme për të përforcuar pavarësinë, efencën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore”	MD, KLD, GJL, GJK, AP, SHM, ZABGJ, KGJK, PP, ILDKP, KUVENDI, Avokatura e Shtetit, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, KSHNJ, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore,	2013 – 2014 - 2015

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Legjislacioni	Prioriteti (referenca tek Udhërrëfyesi)	Institucioni Përgjegjës	Hyrja në fuqi
Ligj nr. 8136, datë 31.7.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës të Shqipërisë”;	Prioriteti 2: “Të merren masa të mëtejshme për të përforcuar pavarësinë, efencën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore”	Shkolla e Magjistraturës	31.7.1996
Ligji nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.	Prioriteti 2: “Të merren masa të mëtejshme për të përforcuar pavarësinë, efencën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore”	Ministria e Drejtësisë	18.02.2008

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Strategji ose PV ose dokument politikash	Prioriteti (referenca tek Udhërrëfyesi)	Institucioni Përgjegjës	Periudha e referuar
Strategjia Ndërsektoriale “Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë, 2012-2020” dhe të planit të saj të veprimit (VKM nr. 405/2012)	Prioriteti nr. 5 “Të merren masa efikase për të forcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshi mbrojtjen e romëve dhe politikat antidiskriminim, si edhe të zbatohen të drejtat e pronësisë.”	MD, ZQRPP, AKKP, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve; Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës; Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave; Ministria e Punëve Publike dhe Transportit; Ministria e Brendshme; Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe e Shanseve të Barabarta; MITIK; KQT; AITPP; ALUIZNI; Avokatura e Shtetit.	2012 - 2020

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

Legjislacioni	Prioriteti (referenca tek Udhërrëfyesi)	Institucioni Përgjegjës	Afati
Projektligj “Për një shtesë në ligjin nr. 9877, datë 18.02.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.	Prioriteti 2: “Të merren masa të mëtijshme për të përforcuar pavarësinë, eficientën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore”	Ministria e Drejtësisë	2014
Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8136, datë 31.07.1996 “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.	Prioriteti 2: “Të merren masa të mëtijshme për të përforcuar pavarësinë, eficientën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore”	Ministria e Drejtësisë	2014

Legjislacioni	Prioriteti (referenca tek Udhërrëfyti)	Institucioni Përgjegjës	Afati
Projektligji “Për administratën gjyqësore”	Prioriteti 2: “Të merren masa të mëtejshme për të përforcuar pavarësinë, efencën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore”	Ministria e Drejtësisë	2014
Projektligji “Për sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve”.	Prioriteti 2: “Të merren masa të mëtejshme për të përforcuar pavarësinë, efencën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore”	Ministria e Drejtësisë	2014
Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”	Prioriteti 2: “Të merren masa të mëtejshme për të përforcuar pavarësinë, efencën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore”	Këshilli i Lartë i Drejtësisë/ Ministria e Drejtësisë	2014
Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë””	Prioriteti 2: “Të merren masa të mëtejshme për të përforcuar pavarësinë, efencën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore”	Ministria e Drejtësisë	2014
Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë””	Prioriteti 2: “Të merren masa të mëtejshme për të përforcuar pavarësinë, efencën dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore”	Ministria e Drejtësisë	2014

IV.2 Politikat kundër korrupsionit

Kuadri i politikave ekzistuese

Strategji ose PV ose dokument politikash	Prioriteti (referenca tek Udhërrëfyti)	Institucioni Përgjegjës	Periudha e referuar
Plani i masave të Udhërrëfytit për Prioritetin nr. 3 “Të bëhen përpjekje të vendosura në luftën kundër korrupsionit, përfshi krijimin e një historiku solid rezultatesh me hetime kryesisht, ndjekje penale dhe dënime”	Prioriteti 3: “Të bëhen përpjekje të vendosura në luftën kundër korrupsionit, përfshi krijimin e një historiku solid rezultatesh me hetime kryesisht, ndjekje penale dhe dënime”	Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, MD, SHM, KLD, PP, ILDKP...etj.	2013 - 2014

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Legjislacioni	Prioriteti (referenca tek Udhërrëfyti)	Institucioni Përgjegjës	Hyrja në fuqi
Ligji nr. 7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar	Prioriteti 3: “Të bëhen përpjekje të vendosura në luftën kundër korrupsionit, përfshi krijimin e një historiku solid rezultatesh me hetime kryesisht, ndjekje penale dhe dënime”	MD	Ndryshimet e fundit me Ligj Nr. 144/2013, Dt.Aktit:02.05.2013

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Strategji ose PV ose dokument politikash	Prioriteti (referenca tek Udhërrëfyti)	Institucioni Përgjegjës	Afati

Strategji ose PV ose dokument politikash	Prioriteti (referenca tek Udhërrëfyti)	Institucioni Përgjegjës	Afati
Strategji Ndërsektoriale e Drejtësisë	-	MD, institucionet e varësisë & institucionet bashkërenduese (KGJK, KLD, SHM, KLD, PP, ZABGJ, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, Unioni i Gjyqtarëve, Shoqata e Prokurorëve)	2014 - 2020
Strategjia e Luftës kundër Korrupsionit dhe Plani i Veprimit	Prioriteti nr. 3	Institucionet kryesore: MSHCV, MD, MB, KLD, PP, ILDKPI, Avokati i Popullit, KLSH, KQZ, MSH, MAS, SHM, GDPMI DPT, DPD. Të gjitha ministritë janë të përfshira në zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit në lidhje me objektivat e Strategjisë	2014 - 2017

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

Legjislacioni	Prioriteti (referenca tek Udhërrëfyti)	Institucioni Përgjegjës	Afati
Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”	Prioriteti 3: “Të bëhen përpjekje të vendosura në luftën kundër korrupsionit, përfshi krijimin e një historiku solid rezultatesh me hetime kryesisht, ndjekje penale dhe dënime””	MD	2014

IV.3 Të drejtat themelore

1. Sistemi i Burgjeve

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politik)	Institucioni lider	Periodha e referimit
Strategjia Ndërsektorale e Drejtësisë	Ministria e Drejtësisë	2010-2013
Strategjia Kombëtare e Sistemit të Burgjeve	DPB	2009-2013
Plan Veprimi në përbushje të rekomandimeve të Raport Progresit për sistemin e burgjeve	DPB	2013-2014
Plan Veprimi në përbushje të rekomandimeve të Avokatit të Popullit	DPB	2013-2014

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Legjislacioni i BE	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, Rekomandimi Rec (2006) 2 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 11 janar 2006 në takimin e 952-të të zëvendës ministrave).	Ligji Nr. 8328, datë 16.4.1998 “Mbi të drejtat dhe rajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgsuarve”, i ndryshuar.	GDP	I pjesshëm	21.3.2008	15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Këshilli i Evropës,					

Rekomandimi CM/Rec (2012) 5 i Komitetit të Ministrave për Shtetet anëtare mbi Kodin Evropian të Etikës për stafin e burgjeve (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 12 prill 2012at takimi 1140 të zëvendës ministrave) Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec (2008) 11 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi rregullat evropiane për të miturit nënshtrohen sanksioneve ose masave (të miratuar nga Komiteti i Ministrave më 5 2008 at nëntor 1040 takimi i zëvendës ministrave). Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec (98) 71 i i Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me aspektet etike dhe organizative të kujdesit shëndetësor në burg (të miratuara nga komiteti i ministrave më 8 prill 1998 në takimin e					
--	--	--	--	--	--

627 të zëvendës ministrave).					
Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec (2012) 5 i Komitetit të Ministrave për Shtetet anëtare mbi Kodin Evropian të Etikës për stafin e burgjeve (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 12 prill 2012at takimi 1140 të zëvendës ministrave).	Ligji Nr.10 032, datë 11.12.2008 “Për policinë e burgjeve”, i ndryshuar	DPB	I pjesshëm	29.12.2008	15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.
Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec (2004) 10 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit të personave me çrregullime mendore.	<i>Ligji Nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, i ndryshuar</i>	Ministria e Shëndetësisë	I plotë	19.4.2012 14.2.2013 (amendimet)	8.5.2012 1.3.2013 (amendimet)

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014-2016

Titulli (Strategji ose PV ose document politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë	Ministria e Drejtësisë	2014-2020	Maj 2014	Maj 2014
Strategjia Anti-korrupsion	Ministria e Shtetit pwr Çwshtjet Vendore (MD institucion linje)	2014 - 2017	Në proces	Në proces
Strategjia Afatmesme për Sistemin e Burgjeve	DPB	2014-2017	Mars 2014	Prill 2014

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014-2016

Legjislacioni i BE-së	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/ përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, Rekomandimi Rec (2006) 2 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 11 janar 2006 në takimin e 952-të të zëvendës ministrave).	Po	Miratimi i projekt-ligjit “Mbi disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin 8328, date 16.04.1998 ” Per te drejtat dhe trajtimin e te denuarve me burgim”, i ndryshuar.	Jo	DPB	I plotë	Prill 2014	Prill 2014
Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec (2012) 5 i Komitetit të Ministrave për Shtetet anëtare mbi Kodin Evropian të Etikës për stafin e burgjeve (Miratuar nga Komiteti i	Jo						

Ministrave më 12 prill 2012at takimi 1140 të zëvendës ministrave) Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec (2008) 11 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi rregullat evropiane për të miturit nënshirohen sanksioneve ose masave (të miratuar nga Komiteti i Ministrave më 5 2008 at nëntor 1040 takimi i zëvendës ministrave). Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec (98) 71 i Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me aspektet etike dhe organizative të kujdesit shëndetësor në burg (të miratuara nga komiteti i ministrave më 8 prill	Po						
	Jo						

1998 në takimin e 627 të zëvendës ministrave).							
Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec (2004) 10 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit të personave me çrregullime mendore.	Jo						
N/A	N/A	Miratimi i projekt-ligjit “Mbi disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin “Per policine e Burgjeve”, i ndryshuar	No	DPB	N/A	Prill 2014	Prill 2014

N/A	N/A	Miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve ne Rregulloren e Pergjithshme te Burgjeve	No	DPB	N/A	Qershor 2014	Qershor 2014
N/A	N/A	Miratimi i VKM "Mbi nxitjen dhe shperblimin e punes se te denuarve dhe paraburgosurve".	N/A	DPB	N/A	Shtator 2014	Shtator 2014
<u>AFAT MESEM (2015 – 2016)</u>							
N/A	N/A	Hartimi i rregulloreve te reja per IEVP	N/A	DPB	N/A	2015	2015

2. Mbrojtja nga Diskriminimi

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU acquis	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
32000L.0043 - Direktiva e Këshillit European 2000/43/KE e 29 qershorit 2000 për "Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave	Ligji nr. 10221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Përafruar plotësisht	04.02.2010	13.03.2010

<i>pavarësisht prejardhjes racore apo etnike";</i>					
32000L0078 - Direktiva e Këshillit European 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për <i>"Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës";</i>	Ligji nr. 10221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Përafruar plotësisht	04.02.2010	13.03.2010
32004L0113 - Direktiva e Këshillit European 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për <i>"Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime";</i>	Ligji nr. 10221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Përafruar plotësisht	04.02.2010	13.03.2010
32006L0054 - Direktiva e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit European 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për <i>"Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës".</i>	Ligji nr. 10221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Përafruar plotësisht	04.02.2010	13.03.2010

3. Mbrojtja e Të Dhënave Personale

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose document politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia për mbrojtjen e të dhënave personale 2012-2013 dhe Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë për mbrojtjen e të dhënave personale 2012 – 2013.	Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale.	2012-2013

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU acquis	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 95/46/EC	Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”	Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale.	I plotë	26.4.2012	15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare Nr. 53, datë 16 maj 2012.

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014-2016

Titulli (Strategji ose PV ose document politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Strategjia për mbrojtjen e të dhënave personale 2014-2017 dhe Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë për mbrojtjen e të dhënave personale 2014 – 2017.	Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale.	2014-2017	Miratuar nga Komisioneri me datë 23 . 12.2013	Janar 2014

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014-2016

EU acquis	Status i përkthimit Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqip (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegj dhe pika e kontakti	Niveli i synuar i përafrimit (iplotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
<u>AFAT MESEM (2015 – 2016)</u>							
Direktiva 95/46/EC	E Përkthyer	Ligji 48/2012 datë 26.4.2012	I përkthyer.	Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale.	Përputhje të plotë.	2014-2017	2014-2017

KAPITULLI 24: DREJTËSI, LIRI DHE SIGURI

I. Hyrje

I.1. Përmbajtja e kapitullit

Legjislacioni (*Acquis*) i Bashkimit Evropian (BE) mbi drejtësinë dhe çështjet e brendshme bazohet mbi parimet e përgjithshme që rrjedhin nga Traktati i Bashkimit Evropian, Traktati i Funksionimit të Bashkimit Evropian, si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Drejtësisë, Liria dhe Siguria, çështje të punëve të brendshme dhe politikave të drejtësisë, janë dizenuar për të garantuar sigurinë, të drejtat dhe lëvizjen e lirë në BE. Fushat e mbuluara përfshijnë harmonizimin e së drejtës private ndërkombëtare, marrëveshjet e ekstradimit ndërmjet shteteve anëtare, politikat e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të kufirit, vizave, emigracioni dhe politikat e azilit dhe bashkëpunim policor dhe gjyqësor.

I.2. Situata në Shqipëri

Shqipëria ka vlerësuar rekomandimet e Komisionit Evropian pasqyruar në Raportin e Progresit për Shqipërinë në tetor 2013 dhe do vazhdojë të përforcojë masat e ndërmarra për luftën kundër krimit të organizuar, veçanërisht do të sigurojë implementimin e masave të ndërmarra në menaxhimin e kufijve dhe në luftën kundër pastrimit të parave dhe trafikeve të drogës.. Projektligji “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” është dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave 22.04.2014, si dhe është miratuar ligji i ri “Për të huajt” në 2013 që synon përafrimin me *acquis* në lidhje me politikën e vizave dhe trajtimin e të huajve. Për më shumë, Ligji parashikon detyrimin për të analizuar dhe publikuar informacione mbi migrimin, të përmirësuar nga profilet vjetore të migrimit. Në prill 2012, u nënshkruan tre marrëveshje me Kosovën për kontrollin e përbashkët kufitar. Për luftën kundër pastrimit të parave, janë implementuar rekomandimet e raundit të fundit vlerësues të MONEYVAL, si dhe ka filluar procedura e “forcimit të respektimit”. Ka vazhduar bashkëpunimi policor dhe lufta kundër krimit të organizuar. Në fushën e bashkëpunimit në luftën kundër drogës, ka vazhduar bashkëpunimin me EMCDDA-në dhe janë zhvilluar trajnime të ndryshme. Janë zbatuar programet lidhur me reduktimin e prodhimit dhe trafikimit të drogave, si dhe garantimit të një kontrolli efektiv për sigurimin e territorit. Forcimi i veprimtimit të ligjit dhe i bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar ka forcuar sigurinë e kufijve dhe ka ndihmuar në reduktimin e trafikimit.

Për parandalimin e pastrimit të parave, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në drejtim të forcimit të sistemit parandalues dhe shkallës së përafrimit me standardet ndërkombëtare. Kemi një përmirësim të ndjeshëm të Raporteve të Aktivitetit të Dyshimtë (RAD), për vitin 2013 75.6% të numrit të rasteve të dërguara në organet ligjzbatuese kanë pasur për indicie RAD të subjekteve të ligjit. DPPPP ka bërë përpjekje të

vazhdueshme për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në nivel ndërkombëtar, rritjes së shkallës së ndërgjegjësimit të subjekteve dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë së tyre, si edhe forcimit të kapaciteteve njerëzore përmes trajnimeve dhe kualifikimeve të ndryshme.

I.3. Struktura e kapitullit

1. KUFIJTË E JASHTËM
2. MIGRACIONI
3. POLITIKA E VIZAVE
4. AZILI
5. BASHKËPUNIMI POLICOR DHE LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR
6. LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT
7. BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E LUFTËS KUNDËR DROGËS
8. SISTEMI DOGANOR
9. BASHKËPUNIMI GJYQËSOR NË ÇËSHTJE CIVILE DHE PENALE

II. Situata aktuale

II.1. Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe legjislacionit të BE-së

MSA:

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian, përcaktohet në Nenin 70 të MSA-së. Disa dispozita të tjera të MSA-së lidhur me marrëdhëniet me jashtë , drejtësi dhe punë të brendshme janë të përcaktuara edhe në Nenet 4, 78, 80, 81, 82, 83, 84 dhe 85. Bashkëpunimi në fushën e menaxhimit të kufijve ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, është parashikuar në Nenin 80 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Gjithashtu, bashkëpunimi në fushën e migracionit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, është parashikuar në Nenet 4, 80 dhe 81 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Bashkëpunimi në fushën e politikës së vizave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, është parashikuar në Nenin 80 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Bashkëpunimi në fushën e azilit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, është parashikuar në Nenin 80 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ku përcaktohet se bashkëpunimi ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në këtë fushë, do të përqendrohet në zbatimin

e legjislacionit të brendshëm për përmbushjen e standardeve të Konventës së Gjenevës të vitit 1951 dhe Protokollit të New York, të vitit 1967, për të siguruar në këtë mënyrë respektimin e parimit të mos-kthimit të individit në atë vend që përbën kërcënim për jetën e tij, si dhe të të drejtave të tjera të azilkërkuesve dhe refugjatëve.

Bashkëpunimi në fushën e bashkëpunimit policor dhe luftën kundër krimit të organizuar, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, është parashikuar në Nenet 4, 82, 84 dhe 85 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër trafikëve të paligjshme, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, është parashikuar në Nenet 4 dhe 85 Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër pastrimit të parave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së, është parashikuar në Nenin 4 dhe 82 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Gjithashtu në Nenet 5, 82 dhe 84 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit është parashikuar bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE në fushën e luftës kundër terrorizmit. Nenet 83 dhe 85 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit sigurojnë bashkëpunimi në fushën e luftës kundër drogës, Angazhimet në fushën e doganave janë marrë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, të parashikuara në nenet 14, 15, 34, 43 dhe 97. Bashkëpunimi në fushën e çështjeve penale është përcaktuar në Nenin 85 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Migrimi, Vizat dhe Azili:

- Direktiva 2013/32/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013 mbi procedurat e përbashkëta për dhënien e mbrojtjes ndërkombëtare,
- Rregullorja (BE) Nr 604/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 qershor 2013 që përcakton kriteret dhe mekanizmat për përcaktimin e vendeve anëtare përgjegjëse për shqyrtimin e aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare të dorëzuar në një nga vendet anëtare nga një shtetas i një shteti të tretë ose nga një person pa shtetësi,
- Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 343/2003 e datës 18 shkurt 2003 që përcakton kriteret dhe mekanizmat për përcaktimin e vendeve anëtare përgjegjëse për shqyrtimin e aplikimeve për azil të dorëzuar në një nga vendet anëtare nga një shtetas i një shteti të tretë ose nga një person pa shtetësi,
- Rregullorja (KE) nr. 1560/2003 e datës 2 shtator 2003 e cila përcakton rregulla të detajuara për aplikimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 343/2003 që përcakton kriteret dhe mekanizmat për përcaktimin vendin anëtar përgjegjës për shqyrtimin e aplikimeve për azil të dorëzuar në një nga vendet anëtare nga një shtetas i një shteti të tretë,

- Rregullorja (KE) nr. 862/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 korrik 2007 mbi statistikën e Komunitetit mbi emigrimin dhe mbrojtjen ndërkombëtare dhe që shfuqizon Rregulloren e Këshillit (EEC) Nr. 311/76 mbi hartimin e statistikave për punëtorët e huaj,
- Direktiva e Këshillit 2003/86/KE e datës 22 shtator 2003 mbi të drejtën për bashkim familjar,
- Direktiva e Këshillit 2009/50/KE e datës 25 Maj 2009 mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimin e qytetarëve të vendeve të treta, për qëllim të punësimit të kualifikimit të lartë,
- Direktiva 2014/66/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 Maj 2014 mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të qytetarëve të vendeve të treta në kuadër të transferimit brenda korporatës,
- Direktiva 2011/98/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011 mbi procedurën e aplikimit të vetëm për një leje të vetme për qytetarët e vendeve të treta për të punuar dhe qëndruar në një vend anëtar dhe mbi një set të përbashkët të drejtash për punëtorët e vendeve të treta që qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në një vend anëtar,
- Direktiva e Këshillit 2003/109/KE e datës 25 nëntor 2003 që lidhet me statusin e qytetarëve të vendeve të treta të cilët janë rezidentë afatgjatë,
- Konventa zbatuese e marrëveshjes Schengen,
- Direktiva 2011/95/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011 mbi standardet për kualifikimin e qytetarëve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status të unifikuar për refugjatët ose për personat që kualifikohen për mbrojtje suplementare dhe për përmbajtjen e mbrojtjes së dhënë,
- Direktiva 2014/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 shkurt 2014 mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të qytetarëve të vendeve të treta për qëllime punësimi si punëtorë sezonal,
- Direktiva e Këshillit 2005/85/KE e datës 1 dhjetor 2005 mbi minimumin e standardeve të procedurave në vendet anëtare për dhënien dhe tërheqjen e statusit të refugjatit,
- Direktiva e Këshillit 2001/55/KE e datës 20 korrik 2001 mbi minimumin e standardeve për dhënien e mbrojtjes së përkohshme në rast të një fluksi hyrës masiv të personave të zhvendosur dhe mbi masat që promovojnë një ekuilibër përpjekjesh mes shteteve anëtare në marrjen e këtyre personave dhe mbajtjen e pasojave që e shoqërojnë,
- Direktiva 2008/115/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 dhjetor 2008 mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta në vendet anëtare për kthimin e qytetarëve të vendeve të treta që qëndrojnë në mënyrë jo ligjore ,
- Rregullorja (KE) nr. 810/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 korrik 2009 që përcakton një kod komunitar për vizat (kodi i vizave),
- Rregullorja (KE) nr. 863/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 korrik 2007 që përcakton një mekanizëm për krijimin e Skuadrave të Ndërhyrjes së Shpejtë Kufitare dhe që Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 2007/2004 që lidhet me këtë mekanizëm dhe që rregullon detyrat dhe kompetencat e oficerëve të ftuar,

- Vendimi i Këshillit 2010/252/BE i datës 26 prill 2010 si suplement i Kodit Schengen të Kufijve përsa i përket survejimit të kufijve të jashtëm detar në kontekstin e bashkëpunimit operacional të koordinuar nga Agjencia Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në kufijtë e jashtëm të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian,
- Rregullorja (KE) nr. 562/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 Mars 2006 që përcakton një kod Komunitar mbi rregullat e lëvizjes së personave nëpërmjet kufijve (Kodi Schengen i Kufijve),
- Direktiva e Këshillit 2005/71/KE e datës 12 tetor 2005 mbi procedurat specifike për pranimin e qytetarëve të vendeve të treta për qëllime të kërkimit shkencor,
- Direktiva e Këshillit 2004/82/KE e datës 29 prill 2004 mbi detyrimin për të komunikuar të dhënat e pasagjerëve,
- Vendimi Kuadër i Këshillit të çështjeve të brendshme dhe drejtësisë 2002/946/ i datës 28 nëntor 2002 mbi forcimin e kuadrit penal për të shtrënguar ndalimin e hyrjes së paautorizuar, transitit dhe rezidencës.

Bashkëpunimi Policor dhe Gjyqësor në Çështje Penale

- Vendimi Kuadër i Këshillit 2004/757/JHA i datës 25 tetor 2004 që përcakton dispozitat bazë për elementët përbërës të akteve kriminale dhe penaliteteve në fushën e trafikimit të drogës;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2003/568/JHA i datës 22 korrik 2003 për luftën kundër korrupsionit në sektorin privat;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 475/2002/JHA i datës 13 qershor 2002 për luftën kundër terrorizmit;
- Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 prill 2011 për parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave;
- Direktiva 2011/92/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011 për luftën ndaj abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë;
- Direktiva 2013/40/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 gusht 2013 për sulmet ndaj sistemeve të informacionit;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 465/2002 i datës 13 qershor 2002 për ekipet e përbashkëta hetimore;
- Direktiva e Këshillit 2004/80/KE e datës 29 prill 2004 për kompensimin e viktimave të krimit;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2005/212/JHA i 24 shkurtit 2005 për konfiskimin e të ardhurave, instrumenteve dhe pasurive me origjinë kriminale;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2005/214/JHA i datës 24 shkurt 2005 për aplikimin e parimit të njohjes së ndërsjelle të penaliteteve financiare;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2006/783/JHA i datës 6 tetor 2006 për aplikimin e parimit të njohjes së ndërsjelle të urdhrave të konfiskimit;

- Vendimi Kuadër i Këshillit 2002/584/JHA i datës 13 qershor 2002 për mandat-arrestin evropian dhe procedurat e dorëzimit ndërmjet Shtete Anëtare;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2003/577/JHA i datës 22 korrik 2003 për ekzekutimin në Bashkimin Evropian të ardhurave për ngrirjen e pasurive apo provave;
- Direktiva 2011/99/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011 për urdhrin evropian të mbrojtjes;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2008/978/JHA i datës 18 dhjetor 2008 për mandatin evropian të provës për qëllime të marrjes së objekteve, dokumenteve dhe të dhënave që të përdoren në çështje penale;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2009/829/JHA i datës 23 tetor 2009 për aplikimin, ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, të parimit të njohjes së ndërsjellë të vendimeve për masat mbikëqyrëse si alternativë ndaj arrestimit me burg;
- Direktiva 2014/41/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 3 prill 2014 për Urdhrin Evropian Hetimor për çështje penale;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2008/947/JHA i datës 27 nëntor 2008 për aplikimin e parimit të njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore dhe dënimeve alternative (shërbim prove), në funksion të mbikëqyrjes së masave dhe sanksioneve alternative;
- Direktiva 2014/42/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 3 prill 2014 për ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi në Bashkimin Evropian;
- Vendimi Kuadër i Këshillit 2008/909/JHA i datës 27 nëntor 2008 për aplikimin e parimit të njohjes së ndërsjellë të vendimeve në çështje penale që imponojnë vendime izolimi ose masa për privim lirie me qëllim ekzekutimin e tyre në Bashkimin Evropian;
- Direktiva 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012 që përcakton standardet bazë për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit;
Plan kombëtar Veprimi kundër trafikimit të mjeteve motorike.	MPB Ministria e Transportit	2014 - 2016	3 Mujori i dytë 2014	3 Mujori i tretë 2014
Plan kombëtar kundër trafikimit të veprave të artit e kulturës.	MPB, Ministria e Kulturës	2014 - 2016	3 Mujori i dytë 2014	3 Mujori i tretë 2014

Masat ligjore të planifikuara 2014-2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për miratim	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
Direktiva 2011/36/EU	JO	Amendimi i Kodit të Procedurës Penale me qëllim përmirësimin e dispozitave mbi aksesin e viktimave të trafikimit në drejtësi	JO	Ministria e Drejtësisë	I plotë	3 Mujori i tretë 2014	3 Mujori i tretë 2014
		Projekt-Vendim i Këshillimit të	JO	Ministria e Punëve të Brendshme	I plotë	3 Mujori i dytë 2014	3 Mujori i dytë 2014

		Ministrave “Për ngritjen e Komitetit Shtetërore kundër Trafikimit të Personave, i ndryshuar”.					
		Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Shëndetësisë “Për ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për Identifikimin	JO	Ministria e Punëve të Brendshme	I plotë	3 Mujori i dytë 2014	3 Mujori i dytë 2014

IV.6. Lufta kundër terrorizmit

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia ndërsektorale për luftën kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit,	Ministria e Drejtësisë, MPB Ministria e Financës	2013-2020
Strategjia Kombëtare e Luftës kundër terrorizmit	Ministria e Drejtësisë, MPB Ministria e Financës	2011-2015

Inventari i masave ligjore

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Vendimin Kuadër 2002/475/JHA/	Ligji Nr. 9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit".	MPB	I pjesshëm	19.05.2008	19.05.2008
	Ligji Nr. 9686, datë 26.02.2007 "Për disa shtesa në ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal	MPB	I pjesshëm	26.02.2007	26.02.2007
Vendim i Këshillit 2007/845/JHA	Ligji Nr. 9258, datë 15.07.2004, "Për masat kundër financimit të Terrorizmit". Shfuqizuar me 157/2013	MPB	I pjesshëm	15.07.2004	15.07.2004
Pozicionin e Përbashkët 2001/931/CFSP	Ligji Nr. 9917, datë 19.05.2008, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit". I dryshuar	MPB Policia e Shtetit	I pjesshëm	19.05.2008	15.06.2008
	Ligji Nr. 9686, datë 26.02.2007 "Për disa shtesa në ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal	MPB Policia e Shtetit	Pjesshëm	26.02.2007	26.02.2007
Vendimin Kuadër 2008/919/JHA	Ligji Nr. 9686, datë 26.02.2007 "Për disa shtesa në ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal	MPB	I pjesshëm	26.02.2007	26.02.2007
Vendimin Kuadër 2001/413/JHA	Ligji Nr. 9686, datë 26.02.2007 "Për disa shtesa në ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal"	MPB	I pjesshëm	26.02.2007	26.02.2007
Vendimin Kuadër 2001/500/JHA	Ligji Nr. 9686, datë 26.02.2007 "Për disa shtesa në ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal"	MPB	I pjesshëm	26.02.2007	26.02.2007
Vendimin Kuadër 2002/475/JHA	Ligji Nr. 7905, datë 21/03/1995 "Kodi i	MPB	I pjesshëm	21.03.1995	21.03.1995

	Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar				
Vendimin Kuadër 2008/919/JHA	Ligji Nr. 7905, datë 21/03/1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar	MPB	I pjesshëm	21.03.1995	21.03.1995
Vendim 2005/671/JHA	Ligji Nr. 7905, datë 21/03/1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar	MPB Policia e Shtetit	I pjesshëm	21.03.1995	21.03.1995
Vendimin Kuadër 2006/783/JHA	Ligji Nr. 7905, datë 21/03/1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar	MPB	I pjesshëm	21.03.1995	21.03.1995
Vendimin Kuadër 2001/413/JHA	Ligji Nr. 7905, datë 21/03/1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar	MPB	I pjesshëm	21.03.1995	21.03.1995
Vendimin Kuadër 2001/500/JHA	Ligji Nr. 7905, datë 21/03/1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar	MPB	I pjesshëm	21.03.1995	21.03.1995
Vendim 2007/845/JHA	Ligji Nr. 9258, datë 15.07.2004, "Për masat kundër financimit të Terrorizmit".	MPB Policia e Shtetit	I pjesshëm	15.07.2004	15.07.2004
Vendimin Kuadër 2005/212/JHA	Ligji Nr. 9258, datë 15.07.2004, "Për masat kundër financimit të Terrorizmit". Shfuqizuar me ligjin 157/2013	MPB	I pjesshëm	15.07.2004	15.07.2004
Rregullore Nr (EC) 2580/2001	Ligji Nr. 157/2013 dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 1, datë 16.01.2014.	Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë Banka e Shqipërisë	I pjesshëm	10.10.2013	14.11.2013
Rregullore Nr.1250/2012	Ligji Nr. 157/2013 dhe Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 1, datë 16.01.2014.	Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë Banka e Shqipërisë	I pjesshëm	10.10.2013	14.11.2013

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për miratim	Hyrja në fuqi
AFAT MESEM (2015 – 2016)							
		•Hartimi i një akti normativ (VKM) “Për funksionimin e Komitetit Ndërinstitucional për Bashkërendimin Institucional të veprimeve, në luftën kundër terrorizmit”.		Ministria e Puneve të Brendshme MM, MF, MPJ, SHISH, MD		3 muji i II, 2014	2014
Kuadër vendim 2002/946/JHA	JO	Hartimi i një ligji organik sipas standardeve Evropiane për luftën kundër terrorizmit	PO	Ministria e Punëve të Brendshme MB,MM,MF,MPJ, SHISH,MD	Pjesshëm	3-mujori i katërt i vitit 2015	3-mujori i katërt i vitit 2015

IV.7. Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër drogës

Kuadri i Politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periodha e referuar
Strategjia Kombëtare kundër Drogës 2012 – 2016.	• Ministria e Shëndetësisë	• 2012-2016
• Strategjia Ndër Sektoriale e Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013-2020.	• Ministria e Punëve të Brendshme	• 2013-2020
• Plani Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale e Luftës kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013-2020.	• Ministria e Punëve të Brendshme	• 2013-2016
Plani Veprimit Kombëtar kundër Kultivimit të Bimëve Narkotike, 2014.	• Ministria e Punëve të Brendshme	• 2014
Strategjia Kombëtare për Arsimin Para Universitar.	• Ministria e Arsimit dhe Sportit	• 2009-2013

Inventari i masave ligjore ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e miratimit (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Vendimi Kuadër i Këshillit 2004/757/JHA	Ligji Nr. 7895, date 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë	Ministria e Drejtësisë	I pjesshëm	27.01.1995	
Plani i Veprimit të Përbashkët, datë 17 dhjetor 1996, në lidhje me përafrimin e ligjeve dhe praktikave të shteteve anëtare të BE-së për të	Ligji nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” (Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë	Ministria e Drejtësisë			

luftuar varësinë ndaj drogës dhe për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e drogave të paligjshme (OJ L 342, datë 31 Dhjetor 1996, fq. 6)	Nr.5 e vitit 1995, faqe nr.159, data e botimit 16.03.1995), shtuar e ndryshuar				
Plani i Veprimit të Përbashkët, datë 17 dhjetor 1996, në lidhje me përafrimin e ligjeve dhe praktikave të shteteve anëtare të BE-së për të luftuar varësinë ndaj drogës dhe për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e drogave të paligjshme (OJ L 342, datë 31 Dhjetor 1996, fq. 6)	Ligji nr.8750, date 26.03.2001 “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope. (Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr.14 e vitit 2001, faqe nr.391, data e botimit 13.04.2001).	Ministria e Punëve të Brendshme	I Plotë	26.03.2001	
Plani i Veprimit të Përbashkët, datë 17 dhjetor 1996, në lidhje me përafrimin e ligjeve dhe praktikave të shteteve anëtare të BE-së për të luftuar varësinë ndaj drogës dhe për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e drogave të paligjshme (OJ L 342, datë 31 Dhjetor 1996, fq. 6)	Ligji nr. 7975, date 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, ndryshuar dhe shtuar me ligjin Nr.9271 datë 09.09.2004; shtuar me ligjin Nr.9559,	Ministria e Shëndetësisë	I Plotë	26.07.1995	

drogës dhe për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e drogave të paligjshme (OJ L 342 31 Dhjetor 1996, fq 6).	datë 08.06.2006. (Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr.14 e vitit 2001, faqe nr.391, data e botimit 13.04.2001; Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr.69 e vitit 2004, faqe nr.4579, data e botimit 07.10.2004)				
Plani i Veprimit të Përbashkët, datë 17 dhjetor 1996, në lidhje me përafrimin e ligjeve dhe praktikave të shteteve anëtare të BE-së për të luftuar varësinë ndaj drogës dhe për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e drogave të paligjshme (OJ L 342, datë 31 Dhjetor 1996, fq. 6)	Ligji nr. 8874, date 29.03.2002 “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope”. (Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr.12 e vitit 2002, faqe nr.359, data e botimit 29.04.2002).	Ministria e Shëndetësisë	I Plotë	29.03.2002	
Rregullorja (KE) Nr 1920/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 12 dhjetor 2006, mbi Qendra Monitoruese	Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 299, datë 14.4.2011 “Për miratimin e rregullores “Për funksionimin e	Ministria e Shëndetësisë	I Plotë	14.04.2011	

Evropiane për Drogat dhe Varësinë nga Droga (ndryshoj) (OJ L 376, datë 27 dhjetor 2006, p 1.) STATUSI I PËRAFRIMIT N/A Rregullorja do të zbatohet direkt nga data e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.	Komitetit Kombëtar të bashkërendimit të luftës kundër drogës, sekretarisë së këtij komiteti dhe zyrës së sistemit kombëtar të të dhënave për drogën”;				
---	---	--	--	--	--

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e miratimit	Hyrja në fuqi
Plani Veprimit për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Drogës	Ministria e Shëndetësisë	2014-2016	2014	2014
Plani Veprimit Kombëtar Kundër Kultivimit të Bimëve Narkotike	Ministria e Punëve të Brendshme	2015, 2016	Çdo vit	Çdo vit
Strategjia Kombëtare për Arsimin Para Universitar	Ministria e Arsimit dhe Sportit	2014-2020	2014	2014

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/ përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për miratimin	Hyrja në fuqi

<u>AFAT MESËM (2015 – 2016)</u>							
Vendimi Kuadër 2004/757/JHA	JO	Ndryshime në Kodin e Procedurës Penale	JO	Ministria e Drejtësisë	I pjesshëm	2016	4 Q 2016
Plani i Veprimit të Përbashkët 1996/750/JHA	JO	Ndryshime në Kodin e Procedurës Penale	JO	Ministria e Drejtësisë	I pjesshëm	2015	4 Q 2015

IV.8. Sistemi Doganor 1

9. BASHKËPUNIMI GJYQËSOR NË ÇËSHTJE CIVILE DHE PENALE

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014-2016

EU acquis	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e EC	Data e planifikuar për miratim	Hyrja në fuqi
Direktiva 2011/36/BE “Mbi parandalimin dhe luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Mbrojtjes së Viktimave” NJAT	jo	Amendimi i Kodit të Procedurës Penale me qëllim përmirësimit e dispozitave mbi aksesin e viktimave të trafikimit në drejtësi.	jo	Ministria e Drejtësisë	I plotë	Katër mujori i tretë, 2014	2014 (në vijim të procedurave të ndjekura nga Kuvendi)

¹ Aktet ligjore për sistemin doganor janë parashikuar në kapitullin 29 “ Bashkimi Doganor” I PKIE

Direktiva e 2012/29/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për krijimin e standardeve minimale të të drejtave, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit	jo	Amendimi i Kodit të Procedurës Penale me qëllim mbrojtjen e viktimave të krimit	jo	Ministria e Drejtësisë	I pjesshëm	Katërmujori i tretë, 2014	2014/(në vijim të procedurave të ndjekura nga Kuvendi)
Direktiva 2012/13/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi të drejtën e informimit në procesin penal.	jo	Amendimi i Kodit të Procedurës Penale me qëllim përmirësimin e të drejtës së informimit në procesin penal	jo	Ministria e Drejtësisë	I pjesshëm	Katërmujori i tretë, 2014	(Në vijim të procedurave të ndjekura nga Kuvendi)
Direktiva 2013/48/BE e Parlamentin Evropian dhe Këshillit mbi të drejtën e aksesit në një avokat në procesin penal dhe në procedurat e urdhër arrestit evropian, dhe mbi të drejtën për të pasur një palë të tretë të informuar	jo	Amendimi i Kodit të Procedurës Penale me qëllim përmirësimin e të drejtave të mbrojtjes	jo	Ministria e Drejtësisë	I pjesshëm	Katërmujori i tretë, 2014	(Në vijim të procedurave të ndjekura nga Kuvendi)

mbi heqjen e lirisë dhe për të komunikuar me personat e tretë dhe me autoritetet konsullore, në rastet e heqjes së lirisë.							
--	--	--	--	--	--	--	--

KAPITULLI 25: SHKENCA DHE KËRKIMI SHKENCOR

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Ky kapitull prezanton nismat ligjore dhe strategjike të ndërmarra në kuadër të promovimit dhe zhvillimit shkencor. Ndërmjet iniciativave të ndërmarra për zhvillimin e kërkimit shkencor në vend, promovimit të programeve shkencore evropiane, ky kapitull do të pasqyrojë legjislacionin shqiptar në fuqi për këtë fushë. Zhvillimi i veprimtarisë shkencore dhe investimet në kërkimin shkencor mbështesin zhvillimin ekonomik të vendit, promovojnë ekselencën (kapital njerëzor dhe qendra kërkimore ekselence) në vend dhe ndikojnë në transferimin e dijeve dhe teknologjive moderne në laboratorët mësimorë të universiteteve me qëllim aplikimin e shkencës në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës. Në parim, acquis në fushën e shkencës dhe kërkimit nuk kërkon transpozimin e rregullave të BE-së në legjislacionin kombëtar. Zbatimi me sukses i acquis në këtë fushë përfshin kryesisht, plotësimin e kushteve të nevojshme për pjesëmarrjen efektive në Programet Kuadër të Kërkimit Shkencor dhe kontributin për krijimin e Hapësirës së Kërkimit Evropian. Kjo kërkon kapacitete të mira administrative (personel të mjaftueshëm dhe njohuri në bashkëpunimin kërkimor), njohuri të shkëlqyera shkencore për të kryer me sukses kërkimin dhe projektet novatore së bashku me partnerët shkencorë nga Shtetet Anëtare të BE-së, si dhe krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin në mënyrë të qëndrueshme nga aspekti ekonomik.

I.2 Situata në Shqipëri

Fokusi kryesor i qeverisë në fushën e kërkimit shkencor për periudhën afatgjatë është inkurajimi i bashkëpunimit në kërkimet shkencore civile dhe zhvillimin e veprimtarisë kërkimore shkencore në përputhje me prioritetet kombëtare të zhvillimit të vendit, si dhe ato evropiane e botërore. Aktualisht janë ngritur grupet e punës për integrimin evropian dhe AKTI ka nisur fushatat e Ditëve Informative për promovimin e programeve evropiane e kombëtare të cilat nxisin kërkuesit shqiptarë dhe institucionet kërkimore si dhe universitetet të jenë më aktivë e koherent në këto programe.

Shqipëria ka inkurajuar dhe vazhdon të inkurajojë integrimin në Hapësirën Kërkimore Evropiane. Për sa i përket projekteve në kuadër të programit e Kuadër Shtatë (FP7) ka pasur 245 aplikime me 34 projekte të fituara. Pritshmëria në këtë program ka qenë e lartë por kërkuesit shqiptarë nuk kanë arritur nivelet e dëshirueshme.

AKTI ka promovuar programin e BE “Horizon 2020” me anë të Ditëve Informative dhe trajnimeve të organizuara në disa institucione, në Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universitetin Epoka, Universitetin Polis, Institutin e Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit, etj. Në periudhën në vazhdim AKTI do vazhdojë të zhvillojë këto veprimtari edhe në universitete dhe institucione të tjera publike që promovojnë programin “Horizon 2020” për kërkimin dhe inovacionin.

Shqipëria duke parë rëndësinë e takimeve të nivelit të lartë të kërkimit, ka filluar të marrë pjesë në takimet e Komitetit ERAC (takimi i datës 6 Shkurt 2014 në Bruksel) e do të vazhdojë të marrë pjesë në takimet e ardhshme të ERAC në mënyrë që të integrohet dhe familjarizohet me aksionet e BE-së për kërkimin dhe inovacionin.

Shqipëria do të rrisë investimin në kërkim dhe inovacion e gjithashtu do të inkurajojë dhe stimulojë edhe sektorin privat të marrë pjesë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit dhe inovacionit. Për vitet në vazhdim, AKTI do t’i paraqesë Bordit Drejtues dhe Ministrive të linjës për kërkimin dhe inovacionin propozime konkrete për rritjen e investimeve në shkencë bazuar në Strategjinë e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (SSHTI) për vitet 2009 - 2015 në kuadër të programeve kombëtare dhe ndërkombëtare për shkencën dhe inovacionin.

Shqipëria ka hartuar Draft Strategjinë Kombëtare për Kërkimin dhe Inovacionin për vitet 2016- 2020. Kjo strategji është në përputhje me strategjitë e Komisionit Evropian për kërkimin dhe inovacionin si dhe me Strategjinë Rajonale për Shkencën dhe Inovacionin.

Ndërkohë në bashkëpunim me UNESCO dhe INSTAT, AKTI ka siguruar disa statistika të rëndësishme mbi kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin në Shqipëri. Ky projekt ka përfunduar në fund të vitit 2013 e tashmë po pritët publikimi zyrtar i tyre.

Në Shtator 2013, Drejtori i Përgjithshëm i AKTI-t dhe përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Kërkimit dhe Inovacionit pranë Komisionit Evropian kanë nënshkruar Marrëveshjen e Grantit FP7 Nr. 619167 AL-ES.Net Albanian Euraxess Service Network. Projekti financohet nga Komisioni Evropian në kuadër të Programit Kuadër 7 (FP7) me kohëzgjatje 3 vjet. Partneri i vetëm në këtë projekt është AKTI. Në Tetor 2013 ka filluar implementimi i këtij projekti duke ngritur Grupin Drejtues të Rrjetit Euraxess në Shqipëri me përfaqësues nga 13 institucione publike (ministri, institucione qeveritare dhe universitete) dhe të Pikave të Kontakteve të këtij rrjeti në të gjithë institucionet kërkimore- shkencore në Shqipëri. Gjithashtu po punohet për krijimin e platformës ueb të Euraxess Albania. Në Janar 2014, AKTI ka dërguar pranë Komisionit Evropian letër interesi për nënshkrimin e Kartës dhe Kodit Evropian të Kërkuesve.

Projekti WeB-InUnion ka si qëllim rritjen e rrjeteve kombëtare dhe rajonale EURAXESS në vendet e Ballkanit Perëndimor. Vendet pjesëmarrëse në projekt janë Kroacia, Serbia, Greqia, Shqipëria, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe Maqedonia. Projekti koordinohet nga Greqia dhe kohëzgjatja e tij është 24 muaj. Sipas planit të punës janë realizuar detyrat e vitit të parë të projektit.

I.3 Struktura e kapitullit

II. Situata aktuale

II.1. Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Detyrimi i Shqipërisë që të bashkëpunojnë me Bashkimin Evropian në fushën e shkencës dhe kërkimit buron nga nenet 70 dhe 109 të MSA-së. Sipas Marrëveshjes së Partneritetit Evropian Shqipëria ka përcaktuar prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme si më poshtë: Prioritete afatshkurtër: Përmirësimi i administrimit të sistemit arsimor, të trajnimit të mësuesve dhe infrastrukturës arsimore si edhe zbatimi i ligjit të ri për arsimin e lartë. Shqipëria do të marrë pjesë në mënyrë aktive në programet e BE-së si Horizont 2020 Erasmus+ me synim përfitimin maksimal prej tyre.

Prioritete Afatmesme sipas përcaktimit nga marrëveshja e Partneritetit Evropian janë përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe krijimi i një sistemi bashkëkohor të arsimit dhe formimit profesional si edhe inkurajimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

II.2. Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Ligji nr. 7893, datë 22.12.1994 “Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 8401, datë 9.09.1998, është pjesërisht I përafruar me vendim e Këshillit Evropian Nr. 1999/65/EC të Programit kuadër të VI të Komunitetit Evropian. Gjithashtu ekzistojnë edhe dy vendime të Këshillit të Ministrave (VKM) në këtë fushë. VKM Nr. 863, datë 29.07.2009, “Për Strategjinë Kombëtare të Kërkimit, Zhvillimit Teknologjik dhe Inovacioneve (SHKKZHTI) dhe VKM nr. 567, datë 23.10.1995 “Për shpërblimin e Këshillave, Komisioneve dhe Ekspertizave të veprimtarisë Shkencore e Teknologjike” i përafruar pjesërisht me vendimin e Këshillit dhe Parlamentit Evropian Nr. 1513/2002/EC lidhur me Programit Kuadër VI të Komunitetit Evropian (2002-2006).

II.3. Institucionet përgjegjëse

Zbatimi i angazhimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e kërkimit shkencor është nën përgjegjësinë e këtyre institucioneve:

- Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)
- Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI)
- Akademia e Shkencave (ASH)
- Instituti i Statistikave
- Instituti i Shëndetit Publik
- Agjencia e Prokurimit Publik

II.4. Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

Fondet e programit për Kërkim dhe Ekselencë

Në 000/lekë

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	444,266	413,899	377,000	377,000
Mbulohen nga buxheti i shtetit	288,437	140,872.0	177,000.0	177,000.0
Mbuluar nga ndihma e huaj	155,829	273,027.2	200,000.0	200,000.0
Ndryshime	0	0	0	0

AKTI

Fondet për Kërkim dhe Zhvillim, teknologji dhe Inovacion, Infrastrukturë, Qendrat e Ekselencës, Programet Dypalëshe

	2012	2013	2014	2015
Kërkesa totale e vlerësuar	923,500	1,152,900	1,311,011	1,990,200
Mbulohen nga buxheti i shtetit	55,500	40,000	36,000	
Mbulohen nga ndihma e huaj	0	0	0	0

III. Prioritetet

Shqipëria inkurajohet të përshpejtojë përpjekjet në fushën e kërkimit dhe inovacionin me synim lehtësimin e integritimit në Zonën Kërkimore Evropiane dhe kontributin në Unionin e Inovacionit. Shqipëria do të ndërmarrë një vlerësim të pjesëmarrjes së saj në programet kërkimore të BE-së me qëllim rritjen e pjesëmarrjes në Horizon 2020 dhe të sigurojë përfitimin maksimal prej tij.

Shqipëria do të inkurajojë përfitimin nga mundësitë për pjesëmarrje në takimet me trupat drejtues të politikave të kërkimit të BE-së, veçanërisht ERAC për t'u familjarizuar më tepër me aksionet e BE-së mbi kërkimin dhe inovacionin.

Niveli i investimeve në kërkim do të rritet. Për këtë qëllim do të hartohet një plan veprimi që të tregojë dhe monitorojë se si do të rritet niveli i investimeve me kontributet nga sektori publik dhe privat.

Gjithashtu do të përditësohet strategjia kombëtare mbi kërkimin për të siguruar mirekoordinim dhe implementimin e veprimeve për inovacionin duke u fokusuar në përfshirjen e SME-ve dhe në forcimin e ndërtimit të kapitalit njerëzor. Në këtë kontekst, gjenerimi i statistikave të besueshme mbi shkencën dhe teknologjinë ka rëndësi të veçantë.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2014 – 2016

SHKENCA DHE KËRKIMI SHKENCOR

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia e Shkencës Teknologjisë e Inovacionit	Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	2009 -2015

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Kapitulli *Arsimi dhe Kultura* synon të japë një panoramë të qartë të situatës aktuale në fushën e arsimit, formimit profesional dhe kulturës, duke nxjerrë në pah nismat e ndërmarra për ngritjen e cilësisë së arsimit në përputhje me standardet evropiane. Ky kapitull përmban masat ligjore të planifikuara dhe prioritetet për reformat në funksion të Integrimit Evropian të vendit.

Acquis për arsimin dhe kulturën konsiston kryesisht në kuadrin e bashkëpunimit të përbërë nga programe dhe metoda të koordinimit të hapur (OMC), që synojnë konvergjencën e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave të përbashkëta. Në fushën e arsimit dhe kulturës shtetet anëtare duhet të sigurojnë menaxhimin e mirë të programeve të decentralizuara të Bashkimit Evropian. *Acquis* kërkon gjithashtu, që shtetet anëtare të lehtësojnë arsimin për fëmijët e punëtorëve emigrantë në Bashkimin Evropian dhe që ata të mos diskriminohen kundrejt shtetasve të BE-së. Në fushën e kulturës, Konventa e UNESCO-s e vitit 2005, “Mbi mbrojtjen dhe nxitjen e diversitetit të shprehjeve kulturore” e cila është

ratifikuar nga Bashkimi Evropian, është një komponent kryesor i *acquis*. BE kontribuon gjithashtu, në promovimin e çështjeve sportive evropiane.

Acquis i BE për kulturën bazohet në parimet e përgjithshme që rrjedhin nga “Traktati për Bashkimin Evropian” dhe “Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian”. Qëllimi i politikave të BE-së për kulturën është për të inkurajuar bashkëpunimin në mbështetje dhe për plotësimin e veprimeve që lidhen me rritjen e dijes dhe përhapjen e kulturës, ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, shkëmbimet kulturore dhe krijimet letrare dhe artistike duke përfshirë dhe sektorin audiovizual. BE gjithashtu fokusohet dhe inkurajon pjesëmarrjen në programet e BE-së.

I.2 Situata në Shqipëri

Gjatë vitit 2013, janë ndërmarrë një sërë përmirësimesh thelbësore në legjislacion dhe në procedura. Një arritje domethënëse ishte miratimi i ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”. Procesi i rekrutimit të drejtuesve të njësive arsimore vendore në nivel qarku u zhvillua për herë të parë përmes konkurseve të hapura dhe procedurave transparente. Institucioneve arsimore iu dha autoritet i plotë për rekrutimin e mësuesve, duke përfshirë në vendimmarrje bordin e tyre, komitetin e prindërve, senatin e shkollës, komunitetin e qeverisjes vendore dhe nxënësit.

MAS, për herë të parë ka nisur procesin e vlerësimit kombëtar të arritjeve të nxënësve në arsimin fillor dhe synon shtrirjen e tij në të gjithë nivelet e sistemit arsimor. Në nëntor 2013 është ndërmarrë nisma “Shkolla si Qendër Komunitare – Një shkollë miqësore për të gjithë”. Kjo nismë synon ndërtimin e një partneriteti të ri mësues-familje-komunitet. MAS në bashkëpunim me Institutin e Zhvillimit të Arsimit (IZHA) po rishikon Kornizën Kurrikulare të arsimit parauniversitar duke u bazuar tek 8 kompetencat kyçe evropiane për arsimin. Reforma e Atertekstit, e ndërmarrë së fundmi, synon heqjen e monopolit për tekstet shkollore. Është ndërtuar komunikim i ri, ku çdo aktor (prindër, mësues, autorë, botues etj.) ka shprehur opinionin e tij për tekstin dhe ka sugjeruar ndërhyrjet konkrete për përmirësimin në secilin tekst. Kjo reformë synon pajisjen e nxënësve me tekste më cilësorë në shtator.

Komiteti i Maturës Shtetërore (MSH) ka hartuar rregulloren e re dhe manualin udhëzues për procesin e maturës shtetërore. Ecuria e suksesshme e deritanishme e procesit të Maturës Shtetërore është një ogur i mirë për sistemin e arsimit, i cili tashmë me ndryshimet konkrete falë reformave siguron cilësi të lartë dhe standarde evropiane.

MAS ka nisur procedurat për rivlerësimin e standardeve të institucioneve të arsimit të lartë (IAL) publik dhe privat, që do të finalizohen me akreditimin dhe renditjen e të gjitha IAL-ve (publike dhe jopublike) nga një organizëm i pavarur dhe transparent, i autorizuar nga ENQA (Organizata Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë).

Në janar të vitit 2014 është krijuar Komisioni për Reformën në Arsimin e Lartë. Ky komision është një organ i pavarur, i përbërë nga një staf ekspertësh nga bota akademike dhe i udhëhequr nga një ekspert ndërkombëtar dhe po merret intensivisht me Reformën në Arsimin e Lartë në vend. Qëllimi kryesor i punës së këtij komisioni është që të mbledhë sugjerime dhe rekomandime për Reformën në Arsimin e Lartë nga grupe ekspertësh dhe akademikësh. Në përfundim do të hartohen dokumente strategjike dhe ligjore për reformimin e arsimit të lartë.

Në Inspektoratin Shtetëror të Arsimit me Urdhër të Kryeministrit nr. 97 datë 21.02.2014 “Për **miratimin** strukturës dhe organikës së Inspektoratit Shtetëror të Arsimit” për herë të parë u hap dhe sektori për inspektimin në institucionet e arsimit të lartë. Ky sektor do të kryejë monitorimin dhe do të sigurojë cilësinë në sektorin e arsimit të lartë.

Deri tani Shqipëria ka arritur progres të dukshëm lidhur me përafrimin e legjislacionit të saj me *acquis* të BE-së. Ligji i ri për trashëgiminë kulturore është hartuar së fundmi nga grupet përkatëse të punës dhe do të çohet gjithë palëve të interesuara përkatëse për komentet dhe sugjerimet përkatëse. Ligje të tjerë të rëndësishëm si për shembull ligji i ri për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera që burojnë prej saj janë vendosur për tu aprovuar gjatë vitit 2014 (Shiko kapitullin 7). Amendimet në Ligjin për Artet janë aprovuar së fundmi. Gjithashtu, Ligji për Librat dhe Ligji për Muzeumet janë planifikuar të miratohen gjatë vitit 2014. Ministria e Kulturës është në hapat e fundit për finalizimin e marrëveshjes me BE-në që do të mundësonte pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin “Evropa Kreative” (Creative Europe).

I.3 Struktura e kapitullit

1. ARSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL
2. KULTURA

II Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar në arsim me *Acquis* të BE-së buron nga neni 70 MSA për përafrimin e legjislacionit dhe neni 100 lidhur me përafrimin e legjislacionit në arsim dhe trajnim. Në fushën e kulturës neni 101 i MSA thekson se “palët zotohen të ndërmarrin bashkëpunim kulturor. Ky bashkëpunim do të shërbejë gjithashtu edhe për rritjen e mirëkuptimit të përbashkët dhe të respektit reciprok ndërmjet

individëve, komunitetit dhe njerëzve. Palët gjithashtu zotohen të bashkëpunojnë për promovimin e diversitetit kulturor, veçanërisht në kuadër të Konventës së UNESCO për mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit të shprehjes kulturore.”

Në përputhje me Partneritetin Evropian prioritetet afatgjatë dhe afatshkurtër në fushën e arsimit dhe trajnimeve, përshkruhen si më poshtë:

Prioritete afatshkurtër:

- Përmirësimi i administrimit të sistemit arsimor, të trajnimit të mësuesve dhe infrastrukturës arsimore.
- Zbatimi i ligjit të ri të arsimit të lartë. Pjesëmarrje me aktive në programet komunitare të BE-së si Horizont 2020, 2020 Erasmus + me synim përfitimin maksimal prej tyre.

Prioritete afatmesme:

- Përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe krijimi i një sistemi bashkëkohor të arsimit dhe formimit profesional , inkurajimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e arsimit të lartë.

Kërkesa të cilat rrjedhin nga akte/direktiva të tjera në fuqi që kanë lidhje me përafrimin janë:

- Rezoluta e Këshillit 16 Nëntor 2007 mbi Agjendën Evropiane;
- Komunikata e Komisionit, Këshillit, Parlamentit, ECSC dhe Komitetit të Rajoneve mbi një Agjendë Evropiane mbi Kulturën (2007);
- Raporti i Komisionit mbi zbatimin e Agjendës për Kulturën (2010);
- Komunikata e Komisionit mbi promovimin e kulturës dhe sektorëve krijues për rritje dhe punësim në BE (2012);
- Konkluzione të Këshillit mbi Qeverisjen Kulturore;
- Rregulloren e Këshillit (BE) Nr. 1295/2013 për lancimin e Programit “Creative Europe”;
- Direktiva 2014/60/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15 Maj 2014 për kthimin e objekteve kulturore të lëvizura kundër ligjit nga territori i një Shteti Anëtar.
- Rregullore e Këshillit (KE) nr. 116/2009 e 18 Dhjetorit 2008 mbi eksportimin e mallrave kulturore.
- Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) nr. 1081/2012 e 9 Nëntorit 2012 për qëllimet e Rregullores së Këshillit (BE) nr. 116/2009 mbi eksportimin e mallrave kulturore

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” synon:

- Fuqizimin e kompetencave të institucioneve që realizojnë drejtpërdrejt shërbimin arsimor nëpërmjet decentralizimit, dekoncentrimit e autonomisë shkollore dhe saktësimi i rolit të nivelit qendror në politika bërje e vendosjen e standardeve të cilësisë së shërbimit arsimor.
- Përmirësimin e ndjeshëm të aftësive menaxhuese në sistemin arsimor nëpërmjet përcaktimit më të qartë të përgjegjësisë të institucioneve e individëve, vlerësimit të jashtëm, vetëvlerësimit e raportimit periodik të punonjësve arsimorë e institucioneve dhe shtimit të transparencës së performancës së tyre. Vendosjen e baraspeshës ndërmjet përgjegjësisë dhe hapësirës vendimmarrëse.
- Shtimin e larmisë së kurrikulës që t’i shkojë më përshtat larmisë së prirjeve, mundësive dhe aspiratave të karrierës së nxënësve.

Ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8872, datë 29.3.2002 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar synon:

- Përgatitjen e të rinjve me njohuri e shprehje të përshtatshme me kërkesat dinamike të tregut të punës përmes modernizimit të AFP, duke u bazuar në kërkesat e niveleve të kualifikimit sipas KSHK.
- Ofrimin e mundësive për përditësim të dijeve e aftësive të të rriturve në përshtatje me kërkesat e tregut të punës.

Ligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” synon:

- Decentralizimin e mëtejshëm të kompetencave KM – MAS – IAL, përmirësimin e strukturës së studimeve universitare në të tre ciklet e studimit (sipas standardeve të Bolonjës).

Ligji Nr. 10 247, datë 04.03.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, përafrohet plotësisht me “Kornizën e Kualifikimeve në Sistemin e Arsimit të Lartë Evropian”, miratuar nga Ministrat përgjegjës të arsimit të lartë evropian në Konferencën e Bergen, datë 20.05.2005; Ky akt është hartuar dhe ndryshuar në përafrim plotë të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve

Projekt - ligji për Trashëgiminë Kulturore

- Ministria e Kulturës ka ndërmarrë një numër masash që kur filloi punën me një mandat të fokusuar ekskluzivisht mbi kulturën. Një aspekt kyç në agjendën e reformës është në fushën e trashëgimisë kulturore. Grupet e punës së fundmi kanë përfunduar përgatitjen e një drafti të ri të ligjit pas një konsultimi të kujdesshëm me grupet e interesit/palët e interesuara. Projekt – ligji do t’i dërgohet tani ministrive

tjera dhe institucioneve përkatëse për mendim. Ky projektligj përafron legjislacionin shqiptar me Direktivën 93/7/EEC për “ Kthimin e objekteve kulturore të trafikuar në mënyrë të paligjshme nga territori i një vendi anëtar ”, si dhe me Rregulloren e Këshillit (EEC) Nr. 3911/92 mbi “Eksportin e mallrave kulturorë”. Gjithashtu projektligji mbi trashëgiminë kulturore është fokusuar në përmirësimin dhe riorganizimin e mbrojtjes së siteve të trashëgimisë kulturore, duke përfshirë dhe peizazhin. Për më tepër, projektligji do të sigurojë qartësi dhe do të përcaktojë kushtet, procedurat dhe sanksionet që do të drejtojnë organizimin e operacioneve. Ai do t’i japë fund konfliktit ekzistues mes qeverisjes vendore dhe atij qendror si dhe praktikave korruptive që kanë penguar mbrojtjen e siteve të trashëgimisë kulturore. Përfundimisht, projekt ligji i ri do të orientohet drejt ruajtjes së siteve të trashëgimisë kulturore. Ai do të përmirësojë administrimin e siteve të trashëgimisë kulturore për të siguruar procedurat e përshtatshme për promovimin e aktiviteteve kulturore.

Ministria e Kulturës ka bërë ndryshime në *Ligjin për Artin dhe Kulturën* të cilat janë miratuar kohët e fundit nga parlamenti shqiptar. Ndryshimet fokusohen në rritjen e transparencës duke vendosur procedura të qarta për vlerësimin e zgjedhjen e projekteve.

II.3 Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)
- Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP),
- Agjencia e Arsimit dhe Zhvillimit (AAZh) ,
- Inspektorati Shtetëror i Arsimit (IShA),
- Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve,
- Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL),
- Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZhA),
- Inspektorati Kombëtar i Arsimit Para-universitar (IKAP),
- Agjencia Kombëtare për Arsimin, Formimin Profesional dhe Kualifikimet (AKAFPK),
- Ministria e Kulturës
- INSTAT
- Ministria e Shëndetësisë

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

në 000/Lek

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	42,034,899	42,077,129	44,734,450	47,378,000
Mbulohen nga buxheti i shtetit	40,416,145	41,723,149	44,324,450	45,378,000
Mbuluar nga ndihma e huaj	1,618,754	353,980	410,000	2,000,000
Ndryshim	0	0	0	0

III. Prioritetet

Prioritetet janë si më poshtë:

1. Rritja e pjesëmarrjes në klasat përgatitore të arsimit parashkollor
 - Zhvillimi i kapitalit njerëzor duke investuar në fëmijërinë e hershme
 - Mundësi hyrjeje dhe përfshirje masive e të gjithë fëmijëve në sistemin e arsimit parashkollor
 - Rritja e cilësisë së shërbimit të mësimdhënies dhe të të nxënit.
2. Reforma në sistemin parauniversitar
 - Reforma në sistemin parauniversitar do të përqendrohet në radhë të parë në rritjen e cilësisë së sistemit arsimor, duke hartuar dhe zbatuar një sistem drejtimi dhe kontrolli vendor dhe kombëtar më të besueshëm. (reformë strukturore 5+4+3 vjet, rishikimi i alartekstit, kurrikula të reja bazuar në kompetenca dhe jo objektiva, karta e performancës/arritjeve për çdo shkollë, vlerësim kombëtar të nxënësve, përmirësimi i procesit të Maturës Shtetërore). Krijimi i një baze të dhënash për menaxhimin efikas administrativ dhe digjitalizimin e çdo procesi të administrimit arsimor, si mjet i domosdoshëm për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies.
 - Përmirësimi i infrastrukturës shkollore: sistemi EMIS të jetë tërësisht funksional, planifikim shkollash të reja, shkolla si qendra komunitare.
 - Proces më të mirë vendimmarrjeje duke krijuar një komunikim të ri shkollë-prindër-qeveri, duke e bërë prindin pjesë të komunikimit dhe arsimit, do të realizohet llogaridhënia e ndërsjellë dhe do të garantohet cilësia në rekrutimin e mësuesve. Procedura e re e

rekrutimit të mësuesve, ku shkolla bashkë me bordin e senatin e saj, komitetin e prindërve, komunitetin e qeverisjes vendore dhe nxënësit, vendos bashkërisht për zgjedhjen e mësuesve, do të institucionalizohet më tej.

- Gjithëpërfshirje sasiore dhe cilësore e grupeve të marginalizuara (uljen e numrit të nxënësve që braktisin shkollën, pakësimi i dukurisë së korrupsionit: zbatimi i rreptë i masave ndëshkuese për të gjitha praktikat korruptive të denoncuar dhe evidentuara).

3. Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë

- Ofrimi i një cilësie shumë të mirë në arsimin e lartë: ngritja e cilësisë në standardet evropiane dhe qëndrueshmëri, për të fituar besimin e shoqërisë dhe të institucioneve kombëtare; reformë thelbësore në kuadrin ligjor si në drejtim të programeve të studimit (zhvillimi i panevojshëm i disa profesioneve dhe i mangët i disa profesioneve të tjera më të kërkuara në tregun e punës, e deri në cilësinë e diplomave)
- Eficencë financiare nëpërmjet menaxhimit dhe alokimit efikas
- Njohje ndërkombëtare dhe emër/përfaqësim më të mirë
- Hartimin e një skeme të re financiare për universitet publike, bazuar në arritje dhe rezultate të institucioneve arsimore, vendosjen e një mekanizmi të ri për dhënie llogari ndaj shtetit dhe aktorëve të tjerë publikë.

4. Rishikimi i Ligjit për Librat dhe Ligjit për Muzeumet brenda vitit 2014;

5. Lancimi i një platforme për zbatimin e strategjisë së arsimit përmes kulturës dhe artit për të bërë artin dhe kulturën të arritshëm dhe të aksesueshëm për studentët e të gjitha moshave. Kjo platformë do të përgatitë një strategji që synon promovimin e shkrimtarëve shqiptarë në tregjet evropiane dhe do të përafrojë funksionimin e fondit shqiptar për përkthim për një përmbushje më të mirë të objektivave.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2014 – 2016

IV.1 Arsimi dhe formimi profesional

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e Referuar
Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe Sportit	2009-2013
Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë	Ministria e Arsimit dhe Sportit	2008-2013

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Strategjia Kombëtare për Arsimin Parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe Sportit	2014-2020	2014	2014
Strategjia Kombëtare për Sportin	Ministria e Arsimit dhe Sportit	2014-2020	2014	2014

IV.2 Kultura

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e Referuar
Programi i Qeverisë Shqiptare	Ministria e Kulturës	2014

Kuadri i masave ligjore ekzistuese

Acquis i BE-së s	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni Kryesor	Niveli i përafrimit	Data e miratimit të legjislacionit Shqiptar	Data e Hyrjes në Fuqi të legjislacionit shqiptar
Rregullore (KE) Nr 116/2009 datë 18 dhjetor 2008 “Mbi eksportin e mallrave kulturorë”	Ligji nr. 9386, dt. 4.5.2005 “Për muzetë ”	Ministria e Kulturës	I pa-përafruar	4.05.2005	26.06.2005
	Ligji nr. 9048 dt. 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore ”	Ministria e Kulturës	I pa-përafruar	7.04.2003	Maj 2003
Rregullore (EU) Nr 1081/2012	Ligji nr. 9386, dt. 4.5.2005 “Për muzetë”	Ministria e Kulturës	I Pa-përafruar	4.05.2005	26.06.2005
	Ligji nr. 9048 dt. 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore ”	Ministria e Kulturës	I pa-përafruar	7.04.2003	Maj 2003

Kuadri i Planifikuar i Politikave 2014 – 2016

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e Referimit	Data e Miratimit	Data e hyrjes në Fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat e Planifikuara Ligjore 2014 – 2016

Acquis i BE-së	Statusi i përkthimi në Shqip (Po/Jo)	Legjislacioni Shqiptar;	Statusi i përkthimit në anglisht (Po/Jo)	Institucioni Përgjegjës/Pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit	Data e Planifikuar e Miratimit	Data e Hyrjes në fuqi
<u>AFAT SHKURTRA (2014)</u>							
Rregullore (EC) NR 116/2009	Jo	Ndryshime në Ligjin Nr. 9386, datë 04.05.2005 “Për muzetë” Ndryshime në Ligjin Nr. 9048 datë 07.04.2003“Për trashëgiminë kulturore“	Jo	Ministria e Kulturës	I Plotë	Tre muhori i tretë 2014	Tre muhori i tretë 2014
Rregullore (BE) Nr. 1081/2012	Jo	Ndryshime në Ligjin Nr. 9386, datë 04.05.2005 “Për muzetë” Ndryshime në Ligjin Nr. 9048 datë 07.04.2003“Për trashëgiminë kulturore“	Jo	Ministria e Kulturës	I Plotë	Tre muhori i tretë 2014	Tre muhori i tretë 2014
<u>AFAT MESËM (2015 – 2016)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

KAPITULLI 27: MJEDISI

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e Kapitullit

Politikat e BE-së për mjedisin kane si qëllim që të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Këto politika bazohen mbi integrimin e mbrojtjes së mjedisit në politikat e tjera të BE-së, veprimet parandaluese, parimin ndotësi paguan, si dhe luftën kundër dëmtimit të mjedisit në burim dhe ndarjen e përgjegjësisë. Legjislacioni mjedisor përfshin mbi 200 akte ligjore kryesore, të cilat mbulojnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe atë të ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, ndryshimet klimatike, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut, organizmat e modifikuara gjenetikisht, kimikatet, zhurmat dhe pyjet. Sigurimi i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së kërkon investime të rëndësishme, por sjell edhe përfitime të rëndësishme. Një administratë e fortë dhe e mirëpajisur në nivel qendror dhe lokal është e domosdoshme për aplikimin dhe zbatimin e *acquis*.

I.2 Situata në Shqipëri

Kushtetuta e Shqipërisë e konsideron zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit si një nga objektivat kryesorë të Shtetit. Ligji i vitit 2011 për mbrojtjen e mjedisit siguron bazat për akte ligjore specifike që normojnë komponentët e ndryshëm të mbrojtjes së mjedisit. Ligje specifike ekzistojnë për të normuar cilësinë e ujit dhe atë të ajrit, menaxhimin e mbetjeve, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e riskut, kimikatet, etj. Megjithëse përafrimi me *acquis* ka përparuar, përsëri nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar një përafrim të plotë me *acquis* mjedisor të BE-së. Në këtë kuadër, si dhe me qëllim përafrimin e plote të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së deri në vitin 2020, Shqipëria po punon për draftimin dhe amendimin e disa ligjeve kryesore, si dhe hartimin e legjislacionit sekondar në fushën e mjedisit dhe atë të ndryshimeve klimatike.

Gjithashtu, progres ka pasur edhe për sa i përket kuadrit institucional dhe administrativ. Me hyrjen në fuqi të Ligjit të vitit 2011 për mbrojtjen e mjedisit, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve është riorganizuar ku përveç ndryshimit të emrit në Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), si dhe shtimit të përgjegjësisë, është rritur edhe numri i punonjësve, nga 42 në 62 punonjës. Në varësi të AKM-së kane kaluar edhe 12 Drejtoritë Rajonale të Mjedisit, të cilat do të operojnë dhe koordinojnë punën dhe funksionet e tyre me ato të AKM-së si në nivel lokal ashtu edhe në nivel kombëtar.

Në Janar 2014, është krijuar Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, i cili është një institucion publik nën varësinë e Ministrisë së Mjedisit, që do të garantojë zbatimin dhe imponimin e ligjit në fushën e mjedisit, pyjeve dhe ujërave. Me qëllim përmirësimin e zbatimit të ligjit, Inspektorati i Mjedisit ka rritur ndjeshëm numrin e kontrolleve në zonat industriale, ku në kryerjen e kësaj detyre ka bashkëpunuar ngushtë me inspektoratet dhe institucionet e tjera shtetërore. Në këtë kuadër, janë ndërmarrë një sërë masash administrative për sa i përket shkeljeve të kushteve të lejes mjedisore, si dhe detyrimeve të tjera që lindin nga legjislacioni mjedisor.

Gjithashtu, me qëllim ndalimin aktivitetëve të paligjshme në zonat e mbrojtura, janë ndërmarrë një sërë hapash të rëndësishëm siç janë **(i)** miratimi i akteve ligjore që ndalojnë gjuetinë apo transportin e qymyrit të drurit, **(ii)** nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme “Për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm të Pyjeve”, i cili krijon Task Forcën mbi Pyjet, **(iii)** rritja e numrit të kontrolleve nga ana e Policisë Pyjore, **(iv)** vendosja e masave administrative për të gjithë shkelësit e legjislacionit mjedisor, etj. Me Urdhër të Kryeministrit në Shkurt 2014, janë krijuar 12 Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Pyjor.

Disa vendime të Qeverisë kanë përmirësuar ndjeshëm partneritetin ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile. Miratimi i VKM “Për miratimin e rregullave, kërkesat dhe procedurat për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”, rritja e numrit të stafit AKM-së i përfshirë drejtpërdrejt në shqyrtimin e aplikacioneve për lejet mjedisore, kryerja rregullisht e konsultimeve me publikun për planet e mjedisit, programet dhe legjislacionin, organizimi takimeve të rregullta me OJQ-të mjedisore, si dhe shpërndarja e Buletineve Mjedisore Javorë dhe Mujorë, kanë përmirësuar ndjeshëm situatën lidhur me ndërgjegjësimin e publikut dhe pjesëmarrjen e tij në vendimmarrjen mjedisore, si dhe aksesin e publikut për informacion mjedisor.

Me organizimin e ri të AKM-se dhe në përputhje të plotë me detyrat dhe përgjegjësitë e saj, vëmendje e veçantë i është dhënë forcimit të Labororit të AKM-se. Laboratori është zhvendosur në një vend të ri, plotësisht të rinovuar dhe në përputhje me standardet e kërkuara ISO 170 25 të manualit të cilësisë. Numri i stacioneve të monitorimit të ajrit është rritur në 6 stacione për vitin 2014. Të dhënat e monitorimit do të japin një pasqyrë të plotë të cilësisë së ajrit në të gjithë vendin, duke përfshirë Tiranën. Buxheti i monitorimit për vitin 2014 është dyfishuar në krahasim me vitin 2013.

Përveç rinovimit të ndërtesës së Labororit të AKM-se është realizuar edhe blerja e pajisjeve teknike për analizimin dhe monitorimin e parametrave themelor të cilësisë së ujit. Për më tepër, për vitin 2014 është përfshirë edhe monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësor, lumenjve, liqeneve dhe ujërave bregdetar, si dhe përcaktimi i metaleve të rënda në lumenj. Për vitin 2014 Shqipëria ka 33 stacione monitorimi në lumenj, 7 stacione në liqene dhe 8 në pjesët bregdetare. Gjatë vitit 2013 Shqipëria kishte vetëm gjysmën e numrit të përgjithshëm të këtyre stacioneve.

I.3 Struktura e kapitullit

1. Legjislacioni Horizontal;
2. Cilësia e Ajrit dhe Ndryshimet Klimatike;
3. Menaxhimi i Mbetjeve;
4. Cilësia e Ujërave;
5. Mbrojtja e Natyrës;
6. Kontrolli i Ndotjes Industriale dhe Menaxhimi i Riskut;
7. Organizmat e Modifikuara Gjenetikut;
8. Kimikatet;
9. Zhurmat;
10. Pyjet

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e Kërkesave të MSA-së dhe Legjislacionit të BE-së

Detyrimi për përafrimin e legjislacionit Shqiptar në fushën e mjedisit me atë të BE-se, rrjedh nga Neni 108 i MSA-se, në të cilin citohet si më poshtë vijon:

1. Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin në detyrën shumë të rëndësishme të luftës kundër degradimit mjedisor, me synim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore.
2. Bashkëpunimi përqendrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit për fushën e mjedisit.

Legjislacioni i BE-së në fushën e mjedisit është i përbërë nga aktet ligjore të më poshtme:

Për fushën e Legjislacionit Horizontal:

- Direktiva 2004/35/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21.04.2004 “Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin” e ndryshuar. FZ Seria L 143, 30.4.2004, f. 56-75;
- Direktiva 2001/42/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 27.06.2001 “Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara”. FZ L 197, 21.7.2001, f. 30–37;

- Direktiva 85/337/KEE të Këshillit, datë 27.06.1985 "Mbi vlerësimin e efekteve të projekteve publike dhe private mbi mjedisin", të ndryshuar. FZ L 175, 5.7.1985, f. 40 – 48;
- Direktiva 2003/35/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 Maj 2003 mbi “Tërheqjen e publikut në vendimmarrje në hartimin e planeve programeve në fushën e mjedisit dhe amendimet për pjesëmarrjen e publikut dhe aksesin në drejtësi të Direktivave të Këshillit 85/337/EEC dhe 96/61/EC”. FZ L 156, 25.06.2003, f. 17 - 25;
- Direktiva 2003/4/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE-së, datë 28 Janar 2003 mbi të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor dhe shfuqizim të Direktivës së Këshillit 90/313/EEC. FZ L 41, 14.02.2003;
- Vendimi i Këshillit të BE-së 2005/370/EC, datë 17 Shkurt 2005 për miratimin në emër të Komunitetit Evropian të Konventës për të drejtën për informim, pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatave për çështjet mjedisore. FZ L 124, 17.5.2005; f. 1 – 3.

Për fushën e Cilësisë së Ajrit:

- Direktiva 2008/50/KE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 21 Maj 2008 mbi cilësinë e ajrit të ambientit dhe për një ajër më të pastër për Evropën. FZ L 152, 11.06.2008;
- Direktiva 2004/107/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 15 Dhjetor 2004, lidhur me arsenikun, kadmiumin, mërkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin e mjedisit. FZ L 23, 2.01.2005;
- Direktiva 2001/81/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 23 Tetor 2001 mbi Tavanet Kombëtare të Shkarkimit për disa ndotës atmosferik e amenduar nga Direktiva 2006/105/KE dhe Rregullorja 219/2009/KE. FZ L 309, 27.11.2001;
- Direktiva e Këshillit 1999/32/KE e datës 26 Prill 1999 në lidhje me reduktimin e përmbajtjes së squfurit në disa lëndë djegëse të lëngshme dhe amendon Direktivën 93/12/KEE siç amendohet nga Rregulloret (KE) 1882/2003 dhe (KE) 219/2009 dhe Direktivat 2005/33/KE dhe 2009/30/KE. FZ L 121, 11.5.1999;
- Direktiva 2012/33 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 21 Nëntor 2012 që amendon Direktivën e Këshillit 1999/32/KE në lidhje me përmbajtjen e squfurit në lëndët djegëse në transportin detar. FZ L 327, 27.11.2012;
- Direktiva e Këshillit 1999/13/KE e datës 11 Mars 1999 mbi kufizimin e shkarkimeve të komponimeve organike të avullueshme (VOC) për shkak të përdorimit të tretësve organik në disa aktivitete dhe instalime. FZ L 85, 29.3.1999;
- Vendimi i Këshillit 2000/541/KE e datës 6 Shtator 2000 mbi kriteret për vlerësimin e planeve kombëtare në përputhje me Nenin 6, të Direktivës së Këshillit 1999/13/KE (njoftuar në kuadër të dokumentit numër C(2000) 2473). FZ L 230, 12.09.2000;
- Direktiva e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian 94/63/KE e datës 20 Dhjetor 1994 mbi kontrollin e shkarkimeve të komponimeve organike të avullueshme (VOC) që burojnë nga depozitimi i karburantit dhe nga shpërndarja e tij nga terminalet tek stacionet e shërbimit siç amendohet nga Rregulloret (KE) 1882/2003 dhe (KE) 1137/2008. FZ L 365, 31.12.1994;

- Direktiva e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian 2009/126/KE e datës 21 Tetor 2009 mbi rikuperimin e avujve të karburantit të Fazës së II, gjatë rimbushjes së mjeteve motorike në stacionet e shërbimit. FZ L 285, 31.10.2009;
- Direktiva 2004/42/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 21 Prill 2004 mbi limitimin e shkarkimeve të komponimeve organike të avullueshme për shkak të përdorimit të tretësve organik në disa bojëra dhe llaqe të caktuara dhe produkteve për rilyerjen e automjeteve që amendon Direktivën 1999/13/KE dhe 2009/112/KE dhe Rregulloren (KE) 1137/2008. FZ L 143, 30.04.2004;
- Direktiva e Këshillit 70/220/KEE e datës 20 Mars 1970 mbi përafrimin e legjislacionit të Vendeve Anëtare në lidhje me masat që do të merren kundër ndotjes së ajrit nga gazet e çliruara nga mjetet motorike me motor me ndezje pozitive. FZ L 76, 06.04.1970;
- Direktiva 97/68/KE e Këshillit dhe e Parlamentit Evropian e datës 16 Dhjetor 1997 mbi përafrimin e legjislacionit të Vendeve Anëtare në lidhje me masat që do të ndërmerren kundër shkarkimit të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me djegie të brendshme që instalohen në makineritë e lëvizshme jo rrugore, amenduar nga Direktiva 2002/88/KE dhe Direktiva 2004/26/KE, dhe amendimi i fundit i Direktivës 2006/105/KE. FZ L 59, 27.02.1998;
- Direktiva 2005/55/KE e Këshillit dhe e Parlamentit Evropian e datës 28 Shtator 2005 mbi përafrimin e legjislacionit të Vendeve Anëtare në lidhje me masat që do të ndërmerren kundër shkarkimeve të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje me kompresion dhe motorët me ndezje pozitive që djegin gaz natyral apo të lëngshëm për përdorim në automjete. FZ L 275, 20.10.2005.

Për fushën e Ndryshimeve Klimatike:

Mekanizmi Monitorues

- Vendimi i Këshillit Nr. 2002/358/KE e datës 25 Prill 2002 në lidhje me miratimin, në emër të Komunitetit Evropian, të Protokollit të Kiotos të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe përmbushjen e përbashkët të angazhimeve në përputhje me to. FZ L 130, 15.05.2002;
- Vendimi i Komisionit Nr. 2005/166/KE e datës 10 Shkurt 2005 që parashtron rregullat e zbatimit të Vendimit Nr. 280/2004/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian lidhur me mekanizmin për monitorimin e emisioneve të gazeve me efekt serrë të Komunitetit dhe për zbatimin e Protokollit të Kiotos. FZ C 166, 07.07.2005;
- Vendimi i Komisionit i datës 14 Dhjetor 2006 që përcakton nivelet përkatëse të emisioneve të akorduara për Komunitetin dhe për secilin nga Shtetet Anëtare të tij sipas Protokollit të Kiotos në bazë të Vendimit të Këshillit Nr. 2002/358/KE (njoftuar nën numrin e dokumenti C (2006) 6468) (2006/944 / KE). FZ L 130, 15.05.2002;
- Vendimi i Komisionit Nr. 2010/778/KE, datë 15 Dhjetor 2010 i cili amendon Vendimin Nr. 2006/944/KE për përcaktimin e niveleve përkatëse të emetimit të akorduara Komunitetit dhe secilit prej Shteteve Anëtare të tij sipas Protokollit të Kiotos në bazë të Vendimit të Këshillit Nr. 2002/358/KE. FZ L 332, 16.12.2010;

- Rregullorja (BE) Nr. 525/2013 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 21 Maj 2013 e mekanizmit për monitorimin dhe raportimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë dhe për raportimin e informacioneve të tjera në nivel kombëtar dhe të Bashkimit Evropian në lidhje me Ndryshimet Klimatike dhe shfuqizimin e Vendimit Nr 280 /2004/KE. FZ L 165, 18.06.2013.

Sistemi i Tregtimit të Emetimeve të BE

- Direktiva Nr. 2003/87/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 13 Tetor 2003 për krijimin e një skeme të tregtimit të njësive të lejuara të gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit e cila amendon Direktivën e Këshillit Nr. 96/61/KE. FZ L 27, 25.10.2003;
- Direktiva Nr. 2004/101/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 27 Tetor 2004 e cila amendon Direktivën Nr. 2003/87/KE për krijimin e një skeme të tregtimit të njësive të lejuara të gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit, në lidhje me mekanizmat e Protokollit të Kiotos-s. FZ L 338, 13.11.2004;
- Vendimi i Komisionit Nr. 2006/780/KE i datës 13 Nëntor 2006 mbi shmangien nga llogaritja e dyfishtë e reduktimit të emisioneve të gazeve me efekt serrë sipas skemës për tregtimin e emisioneve të Komunitetit për projektet e aktiviteteve sipas Protokollit të Kiotos në bazë të Direktivës Nr. 2003/87/KE të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian. FZ L 316, 16.11.2006;
- Direktiva Nr. 2009/29/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 23 Prill 2009 e cila amendon Direktivën Nr. 2003/87/KE në mënyrë që të përmirësojë dhe zgjerojë skemën tregtare të kompensimit të njësive të lejuara të emisioneve të gazeve me efekt serrë të Komunitetit. FZ L 140, 5.6.2009;
- Vendimi i Komisionit Nr. 2010/2/KE i cili përcakton një listë të sektorëve dhe nënsektorëve të cilët mendohet të jenë të ekspozuar ndaj një risku të konsiderueshëm të rrjedhjes së karbonit. FZ L 1, 05.01.2010;
- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 389/2013 e datës 2 Maj 2013 për krijimin e një Regjistri të Bashkimit Evropian në zbatim të Direktivës Nr. 2003/87/EC të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, Vendimet Nr. 280/2004/KE dhe Nr. 406/2009/KE të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian dhe shfuqizimi i Rregulloreve të Komisionit (BE) Nr. 920/2010 dhe Nr. 1193/2011. FZ L 122, 3.05.2013;
- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 1031/2010 datë 12 Nëntor 2010 mbi afatin kohor, administrimin dhe aspekte të tjera të ankandit të njësive të lejuara të emisioneve të gazeve me efekt serrë në zbatim të Direktivës Nr. 2003/87/KE të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian për krijimin e një skeme për tregtimin e gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit. FZ L 302, 18.11.2010;
- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 550/2011 datë 7 Qershor 2011 mbi përcaktimin, në zbatim të Direktivës Nr. 2003/87/KE të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, për disa kufizime të zbatueshme për përdorimin e krediteve ndërkombëtare nga projektet që përfshijnë gaze industriale. FZ L 149, 08.06.2011;
- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 1123/2013 e datës 8 Nëntor 2013 për përcaktimin e të drejtave ndërkombëtare të krediteve në zbatim të Direktivës Nr. 2003/87/KE të Parlamentit dhe Tekstit të Këshillit Evropian në përputhje me Agjencinë Evropiane të Mjedisit. FZ L 299, 02.09.2013;

- Vendimi i Komisionit Nr. 2011/278/BE për përcaktimin e rregullave transitore të Bashkimit Evropian të zgjeruar për harmonizimin e shpërndarjes së lirë të njësive të lejuara të emisioneve në përputhje me Nenin 10a të Direktivës Nr. 2003/87/KE të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian (të njoftuar në dokumentin C (2011) 2772), FZ C 278, 22.09.2011;
- Vendimi i Komisionit Nr. 2013/447/BE datë 5 Shtator 2013 për faktorin standard të përdorimit të kapaciteteve në përputhje me nenin 18 (2) të Vendimit Nr. 2011/278/BE Tekst me rëndësi nga Agjencia Evropiane e Mjedisit. FZ L 240, 07.09.2013;
- Vendimi i Komisionit Nr. 2011/745/BE i cili amendon Vendimet Nr. 2010/2/EU dhe Nr. 2011/278/BE sa i përket sektorëve dhe nënsektorëve të cilët mendohen të jenë të ekspozuar ndaj një risku të konsiderueshëm të rrjedhjes së karbonit. FZ L 299, 17.11.2011;
- Rregullorja e Komisionit Nr. 600/2012 për verifikimin e raporteve të emetimeve të gazeve me efekt serrë dhe raportet ton-kilometër dhe akreditimin e verifikuesve sipas Direktivës Nr. 2003/87/KE të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian Tekst me rëndësi nga Agjencia Evropiane e Mjedisit. FZ L 181, 12.07.2012;
- Rregullorja e Komisionit Nr. 601/2012 mbi monitorimin dhe raportimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë në zbatim të Direktivës Nr. 2003/87/KE të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian. FZ L 181, 12.07.2012;
- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 176/2014 e datës 25 Shkurt 2014 e cila amendon Rregulloren (BE) Nr. 1031/2010 në veçanti për të përcaktuar vëllimin e njësive të lejuara të emetimeve të gazeve me efekt serrë që do të dalin në ankand në 2013-2020. FZ L 56, 26.02.2014.

Sistemi i Tregtimit të Emisioneve: Aktivitetet e Aviacionit

- Direktiva Nr. 2008/101/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 19 Nëntor 2008 e cila amendon Direktivën Nr. 2003/87/KE në mënyrë që të përfshijë aktivitetet e aviacionit në skemën e tregtisë së njësive të lejuara të gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit. FZ L 8, 13.01.2009;
- Vendimi i Komisionit Nr. 2009/450/KE i datës 8 Qershor 2009 mbi interpretimin e detajuar të aktiviteteve të aviacionit të listuara në Aneksin I të Direktivës Nr. 2003/87/KE. FZ L149, 12.06. 2009;
- Vendimi Nr. 377/2013/BE i Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 Prill 2013 për shmangien përkohësisht nga Direktiva Nr. 2003/87/EC për krijimin e një skeme të tregtisë për njësitë e lejuara të emetimeve të gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit. FZ L 113, 25.04.2013.

Vendimi për Shpërndarjen e Përpjekjeve

- Vendimi Nr. 406/2009/KE i Parlamentit dhe i Këshillit Evropian i datës 23 Prill 2009 mbi përpjekjet e Shteteve Anëtare për të reduktuar emetimet e tyre të gazeve me efekt serrë për të përmbushur angazhimet e Komunitetit Evropian për reduktimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë deri në vitin 2020. FZ L 140, 05.06.2009;

Substancat Ozonholluese

- Rregullorja (KE) Nr. 1005/2009 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 16 Shtator 2009 mbi substancat që hollojnë shtresën e ozonit. FZ L 286, 31.10.2009;
- Vendimi i Komisionit Nr. 2010/372/KE i datës 18 Qershor 2010 mbi përdorimin e substancave të kontrolluara si agjentë të procesit sipas nenit 8 (4) të Rregullores (KE) Nr. 1005/2009 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian. FZ L 169, 03.07.2010;
- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 744/2010 e datës 18 Gusht 2010 e cila amendon Rregulloren (KE) Nr. 1005/2009 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian për substancat që hollojnë shtresën e ozonit, në lidhje me përdorimet kritike të haloneve. FZ L 218, 19.08.2010;
- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 291/2011 e datës 24 Mars 2011 për përdorimin thelbësor të substancave të kontrolluara përveç hidroklorofluorokarboneve për laboratorët dhe për qëllime analitike në Bashkimin Evropian sipas Rregullores (KE) Nr. 1005/2009 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian për substancat që hollojnë shtresën e ozonit. FZ L 139, 26.05.2011;
- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 537/2011 e datës 1 Qershor 2011 e mekanizmit për alokimin e sasive të kontrolluara të substancave të lejuara për përdorime laboratorike dhe analitike në Bashkimin Evropian nën Rregulloren (KE) Nr. 1005/2009 e Parlamentit dhe të Këshillit Evropian për substancat që hollojnë shtresën e ozonit. FZ L 147, 02.06.2011.

Gazet e Florinuara

- Rregullorja (KE) Nr. 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 17 Maj 2006, mbi krijimin e formatit për raportimin që duhet të dorëzohet nga prodhuesit, importuesit dhe eksportuesit e disa gazeve serrë të florinuara. FZ L 161, 14.06.2006;
- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 1493/2007 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 17 Dhjetor 2007 mbi krijimin, në përputhje me Rregulloren e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian Nr. 842/2006, mbi krijimin e formatit për raportimin që duhet të dorëzohet nga prodhuesit, importuesit dhe eksportuesit e disa gazeve serrë të florinuara. FZ L 161, 14.06.2006;
- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 1494/2007 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 17 Dhjetor 2007 mbi krijimin, në përputhje me Rregulloren e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian Nr. 842/2006, mbi formatin e etiketave dhe kërkesave shtesë të etiketimit për sa i përket produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara. FZ L 332, 18.12.2007;
- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 1494/2007 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 17 Dhjetor 2007 mbi krijimin, në përputhje me Rregulloren e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian Nr. 842/2006, mbi formatin e etiketave dhe kërkesave shtesë të etiketimit për sa i përket produkteve dhe pajisjeve që përmbajnë disa gazeve serrë të florinuara. FZ L 332, 18.12.2007;
- Rregullorja e Komisionit (KE) 1516/2007 e datës 19 Dhjetor 2007 mbi përcaktimin në përputhje me Rregulloren (KE) Nr 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës, mbi kërkesat standarde të kontrollit të rrjedhjeve për stacionet fikse ftohëse, kondicionimin e ajrit dhe pompat e nxehtësisë që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara. FZ L 335, 20.12.2007;

- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 303/2008 e datës 2 Prill 2008 mbi përcaktimin në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian mbi kërkesat dhe kushtet minimale për njohje të përbashkët për certifikimin e kompanive dhe personelit sa i përket për stacionet fikse ftohëse, kondicionimin e ajrit dhe pompat e nxehtësisë që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara. FZ L 92, 03.04.2008;
- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 304/2008 e datës 2 Prill 2008, mbi përcaktimin në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës, mbi kërkesat dhe kushtet minimale për njohje të përbashkët për certifikimin e kompanive dhe personelit sa i përket sistemeve të palëvizshme të mbrojtjes nga zjarri dhe shuarësve të zjarrit që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara. FZ L 92, 03.04.2008;
- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 305/2008 e datës 2 Prill 2008, mbi përcaktimin në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian, mbi kërkesat dhe kushtet minimale për njohje të përbashkët për certifikimin e kompanive dhe personelit për rikuperimin e disa gazeve serrë të florinuara nga kutia e shpejtësisë së tensionit të lartë. FZ L 92, 03.04.2008;
- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 306/2008, e datës 2 Prill 2008, mbi përcaktimin në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian, mbi kërkesat dhe kushtet minimale për njohje të përbashkët për certifikimin e kompanive dhe personelit për rikuperimin nga pajisjet, të disa tretësve me bazë disa gaze serrë të florinuara. FZ L 92, 03.04.2008;
- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 307/2008, e datës 2 Prill 2008, mbi përcaktimin në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian, mbi kërkesat për programet e trajnimit dhe kushtet për njohje të përbashkët të certifikimit të trajnimit për personelin përsa i përket sistemeve të kondicionimit të ajrit, në disa mjete motorike që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara. FZ L 92, 03.04.2008;
- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 308/2008, e datës 2 Prill 2008, mbi përcaktimin në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 842/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian, të formatit të njoftimit për trajnimet dhe programet e certifikimit të Vendeve Anëtare. FZ L 92, 3.4.2008.

Cilësia e Lëndës Djegëse

- Direktiva 98/70/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 13 Tetor 1998 në lidhje me cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe naftë dhe që amendon Direktivën e Këshillit 93/12/KEE. FZ L 350, 28.12.1998;
- Direktiva e Komisionit 2002/159/KE e datës 18 Shkurt 2002 mbi një format të përbashkët për dorëzimin e përmbledhjeve të të dhënave kombëtare mbi cilësinë e lëndës djegëse (të njoftuara në kuadër të dokumentit me numër C(2002) 508). FZ L 053, 23.02.2002;
- Direktiva 2009/30/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian që amendon Direktivën 98/70/KE përsa i përket specifikimeve të benzinës, naftës dhe gas-nafte dhe prezantimin e një mekanizmi për monitorimin dhe reduktimin e emetimeve të gazeve serrë dhe amendimin e

Direktivës së Këshillit 1999/32/KE për sa i përket specifikimit të lëndës djegëse të përdorur nga mjetet në brendësi të rrugëve ujore dhe shfuqizimin e Direktivës 93/12/KEE. FZ L 140, 05.06.2009;

Emetimet e CO2 nga Makinat dhe Furgonat

- Direktiva 1999/94/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 13 Dhjetor 1999 në lidhje me disponueshmërinë e informacionit të konsumatorit mbi ekonominë e lëndës djegëse dhe emetimet e CO2 në lidhje me tregtimin e makinave të reja të pasagjerëve. FZ L 237, 6.9.2000;
- Rregullore (KE) Nr. 443/2009 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 23 Prill 2009, që vendos standardet e performancës së emetimeve për makinat e reja të pasagjerëve si pjesë e përjasjes së integruar të Komunitetit për të reduktuar emetimet e CO2 nga makinat e lehta. FZ L 140, 05.06.2009;
- Rregullore e Komisionit (BE) Nr. 1014/2010 e datës 10 Nëntor 2010 mbi monitorimin dhe raportimin e të dhënave mbi regjistrimin e makinave të reja të pasagjerëve në përputhje me Rregulloren e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian (KE) Nr. 443/2009. FZ L 120, 01.05.2013;
- Rregullore e Komisionit (BE) Nr. 63/2011 e datës 26 Janar 2011, mbi përcaktimin e masave të detajuara për aplikimin për shmangien nga objektivat specifike të emetimeve të CO2 në përputhje me Nenin 11, të Rregullores së Parlamentit dhe e Këshillit Evropian (KE) Nr. 443/2009. FZ L 23, 27.01.2011;
- Rregullore (BE) Nr. 510/2011 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 11 Maj 2011, që vendos standardet e performancës së emetimeve për makinat e reja tregtare të lehta si pjesë e përjasjes së integruar e Bashkimit për të reduktuar emetimet e CO2 nga makinat e lehta. FZ L 145, 31.05.2011;
- Rregullorja e Zbatimit të Komisionit (BE) Nr. 725/2011 e datës 25 Korrik 2011, që vendos një procedurë për miratimin dhe certifikimin e teknologjive novatore për reduktimin e emetimeve të CO2 nga makinat e pasagjerëve, në përputhje me Rregulloren e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian (KE) 443/2009. FZ L 194, 26.07.2011;
- Vendimi i Komisionit 2012/100/BE i datës 17 Shkurt 2012 mbi metodën për grumbullimin e shpërblimeve për emisionet e tepërta të CO2 nga makinat e reja të pasagjerëve në përputhje me Rregulloren e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian (KE) Nr 443/2009; Teksti përkatës me EEA. FZ L 047, 18.2.2012;
- Rregullorja e Zbatimit të Komisionit (BE) Nr. 293/2012 e datës 3 Prill 2012 mbi monitorimin dhe raportimin e të dhënave mbi regjistrimin e makinave të reja të lehta tregtare në përputhje me Rregulloren e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian (KE) Nr. 510/2011. FZ L 98, 04.04.2012;

- Rregullorja e Zbatimit të Komisionit 2012/99/BE e datës 17 Shkurt 2012 mbi marrëveshjet e detajuara për grumbullimin e shpërblimeve për emisionet e tepërta të CO₂ nga makinat e reja të lehta tregtare në përputhje me Rregulloren e Parlamentit dhe Këshillit Evropian (BE) Nr. 510/2011; Teksti përkatës me EEA. FZ L 47, 18.02.2012;
- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 397/2013 e datës 30 Prill 2013 që amendon Rregulloren e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian (KE) Nr. 443/2009 për sa i përket monitorimit të emetimeve të CO₂ nga makinat e reja të pasagjerëve. FZ L 120, 01.05.2013;
- Rregullorja e Zbatimit të Komisionit (BE) Nr. 396/2013 e datës 30 Prill 2013 që amendon Rregulloren (BE) Nr. 1014/2010 për sa i përket disa kërkesave për monitorimin e emetimeve të CO₂ nga makinat e reja të pasagjerëve. FZ L 120, 01.05.2013.

Pyjet dhe Bujgësia

- Vendimi i Parlamentit dhe i Këshillit Evropian Nr. 529/2013/BE, e datës 21 Maj 2013 mbi rregullat e llogaritjes së emetimeve të gazeve serrë dhe heqjeve që rezultojnë nga aktivitetet që lidhen me përdorimin e tokës, ndryshimin e përdorimit të tokës dhe pyjet dhe mbi masat që lidhen me këto aktivitete. FZ L 165, 18.6.2013;

Kapja dhe Depozitimi i Karbonit

- Direktiva e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian 2009/31/KE e datës 23 Prill 2009 mbi depozitimin gjeologjik të dyoksidit të karbonit dhe që amendon Direktivën e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian 85/337/KEE, Direktivat e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian 2000/60/KE, 2001/80/KE, 2004/35/KE, 2006/12/EC, 2008/1/KE dhe Rregulloren (KE) Nr 1013/2006. FZ L 140, 05.06.2009;
- Direktiva e Komisionit 2010/670/BE e datës 3 Nëntor 2010 që përcakton kriteret dhe masat për financimin dhe projektet treguese tregtare që synojnë kapjen dhe depozitimin gjeologjik të sigurtë nga ana mjedisore të dyoksidit të karbonit si dhe projektet që tregojnë teknologjitë e reja të energjisë së rinovueshme në kuadër të skemës për tregtimin e emetimeve të lejuara të gazeve serrë brenda Komunitetit të përcaktuar nga Direktiva e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian 2003/87 (njoftuar në kuadër të dokumentit K(2010) 7499). FZ L 290, 06.11.2010.

Për Fushën e Menaxhimit të Mbetjeve:

- Direktiva 2008/98/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 19 Nëntor 2008 Mbi Mbetjet. FZ L 312, 22.11.2008, f. 3 - 30;
- Direktiva 86/278/EEC “Për mbrojtjen e mjedisit dhe veçanërisht të tokës, kur llumrat e ujërave të ndotura përdoren në bujqësi” ndryshuar nga Direktiva 91/692/EEC, Rregullorja (EC) 807/2003 dhe Rregullorja (EC) 219/2009. FZ L 181, 4.7.1986, f. 6;

- Direktiva 2006/66/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 6 Shtator 2006 “Për bateritë dhe akumulatorët, mbetjet nga bateritë dhe akumulatorët”, e amenduar nga Direktiva 2008/12/EC, nga Direktiva 2008/103/EC dhe Direktiva 2013/56/BE dhe Vendimet e Komisionit 2008/763/KE, 2009/603/KE, 2009/851/KE. FZ L 266, 26.09.2006, f. 1;
- Direktiva 94/62/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 20 Dhjetor 1994 “Për Ambalazhet dhe Mbetjet nga Ambalazhet”, e amenduar nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 219/2009 dhe Direktivat 2004/12/KE, 2005/20/KE dhe 2013/2/BE. FZ L 365, 31.12.1994;
- Direktiva 96/59/KE e datës 16 Shtator 1996 “Për asgjësimin e bifenileve të poliklorinuara dhe trifenileve të poliklorinuara (PCB/PCT)”, e amenduar nga Rregullorja (EC) 596/2009. FZ L 243, 24.09.1996, f. 31 - 35;
- Direktiva 2000/53/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 18 Shtator 2000 "Për automjetet në fund të jetës". FZ L 269, 21.10.2000, f. 34 - 43;
- Direktiva 2002/96/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 27 Janar 2003 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike (MPEE)”, e amenduar nga Direktiva 2003/108/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 8 Dhjetor 2003. FZ L 37, 13.02.2003, f. 24 - 39;
- Direktiva e Këshillit 1999/31/KE e 26 Prillit 1999 “Mbi landfillin e mbetjeve”, e amenduar nga Rregullorja (EC) 1882/2003 dhe (EC) 1137/2008 dhe Direktiva 2011/97/BE. FZ L 182/1, 16.7.1999, f. 1 - 19;
- Direktiva 2006/21/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 15 Mars 2006 “Për menaxhimin e mbetjeve nga industria nxjerrëse” që amendon Direktivën 2004/35/KE dhe Rregulloren 596/2009/KE, e amenduar nga Vendimet e Komisionit 2009/335/KE, 2009/337/KE, 2009/358/KE, 2009/359/KE dhe 2009/360/KE. FZ L 102, 11.04.2006, f. 15 – 34;
- Rregullorja 1257/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 20 Nëntor 2013 “Për riciklimin e anijeve” që amendon rregulloren 1013/2006 dhe direktivën 2009/16/KE. FZ L 330, 10.12.2013, f. 1 –20;
- Rregullorja 1013/2006 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 14 Qershor 2006 “Për transferimin e mbetjeve”, e amenduar nga Rregullorja 1379/2007/KE, 669/2008/KE, 219/2009/KE, 255/2013/BE dhe 308/2009/KE, 664/2011/BE dhe 135/2012/KE. FZ L 190, 12.07.2006, f. 1 – 98;
- Direktiva 2012/19/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 4 Korrik 2012 “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike (MPEE)”. FZ L 197, 24.07.2012, f. 38 – 71;
- Direktiva 2011/65/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 8 Qershor 2011 “Për kufizimin e përdorimit të substancave të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike”, e amenduar nga direktivat 2012/50/BE, 2012/51/BE, 2014/1/BE dhe 2014/16/BE. FZ L 174, 01.07.2011, f. 88 – 110.

Për Fushën e Cilësisë së Ujërave:

- Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 Tetor 2000 për krijimin e një kuadri në fushën e politikave të ujit, amenduar nga Vendimi 2455/2001/EC dhe Direktivat 2008/32/EC, 2008/105/EC, 2009/31/EC dhe 2013/39/BE. FZ L 327, 22.12.2000, f. 1 – 73;
- Direktiva e Këshillit 91/271/EEC e 21 Maj 1991 për trajtimin e ujerave të ndotur urbane, amenduar nga Direktiva 98/15/EC dhe Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 1137/2008. FZ. L 135, 30.05.1991, f. 40 – 52;
- Direktiva 2008/56/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 17 Qershor 2008 për krijimin e një kuadri në fushën e politikave mjedisore detare (direktiva për kuadrin e strategjisë detare). FZ L 164, 25.06.2008, f. 19 – 40;
- Direktiva e Këshillit 98/83/EC e 3 Nëntor 1998 për cilësinë e ujit të pijshëm, amenduar nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 596/2009. FZ L 330, 05.12.1998, f. 32 – 54;
- Direktiva e Këshillit 91/676/EEC e 12 Dhjetor 1991 për mbrojtjen e ujerave nga ndotja e shkaktuar nga nitratet e përdorura në bujqësi, amenduar nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 1137/2008. FZ L 375, 31.12.1991, f. 1 – 8;
- Direktiva 2006/7/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15 Shkurt 2006 për menaxhimin e cilësisë së ujerave të largës që shfuqizon Direktivën 76/160/EEC të amenduar me Rregulloren (EC) 596/2009. FZ.L 64, 04.03.2006, f. 37 – 51;
- Direktiva 2006/118/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 12 Dhjetor 2006 për mbrojtjen e ujerave nëntokësore nga ndotja dhe degradimi. FZ.L 372, 27.12.2006, f. 19 – 31;
- Direktiva 2013/39/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 12 Gusht 2013 që amendon Direktiva 2000/60/EC dhe 2008/105/EC për sa i përket substancave prioritare në fushën e politikave të ujit. FZ. L 226, 24.08.2013, f. 1 – 17;
- Direktiva 2009/90/EC e 31 Korrik 2009 që parashtrohet, në ndjekje të Direktivës 2000/60/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, specifikimet teknike për analizat kimike dhe monitorimin e statusit të ujit. FZ L 201, 01.08.2009, f. 36 – 38;
- Direktiva 2007/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 Tetor 2007 për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga përmytjet. FZ L 288, 06.11.2007, f. 27 – 34.

Për Fushën e Mbrojtjes së Natyrës:

- Direktiva 2009/147/EC e 30 Nëntorit 2009 “Për ruajtjen e shpendëve të egër” (versioni i konsoliduar). FZ L 20, 26.1.2010, f. 7 - 25;
- Direktiva 92/43/EEC e 21 Majit 1992 “Për ruajtjen e habitateve natyrore, florën dhe faunën e egër, të ndryshuar nga Direktiva 97/62/EC, Direktiva 2006/105/EC dhe Rregullorja (EC) 1882/2003. FZ L 206, 22.07.1992, f.7 – 50;
- Direktiva 1999/22/EC e 29 Marsit 1999 lidhur me mbajtjen e kafshëve në kopshtet zoologjike. FZ L 94, 9.4.1999, f.24 - 26;
- Rregullore EC/338/97 e 9 Dhjetorit 1996 për mbrojtjen e llojeve të faunës së egër duke rregulluar tregtinë e tyre. FZ L 61, 3.3.1997, f.1 - 69;

- Rregullore EEC/3254/91 e 4 Nëntorit 1991 që ndalon përdorimin e leqeve (kurtheve) në Komunitet dhe hyrjen në Komunitet të gëzofit dhe prodhimeve të disa llojesh të faunës së egër me origjinë nga vendet që i kapin ato duke përdorur metodat e kurtheve (leqeve) që nuk plotësojnë standardet njerëzore ndërkombëtare të zënies me kurthe (leqe). FZ L 308, 9.11.1991, f.1 – 4;
- Direktiva 83/129/EEC e 28 Marsit 1983 lidhur me importin në shtetet anëtare të lëkurës së disa llojeve të vegjlish të fokave dhe produkteve të derivuara prej tyre. FZ L 91, 9.4.1983, f.30;
- Rregullore e Këshillit 348/81/EEC e 20 Janarit 1981 për rregullat e përbashkëta për importin e balenave dhe produkteve të tjera të cetaceve dhe amendimet. FZ L 39, 12.2.1981.

Për fushën e Kontrollit të Ndotjes Industriale dhe Menaxhimit të Riskut:

- Direktiva 2008/1/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 15.01.2008 “Mbi kontrollin dhe parandalimin e integruar të ndotjes”, e ndryshuar. FZ L 24, 29.01.2008, f. 8 - 29, e ndryshuar nga Direktivat 2006/105/EC dhe 2009/31/EC (dhe do të zëvendësohet më 01.01.2016 nga Direktiva 2010/75/EU);
- Direktiva 2001/80/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23.10.2001 “Mbi kufizimin e shkarkimeve të disa ndotësve në ajër nga instalimet e mëdha me djegie”. FZ L 309, 27.11.2001, f. 1 – 21;
- Rregullore e EC/166/2006 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian mbi Regjistrin Evropian të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve. FZ L 33, 04.02.2006, f. 1 - 17, ndryshuar nga Direktivat e Këshillit 91/689/KEE dhe 96/61/KE;
- Rregullore (EC) 66/2010 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e 17 Korrikut 2000 mbi EU ECOLABEL. FZ L 27, 30.01.2010, f. 1 – 19;
- Rregullore (EC) 1221/2009 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e 25 Nëntorit 2009 mbi Pjesëmarrjen Vullnetare të Organizatave në Komunitetin e Eko-Menaxhimit dhe Skemat e Auditit (EMAS). FZ L 342, 22.12.2009, f. 1 – 45;
- Direktiva 96/82/KE e datës 9 Dhjetor 1996 “Për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që shkaktohen nga substanca të rrezikshme”, të amenduar nga Rregullorja EC/1882/2003, Direktiva 2003/105/EC dhe Rregullorja EC/1137/2008. FZ L 10, 14.01.1997, f. 13 - 33.

Për fushën e Organizmave të Modifikuara Gjenetikisht:

- Direktiva 2001/18/EC e 12 Marsit 2001 për lëshimin e kontrolluar në mjedis të Organizmave të Modifikuara Gjenetikisht. FZ L 106, 17.4.2001;
- Vendim 2002/811/EC i 3 Tetorit 2002 që vendos udhëzues për Aneksin shtesë VII të Direktivës 2001/18/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për lëshimin e kontrolluar në mjedis të Organizmave të Modifikuara Gjenetikisht dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 90/220/EEC. FZ L 280, 18.10.2002;

- Vendim i Komisionit 2002/813/EC i 3 Tetorit 2002, që vendos sipas Direktivës 2001/18/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, formatin për informacionin përmbledhës të lajmërimit, për lajmërimet që lidhen me lëshimin e kontrolluar në mjedis të OMGJ-ve për qëllime të tjera përveç hedhjes së tyre në treg. FZ L 280, 18.10.2002, f. 62 – 83;
- Vendim i Komisionit 2003/701/EC i 29 Shtatorit 2003 që vendos në vijim të Direktivës 2001/18/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit një format për paraqitjen e rezultateve të hedhjes së kontrolluar në mjedis të bimëve të larta të Modifikuara Gjenetikisht për qëllime përveç hedhjes së tyre në treg. FZ L 254, 8.10.2003, f.21-28;
- Rregullore 1830/2003 e 22 Shtatorit 2003 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit lidhur me gjurmueshmërinë dhe etiketimin e OMGJ-ve dhe gjurmueshmërinë e ushqimeve dhe produkteve ushqimore të prodhuara nga OMGJ dhe që amendon Direktivën 2001/18/EC. FZ L 268, 18.10.2003, f. 24 - 28.

Për fushën e Kimikateve:

- Rregullorja (KE) Nr. 1907/2006 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 18 Dhjetor 2006 në lidhje me Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH), krijimin e Agjencisë Evropiane të Kimikateve ECHA, që amendon Direktivën 1999/45/KE dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KEE) Nr. 793/93, si dhe Direktivën e Këshillit 76/769/KEE dhe Direktivat e Komisionit 91/155/KEE, 93/67/KEE, 93/105/KE dhe 2000/21/KE. FZ L 396/1, 30.12.2006;
- Rregullorja (KE) Nr. 1272/2008 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 16 Dhjetor 2008 mbi Klasifikimin, Etiketimin dhe Paketimin e Substancave dhe Përzierjeve, që amendon dhe shfuqizon Direktivat 67/548/KEE dhe 1999/45/KE, dhe amendon Rregulloren (KE) 1907/2006. FZ L 35, 31.12.2008;
- Rregullorja (KE) Nr. 1102/2008 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 22 Tetor 2008 mbi ndalimin e eksportit të merkurit metalik dhe të disa komponimeve dhe përzierjeve dhe depozitimin e sigurtë të merkurit metalik. FZ L 304, 14.12.2008;
- Direktiva e Këshillit 87/217/KEE e datës 19 Mars 1987 mbi parandalimin dhe reduktimin e ndotjes mjedisore nga asbesti siç amendohet nga Direktiva 91/692/KEE dhe Rregullorja (KE) 807/2003. FZ L 085, 28.3.1987;
- Direktiva 98/8/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 16 Shkurt 1998 në lidhje me hedhjen në treg të produkteve biocide siç është amenduar nga Rregullorja (KE) 1882/2003 dhe Direktivat 2006/50/KE, 2006/140/KE dhe 2009/151/KE. FZ L 123, 24.05.1998;
- Rregullorja (BE) Nr. 528/2012 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 22 Maj 2012 në lidhje me përdorimin dhe disponueshmërinë në treg të produkteve biocide, 528/2012. FZ L 167, 27.06.2012;
- Rregullorja (KE) Nr. 850/2004 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 29 Prill 2004 mbi ndotësit organik të qëndrueshëm dhe që amendon Direktivën 79/117/KEE dhe Rregulloret (KE) 1195/2006, (KE) 172/2007, (KE) 323/2007, (KE) 219/2009 dhe (KE) 304/2009. FZ L 158, 30.4.2004;

- Rregullorja (KE) Nr. 689/2008 e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 17 Qershor 2008 në lidhje me eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme (do të shfuqizohet nga 649/2012/BE). FZ L 204, 31.07.2008;
- Direktiva 2010/63/BE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 22 Shtator 2010 mbi mbrojtjen e kafshëve të përdorura për qëllime shkencore. FZ L 276, 20.10.2010.

Për fushën e Zhurmave:

- Direktiva 2002/49/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 25 Qershor 2002 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis”. FZ L 189, 18.07.2002.

Për fushën e Pyjeve:

- Direktiva e Këshillit 88/332/KEE 13 Qershor 1988 për amendimin e disa Direktivave mbi tregtimin e farave dhe shpërndarjen e tyre;
- Vendimi i Këshillit 89/367/KEE i 29 Majit 1989 për krijimin e Komitetit të Përhershëm të Pyjeve;
- Vendimi i Komisionit 96/653/EC i 11 Nëntorit 1996 i cili autorizon vendet anëtare për lejimin e përkohshëm të tregtimit të materialeve riprodhuese pyjore të cilat nuk përmbushin kërkesat e Direktivës së Këshillit 66/404/KEE dhe 71/161/KEE;
- Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 1460/98 e 8 Korrikut 1998 që amendon Rregulloren (KEE) Nr. 1170/93 që heq disa rregulla të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 2158/92 mbi mbrojtjen e pyjeve të vendeve Komunitare nga zjarri;
- Rregullorja (EC) Nr. 2152/2003 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës e 17 Nëntorit 2003 për monitorimin e pyjeve dhe ndërveprimin mjedisor në vendet Komunitare (Fokus Pyjet);
- Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 1737/2006 e 7 Nëntorit 2006 “Për heqjen e disa rregullave të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 2152/2003 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës për monitorimin e pyjeve dhe ndërveprimin mjedisor në vendet e Komunitetit”;
- Rregullorja (KE) Nr. 2152/2003 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 17 Nëntor 2003, lidhur me monitorimin e pyjeve dhe ndërveprimeve mjedisore në Komunitet (Kadri Pyjor), FZ L 324, 11.12.2003, f. 1 - 8, ndryshuar nga Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 1737/2006, e datës 7 Nëntor 2006, që përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e Rregullores së mësipërme;
- Rregullorja e Këshillit (KEE) Nr. 1615/89, 29 Maj 1989 për krijimin e Sistemit Evropian të Informacionit Pyjor dhe të Komunikimit (Efics), FZ L 165, 15.06.1989, f. 12 - 13, i ndryshuar me Rregulloret e Këshillit Nr. 400 / 94, të datës 21 Shkurt 1994 dhe Nr. 1100/98, të datës 25 Maj 1998;
- Rregullorja e Këshillit (KEE) Nr. 2158/92, 23 Korrik 1992 mbi mbrojtjen e pyjeve të Komunitetit nga zjarret, FZ L 217, 31.07.1992, f. 3 – 7, ndryshuar me Rregulloret e Komisionit (KEE dhe KE) Nr. 1170/93, të datës 13 Maj 1993, Nr. 1460/98, të datës 8 Korrik 1998, Nr. 1727/1999, të datës 28 Korrik 1999, Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 308/97, e datës 17 Shkurt 1997, dhe Rregulloret e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Nr. 1485/2001, të datës 27 Qershor 2001 dhe Nr. 805/2002, e datës 15 Shkurt 2002;

- Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 2173/2005, 20 Dhjetor 2005, mbi krijimin e një skeme lejesh FLEGT për importet e lëndës drusore në Komunitetin Evropian FZ L 92, 06.04.2011, f. 127 – 238, ndryshuar nga Rregullorja e Komisionit (KE) Nr. 1024/2008, 17 Tetor 2008, që përcakton masat e detajuara për zbatimin e Rregullores së mësipërme;
- Rregullorja Nr. 995/2010 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, 20 Tetor 2010, që formulon detyrimet e operatorëve, të cilët vendosin lëndën drusore dhe prodhimet e drurit në treg (Tekst me relevancë EEA), FZ L 295, 12.11.2010, f. 23 – 34, ndryshuar me Rregulloren e Komisioni për Zbatimin (BE) Nr. 607/2012, të datës 6 Korrik 2012 mbi rregullat e hollësishme lidhur me sistemin e kujdesit të duhur dhe frekuencën dhe natyrën e kontrolleve mbi organizatat monitoruese, siç parashikohet në Rregulloren e mësipërme.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Në fushën e **legjislacionit horizontal** është shënuar progres për sa i përket transpozimit të Direktivave të VNM-se dhe VSM-se, por nuk ka ndonjë progres për sa i përket direktivave të tjera. Transpozimi i Direktivës së VNM-se (2011/92/EU) ka përparuar se tepërmi duke arritur në 97 %, ndërkohë që po punohet për përafrimin e plote të saj. Gjithashtu, progres i rendesishëm shënohet edhe për sa i përket transpozimit të Direktivës së VSM-se, duke arritur në 86 %. Pjesa më e madhe e dispozitave të kësaj Direktive janë transpozuar me miratimin e Ligjit nr. 91/2013 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, në Shkurt 2013. Ky ligj, transponon Anekset dhe shumicën e dispozitave, si dhe siguron bazën ligjore për miratimin e legjislacionit dytësor. Transpozimi i plote i Direktivës mbi Aksesin në Informacion dhe asaj mbi Pjesëmarrjen e Publikut është arritur që në vitin 2012.

Në fushën e **cilësisë së ajrit**, Ligji i ri "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit" dhe projekt VKM "Mbi vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat në lidhje me disa ndotës" pritet të transpozojnë dispozitat e mbetura të Direktivës 2008/50/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e datës 21 Maj 2008 mbi cilësinë e ajrit të ambientit dhe për një ajër më të pastër për Evropën, duke arritur transpozimin e plotë të Direktivës.

Progres është arritur edhe në transpozimin e *acquis* në fushën e **menaxhimit të mbetjeve**. Transpozimi i Direktivës Kuadër të Mbetjeve ka arritur në masën rreth 95%.

Në këtë fushe progres shënohet edhe në transpozimin e Direktivës mbi Llumrat e Ujerave të Ndotura. Konkretisht, progresi ka të bëjë me VKM "Kërkesat për përdorimin në bujqësi të llumrave të ujërave të ndotura", e cila është dërguar për mendim në Ministrinë e Linjës. Kjo VKM do të transpozohet pjesën më të madhe të dispozitave të kësaj direktive.

Transpozimi i Direktivës të Bateritë ka përparuar për shkak të miratimit në Dhjetor 2012 të VKM-se "Mbi bateritë dhe akumulatorët dhe mbetjet e tyre". Niveli i transpozimit është i lartë duke arritur afërsisht 90 %. Megjithatë, legjislacioni kombëtar nuk ka transpozuar ende gjashtë dispozitat e mbetura të kësaj Direktive.

Transpozimi i Direktivës mbi Mbeturinat e Paketimeve ka përfunduar në vitin 2012, me miratimin Ligjit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, në Shtator 2011, si dhe VKM nr. 177/2012 "Për paketimin dhe mbeturinat e tyre", në Mars 2012.

Miratimi i VKM nr. 705/2012 "Për menaxhimin e automjeteve në fund të jetës", në Tetor 2012, ka përmirësuar dukshëm transpozimin e Direktivës përkatëse. Niveli i transpozimit ka arritur në 83%.

Niveli i transpozimit të Direktivës së re WEEE (2012/19/EU) është në fazë të hershme dhe shkalla e transpozimit prej 8% është rezultat i perputhshmërisë me Direktivën 2002/96/EC.

Transpozimi i Direktivës së Landfilleve është në shkallën 98 %. Vetëm dy dispozita të Direktivës (neni 2 dhe 14 (d)), mbeten për tu transpozuar në legjislacionin kombëtar. Progresi në transpozim është arritur nëpërmjet miratimit të VKM "Për landfillet e mbetjeve", në Korrik 2012.

Në fushën e **cilësisë së ujërave** progres është bërë në drejtim të transpozimit të Direktivës Kuadër të Ujit për shkak të miratimit të "Ligjit për menaxhimin e integruar të ujërave", në Nëntor 2012. "Ligji për Menaxhimin e Integruar të Ujërave", i cili u miratua në Nëntor 2012 ka transpozuar edhe disa dispozitave të Direktivës së Ujërave të Ndotur Urban.

Transpozimi i Direktivës së Ujit të Pijshëm është në fazë të avancuar, në shkallën 80%. Ndërsa transpozimi i Direktivës së Nitrateseve është në fazën fillestare, ku vetëm 4 dispozita të Direktivës janë transpozuar në legjislacionin kombëtar.

Direktiva e Ujërave të Larjes është transpozuar plotësisht me VKM nr. 797 "Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare "Për menaxhimin e cilësisë së ujërave të larjes", të miratuar në vitin 2010.

Në fushën e **mbrojtjes së natyrës**, transpozimi i dispozitave të mbetura të Direktivës së Shpendëve të Egër do të plotësohet pas anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Legjislacioni që transponon Direktivën e Shpendëve të Egër janë Ligji për Mbrojtjen e Faunës së Egër, Ligji për Gjuetinë, Ligji për Zonat e Mbrojtura dhe Urdhri i Ministrit për miratimin e listës së specieve që mund të gjuhen në Republikën e Shqipërisë.

Progres është shënuar edhe ne transpozimin e Direktivës se Habitave, e cila është ne shkallen 86%. Progresi ka ndodhur për shkak të draft ligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin "Për mbrojtjen e biodiversitetit" nr. 9587, date 20/07/2006". Transpozimi do të përfundojë pas hyrjes në BE .

Në fushën e **kontrollit të ndotjes industriale dhe menaxhimit të riskut**, transpozimi i Direktivës së Emetimeve Industriale mendohet të jetë rreth 44%, ku progresi kryesor është arritur në vitin 2011 nëpërmjet miratimit të disa akteve ligjore. Shumica e përkufizimeve të kësaj Direktive, të përcaktuara në Kapitullin I, janë transpozuar nga Ligji nr. 10448, date 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit". Lidhur me Kapitullin II, III, IV dhe V të kësaj Direktive, me rëndësi për transpozim është Ligji "Për Lejet e Mjedisit". Përveç ligjit "Për Lejet e Mjedisit", një akt tjetër i rëndësishëm për transpozimin e dispozitave të kësaj direktive që kanë të bëjnë me impiantet e incenerimit të mbetjeve dhe impiantet e co-incenerimit të mbetjeve, është VKM nr. 178, date 06.03.2012 "Për djegien e mbetjeve".

Transpozimi i plotë i *acquis* në fushën e **kimikateve** është planifikuar për vitin 2015.

Progres është shënuar edhe për sa i përket transpozimit të **Direktivës se Zhurmave Mjedisore**. Progres ky i arritur në Janar 2013 për shkak të miratimit të Udhëzimit nr. 2, date 7.01.2013 "Për treguesit, metodat e vlerësimit, rregullat dhe kërkesat teknike të metodologjisë për vlerësimin e nivelit të zhurmës, dhe për verifikimin e ndërhyrjeve të bëra për të zgjidhur dhe për të përmirësuar situatën". Megjithatë, ka ende disa dispozita që ende duhen transpozuar.

Ne fushën e **ndryshimeve klimatike**, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Vjenës dhe Protokollin e Montrealit, në Tetor 1999, si dhe është anëtare e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), që nga Janari 1995. Shqipëria ka përgatitur dy Komunikime Kombëtare në 2002 dhe 2009, si dhe ka finalizuar me sukses vetë vlerësimin për përgatitjen e Komunikimit të Tretë Kombëtar të UNFCCC.

Në dhjetor 2004, Qeveria Shqiptare ka ratifikuar Protokollin e Kiotos. Deri në vitin 2015, Qeveria Shqiptare ka planifikuar zbatimin e një sere aktiviteteve për adresimin e çështjes së ndryshimeve klimatike. Me 12 Dhjetor 2012, Ish-MMPAU, Ish-METE dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara, përmes USAID-it, kanë nënshkruar një "Memorandum Mirëkuptimi dhe deklaratën e bashkëpunimit për zhvillimin e kapaciteteve për zhvillimin e strategjive të emetimeve të ulëta (KE-LEDs)". Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit dhe Deklaratës së Bashkëpunimit është që përmes Programit të Rritjes Kapaciteteve për Strategjitë e Zhvillimeve të Ulëta të Emetimeve (KE-LEDs), të mbështesë përpjekjet e vendeve në zhvillim për të ndjekur zhvillimet afatgjata transformuese dhe të përshpejtojë rritjen e një ekonomie të qëndrueshme klimatike, duke ngadalësuar rritjen e emetimeve të gazrave serrë (GHG). KE-LEDs mbështet programet e zhvillimit, planet, politikat dhe plotëson përpjekjet e donatorëve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare për të mbështetur LEDS.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Për fushën e Legjislacionit Horizontal:

Ministria e Mjedisit (MM), është institucioni përgjegjës për hartimin dhe propozimin e politikave, strategjive, planeve dhe legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e mjedisit, Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe në fushën e informimit dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje mjedisore. MM dhe institucionet e saj të varësisë, konkretisht Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM), si dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (ISHMPU) kanë angazhimin për të garantuar zbatimin e tyre.

Përveç MM-së dhe institucioneve të varësisë, edhe ministritë e linjës janë përgjegjëse për të siguruar zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit dhe plotësimin e standardeve mjedisore, sigurimin e procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimit Strategjik Mjedisor, si dhe informimin e publikut dhe pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje me ndikim në mjedis, si Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Autoritetet vendore, Bashkitë dhe Komunat kanë një rol shumë të rëndësishëm në zbatimin e procedurës së Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe në përmbushjen e detyrimeve për informim dhe pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje mjedisore, veçanërisht për sa i përket proceseve që kërkojnë Vlerësim Strategjik Mjedisor për projekte të mëdha publike.

Për fushën e Cilësisë së Ajrit dhe Ndryshimeve Klimatike

Ministria e Mjedisit (MM), është institucioni përgjegjës për hartimin e politikave, strategjive, planeve dhe legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e cilësisë së ajrit nga ndotja.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), është organi qendror për menaxhimin e Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Cilësisë së Ajrit, nëpërmjet institucioneve të kontraktuara nga MM. AKM grumbullon, përpunon të dhënat e monitorimit dhe bën publike raportin e gjendjes së cilësisë së ajrit.

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave (ISHMPU), është autoriteti kompetent që kontrollon kushtet e lejes së mjedisit të aktiviteteve industriale dhe të ndërtimit lidhur me shkarkimet në ajër.

Gjithashtu, MM është institucioni që harton politikat kombëtare për Ndryshimet Klimatike dhe koordinon integrimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike në politikat sektoriale të bujqësisë, turizmit, shëndetësisë, energjisë, transportit, pyjeve, ujërave, etj. MM është përcaktuar si Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar (AKP) në kuadër të detyrimeve të vendit ndaj Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike dhe Protokollit të Kiotos, si dhe për ndjekjen e projekteve të Mekanizmit të Zhvillimit të Pastër.

Përveç Ministrisë së Mjedisit, përgjegjëse për fushën e Ajrit dhe Ndryshimeve Klimatike janë edhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, si dhe Ministria e Integritimit Evropian.

Për Fushën e Menaxhimit të Mbetjeve

Ministria e Mjedisit (MM), është institucioni kryesor i përfshirë në menaxhimin dhe hartimin e politikave në fushën e mbetjeve. Ministria e Mjedisit **(i)** Harton rregullat/ligjet për menaxhimin e mbetjeve për të gjitha fazat (ndarja, ripërdorimi, riciklimi, kompostimi, hedhja dhe djegia), **(ii)** Vlerëson dhe jep lejet për transitimin dhe për eksportin e mbetjeve, **(iii)** Vendos rregullat për monitorimin dhe inspektimin/kontrollin për zbatimin e akteve lidhur me mbetjet, si dhe **(iv)** Organizon dhe menaxhon regjistrat lidhur me çështje të ndryshme të mbetjeve.

Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit (MZHUT), zbaton politikat kombëtare dhe rajonale në planifikimin e territorit për depozitimin e mbetjeve të zonave urbane dhe rajonale përkatëse për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe për të arritur objektivat e brendshme, ministria përdor marrëdhëniet e ndërsjellta me ministrinë e linjës, institucionet e varësisë dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore (NJQV).

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI), në fushën e menaxhimit të mbetjeve të ngurta ka si mision të udhëheqë, të planifikojë, të koordinojë dhe të monitorojë aktivitetin e trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve të ngurta urbane dhe mbetjeve të ndërtimit në të gjitha fazat e zhvillimit, si projektimi, zbatimi i punimeve dhe shfrytëzimi i landfilleve rajonal dhe impianteve të incenerimit të mbetjeve urbane, duke përcaktuar rregullat, teknikat dhe metodat e trajtimit të tyre, në çdo fazë, duke përfshirë krijimin, ndarjen, grumbullimin, ruajtjen, transportin, riciklimin, trajtimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe në zvogëlimin e ndikimit të tyre.

Planifikimi dhe ndjekja e investimeve, bazuar në prioritetet e përfshira në PBA duke siguruar realizimin e studimeve, projekteve dhe implementimin e tyre për mbylljen e venddepozitimeve ekzistuese dhe ndërtimin e impianteve të reja të trajtimit të mbetjeve.

Sensibilizimi, koordinimi dhe bashkëpunimi me strukturat dhe institucionet përkatëse, donatorët dhe NjQV-të për të vënë në jetë parimet më të rëndësishme të metodave bashkëkohore të cituara në Planin Kombëtar “Parandalimi, pakësimi, riciklimi dhe me pas asgjësimi i mbeturinave”.

Hartimi i regjistrit vjetor të mbetjeve në rang bashkie, qarku apo vendi, me qëllim njohjen dhe vlerësimin e situatës mjedisore të shkaktuar nga mbetjet në vend. Përgatitja e raporteve të nevojshme për evidentimin e problemeve dhe rrugët e zgjidhjes.

Identifikimi i metodave të përshtatshme të trajtimit të mbetjeve të ngurta, duke bërë të mundur reduktimin e rreziqeve ndaj shëndetit të banorëve.

Ministria e Shëndetësisë (MSH), së bashku me Ministrinë e Mjedisit kanë përgjegjësi për të hartuar rregulloret për menaxhimin e mbetjeve spitalore. Spitalet dhe të gjithë gjeneruesit e mbetjeve shëndetësore kanë përgjegjësi të hartojnë dhe azhurnojnë planet e tyre të menaxhimit të mbetjeve, në përputhje me planet kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe planet e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI), së bashku me MM ka përgjegjësi për të hartuar rregulloret për mbetjet industriale dhe mbetjet minerare, si dhe në rehabilitimin e vendeve të hedhjes sipas specifikave të përmbajtjes së mbetjeve.

Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me MM ka për detyrë të hartojë rregulloret lidhur me mbetjet ushtarake.

Ministria e Financave (MF), në bashkëpunim me MM ka për detyrë të hartojë legjislacionin për taksat e ndryshme mjedisore.

Ministria e Financave harton rregullat mbi garancitë financiare për lejet mjedisore të vendeve të mbetjeve të rrezikshme, të cilat miratohen më vonë nga Këshilli i Ministrave.

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU), në bashkëpunim me MM ka për detyrë të hartojë rregulloret për mbetjet bujqësore dhe të kafshëve.

Për Fushën e Menaxhimit të Ujërave

Institucionet kryesore përgjegjëse për menaxhimin e ujërave në Republikën e Shqipërisë janë Ministria e Mjedisit dhe institucionet e varësisë së saj, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit

Rural dhe Administrimit të Ujerave, institucionet e varësisë së tyre, si dhe Njësitet e Qeverisjes Vendore, Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU), është organi qendror vendimmarrës, përgjegjës për administrimin e burimeve ujore. KKU është organ ndërmënytor që kryesohet nga Kryeministri dhe trajton çështjet e administrimit dhe menaxhimit të integruar të burimeve ujore. KKU përbëhet nga MM, MBZHRAU, MTI, MEI, MSH, MPB, MZHUT, MZHETS, si dhe MF.

KKU ofron kështu një forum të nivelit shumë të lartë brenda të cilit çështjet e planifikimit dhe administrimit të rezervave ujore mund të diskutohen në një mënyrë të integruar.

Ministria e Mjedisit, është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave, strategjive, planeve kombëtare dhe legjislacionit për mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja, shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore, përmirësimin e mjedisit ujor, mbrojtjen e ujerave sipërfaqësore të brendshme, ujerave të përkohshme, ujerave bregdetare, dhe atyre nëntokësore, si dhe statusin e tyre.

Drejtoria e Burimeve Ujore (Sekretariati Teknik pranë Ministrisë së Mjedisit) është organ ekzekutiv i KKU-së dhe përbëhet nga dy sektorë të saj:

- Sektori i Politikave të Burimeve Ujore (1 + 3);
- Sektori i Kadastrës dhe Sekretariatit Teknik të Ujit (1 + 2)

Këshillat e Baseneve Ujore (KBU), janë autoritetet lokale përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore në basenat përkatëse. KBU-të drejtohen nga Prefekti.

Agjencitë e Baseneve Ujore (ABU), janë struktura në varësi të Ministrisë së Mjedisit, të cilat funksionojnë në çdo basen ujor të krijuar nga KKU-ja. Në Republikën e Shqipërisë ekzistojnë gjithsej 6 ABU, të cilat janë përgjegjëse për:

- Hartimin e inventarit të burimeve ujore në sasi dhe cilësi, si dhe përditësimin periodik të tij;
- Përgatitjen e raporteve, dhënie opinione për burimet ujore dhe paraqitjen e tyre për ndjekje të mëtejshme në KBU;
- Përgatitjen e materialeve për mbledhjet e KBU-së.

MBZHRAU administron infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit, por jo rezervën ujore.

MTI menaxhon infrastrukturën e sistemeve të ujësjellës kanalizimeve, por jo rezervën ujore.

MSH administron cilësinë e ujit të pijshëm nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik (ISHP), por jo rezervën ujore.

MEI menaxhon infrastrukturën e hidrocentraleve, por jo rezervën ujore që përdoret për prodhim energjie.

MPB ka nën varësi të saj Drejtorinë e Emergjencave Civile dhe koordinon punën për infrastrukturën e ndërhyrjes së emergjencave civile, por jo rezervën ujore.

MZHUT menaxhon infrastrukturën urbane dhe përdorimin e ujerave për qëllime turistike, por nuk menaxhon rezervën ujore.

MZHETS është përgjegjëse për analizat ekonomike dhe për investimet në fushën e burimeve ujore.

MF është përgjegjëse për shpërndarjen e financimeve për sektorin e ujerave.

Për fushën e Mbrojtjes së Natyrës:

Ministria e Mjedisit, nëpërmjet Drejtorisë së Biodiversitetit dhe Zonave të Mbrojtura në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Mjedisore dhe Jetësimi të Prioriteteve, mbulon çështjet e lidhura me hartimin e politikave për mbrojtjen e natyrës, si dhe hartimin e dokumenteve strategjik në këtë fushë.

Bashkëpunimi shtrihet dhe me Drejtoritë e tjera të Ministrisë dhe me institucionet zbatuese:

- Agjencinë Kombëtare të Mjedisit;
- Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Pyjor;
- Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave

Në fushën e mbrojtjes së natyrës, Ministria e Mjedisit bashkëpunon me Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për biodiversitetin bujqësor, Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit për bashkëpunimin në vendim-marrjen për përdorimin e territorit, Ministrinë e Punëve të Brendshme për bashkërendimin e punës për menaxhimin e aktivitetit të gjuetisë sportive dhe turistike, Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore për menaxhimin e burimeve natyrore lokale në pronësi komunale, si dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për kontrollin doganor të tregtimit ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër.

Për fushën e Kontrollit të Ndotjes Industriale dhe Menaxhimit të Riskut:

Ministria e Mjedisit (MM), është institucioni përgjegjës për hartimin dhe propozimin e politikave, strategjive, planeve dhe legjislacionit kombëtar për parandalimin e ndotjes industriale dhe minimizimin e saj. Përkatësisht **Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)**, **Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM)** dhe **Inspektoratin Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave**, janë institucionet e varësisë së Ministrisë së Mjedisit që janë përgjegjëse për procedurën e lëshimit të lejeve të mjedisit për instalimet industrial, si dhe për monitorimin e zbatimit të kushteve të lejeve të mjedisit.

Përveç MM-së dhe institucioneve të varësisë, edhe **ministritë e linjës** janë përgjegjëse për të siguruar zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes industriale, sigurimin e procesit të lëshimit të lejeve të mjedisit, si dhe informimin e publikut dhe pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje për lejet e mjedisit. Këtu mund të përmendim **Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë**, **Ministrinë e Shëndetësisë**, **Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit**, **Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës**, **Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes**, si dhe **Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave**.

Autoritetet vendore, bashkitë dhe komunat kanë një rol shumë të rëndësishëm në zbatimin e procedurës së lëshimit të lejeve të mjedisit për instalimet industriale dhe në përmbushjen e detyrimeve për informim dhe pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje.

MM është përgjegjëse edhe për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, rregulloreve dhe strategjive për fushën e aksidenteve industriale. Gjithashtu, MM bën edhe vlerësimin e efekteve të aksidenteve mbi mjedisin. **Ministritë e Linjës** të cilat trajtojnë kimikatet apo substanca të rrezikshme janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit.

Për fushën e Organizmave të Modifikuara Gjenetiki:

Si një fushë ndërtematike, nuk ka struktura të përcaktuara me ligj për OMGJ-të. Ndërkohë, në kuadër të zbatimit të Protokollit të Kartagenas për Biosigurinë të Konventës së Biodiversitetit (CBD) janë identifikuar aktorët kryesorë. Në këtë kontekst kjo fushë kërkon kontributin e të gjithë aktorëve kryesorë të përcaktuar dhe bashkërendimin e punës ndërmjet tyre.

Institucionet kryesore janë Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për mbjelljet, ushqimet dhe tregtimin, **Ministria e Mjedisit** për introduktimin e kontrolluar në mjedis, duke përfshirë vendosjen dhe mënyrat e sistemit të lajmërimit (notifikimit) midis shteteve Palë të Protokollit të Biosigurisë.

Në nivel kombëtar në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”, u krijua **Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)** në varësi të MBZHRAU me VKM nr. 1081, datë 21.10.2009 “Për organizmin dhe funksionimin e AKU-së”. Ndërmjet detyrave të AKU-së përcaktohet se “Drejton procesin e vlerësimit të riskut në fushën e ushqimit dhe ushqimeve për kafshë”.

Aktorë të tjerë për politikat janë Ministria e Shëndetësisë për mikroorganizmat në gjendje të mbyllur dhe ndikimet në shëndetin e njeriut dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit për zhvillimin e bioteknologjisë. **Drejtoria e Përgjithshme e Doganave** për zbatimin e Protokollit të Biosigurisë lidhur me lëvizjet ndërkufitare të OMGJ-ve.

Në kuadër të reformës së institucioneve kërkimore shkencore është krijuar **Departamenti i Bioteknologjisë pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës**, i cili në bashkëpunim me institucione të tjera në varësi të Ministrive të përmendura më lart dhe me Akademinë e Shkencave janë të rëndësishëm për kryerjen e procedurës së vlerësimit të rrezikut të OMGJ -së.

Për fushën e Kimikateve

Çështjet e menaxhimit të kimikateve janë detyrë e disa institucioneve, përkatësisht e **Ministrisë së Mjedisit (MM)**, **Ministrisë së Shëndetësisë (MSH)**, **Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI)**, **Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU)**, **Ministrisë së Mbrojtjes**, **Ministrisë së Transporteve dhe Infrastrukturës (MTI)**, **Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR)**, si dhe **Ministrisë së Financave (MF)**.

Në varësi të llojit të substancave dhe preparateve kimike, Ministria përkatëse licencon aktivitetet e menaxhimit, importit dhe eksportit të substancave dhe preparateve të rrezikshme.

MM, është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit të kimikateve dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të riskut në mjedis, krijimin e Regjistrit Kombëtar të Kimikateve, dhe inspektimin e aktiviteteve që menaxhojnë kimikatet. ISHMPU kontrollon administrimin e kimikateve në aktivitetet e pajisura me leje mjedisore.

MSH, është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit të biocideve, përcaktimin e procedurave të vlerësimit të riskut në shëndet, autorizimin e importit dhe përdorimit të biocideve. Kontrolli i menaxhimit të biocideve kryhet nga Inspektorati Sanitar Shtetëror.

MEI, është përgjegjëse për kimikatet si lëndë e parë për industrinë, import-eksportin dhe kontrollin e kimikateve të konsumit.

MBZHRAU, është përgjegjëse për lejet e prodhimit dhe të importimit të produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe plehrave kimike, vlerësimin, testimin, administrimin dhe kontrollin e tyre. Importi dhe eksporti i tyre kontrollohen nga kjo ministri, përmes **Agjencisë Kombëtare të Ushqimit (AKU)**. Në kontrollin e PMB-ve janë të angazhuar institutet kërkimore në varësi të MBZHRAU, si **Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV)**, si dhe **Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB)**. Gjithashtu, kjo ministri mbulon direktivat që lidhen me produktet e mbrojtjes së bimëve dhe përdorimet në bujqësi, si dhe për mbrojtjen e kafshëve të laboratorit.

MMSR, ka përcaktuar punët e vështira ose të rrezikshme, si dhe listën e substancave të rrezikshme, me qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe sigurimin në punë nga përdorimi i tyre. Inspektorati Shtetëror i Punës në vartësi të kësaj ministrie dhe në bashkëpunim me inspektoratet e tjera të shtetit koordinojnë punën për të siguruar zbatimin e legjislacionit të punës nga punëdhënësit dhe personat e siguruar prej tyre.

MTI, përgjigjet për transportin e mallrave të rrezikshme. Ajo lëshon lejen për automjetet që transportojnë mallrat e rrezikshme, bën kontrollin teknik dhe bashkërisht me Ministrinë e Punëve të Brendshme i shoqëron këto mallra deri në destinacion brenda vendit. Transporti i lëndëve eksplozive të importit sigurohet me mjetet dhe personelin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Ministria e Mbrojtjes, jep lejet dhe ka përgjegjësinë kryesore për importin, eksportin, testimin e lëndëve eksplozive dhe transportin e lëndëve kimike të rrezikshme. **Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksportit (AKSHE)** pajis me licencë importi, eksporti, transiti, me autorizim, me certifikatë ndërkombëtare importi, certifikatën e përdoruesit të fundit, certifikatë shpërndarjeje dhe certifikatë doganore, të mbërritjes së mallit në destinacion, subjekte fizike ose juridike, që kryejnë transferime ndërkombëtare të mallrave ushtarake, mallrave me përdorim të dyfishtë, si dhe të teknologjive të tyre.

MF, autoritetet doganore regjistrojnë ngarkesën me substanca dhe preparate të rrezikshme, që kalon kufirin shtetëror, si dhe kontrollojnë dokumentacionin shoqërues sipas legjislacionit në fuqi.

Për fushën e Pyjeve:

Ministria e Mjedisit (MM) dhe institucionet e varësisë, janë institucionet përgjegjëse për hartimin e politikave, strategjive, planeve dhe legjislacionit kombëtar për mbrojtjen e pyjeve.

Njësitë e Qeverisjes Vendore janë përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave të transferuara.

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të ligjshmërisë në fondin pyjor kullosor.

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

Tavanet e Shpenzimeve të Ministrisë së Mjedisit për periudhën 2014 – 2020, janë si më poshtë vijon:

(në milion Lek)

	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	Totali
Kosto Totale	2,458.85	2,001.00	2,019.00	1,889.00	2,600.00	2,740.00	2,800.00	16,508
Buxheti i Shtetit	1,911.73	1,501.00	1,519.00	1,389.00	1,900.00	2,000.00	2,100.00	12,320.73
Asistenca e Huaj	547.13	500.00	500.00	500.00	700.00	740.00	700.00	4,187.13

III. Prioritetet

Për sa i përket mjedisit, në fushën e **legjislacionit horizontal**, disa nga prioritetet kryesore kane te bëjnë me **(i)** përafrimin e plote te Ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe Ligjit “Për lejet mjedisore” me Direktivën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, **(ii)** forcimin e zbatimit te legjislacionit mjedisor, si dhe **(iii)** garantimin siç duhet te informimit dhe pjesëmarrjes se publikut në vendimmarrje.

Miratimi i projektligjit për **cilësinë e ajrit** dhe aktet nënligjore për vlerësimin e cilësisë së ajrit dhe kriteret për disa ndotës të caktuar, si dhe përafrimi i plote i legjislacionit te BE-se, janë disa nga prioritetet kryesore ne këtë fushe. Gjithashtu, me qellim përmirësimin e cilësisë se ajrit, si prioritet te Ministrisë se Mjedisit janë edhe **(i)** hartimi i planit kombëtar dhe planeve lokale te veprimit për përmirësimin e cilësisë se ajrit te mjedisit, **(ii)** forcimi i sistemit kombëtar te monitorimit te ajrit urban dhe shkarkimeve ne ajër sipas standardeve evropiane, si dhe **(iii)** forcimi i bashkëpunimit me institucionet e linjës për integrimin e politikave te cilësisë se ajrit ne strategjitë sektoriale te tyre.

Megjithëse, janë miratuar aktet nënligjore për **menaxhimin e mbetjeve**, si dhe janë përgatitur planet e menaxhimit për Tiranën, Lezhën dhe Shkodrën, përmirësimi i menaxhimit te integruar mbetjeve vazhdon të jetë një nga prioritetet kryesore te punës se Ministrisë se Mjedisit. Ndarja e mbetjeve ne burim, rritja e nivelit te riciklimit, forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e mbetjeve, asimilimi i plote i hedhjes se mbetjeve ne vendgrumbullime të pasigurta dhe asimilimi i plote i djegies se mbetjeve, ndërtimi i landfillleve sipas standardeve te BE-së, sigurimi i faciliteteve për mbetjet e rrezikshme, mjekësore ose ndërtimore, si dhe sigurimi i investimeve te reja për sa i përket ndarjes dhe riciklimit te mbetjeve, janë disa nga prioritetet kryesore ne këtë fushe.

Në fushën e ***cilësisë së ujit***, Ministria e Mjedisit ka si prioritet të punës së saj **(i)** përmirësimin e kuadrit ligjor nëpërmjet hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 111/2012, **(ii)** vlerësimin e shkallës së dëmtimit të baseneve të lumenjve si rezultat i aktiviteteve të subjekteve që shfrytëzojnë inertet lumore dhe ndërmarrja e masave ndëshkuese, **(iii)** krijimi i regjistrit kombëtar të burimeve ujore, si dhe **(iv)** përmirësimi i menaxhimit të burimeve ujore në nivel baseni dhe kombëtar nëpërmjet hartimit të strategjisë kombëtare të menaxhimit të integruar të burimeve ujore, hartimit të 2 planeve të menaxhimit të baseneve të lumenjve (Drin-Bunë dhe Seman) dhe krijimit të kadastrës elektronike kombëtare të burimeve ujore.

Në fushën e ***mbrojtjes së natyrës***, do të punohet për të garantuar **(i)** mbrojtjen e zonave të mbrojtura, **(ii)** zbatimin e rregullave të miratuara në vitin 2011 për ngritjen e zonave të mbrojtjes së veçantë në kuadrin e Fatura 2000, **(iii)** marrjen e masave për ndalimin e veprimtarive të paligjshme si gjuetia, prerja e drurëve dhe ndërtimet pa leje në zonat e mbrojtura, si dhe **(iv)** forcimin e kapaciteteve administrative të inspektoratit për goditjen e këtyre fenomeneve.

Për sa i përket ***politikave për zhurmën në mjedis***, një nga prioritetet kryesore në këtë fushe është forcimi i zbatimit të vendimeve të task forcës së ngritur për ndotjen akustike në qendrat urbane dhe zonat turistike bregdetare.

Në fushën e ***kimikateve***, dy nga prioritetet e Ministrisë së Mjedisit janë përafrimi i plote legjislationit të BE-së në këtë fushe dhe zbatimi i këtij legjislationi, si dhe ngritja e sistemit kombëtar të menaxhimit të integruar të kimikateve.

Për sa i përket ***ndryshimeve klimatike***, përafrimi i plote me legjislationin e BE-së, hartimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit Kombëtar të Veprimtari për Ndryshimet Klimatike, ngritja e sistemit kombëtar të inventarëve të shkarkimeve në ajër dhe të gazeve me efekt serra, si dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet e linjës për integrimin e politikave të ndryshimeve klimatike në strategjitë e tyre sektoriale, janë disa nga prioritetet në këtë fushe.

Në fushën e ***pyjeve***, prioritetet e Ministrisë së Mjedisit kanë të bëjnë me **(i)** përafrimin e plote të legjislationit kombëtar me atë të BE-së në këtë fushe, **(ii)** hartimin e një Strategjie të Re 10-vjeçare për Pyjet dhe Kullotat, si dhe **(iii)** Inventarin Kombëtar të Pyjeve.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2014 – 2016

IV.1 Legjislacioni horizontal

IV.1.1 Kuadri i Politikave Ekzistuese

Titulli (Strategji, Plane Veprimi ose Dokumente Politik)	Institucioni Lider	Periudha e Referuar
Strategjia Kombëtare e Mjedisit	Ministria e Mjedisit	2007 – 2012

IV.1.2 Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Legjislacioni i BE-së	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni Lider	Niveli i Përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e Miratimit (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në Fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2004/35/KE	Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”	Ministria e Mjedisit	I plotë	09.06.2011	Janar 2013
Direktiva 2001/42/KE	Ligji nr. 91, datë 28.02.2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)”	Ministria e Mjedisit	I plotë	28.02.2013	Mars 2013
Direktive 2011/92/EU	Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM)”	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	07.07.2011	Shkurt 2013
Direktiva 92/2011/KEE	VKM nr. 13, datë 4.1.2013 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM)”	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	04.01.2013	Janar 2013
Direktiva	Ligji nr. 10431, datë	Ministria e Mjedisit	Përafrim i plotë	09.06.2011	Janar 2013

2003/35/KE	09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”; Ligji nr. 8672, datë 26.10.2000 “Për Ratifikimin e Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’i drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”; VKM nr. 994, datë 02.07.2008 “Për tërheqjen e publikut në vendimmarrje për mjedisin”; Urdhri i Ministrit nr. 1, datë 03.03.2009 “ Për detyrat e organeve mjedisore për të siguruar pjesëmarrjen e publikut dhe të OJF-ve mjedisore në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis”			26.10.2000 2.07.2008 3.03.2009	Nëntor 2000 Korrik 2008 Mars 2009
Direktiva 2003 /4/KE	Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”; Ligji nr. 8672 datë 26.10.2000 “Për Ratifikimin e Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë	Ministria e Mjedisit	Përafrim i plotë	09.06.2011 26.10.2000	Janar 2013 Nëntor 2000

	pjesë në vendimarrje dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit"; Ligji nr. 8053, datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumente zyrtarë"; VKM nr. 16, datë 04.01.2012 "Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor"			30.06.1999 4.01.2012	Korrik 1999 Shkurt 2012
--	---	--	--	------------------------------------	---------------------------------------

IV.1.3 Kuadri i Politikave të Planifikuara për Periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji, Plane Veprimi ose Dokumente Politik)	Institucioni Lider	Periudha e Referuar	Data e Miratimit	Hyrja në fuqi
Strategjia Sektoriale e Mjedisit	Ministria e Mjedisit	2014 - 2020	2014	Pas botimit në Fletoren Zyrtare
Metodologjia Kombëtare të Procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis	Ministria e Mjedisit	2014 – në vazhdim	Tremujori 4, 2014	Pas botimit në Fletoren Zyrtare
Metodika Kombëtare e Vlerësimit Strategjik Mjedisor	Ministria e Mjedisit	2015 – në vazhdim	Tremujori 4, 2015	Pas botimit në Fletoren Zyrtare

IV.1.4 Masat Ligjore të Parashikuara për Periudhën 2014 – 2016

Legjislacioni i BE-së	Status i Përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i Përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe Pika e Kontaktit	Niveli i Synuar i Përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e Planifikuar për Miratim	Hyrja në Fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
Direktive 2011/92/EU	Po	Ligj i ri “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i cili do të shfuqizojë Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM)” dhe VKM nr. 13, datë 4.1.2013 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjëseve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM)”	Jo	Ministria e Mjedisit	I plotë	Tremujori 3, 2014	15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare
	Po	VKM “Për miratimin e rregullave, afateve dhe përgjegjëseve	Jo	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	Tremujori 2, 2014	Pas botimit në Fletoren Zyrtare

	Jo	për informimin dhe pjesëmarrjen e publikut gjatë procesit VNM”; VKM “Për miratimin e rregullave dhe procedurës për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkufitar”	Jo	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	Tremujori 4, 2014	Pas botimit në Fletoren Zyrtare
Direktiva 2001/42/KE	Jo	VKM “Për rregullat e procedurat për konsultimin me grupet e interesit dhe publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit (VSM)”	Jo	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	Tremujori 4, 2014	Pas botimit në Fletoren Zyrtare
<u>AFAT MESEM (2015 – 2016)</u>							
Direktiva 2001/42/KE	Jo	VKM “Për rregullat, përgjegjësitë dhe procedurat e detajuara për VSM-në në kontekstin ndërkufitar”	Jo	Ministria e Mjedisit	I pjesshëm	Tremujori 4, 2015	Pas botimit në Fletoren Zyrtare

IV.2 Cilësia e ajrit dhe ndryshimet klimaterike

IV.2.1 Kuadri i Politikave Ekzistuese

Titulli (Strategji, Plane Veprimi ose Dokumente Politik)	Institucioni Lider	Periudha e Referuar
Dokument Politikash për Adaptim ndaj Ndryshimeve Klimatike në Deltat e Lumenjve Drini-Mati dhe më tej	Ministria e Mjedisit	2013 - 2020
Strategjia për Përshtatjen e Sistemit Shëndetësor ndaj Ndryshimeve të Klimës	Ministria e Shëndetësisë	2011 - 2021
Plani i Administrimit për Heqjen nga Përdorimi të Hidroklorfluorokarboneve	Ministria e Mjedisit	2011 - 2040

IV.2.2 Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Legjislacioni i BE-së	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni Lider	Niveli i Përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e Miratimit (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në Fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 96/62/EC	Ligji nr. 10266, datë 15.04.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8897, datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”	Ministria e Mjedisit	I Pjesshëm	15.04.2010	15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare
Direktiva • 1999/32/EC	VKM nr. 781, datë 14.11.2012 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme të lëngshme për përdorim termik civil dhe industrial, si dhe për përdorim në mjetet e	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I Plotë	14.11.2012	Pas botimit në Fletoren Zyrtare

	transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”				
Direktiva 98/70/EC	• VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, e cila përcakton standardet dhe specifikime teknike në lidhje me kushtet shëndetësore dhe mjedisore për lëndët djegëse që duhet të përdoren për automjetet; •	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I Plotë	21.03.2007	Pas botimit në Fletoren Zyrtare
Direktiva • 2000/71/EC	• VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, e cila përcakton standardet dhe specifikime teknike në lidhje me kushtet shëndetësore dhe mjedisore për lëndët djegëse që duhet të përdoren për automjetet; Urdhër i Përbashkët nr. 6, datë 09.10.2007 “Për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për cilësinë e lëndëve djegëse”.	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I Plotë	21.03.2007	Pas botimit në Fletoren Zyrtare

• Direktiva • 2003/17/EC Rregullore 1882/EC	• VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel”, e cila përcakton standardet dhe specifikime teknike në lidhje me kushtet shëndetësore dhe mjedisore për lëndët djegëse që duhet të përdoren për automjetet;	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I Plotë	21.03.2007	Pas botimit në Fletoren Zyrtare
	Urdhër i Përbashkët nr. 6, datë 09.10.2007 “Për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për cilësinë e lëndëve djegëse”.	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	I Plotë	21.03.2007	Pas botimit në Fletoren Zyrtare

IV.2.3 Kuadri i Politikave të Planifikuara për Periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji, Plane Veprimi ose Dokumente Politik)	Institucioni Lider	Periudha e Referuar	Data e Miratimit	Hyrja në fuqi
Strategjia Kombëtare e Cilësisë së Ajrit të Mjedisit	Ministria e Mjedisit	2015 - 2025	Tremujori 2, 2014	1.01.2015
Strategji Kombëtare dhe Plan	Ministria e Mjedisit	2015 - 2030	Tremujori 4, 2015	Pas botimit në Fletoren Zyrtare

Kombëtar i Veprimit për Ndryshimet Klimatike				
Plani Kombëtar për Adaptim ndaj Ndryshimeve Klimatike	Ministria e Mjedisit	2015 - 2025	Tremujori 4, 2015	Pas botimit në Fletoren Zyrtare
Plani Kombëtar i Cilësisë së Ajrit	Ministria e Mjedisit	2017 - 2022	Tremujori 4, 2016	Pas botimit në Fletoren Zyrtare

IV.2.4 Masat Ligjore të Parashikuara për Periudhën 2014 – 2016

Legjislacioni i BE-së	Status i Përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i Përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe Pika e Kontaktit	Niveli i Synuar i Përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e Planifikuar për Miratim	Hyrja në Fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
Direktiva 2008/50/KE	Po	Ligji “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit”;	Po	Ministria e Mjedisit	Plotë	Tremujori 3, 2014	3 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare
		VKM “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të”;	Po	Ministria e Mjedisit	Plotë	Tremujori 3, 2014	3 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare

		VKM “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit”				Tremujori 3, 2014	15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare
Direktiva 2004/107/KE	Po	Ligji “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit të mjedisit”;	Po	Ministria e Mjedisit	Plotë	Tremujori 3, 2014	3 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare
		VKM “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të”	Po	Ministria e Mjedisit	Plotë	Tremujori 3, 2014	3 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare
		VKM “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Cilësisë së Ajrit”	Po	Ministria e Mjedisit	Plotë	Tremujori 3, 2014	15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare
Rregullore 842/2006	Po	VKM “Mbi parandalimin dhe reduktimin e emisioneve të gazeve serrë të florinuara”	Jo	Ministria e Mjedisit	Plotësisht	Tremujori 3, 2014	2 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare
Rregullore 1493/2007	Po	VKM “Mbi parandalimin dhe reduktimin e emisioneve të gazeve serrë të florinuara”	Jo	Ministria e Mjedisit	Plotësisht	Tremujori 3, 2014	2 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare

Rregullore 1494/2007	Po	VKM “Mbi parandalimin dhe reduktimin e emisioneve të gazeve serrë të florinuara”	Jo	Ministria e Mjedisit	Plotësisht	Tremujori 3, 2014	2 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare
<u>AFAT MESEM (2015 – 2016)</u>							
Direktive 2010/75/EU Vendimi 2000/541/KE	Jo	VKM “Mbi masat për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa aktivitete dhe instalime”	Po	Ministria e Mjedisit	Plotësisht	Tremujori 4, 2015	3 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare
Direktiva 2004/42/KE	Jo	VKM “Mbi masat për kufizimin e përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i përbërësve organikë në disa bojëra, llaqe dhe produkte për lustrimin e automjeteve”	Po	Ministria e Mjedisit	Plotësisht	Tremujori 4, 2015	3 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare
Direktiva 94/63/KE	Jo	VKM “Mbi masat për kontrollin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC) që rezultojnë nga magazinimi i benzinës dhe	Po	Ministria e Mjedisit	Plotësisht	Tremujori 4, 2015	3 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare

		shpërndarjes së saj nga терминаlet në pikat e shitjes”					
Direktiva 2009/126/KE	Jo	VKM “Mbi kapjen e avujve të benzinës në fazën II gjatë rimbushjes së automjeteve në pikat e shitjes”.	Po	Ministria e Mjedisit	Plotësisht	Tremujori 4, 2015	3 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare
Rregullore 1497/2007	Jo	Urdhër i Përbashkët i Ministrave “Mbi kërkesat standarde të kontrollit të rrjedhjeve nga pajisjet që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara”	Jo	Ministria e Mjedisit	Plotësisht	Tremujori 4, 2015	2 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare
Rregullore 1516/2007	Jo	Urdhër i Përbashkët i Ministrave “Mbi kërkesat standarde të kontrollit të rrjedhjeve nga pajisjet që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara”	Jo	Ministria e Mjedisit	Plotësisht	Tremujori 4, 2015	2 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare
Rregullore 303/2008	Jo	Urdhër i Përbashkët i Ministrave “Mbi kërkesat dhe kushtet minimale të certifikimit të kompanive dhe personelit që kryen	Jo	Ministria e Mjedisit	Plotësisht	Tremujori 4, 2015	2 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare

		shërbime në pajisje që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara					
Rregullore 304/2008	Jo	Urdhër i Përbashkët i Ministrave “Mbi kërkesat dhe kushtet minimale të certifikimit të kompanive dhe personelit që kryen shërbime në pajisje që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara	Jo	Ministria e Mjedisit	Plotësisht	Tremujori 4, 2015	2 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare
Rregullore 305/2008	Jo	Urdhër i Përbashkët i Ministrave “Mbi kërkesat dhe kushtet minimale të certifikimit të kompanive dhe personelit që kryen shërbime në pajisje që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara	Jo	Ministria e Mjedisit	Plotësisht	Tremujori 4, 2015	2 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare
Rregullore • 306/2008	Jo	Urdhër i Përbashkët i Ministrave “Mbi kërkesat dhe kushtet minimale të certifikimit të kompanive dhe personelit që kryen	Jo	Ministria e Mjedisit	Plotësisht	Tremujori 4, 2015	2 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare

		shërbime në pajisje që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara					
Rregullore 307/2008	Jo	Urdhër i Përbashkët i Ministrave “Mbi kërkesat dhe kushtet minimale të certifikimit të kompanive dhe personelit që kryen shërbime në pajisje që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara	Jo	Ministria e Mjedisit Laureta Dibra	Plotësisht	Tremujori 4, 2015	2 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare
Rregullore 308/2008	Jo	Urdhër i Përbashkët i Ministrave “Mbi kërkesat dhe kushtet minimale të certifikimit të kompanive dhe personelit që kryen shërbime në pajisje që përmbajnë disa gaze serrë të florinuara	Jo	Ministria e Mjedisit	Plotësisht	Tremujori 4, 2015	2 vjet pas botimit në Fletoren Zyrtare
Rregullore 1005/2009	Jo	VKM “Mbi Substancat Ozonholluese”	Jo	Ministria e Mjedisit	Pjesërisht	Tremujori 3, 2016	Pas botimit në Fletoren Zyrtare
Vendimi 2010/372	Jo	VKM “Mbi Substancat	Jo	Ministria e Mjedisit	Pjesërisht	Tremujori 3, 2016	Pas botimit në Fletoren Zyrtare

		Ozonholluese”					
Rregullore 744/2010	Jo	VKM “Mbi Substancat Ozonholluese”	Jo	Ministria e Mjedisit	Pjesërisht	Tremujori 3, 2016	Pas botimit në Fletoren Zyrtare
Rregullore 291/2011 537/2011	Jo	VKM “Mbi Substancat Ozonholluese”	Jo	Ministria e Mjedisit	Pjesërisht	Tremujori 3, 2016	Pas botimit në Fletoren Zyrtare
Rregullore 537/2011	Jo	VKM “Mbi Substancat Ozonholluese”	Jo	Ministria e Mjedisit	Pjesërisht	Tremujori 3, 2016	Pas botimit në Fletoren Zyrtare
Rregullore 525/2013	Jo	VKM ”Mbi krijimin e mekanizmit të monitorimit dhe raportimit të gazeve me efekt serrë”	Jo	Ministria e Mjedisit	Plotësisht	Tremujori 4, 2015	1 vit pas botimit në Fletoren Zyrtare
Direktiva 98/70/KE	Jo	Udhëzim i Përbashkët ”Për mbledhjen, ruajtjen dhe raportimin e të dhënave për cilësinë e lëndëve djegëse”	Jo	Ministria e Energjisë dhe Industrië	Plotësisht	Tremujori 4, 2015	Pas botimit në Fletoren Zyrtare
Vendim 2002/159/KE	Jo	Udhëzim i Përbashkët ”Për mbledhjen, ruajtjen	Jo	Ministria e Energjisë dhe Industrië	Plotësisht	Tremujori 4, 2015	Pas botimit në Fletoren Zyrtare

		dhe raportimin e të dhënave për cilësinë e lëndëve djegëse”					
Direktive 2009/30/KE	Jo	Udhëzim i Përbashkët ”Për mbledhjen, ruajtjen dhe raportimin e të dhënave për cilësinë e lëndëve djegëse”	Jo	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	Plotësisht	Tremujori 4, 2015	Pas botimit në Fletoren Zyrtare

IV.3 Menaxhimi i mbetjeve

IV.3.1 Kuadri i Politikave Ekzistuese

Titulli (Strategji, Plane Veprimi ose Dokumente Politik)	Institucioni Lider	Periudha e Referuar
Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve	Ministria e Mjedisit	2010 - 2025
Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve	Ministria e Mjedisit	2010 - 2025

IV.3.2 Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Legjislacioni i BE-së	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni Lider	Niveli i Përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e Miratimit (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në Fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2008/98/EC	Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 ”Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”; VKM nr. 765, datë 07.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e	Ministria e Mjedisit	I plotë	22.09.2011	23.11.2011

	diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”			07.11.2012	22.11.2012
Direktiva 2000/76/EC	VKM nr. 178, datë 06.03.2012 “Për incinerimin e mbetjeve”	Ministria e Mjedisit	I plotë	06.03.2012	11.04.2012
Direktiva 94/62/EC	VKM nr. 177, datë 06.03.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”	Ministria e Mjedisit	I plotë	06.03.2012	11.04.2012
Direktiva 1999/31/EC	VKM nr. 452, datë 11.07.2012 “Për landfillet e mbetjeve”	Ministria e Mjedisit	I plotë	11.07.2012	28.08.2012
Direktiva 2000/53/EC	VKM nr. 705, datë 10.10.2012 “Për menaxhimin e mbetjeve të automjeteve në fund të jetës”	Ministria e Mjedisit	I plotë	10.10.2012	06.11.2012
Direktiva 2006/66/EC	VKM nr. 866, datë 4.12.2012 “Për bateritë akumulatorët dhe mbetjet e tyre”.	Ministria e Mjedisit	I plotë	04.12.2012	27.12.2012
Direktiva 2002/96/EC	VKM nr. 957, datë 19.12.2012“Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”	Ministria e Mjedisit	I plotë	19.12.2012	Dhjetor 2012
Direktiva 2008/98/EC; Rregullore e BE-së nr. 333, 31.03.2011	VKM nr. 117, datë 13.02.2013 “Për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet kur disa tipe të metalit skrap pushojnë së qeni mbetje”	Ministria e Mjedisit	I plotë	13.02.2013	01.03.2013

IV.3.3 Kuadri i Politikave të Planifikuara për Periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji, Plane Veprimi ose Dokumente Politik)	Institucioni Lider	Periudha e Referuar	Data e Miratimit	Hyrja në fuqi
Rishikimi i Planit dhe Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve, pas reformës administrative-territoriale	Ministria e Mjedisit	2016 - 2031	2016	2016

IV.3.4 Masat Ligjore të Parashikuara për Periudhën 2014 – 2016

Legjislacioni i BE-së	Status i Përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i Përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe Pika e Kontaktit	Niveli i Synuar i Përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e Planifikuar për Miratim	Hyrja në Fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
Direktiva Kuadër e Mbetjeve 2008/98/EC	Po	VKM “Për dokumentin e transferimit të mbetjeve”; VKM “Për dokumentet e dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”; VKM ” Për grumbullimin e	Jo	Ministria e Mjedisit	I plotë	Prill 2014 Prill 2014 Maj 2014 Korrik 2014 Shtator 2014	Pas botimit në Fletoren Zyrtare

		diferencuar të mbetjeve në burim”;					
		VKM “Pëmbetjet bio”;					
		VKM “Kërkesat për menaxhimin e mbetjeve inerte”					
<u>AFAT MESEM (2015 – 2016)</u>							
Direktiva 2006/21/EC	Jo	VKM “Mbetjet e industrisë nxjerrëse”	Jo	Ministria e Mjedisit	I plotë	2015	2015
Direktiva 96/59/EC	Jo	VKM “Për asgjësimin e PCB/PCT”	Jo	Ministria e Mjedisit	I plotë	2015	2015
Direktiva 2010/75/EU	Jo	VKM “Mbetjet e industrisë së dyoksidit të titanit”	Jo	Ministria e Mjedisit	I plotë	2016	2016
Direktiva 2008/98/EC	Po	VKM “Kostot e menaxhimit të mbetjeve”	Jo	Ministria e Mjedisit	I plotë	2016	2016

IV.4 Menaxhimi i ujërave

IV.4.1 Kuadri i Politikave Ekzistuese

Titulli (Strategji, Plane Veprimi ose Dokumente Politik)	Institucioni Lider	Periudha e Referuar
Strategjia Ndersektorale e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	2011 – 2017
Memorandum Mirëkuptimi për „Drin: Një vizion strategjik i përbashkët”, ndërmjet Shqipërisë,	Ministria e Mjedisit	Nënshkruar me date 25.11.2011

Maqedonisë, Malit të Zi, Kosovës dhe Greqisë		
Memorandum Mirëkuptimi për “Situatën e pas përmbajtjeve dhe rregullimin e regjimit ujqor të liqenit të Shkodrës, lumit Buna dhe Drin,,”, ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi	Ministria e Mjedisit	Nënshkruar me datë 14.12.2010
Plani i Menaxhimit të Basenit të Lumit Mat	Ministria e Mjedisit	2013 - 2019
8 Librat e Rregullave Teknike për Sistemin e Ujësjetllës Kanalizimeve: • Libri 1: Trasetë e tubacioneve dhe gërmimet; • Libri 2: Stacionet e pompave; • Libri 3: Përpunimi i ujit të pijshëm; • Libri 4: Rezervuarët (Depot e ujit); • Libri 5: Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm, projektimi, materialet dhe rehabilitimi; • Libri 6: Sistemet e ujërave të zeza. Pjesa 1: Projektimi i sistemeve të ujërave të zeza dhe Pjesa 2: Riparimi, rehabilitimi dhe rinovimi i sistemeve të kanalizimeve; • Libri 7: Trajtimi i ujërave të ndotura (Filtrat rrjedhës, Disqet biologjikë, Llumrat aktivë); • Libri 8: Pjesa 1: Sistemet e kanalizimeve individuale dhe Pjesa 2: Menaxhimi dhe përpunimi i mbetjeve	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	Hartuar në vitin 2013

IV.4.2 Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

Legjislacioni i BE-së	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni Lider	Niveli i Përafrimit (i plotë/i pjesshëm/mospërputhje)	Data e Miratimit (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në Fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2000/60/EC	- Ligji nr. 111/2012, date 15.11.2012 për „Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore“; - Ligji nr. 9103, date 10.7.2003 “Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare”; - Ligji nr. 30/2013, date 13.02.2013 që amendon Ligjin nr. 8905, date 06.06.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”	Ministria e Mjedisit	I plote I pjesshëm I pjesshëm	15.11.2012 10.07.2003 13.02.2013	16.12.2013 04.08.2003 12.03.2013
Direktiva 91/271/EEC	- Ligji nr. 34/2013 që amendon Ligjin nr 9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”; - Ligji nr. 8102, datë 28.3.1996 “Mbi kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura”; - Ligji nr. 9915, date 12.05.2008 „Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8102, date 28.03.1996 për „Kuatrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura“; - VKM nr. 177, date 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”; - VKM nr. 614, date 14.09.2011 “Për miratimin e Strategjisë Ndersektoriale të Furnizimit me Ujë të Pijshëm dhe Largimit të Ujërave të Ndotur“;	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës Ministria e Mjedisit Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	I plote I pjesshëm I pjesshëm I plote I plote	24.07.2003 28.03.1996 12.05.2008 31.03.2005 14.09.2011	22.09.2003 09.05.1996 28.05.2008 18.04.2005 17.10.2011

	• VKM nr. 1304, date 11.12.2009 “Për Miratimin e modelit të rregullores të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve”	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	I pjesshëm	11.12.2009	04.02.2010
Direktiva 98/83/EC	• Ligji nr. 9915, date 12.05.2008 „Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8102, date 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura” • VKM nr. 145, date 26.02.1998 “Për miratimin e rregullores higjieniko-shëndetësore për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm”	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	I plote	12.05.2008	28.05.2008
		Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	I pjesshëm	12.05.2008	28.05.2008
Direktiva 2006/7/EC	• VKM nr. 835, datë 30.11.2011 “Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare të pishinave” • VKM nr. 797, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare për administrimin e cilësisë së ujërave të largës”	Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	30.11.2011	04.01.2012
		Ministria e Shëndetësisë	I pjesshëm	29.09.2010	11.11.2010
Direktiva 2007/60/EC	• Ligji nr. 9860, date 21.01.2008 që amendon Ligjin nr. 8518, date 30.7.1999 “Për Ujitjen dhe Kullimin” • VKM nr. 835, date 3.12.2004 “Për Planin Kombëtar të Emergjencave Civile”	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	I pjesshëm	21.01.2008	13.02.2008
		Ministria e Punëve të Brendshme	I pjesshëm	03.12.2004	28.12.2004

IV.4.3 Kuadri i Politikave të Planifikuara për Periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji, Plane Veprimi ose Dokumente Politik)	Institucioni Lider	Periudha e Referuar	Data e Miratimit	Hyrja në fuqi
Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore	Ministria e Mjedisit	2015 - 2020	2016	Pas botimit në Fletoren Zyrtare
Marrëveshje Dypalëshe për Menaxhimin e Ujerave Ndërkufitare me Greqinë	Ministria e Mjedisit	2015 - 2025	2016	Pas botimit në Fletoren Zyrtare
Marrëveshje Dypalëshe për Menaxhimin e Ujerave Ndërkufitare me Maqedoninë	Ministria e Mjedisit	2015 - 2025	2016	Pas botimit në Fletoren Zyrtare
Marrëveshje Dypalëshe për Menaxhimin e Ujerave Ndërkufitare me Kosovën	Ministria e Mjedisit	2015 - 2025	2016	Pas botimit në Fletoren Zyrtare
Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Drin-Buna	Ministria e Mjedisit	2015 - 2021	2016	Pas botimit në Fletoren Zyrtare
Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Seman	Ministria e Mjedisit	2015 - 2021	2016	Pas botimit në Fletoren Zyrtare

IV.4.4 Masat Ligjore të Parashikuara për Periudhën 2014 – 2016

Legjislacioni i BE-së	Status i Përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i Përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe Pika e Kontaktit	Niveli i Synuar i Përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e Planifikuar për Miratim	Hyrja në Fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
Direktiva 2000/60/EC	Po	VKM “Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Ujrat, planet e	po	Ministria e Mjedisit	I plote	Dhjetor 2014	15 dite pas publikimit në Fletoren Zyrtare

	Po	menaxhimit te baseneve te lumenjve dhe planet e menaxhimit te rrezikut nga përmbytjet“;				Tremujori 2, 2014	
		VKM “Për komisionet e posaçme te administrimit te ujerave ndërkufitare”;	Jo		I pjesshëm	Tremujori 2, 2014	15 dite pas publikimit në Fletoren Zyrtare
		VKM “Plani Menaxhimit te Basenit te Matit”;	Jo			Tremujori 2, 2014	
		VKM “Për miratimin e formularit të kërkesës për leje për përdorimin e burimeve ujore”;	Jo		I pjesshëm		5 dite pas publikimit në Fletoren Zyrtare
		VKM “Për miratimin e formularit të kërkesës për autorizim për përdorimin e burimeve ujore”;	Jo		I pjesshëm	Tremujori 2, 2014	15 dite pas publikimit në Fletoren Zyrtare
		VKM “Për përcaktimin e kushteve te përgjithshme dhe te posaçme te licencimit, autorizimit, lejes dhe koncesionit për përdorimin e burimeve ujore“;	Jo		I pjesshëm	Tremujori 3, 2014	15 dite pas publikimit në Fletoren Zyrtare
		VKM “Për kushtet dhe kriteret e nevojshme për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e Kadastrës Kombëtare te Burimeve Ujore“;	Jo		I pjesshëm	Tremujori 3, 2014	15 dite pas publikimit në Fletoren Zyrtare

			Jo		I pjesshëm		15 dite pas publikimit në Fletoren Zyrtare
Direktiva 2007/60/EC	PO	VKM “Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Ujerat, planet e menaxhimit të baseneve të lumenjve dhe planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet”;	po	Ministria e Mjedisit	I plote	Tremujori 4, 2014	15 dite pas publikimit në Fletoren Zyrtare
		VKM “Për komisionet e posaçme të administrimit të ujerave ndërkufitare”;	Jo		I pjesshëm	Tremujori 2, 2014	15 dite pas publikimit në Fletoren Zyrtare
		VKM “Plani i Menaxhimit të Basenit të Matit”;	Jo		I pjesshëm	Tremujori 2, 2014	15 dite pas publikimit në Fletoren Zyrtare
		VKM “Për miratimin e formularit të kërkesës për leje për përdorimin e burimeve ujore”;	Jo		I pjesshëm	Tremujori 2, 2014	15 dite pas publikimit në Fletoren Zyrtare
		VKM “Për miratimin e formularit të kërkesës për autorizim për përdorimin e burimeve ujore”;	Jo		I pjesshëm	Tremujori 2, 2014	15 dite pas publikimit në Fletoren Zyrtare
		VKM “Për përcaktimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme të licencimit, autorizimit, lejes dhe koncesionit për	Jo		I pjesshëm	Tremujori 3,	15 dite pas

		përdorimin e burimeve ujore““; VKM “Për kushtet dhe kriteret e nevojshme për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore““	Jo		I pjesshëm	2014 Tremujori 3, 2014	publikimit në Fletoren Zyrtare 15 dite pas publikimit në Fletoren Zyrtare
Direktiva 2009/90/EC	JO	VKM “Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Ujrat, planet e menaxhimit të baseneve të lumenjve dhe planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbajtjet““; VKM “Për komisionet e posaçme të administrimit të ujerave ndërkufitare““; VKM “Plani i Menaxhimit të Basenit të Matit““; VKM “Për miratimin e formularit të kërkesës për leje për përdorimin e burimeve ujore““; VKM “Për miratimin e formularit të kërkesës	po Jo Jo Jo Jo	Ministria e Mjedisit	I plote I pjesshëm I pjesshëm I pjesshëm	Tremujori 4, 2014 Tremujori 2, 2014 Tremujori 2, 2014 Tremujori 2, 2014	15 dite pas publikimit në Fletoren Zyrtare 15 dite pas publikimit në Fletoren Zyrtare 15 dite pas publikimit në Fletoren Zyrtare

Administrata Doganore Shqiptare ka bërë progres në përafrimin e legjislacionit doganor me atë të BE-së. Administrata Doganore përfiton statusin e nëpunësit civil. Është miratuar legjislacioni i ri mbi akcizat i përafruar me aktet e BE-së, si dhe administrimi i akcizës kaloi tek doganat. Administrata doganore përditëson nomenklaturën e mallrave në linjë me versionin 2014 të Nomenklaturës së Kombinuar të BE-së. Tarifat preferenciale të vitit 2014 janë përfshirë në sistemin Asycuda World. Janë miratuar një sërë aktesh lidhur me shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve, ndalimin e importit të mbetjeve, politika të brendshme dhe sigurie në Sistemin e TI-së së Doganave. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave bashkëpunon me institucione të tjera për uljen e rreziqeve, formaliteteve doganore, lehtësimin e procedurave nëpërmjet E-pagesave, kryerjen e analizave laboratorike, për monitorimin dhe mbrojtjen nga kimikatet e rrezikshme, për shkëmbim elektronik të të dhënave me Kosovën, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Ka një bashkëpunim të mirë me vendet e tjera në kuadër të marrëveshjeve për asistencë të ndërsjellë në çështjet doganore (bazuar në Protokollin 6 të MSA), me qendrën SELEC, etj. DPD ka miratuar Strategjinë e Biznesit dhe miraton çdo vit planin e veprimit në zbatim të saj; ka miratuar Strategjinë e Teknologjisë së Informacionit dhe dokumentin e politikës së sigurisë; Strategjinë e Brendshme për të Drejtat e Pronësisë Intellektuale. Autoriteti Doganor do të instalojë INES + i cili do të jetë plotësisht në linjë me sistemin COPIS të të dhënave, i cili do të do të thjeshtojë procedurat, analizimin e të dhënave, etj. Është implementuar sistemi i rikuperimit në raste të fatkeqësive natyrore për replikimin online të të dhënave. Është konfiguruar dhe instaluar Portali Asycuda World dhe është përmirësuar Sistemi TI-së. Administrata Doganore ka fuqizuar investigimin e brendshëm; ka rritur luftën kundër korrupsionit, përpjekjet në parandalimin e hyrjes së mallrave të falsifikuara në Shqipëri. Progres është bërë në lidhje me kapacitetet administrative dhe operacionale, infrastrukturën në

pikat e kalimit kufitar duke përfshirë sistemin e monitorimit me kamera 24 orë në të gjithë sistemin doganor dhe kryesisht në pikat e kalimit kufitar. Koncepti “one stop shop” zbatohet në Pikat e Kalimit Kufitar nga Doganat, Policia e Shtetit dhe Shërbimi Fitosanitar. Shqipëria merr pjesë në Programin e BE-së Doganat 2013 dhe kemi aplikuar për të marrë pjesë në Doganat 2020. Është rritur kapaciteti dhe efienca e laboratorit doganor. Ka pasur zhvillim, sidomos në lidhje me tarifën, origjinën dhe importimin e përkohshëm.

Mbështetur në rekomandimet e BE-së për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e procedurave të Konventës ATA, kjo Konventë është plotësisht funksionale. Meqenëse se numri i rasteve është i vogël nuk ka një modul specifik në sistemin Asycuda, por në e mbulojmë këtë me anë të modulit të Regjimit të Importimit të Përkohshëm.

Norma e përdorimit të vlerësimit doganor me anë të transaksioneve është akoma e ulët në krahasim me standardet e BE-së. Në mënyrë që të kemi rezultate më të mira ka filluar procesi i reduktimit të dosjeve të të dhënave të disponueshme duke u mbështetur në kriteret e paracaktuara. ADSH po punon për rritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale të stafit operacional. Arritja e standardeve të BE-së për “normën e përdorimit të vlerësimit doganor me anë të transaksioneve” është një objektivi që kërkon një proces në vazhdimësi i cili lidhet ngushtë me: rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit të biznesit, rritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale në administratën doganore, rritjen e kontrollit aposterior, fuqizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe shkëmbimeve reciproke me doganat homologe të vendeve të tjera, etj., rritjen e bashkëpunimit me grupet e interesit, dhomat e tregtisë dhe përfaqësuesit e biznesit.

Përpjekje të mëtejshme kërkohen për rritjen e ndërveprimit online të DPD duke u përfshirë me sistemet e BE të doganave dhe akcizës. Strategjia e TI-së akoma nuk është harmonizuar me strategjinë e biznesit. DPD është në hapat e parë të implementimit të (Sportelit të Vetëm (Single Window), një proces që do të ndihmojë në krijimin e një platforme ndërveprimi me institucionet ndërkombëtare, një hap i nevojshëm për të proceduar me zhvillimet e mëtejshme ndërfunksionale me sistemet doganorë të BE-së.

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Angazhimet në fushën e doganave janë marrë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim –Asociimit, nenet 13, 14, 15, 34, 43, 70, 86 dhe 97. Nenet 13, 14, 15, 34, 43 dhe 86 parashikojnë në veçanti forcimin e bashkëpunimit me vendet e rajonit që kanë nënshkruar MSA, ndërsa neni 41 dhe Protokollu 4 përcaktojnë rregullat e origjinës për implementimin e dispozitave të kësaj Marrëveshje.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, në veçanti neni 97 i referohet doganave. Ky nen parashikon, detyrimin për të përafruar legjislacionin doganor shqiptar me atë të BE-së, bashkëpunimin mes Palëve duke pasur parasysh Acquis në fushën e doganave dhe bashkëpunimin për asistencë të ndërsjellë administrative në çështje doganore.

Legjislacioni doganor mbështetet kryesisht në aktet e BE-së të përmendura më poshtë:

- Rregullore e Këshillit 2913/92/KEE “Për Kodin Doganor Komunitar”, e ndryshuar (GZ L 302, 19.10.1992, f. 1 – 50);
- Rregullore nr. 952/2013, datë 09.10.2013 “Kodi Doganor i Bashkimit”;
- Rregullore e Komisionit (KEE) Nr. 2454/93, të datës 02.07.1993 “Për përcaktimin e dispozitave për zbatimin e Rregullores së Këshillit (KEE) nr. 2913/92 për themelimin e Kodit Doganor të Komunitetit;
- Rregullore e Këshillit 2658/87/KEE datë 23 korrik 1987 “Për tarifën dhe nomenklaturën statistikore dhe për tarifën e përbashkëta doganore”, e ndryshuar;
- Rregullore (KE) nr. 1186/2009, datë 16 nëntorit 2009 “Mbi përjashtimet nga detyrimet doganore”;
- Direktiva 2007/74/KE e Këshillit Evropian, datë 20 dhjetor 2007 “Mbi përjashtimet nga TVSH dhe Akcizën për mallrat e importuara nga udhëtarët”;
- Direktiva e Këshillit 2008/118/KE e 16 dhjetorit 2008 “Mbi masat e përgjithshme për akcizën dhe shfuqizimin e Direktivës 92/12/KEE”;
- Direktiva 2003/96/KE e Këshillit të datës 27 Tetor 2003 që “Ristrukturon kuadrin Komunitar për taksimin e produkteve të energjisë dhe elektricitetit”;
- Direktiva 92/83/KEE e datës 19 tetor 1992 “Mbi harmonizimin e strukturave të taksës së akcizës mbi alkoolin dhe pijet alkoolike”;
- Direktiva 92/84/KEE e datës 19 tetor 1992 “Mbi harmonizimin e niveleve të detyrimit të akcizës mbi alkoolin dhe pijet alkoolike”;
- Direktiva 92/12/KEE e 25 shkurt 1992 “Rregulla të përgjithshme për mbajtjen, lëvizjen dhe mbikëqyrjen e produkteve të akcizës”;
- Vendimi i Komisionit nr. 428 i datës 22 qershor 2006 që përcakton “Një markim të përbashkët fiskal për gazin dhe vajgurin”;
- Rregullore 608/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 12 qershorit 2013, e cila “Shfuqizon Rregullore (KE) nr. 1383/2003”.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Në përgjithësi, Administrata Doganore Shqiptare ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga MSA. Së fundmi, Shqipëria ka finalizuar draftin e ri të Kodit Doganor, i cili përafron plotësisht Rregulloren e Komisionit nr. 952/2013, datë 9 tetor 2013 “Kodi Doganor i Bashkimit” si dhe bazohet në një sërë aktesh të tjera evropiane që rregullojnë elementë specifikë doganorë. Pas miratimit të Dispozitave Zbatuese të Rregullores së BE-së nr. 952/2013, Shqipëria do të fillojë përafrimin e dispozitave të veta kombëtare. Me VKM 612/2012, datë 09.05.2012 "Mbi Dispozitat Zbatuese të

Ligji “Mbi Akcizat”, i ndryshuar, Shqipëria është duke përdorur praktikat më të mira të legjislacionit francez dhe italian. Ligji nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Mbi Akcizat në Republikën e Shqipërisë” po rishikohet dhe pritet të amendohet së shpejti.

Republika e Shqipërisë ka aderuar në disa konventa mbi fushën doganore, marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e tregtisë së lirë dhe marrëveshjet bilaterale me administratat doganore homologe.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Administrata Doganore Shqiptare përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nga Degët Doganore. Ajo varet nga Ministria e Financave dhe është nën mbikëqyrjen e saj.

Grupi Punues Ndërinstitucional për Integrim Evropian i ngarkuar me Kapitullin 29 (Doganat) drejtohet nga Ministria e Financave.

II.4 Sqarime në lidhje me parashikimet financiare

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka të akorduar buxhet në vite si më poshtë:

000/leke

	2012	2013	2014	2015
Totali	1.527.723	1.656.073	2.259.260	2.079.300
Mbështetje nga buxheti i shtetit	1.511.723	1.450.073	1.594.260	1.666.300
Asistencë e huaj	16.000	206.000	665.000	413.000

Projektet e huaja nga të cilat përfiton Drejtoria e Përgjithshme e Doganave janë:

1. Programi IPA 2011 “Mbështetje për tranzicionin dhe përforcimin e institucioneve” miratuar nga Komisioni Evropian nr. C (2011) 7318 datë 13.10.2011 në dy projekte (Vlera Totale, Grant 3,000,000 €) e cila konsiston në:
 - Kontratë Asistence Teknike (Binjakëzim) për DPD në fushat e Kontrollit të Pas-Zhdoganimit, Analizës së Riskut, Mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale dhe Labororit Doganor (Vlera e Grantit 1,500,000 €).
 - Kontrate për blerjen e makinerive dhe pajisjeve për Laboratorin Kimik Doganor (Vlera e Grantit 1,500,000 €).

2. Programi IPA 2012 (Vlera e Grantit 6,500,000 €) e cila konsiston në:
 - Projekt Binjakëzimi për përafrimin e legjislacionit doganor dhe procedurave me ato të BE-së nga pikëpamja e ndërveprimit të sistemeve të TI me sistemet e BE-së (Vlera e Grantit 1,200,000 €).
 - Kontratë Asistence Teknike për zhvillimin e aplikacionit nacional plotësisht të përputhshëm me NCTS (Sistemi i Ri i Kompjuterizuar i Transitit) të BE-së (Vlera e Grantit 1,300,000 €).
 - Blerja e 8 makinave të specializuara për Drejtorinë e Anti-Kontrabandës dhe pajisjet përkatëse (Vlera e Grantit 1,000,000 €).
 - Përfundimi i Rehabilitimit të PKK Morine Faza II dhe ndërtimi i PKK Hani i Hotit (Vlera e Grantit 3,000,000 €).
3. Programi IPA 2013 ((Vlera e Grantit 4,500,000 €).
 - Kontratë binjakëzimi për përafrimin e Procedurave dhe legjislacionit në fushën e tarifës (Vlera e Grantit 1,800,000 €).
 - Kontratë shërbimi për zhvillimin e modulit ITMS (Sistemi i Menaxhimit të Integruar të Tarifës) (Vlera e Grantit 1,500,000 €).
 - Kontratë Blerje dhe instalimi i skemës së alarmit për radioaktivitet në të gjitha PKK dhe blerje e portaleve në 9 PKK së bashku me hardware (Vlera e Grantit 1,200,000 €).
4. Projekti i ANEAS “ Vendosija e një sistemi kontrolli dhe instalimi pilot i pajisjeve zbuluese për të siguruar kontrollin e materialeve radioaktive (Vlera e Grantit 800,000 €).
5. Programi “Doganat 2013” (Vlera e Grantit 50,000 €).

III. Prioritetet

Përparësitë afat-shkurtra:

- Kodi i ri Doganor Shqiptar është draftuar dhe dërguar pranë Ministrisë së Financave për ndjekjen e procedurave të nevojshme ligjore.
- Në lidhje me procedurat e thjeshtuara, masat e sigurisë dhe konceptin e operatorit ekonomik të autorizuar, është parashikuar draftimi i dispozitave zbatuese deri në fund të vitit 2014. Ky hap varet nga miratimi i Kodit të ri Doganor Shqiptar.
- Do të vazhdohet përafrimi i legjislacionit doganor dhe të akcizës si dhe të procedurave me praktikën e BE-së.
- Të sigurohet përditësimi në kohë i tarifave kombëtare mbi bazën e Nomenklaturës së Kombinuar më të fundit.

Përparësitë afat-mesme:

- Të përafrohet më tej legjislacioni shqiptar për doganat me *acquis* e BE-së;

- Të shtohen kapacitetet administrative për përmbushjen e misionit doganor dhe pajtueshmërinë me legjislacionin doganor;
- Të forcohen kapacitetet administrative në kuadër të luftës kundër korrupsionit, krimit ndërkufitar dhe evazionit fiskal.
- Përmirësimi i transparencës dhe shkëmbimit të informacionit me Shtetet Anëtare të BE-së në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i masave që parandalojnë shmangien apo evazionin e taksave.
- Përmirësimi i sistemeve dhe platformave të TI-së.

Administrata Doganore përditësohet me zhvillimet më të fundit të legjislacionit të BE-së. Pas miratimit të Dispozitave Zbatuese të KDB, të cilat janë nën diskutim dhe pritet të miratohen së shpejti, ne do të fillojmë përafrimin e tyre brenda vitit 2016. Autoriteti Doganor do të instalojë INES + i cili do të jetë plotësisht në linjë me sistemin COPIS të të dhënave. Ky sistem do të mundësojë përpunimin e të dhënave në mënyrë elektronike dhe po ashtu do të shërbejë si një databazë. INES + software do të thjeshtojë procedurat, përpunimin e të dhënave dhe mundësinë e krijuar profile të riskut me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale.

IV. Plani i Veprimit 2014 – 2016

IV.1 Bashkimi doganor

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periodha e referuar
Strategjia e Biznesit të Administratës Doganore Shqiptare	MF	2013 - 2017
Plani i Veprimi në zbatim të strategjisë së biznesit të DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	2014 (miratohet çdo vit)
Strategjia e Teknologjisë së Informacionit	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	2013 - 2017
Rregullore për Politikën e përdorimit dhe sigurisë së sistemeve të IT nga DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	2013
Strategjia ndër-sektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme dhe terrorizmit, 2013-2020 dhe planit të veprimit për vitet 2013-2016	Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Prokuroria e Përgjithshme dhe Shërbimi Informativ Shtetëror	2013 - 2016
Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale	Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave	2010-2015
Strategjia për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale nga	DPD	2013-2015

Administrata Doganore Shqiptare		
Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufirit	Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Shërbimi Informativ Shtetëror	2014-2020
Strategjia Kombëtare për Hetimin e Krimit Financiar	Komiteti për Bashkërendimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave	2009-2015
Strategjia Kombëtare Kundër Drogës	Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj strategjie	2012-2016
Strategjia Ndër-sektoriale e Luftës Kundër Krimit të Organizuar, Trafikeve të Paligjshme dhe Terrorizmit, 2013-2020	Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Mbrojtjes, Prokuroria e Përgjithshme dhe Shërbimi Informativ Shtetëror	2013-2020
Strategjia Ndër-sektoriale e Luftës Kundër Terrorizmit, 2011-2015,	Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore	2011 - 2015
Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve dhe të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve	Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore	2010-2025

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Rregullore 2913/92/KEE	Ligji nr. 8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar	MF	I pjesshëm	27.01.1999	06.03.1999
Rregullore e Këshillit 2658/87/KEE	Ligji nr. 9461, datë 21.12.2005, “Për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore”, i ndryshuar	MF	I pjesshëm	21.12.2005	01.01.2006
Direktiva 2008/118/KE	Ligji nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar	MF	I pjesshëm	24.05.2012	1.09.2012

Direktiva e Këshillit 2003/96/ KE Direktiva 92/83/KEE KEE e datës 19 tetor 1992 Direktiva 92/12/KEE Vendimi i Komisionit nr. 428 datë 22.06.2006 Rregullore 2008/450					
Rregullore e Komisionit (KEE) Nr. 2454/93, të datës. 02.07.1993 Rregullore 1383/2003/KE	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 205, datë 13.04.1999, “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar	MF	I pjesshëm	13.04.1999	06.03.1999),
Rregullore Nr. 1001/2013/BE ; Rregullore Nr. 1326/2013/BE	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1067 datë 14.12.2013 “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave” i ndryshuar	MF	I plotë	14.12.2013	01.01.2014

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Projekt Strategjia e Trajnimeve për administratën doganore	DPD	2016 - 2018	Tre mujori i dyte 2015	Tre mujori i pare 2016

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e EC)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
Rregullore e Komisionit nr. 952/2013, dt 09 tetor 2013 “Kodi Doganor i Bashkimit”; Rregullore e Këshillit (KE) nr. 1186/2009, datë 16, nëntor 2009, mbi përjashtimet nga detyrimet doganore Direktiva e Këshillit 2007/74/KE datë 20 Dhjetor 2007	Po	Projekt ligj “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” që shfuqizon ligjin nr. 8449, datë 27.1.1999.	Jo	MF	I pjesshëm	brenda 4 mujorit të fundit 2014	Disa nene hyjnë në fuqi pas botimit në FZ, disa ne: 1 janar 2015; disa më 1 qershor 2017.
Rregullore Nr. 608/2013/BE	Jo	Projekt – Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 205 dt. 13.04.1999, “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor të RSH”.	Po	MF	Pjesërisht	Tre mujori i fundit 2014	Tre mujori i fundit 2014

Ndryshim i Aneksit 1 të Rregullores së Këshillit 2658/87/KEE	Jo	Projekt – Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2015”	Jo	MF	I plotë	Tre mujori i fundit 2014	Tremujori i parë i 2015
<u>AFAT MESËM (2015 – 2016)</u>							
Rregullore Nr. 1186/2009/KE Direktiva 2007/74/KE Rregullore 2454/93/KE	Jo	Projekt Vendim i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime ne Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 205 dt 13.04.1999, “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor te RSH” për OEA, procedurat e thjeshtuara, përjashtimet.	Pjesërisht	MF	I pjesshëm	Tre mujori i parë 2015 (në varësi të miratimit të projekt ligjit “Kodi Doganor I RSH”)	Tre mujori i dytë 2015
Ndryshim i Aneksit 1 të Rregullores së Këshillit 2658/87	Jo	Projekt Vendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2016”	Jo	MF	I plotë	Tre mujori i fundit 2015	Tre mujori i parë 2016

KAPITULLI 30: MARRËDHËNIET ME JASHTË

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis e BE-së në fushën e marrëdhënieve me jashtë, në një pjesë të konsiderueshme mbështetet në legjislacionin e politikës së përbashkët tregtare. Ajo gjithashtu përmbledh edhe legjislacionin për politikën e zhvillimit dhe ndihmës humanitare. Legjislacioni i BE-së në fushën e politikës së përbashkët tregtare përbëhet kryesisht nga ligjet primare (Traktati), nga aktet nënligjore të BE-së (kryesisht në formën e rregulloreve) si dhe nga marrëveshjet shumëpalëshe dhe dypalëshe të BE-së. Shqipëria do të duhet të sigurojë që regjimi i tij tregtar të jetë në përputhje me regjimin e BE-së.

Përveç marrëdhënieve ekonomike e tregtare, kapitulli marrëdhëniet me jashtë i *acquis* së BE-së ,gjithashtu, përfshin edhe bashkëpunimin në aspektin e politikës së zhvillimit dhe të ndihmës humanitare. Në fushën e politikës së zhvillimit dhe ndihmës humanitare, shtetet anëtare, duhet të përputhin me legjislacionin e BE-së, angazhimet ndërkombëtare dhe të sigurojnë kapacitetin për të marrë pjesë në zhvillimet dhe në politikën humanitare të BE-së.

Legjislacioni shqiptar do të duhet të shfuqizohet sapo Shqipëria të hyjë në BE ndërsa rregulloret e BE-së do të funksionojnë menjëherë në rendin ligjor kombëtar. Vetëm aspektet institucionale të zbatimit, duhet të rregullohen nga ligjet shqiptare që mund të referohen për normat e tyre për Rregulloren e BE-së.

I.2 Situata në Shqipëri

Shqipëria zbaton të gjitha detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) si dhe të gjitha marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, dypalëshe dhe shumëpalëshe tregtare. Politika tregtare e Shqipërisë ndjek parimet e politikës së përbashkët tregtare të Bashkimit Evropian. Shqipëria, krahas parimeve të OBT-së, respekton edhe rregullat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian, CEFTA, EFTA dhe Turqinë.

Forcimi i kapaciteteve administrative është një komponent i domosdoshëm për shtetet e reja që kërkojnë të integrohen në Bashkimin Evropian. Kriteret kryesore janë rritja e njohurive të administratës publike për Politikën e Përbashkët Tregtare, thjeshtimi i instrumenteve për hartimin dhe bashkërendimin e politikës tregtare, në mënyrë që të përputhet me politikën e përbashkët tregtare të BE-së.

I.3 Struktura e kapitullit

1. POLITIKA TREGTARE
2. BASHKËPUNIMI PËR ZHVILLIM DHE NDIHMA HUMANITARE

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe legjislacionit të BE-së

1. POLITIKA TREGTARE

Detyrimi për përafrimin e ligjit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian buron nga neni 70 MSA-së, dispozitë nga cila Shqipëria ka jo vetëm detyrimin për të sjellë legjislacionin e saj kombëtar në përputhje me të drejtën e BE-së, por edhe të sigurohet se ajo të zbatohet. Kështu, tashmë në këtë fazë të procesit të paraanëtarësimit organet e ndryshme shtetërore duhet të jenë të përfshirë në ushtrimin e përafrimit. Për më tepër, meqenëse edhe vetë ligji i BE-së i nënshtrohet zhvillimeve të vazhdueshme për përafrimin e ligjeve, nuk do të jetë i plotë me përshtatjen e legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së aktualisht në fuqi. Monitorimi i vazhdueshëm i zhvillimeve të BE-së është i nevojshëm edhe për përpjekjet e parapranimit dhe përgatitjes së Shqipërisë për anëtarësim në BE.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) përfshin një pjesë kryesore të tregtisë së lirë midis Shqipërisë dhe BE-së. Ajo përfshin dispozita në disa fusha që kërkojnë se palët duhet të veprojnë në përputhje me rregullat e OBT-së ose të detyrimeve ndërkombëtare. Detyrimet e Shqipërisë sipas përcaktimeve të MSA-së për politikën tregtare në mënyrë të përmbledhur janë:

Nenet relevante të MSA-së për këtë kapitull janë: 7, 16, 19, 20, 21, 25, 26, 27, 28, 29, 33, 34, 40, 59, 60, 70, 71, 72, 73, 74, 97.

2. BASHKËPUNIMI PËR ZHVILLIM DHE NDIHMA HUMANITARE

Në fushën e bashkëpunimit për zhvillim dhe ndihmës humanitare, Shqipëria duhet të jetë në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe angazhimeve ndërkombëtare për të siguruar kapacitetin për të marrë pjesë në zhvillimet e BE-së dhe politikën humanitare.

Legjislacioni kryesor i Bashkimit Evropian në këtë fushë përmbledh:

Politika e Përbashkët Tregtare kërkon një politikë të përbashkët tregtare të regjimit të Import/Eksportit, Masat Tregtare të Mbrojtjes si dhe Kuadrin Tregtar Shumëpalësh të OBT-së.

1. Rregullorja 428/2009 “Për krijimin e regjimit të Komunitetit për kontrollin e eksporteve, transferim, ndërmjetësimin dhe transitin e mallrave me përdorim të dyfishtë”;
2. Rregullorja 260/2009 “Për rregullat e përbashkëta në importe të BE-së”;
3. Rregullorja 1225/2009 “Mbi mbrojtjen kundër dumpingut në importe nga vendet jo anëtare të BE-së”;
4. Direktiva 98/29/KE “Mbi harmonizimin e dispozitave kryesore lidhur me sigurimin e kredive të eksportit për transaksionet afatmesme dhe afatgjatë (e ndryshuar me Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 806/2003)”.
5. Direktiva e 84/568/KEE “Mbi detyrimet reciproke të organizatave të sigurimit të kredive të eksportit të vendeve anëtare që veprojnë në emër të shtetit ose me mbështetjen e saj, ose të departamenteve publike që veprojnë në vend të këtyre organizatave, në rastin e garancive të përbashkëta për një kontratë që përfshin një ose më shumë të nënkontraktuar në një ose më shumë shtete anëtare të Komunitetit Evropian”.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

1. POLITIKA TREGTARE

Shqipëria është anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë nga shtatori i vitit 2000 dhe **politika tregtare** ndjek parimet dhe rregullat e kësaj organizate. Shqipëria ka përafruar legjislacionin e saj të brendshëm me atë të BE-së në fushën e importit të mallrave, ndihmës shtetërore, prokurimit publik, aviacionit civil, subvencioneve, etj, në përputhje me angazhimet e saj në këtë organizatë. Shqipëria ndjek të gjitha zhvillimet në OBT dhe notifikon në mënyrë periodike legjislacionin e saj në përputhje me parimin e transparencës.

Planifikimi i angazhimeve të Shqipërisë të ndërmarra në Marrëveshjen e Përgjithshme mbi Tregtinë në Shërbime (GATS), si dhe kufizimet horizontale dhe angazhimet specifike sektoriale në Shqipëri, përgjithësisht ndryshojnë nga ato të ndërmarra nga BE-ja. Megjithatë, asnjë nga angazhimet e Shqipërisë në GATS nuk pengojnë aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit në BE.

E gjithë strategjia e politikës tregtare pas anëtarësimit në Organizatën Botërore të Tregtisë është mbështetur në (i) Raportin e Anëtarësimit të Shqipërisë në këtë organizatë, (ii) Ligjin Nr. 8649, datë 28.07.2000, “Për ratifikimin e rezultateve të Raundit të Uruguait të negociatave tregtare shumëpalëshe”.

Shqipëria ka tashme në zbatim marrëveshje të tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian (pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit) ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë, vendet e Evropës Juglindore (CEFTA 2006), vendet EFTA dhe Turqisë. Tregtia me vendet CEFTA është liberalizuar krejtësisht me ratifikimin e Protokollit 3 shtesë ndërmjet Shqipërisë dhe Bosnjë-Hercegovinës në kuadër të kësaj marrëveshjeje.

Republika e Shqipërisë ka në zbatim **43 marrëveshje dypalëshe** për “Nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve”, të cilat janë aktualisht në fuqi. Vendet me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve janë: Austri; Azerbajxhan; Unioni i përkohshëm Belgjik-Luksemburg; Bosnje Hercegovina; Britani e Madhe; Bullgari; Çeki; Danimarkë; Egjipt; Finlandë; Francë; Greqi; Gjermani; Holandë; Hungari; Itali; Izrael; Katar; Kinë; Koreja e Jugut; Kroaci; Kuvajt; Lituani; Malajzi; Maltë; Maqedoni; Moldavi; Poloni; Portugali; Qipro; Rumani; Rusi; San Marino; Serbi; Slloveni; Spanjë; Suedi; Tunizi; Turqi; Ukrainë; SHBA; Zvicër.

Janë në proces negocimi marrëveshjet për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve me Emiratet e Bashkuara Arabe, Kanadanë, Islandën, Turqinë, Sllovakinë, Marokun dhe Libanin.

Republika e Shqipërisë ka në zbatim 37 marrëveshje bashkëpunimi ekonomik dhe teknik me vende të ndryshme në zhvillim. Vendet me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ekonomik dhe teknik janë: Arabi Saudite; Argjentinë; Austri; Unioni i përkohshëm Belgjik Luksemburg; Bullgari; Brazil; Çeki; Danimarkë; Emiratet e Bashkuara Arabe; Egjipt; Finlandë; Francë; Gjermani; Greqi; Hungari; Izrael; Japoni; Katar; Kinë; Kroaci; Koreja e Jugut; Kuvajt; Libi; Malajzi; Maqedoni; Poloni; Rumani; Rusi; Serbi; Slloveni; Sllovaki; Suedi; Turqi; Ukrainë; Uruguai; SHBA; Zvicër.

Në proces janë marrëveshjet me Bosnje Hercegovinën, Malin e Zi, Brazilin dhe Korenë e Jugut.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Institucionet përgjegjëse për politikën tregtare përfshijnë:

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si përgjegjëse për hartimin, ndjekjen dhe monitorimin e politikave tregtare në Shqipëri,
2. Ministria e Integrimit Evropian,
3. Ministria e Drejtësisë,
4. Ministria e Financave,
5. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave,

6. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës,
7. Ministria e Mbrojtjes,
8. Ministria e Shëndetësisë,
9. Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit,
10. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë,
11. Ministria e Mjedisit,
12. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,
13. Banka e Shqipërisë,
14. Autoriteti i Konkurrencës,
15. Agjencia e Prokurimit Publik;
16. Ministri për Inovacionin, dhe Administratën Publike,
17. Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave;
18. Zyra shqiptare për të Drejtat e Autorit;
19. Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil,
20. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; si dhe çdo ministri apo institucion tjetër që prek tregtinë.

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

	2012	2013	2014	2015
Kostot totale e vlerësuar	0	0	226.000	
Buxheti i Shtetit	0	0	226.000	
Mbuluar nga ndihma e huaj	0	0		
Ndryshim	0	0	0	

III. Prioritetet

Me anëtarësimin në Bashkimi Evropian, Shqipëria do të jetë e detyruar të përshtatë politikën e përbashkët tregtare me atë të BE-së. Për këtë Shqipëria do të zbatojë të gjitha marrëveshjet tregtare autonome (preferenciale dhe jopreferenciale) që BE-ja u garanton disa vendeve jo anëtare të BE-së, duke përfshirë edhe Sistemin e Përgjithësuar të Preferencave (SPP).

Shqipëria do të duhet të përfundojë të gjitha marrëveshjet e saj të tanishme preferenciale tregtare me vendet jo anëtare të BE-së dhe të sjellë të gjitha marrëveshjet e tjera, duke përfshirë marrëveshjet jopreferenciale të tregut, në përputhje me detyrimet e anëtarësimit në BE. Shqipëria do të bëhet palë e Zonës Ekonomike Evropiane dhe, pas pranimit, do të duhet të zbatojnë të gjitha marrëveshjet e tregtisë ndërkombëtare të BE-së, përfshirë këtu OBT-në.

Në përputhje me detyrimet e MSA-së, Shqipëria duhet të:

- Vlerësojë mundësitë për zgjerimin e koncesioneve për produktet bujqësore dhe peshkun;
- Të ndjekë të gjitha zhvillimet në politikën e përbashkët tregtare të BE-së.

Mbështetur në sa sipër prioritetet shqiptare përfshijnë:

1. Ngritja e kapaciteteve të administratës publike për të ndjekur zhvillimet e Politikës së Përbashkët Tregtare me Bashkimin Evropian
2. Thellimi i integritetit rajonal në kuadër të Marrëveshjes CEFTA. Avancimi i negociatave për liberalizimin e mëtejshëm të tregtisë së shërbimeve me vendet palë të kësaj marrëveshje.

Në fushën e zhvillimit të bashkëpunimit dhe ndihmës humanitare, Shqipëria do të duhet të zhvillojë politikën e saj kombëtare dhe forcimin e kapaciteteve institucionale në mënyrë që të përputhen me standardet e BE-së.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2014 – 2016

IV.1 Politika tregtare

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
n/a	n/a	n/a

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Rregullorja Nr. 260/2009	Ligji Nr. 9790, datë 19/07/2007 “Për masat mbrojtëse në Import”	MZHETS	I pjesshëm	19.07.2007	3.08. 2007
Rregullorja Nr. 597/2009	Ligji Nr. 9796 23/07/2007 “Për Antidumping dhe Masave Kundërbalancuese”	MZHETS	I pjesshëm	23.07.2007	7.08. 2007
Rregullorja Nr. 1225/2009	Ligji Nr. 9796 23/07/2007 “Për Antidumping dhe Masave Kundërbalancuese”	MZHETS	I pjesshëm	23.07.2007	7.08. 2007
Rregullorja Nr. 1334/2000	Ligji “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë” nr. 9707, datë 5.4.2007	AKSHI	I pjesshëm	24.04.2007	9.05.2007

Rregullorja Nr. 428/2009	Vendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import- eksporteve”, Nr. 106 datë 9/2/ 2011	AKSHI	I pjesshëm	09.02.2011	24.02.2011
-----------------------------	--	-------	------------	------------	------------

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet)	Status i përkthimit në Anglisht	Institucion Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje I pjesshëm)	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
<u>AFAT MESEM (2015 – 2016)</u>							
Rregullorja Nr. 428/2009	jo	Ligji, “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të	jo	AKSHI	I plotë	Tre mujori i parë i 2015	Tre mujori dytë i 2015

		mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë” nr. 9707, datë 5.4.2007					
Direktiva 98/29/KE	jo	Ligji për sigurimin e kredive të eksportit	jo	MZHETS	I pjesshëm	Tre mujori i katërt 2016	Tre mujori i dytë 2017
Direktiva 84/568/KEE	jo	Ligji për sigurimin e kredive të eksportit	jo	MZHETS	I pjesshëm	Tre mujori i katërt 2016	Tre mujori i dytë 2017

KAPITULLI 31: POLITIKAT E JASHTME, E SIGURISË DHE E MBROJTJES

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Shqipëria ka shprehur vullnetin të vijojë njehsimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian në fushën e Politikës së Jashtme, të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Shqipëria mbështet fuqishëm politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian, e cila ka për qëllim forcimin e rolit të Bashkimit Evropian si entitet politik me ndikim gjithnjë e në rritje në politikën ndërkombëtare.

Samiti i Selanikut në qershor 2003 konfirmoi perspektivën e qartë evropiane për vendet e Ballkanit Perëndimor. Shqipëria që prej janarit 2004, i është bashkuar rregullisht qëndrimeve të përbashkëta të Bashkimit Evropian në fushën e PJSM. Shqipëria ka kontribuar dhe kontribuon në misionet ushtarake të Bashkimit Evropian të ndërmarra në kuadër të PJSM.

Shqipëria, zhvillon një dialog politik të ngushtë me institucionet e Bashkimit Evropian dhe vendet anëtare të tij. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) në datë 1 prill 2009, dialogu politik institucional me Bashkimit Evropian zhvillohet në kuadër të takimeve të Këshillit të Stabilizim Asociimit, të Komitetit dhe gjashtë Nënkomiteteve të Stabilizimi Asociimit, si dhe në kuadër të Komitetit ndër-parlamentar midis Parlamentit Evropian dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Shqipëria ka aplikuar për anëtarësim në Bashkimin Evropian në vitin 2009. Komisioni Evropian në raport-progresin e tij vjetor të vitit 2013 i ka rekomanduar Parlamentit Evropian dhe Këshillit që t'i akordojë vendit statusin kandidat. Dialogu politik zhvillohet intensivisht në disa nivele ndërmjet institucioneve shqiptare edhe atyre të Bashkimit Evropian për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara për të ndërmarrë këtë hap.

Ecuria e integritimit evropian të Shqipërisë diskutohet edhe në nivel dypalësh me vendet anëtare të Bashkimit Evropian me rastin e vizitave të nivelit të lartë.

I.2 Situata në Shqipëri

Shqipëria ka vazhduar të angazhohet në një dialog të rregullt politik me Bashkimin Evropian për çështjet e politikës së jashtme të sigurisë. Sa i përket PBJS (CFSP), Shqipëria i është bashkuar të gjitha qëndrimeve të Bashkimit Evropian dhe vendimeve të Këshillit, kur i është kërkuar. Shqipëria i është bashkuar edhe qëndrimeve të BE në OKB, dhe ka bashkë-sponsorizuar rezolutat e Bashkimit Evropian. Shqipëria vazhdon të marrë pjesë në operacionet e menaxhimit të krizave civile dhe ushtarake në kuadër të sigurisë dhe të mbrojtjes politike të përbashkët.

Republika e Shqipërisë beson thellësisht në vlerat evropiane të demokracisë, shtetit të së drejtës dhe mbrojtjes e respektimit të të drejtave të njeriut.

Në themel të vizionit të politikës së jashtme të Shqipërisë qëndron ndërtimi i marrëdhënieve dy dhe shumëpalëshe të karakterizuara nga fryma e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit. Në zbatim të këtij orientimi themelor të politikës së jashtme, Shqipëria ka adoptuar gjithnjë e më shumë një rol të dukshëm aktiv në favor të paqes dhe stabilitetit në rajon, e më gjerë.

Republika e Shqipërisë konsideron se bashkëpunimi rajonal dhe pronësia rajonale janë jo vetëm parakushte të integritimit evropian, por edhe domosdoshmëri e kohës për të transformuar përfundimisht imazhin e rajonit tonë. Ky orientim i politikës sonë të jashtme reflektohet në të pjesëmarrjen tonë proaktive në të gjitha nismat dhe organizatat shumëpalëshe që veprojnë në rajonin e Evropës Juglindore e më gjerë.

Në planin ndërkombëtar, Republika e Shqipërisë i kushton vëmendje gjithnjë e më rritje pjesëmarrjes aktive dhe përfaqësimit të saj në organizatat ndërkombëtare, me të cilat ndan vlera të përbashkëta.

Shqipëria do të vazhdojë të sigurojë koordinimin dhe bashkëpunimin në planin kombëtar, rajonal e ndërkombëtar, me qëllim që të zvogëlojë në maksimum rrezikun ndaj terrorizmit që lidhet me vendin dhe interesat tona, duke siguruar përmirësimin e elementeve të sigurisë dhe rritjen e besimit të komunitetit për masat parandaluese ndaj akteve dhe fenomeneve terroriste.

I.3 Struktura e kapitullit

1. DIALOGU POLITIK
2. BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTRAJE
3. KONTROLI I ARMËVE
4. ZBATIMI I MASAVE KUFIZUESE DHE SANKSIONEVE EKONOMIKE
5. LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT
6. POLITIKA EUROPIANE E SIGURISË DHE MBROJTJES
7. SISTEMI I VIZAVE

II. Situata aktuale

Lidhur me kontributin në kuadër të PJSM, Shqipëria vijon të kontribuojë me 1 (një) ushtarak në Operacionin EUFOR - Althea në Bosnjë-Hercegovinë, në funksionin “Këshilltar për Shtabë”, në Shtabin Qendror të Operacionit “ALTHEA”. Lidhur me politikën e vizave, realizimi i lëvizjes pa viza i shtetasve shqiptarë në vendet e Bashkimit Evropian që zbatojnë marrëveshjen Shengen, përbën një arritje të MPJ dhe të gjitha institucioneve shqiptare të përfshira në këtë proces.

Lidhur me mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, Shqipëria ka vijuar zbatimin e planit të veprimit për shkatërrimin e armatimeve shtesë. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për përmbylljen e një regjistri kombëtar të armëve dhe municioneve nën menaxhimin e Policisë së Shtetit.

Shqipëria nuk e ka miratuar Ligjin për Masat Kufizuese që do të ofrojë procedurën e unifikuar për zbatimin e masave kufizuese si ndaj vendeve të treta ashtu edhe ndaj aktorëve jo-shtetërorë. Baza ligjore për zbatimin e masave kufizuese të vëna nga BE dhe OKB mund të gjenden në Kushtetutën e Shqipërisë. Megjithatë, masat kufizuese financiare në fjalë janë të rregulluara në detaje në Ligjin për Masat kundër financimit të terrorizmit. Ligji parashikon përkufizimin bazë të pasurive dhe pronave të tjera që janë objekt i masave të synuara financiare kufizuese.

Autoriteti përgjegjës për zbatimin e masave të synuara financiare kufizuese është Ministria e Financave, e cila merr vendimin për një bllokim të përkohshëm, konfiskimin apo ngrirje të fondeve dhe të pasurive të tjera financiare.

Përveç kësaj, ligji parashikon që Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, të jetë autoriteti përgjegjës për mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe shkëmbimin e të dhënave për zbatimin e masave kundër terrorizmit. Struktura organizative dhe funksionet kryesore të Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave janë dhënë në kuadër të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Në bazë të këtij ligji, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave i raporton drejtpërdrejtë Ministrit të Financave dhe shërben si Njësi e Inteligjencës Financiare të Shqipërisë

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

Detyrimi për të përafruar legjislacionin shqiptar mbi informacionin e klasifikuar me atë të Bashkimit Evropian rrjedh prej nenit 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Përsa i përket Armëve të Shkatërrimit në Masë, strategjia e BE nënvizon rëndësinë e të vepruarit në mënyrë që të zgjidhen, parandalohen, frenohen, ndalohen dhe të eliminohen programet për shtimin e këtyre armëve dhe raketave. BE është e angazhuar në sistemin traktateve shumëpalëshe, të cilat ofrojnë bazat ligjore dhe normative për të gjitha përpjekjet për mos shtimin e këtyre armëve. Politika e BE është e angazhuar në zbatimin dhe universalizimin e normave ekzistuese të çarmatimit dhe të mospërhapjes. Për këtë qëllim, ne do të angazhohemi në universalizimin e NPT-s, të marrëveshjeve të Sigurisë së IAEA-s dhe protokollet shpesh të tyre, CWC-s, BTWC-s, HCOC-s, dhe hyrjes së mëhershme në fuqi të CTBT-s. Politikat e BE-s kërkojnë që të përparohet në luftën kundër armëve biologjike dhe kimike të deklaruar universalisht të jashtëligjshme në përputhje me ligjet e detyrueshme ndërkombëtare. Politikat e BE-s zbatojnë marrëveshjet ndërkombëtare në ndalimin e materialeve të zbërthyeshme të armëve bërthamore ose të pajisjeve të tjera bërthamore. BE do të asistojë vendet e treta në përmbytjen e detyrimeve të tyre të bazuara në konventat dhe regjimet shumëpalëshe.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Shih më poshtë.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) është institucioni udhëheqës për GNP të Kapitullit 31. Institucione të tjera të përfshira, janë:

- Ministria e Brendshme;
- Ministria e Mbrojtjes;
- DSIK;
- Këshilli i Ministrave
- INSTAT;

Autoriteti përgjegjës për zbatimin e regjimit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë është Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE).

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

Kosto administrative të parashikuara në PBA.

III. Prioritetet

Objektivi është që të jenë plotësisht në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fushën e përbashkët së përbashkët të jashtme të sigurisë dhe të mbrojtjes në të ardhmen e afërt. Prioritetet e Shqipërisë janë të lidhura me politikën e BE-së në fushën e Politikës së përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PJSM).

Shqipëria vijon të njehsojë bazën ligjore në fushën e politikës së jashtme të sigurisë dhe mbrojtjes. Përpjekje të mëtejshme nevojiten për përmbylljen e regjistrimit elektronik të armëve dhe municioneve nën menaxhimin e Policisë së Shtetit. Në tërësi, përgatitet në fushën e politikës së jashtme të sigurisë dhe mbrojtjes janë në rrugën e duhur.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2014 – 2016

IV.1 Dialogu politik

Integrimi Evropian i Shqipërisë është konsideruar si një objektiv strategjik dhe një garanci për paqen, stabilitetin dhe prosperitetin e rajonit dhe më gjerë. Në këtë kontekst, Shqipëria është e gatshme të ndërmarrë të gjitha reformat e nevojshme për të përfunduar procesin e Integrimit Evropian, me qëllim që të arrijë marrjen e statusit të kandidatit dhe hapjen e negociatave për anëtarësim.

Shqipëria zhvillon një dialog politik intensiv me Bashkimin Evropian dhe Shtetet Anëtare të saj. Ky dialog zhvillohet në vazhdimësi në kuadrin e Këshillit të Stabilizim Asociimit dhe të strukturave të përbashkëta nën Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA).

IV.2 Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare

Pjesëmarrja e Shqipërisë në Organizatat Rajonale

Organizatë rajonale	Data e pranimit
SEECF Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore	1996
RCC Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal	27 Shkurt 2008
CEI Nisma e Evropës Qendrore	1996
BEDZ/BSEC Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi	25 Qershor 1992
NAJ Nisma Adriatiko-Joniane	20 Maj 2000
MARRI Nisma Rajonale për Migracionin, Azilin dhe Refugjatët	2003
RACVIAC Qendra Rajonale për Verifikimin e Kontrollit të Armëve	2000
A-5 Karta e Partneritetit të Adriatikut	2 Maj 2003

Pjesëmarrje e Shqipërisë në Organizatat Ndërkombëtare

Organizatë Ndërkombëtare	Data e pranimit
OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara	14 Dhjetor 1955
OSBE	20 Qershor 1991
Këshilli i Evropës	13 Korrik 1995
IAEA Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike	29 Korrik 1957
CTBTO - Organizata e Traktatit për Ndalimin Gjithëpërfshirës të Provave Bërthamore	1996
IOF - Organizatën Ndërkombëtare e Frankofonisë	1999

UNAOC - Aleanca e Qytetërimeve e Kombeve të Bashkuara	2005
UNESCO – Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën	1958
IACA – Akademia Ndërkombëtare Antikorrupsion	21 Shtator 2011

IV.3 Kontrolli i armëve

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periodha e referuar
Implementimi i Dokumentit të Vjenës 2011 (Dokumenti i Vjenës është një marrëveshje midis shteteve pjesëmarrëse për implementimin dhe marrjen e masave për parandalimin e konflikteve nën ombrellën e OSBE-së)	Ministria e Mbrojtjes	2011 - vijimësi

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1334/2000	Ligji “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, i ndryshuar. nr. 9707, datë 05.04.2007	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror i Eksporteve	I pjesshëm	24.04.2007	09.05.2007
Lista e përbashkët ushtarake e Bashkimit Evropian (2010/C 69/03)	Vendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror i Eksporteve	I plotë	09.02.2011	24.02.2011

	të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve” nr. 106, datë 09.02.2011				
Direktivë (91/477/KEE)	Ligji nr. 99/2013 “Mbi armët”	Ministria e Punëve të Brendshme	I plotë	18.03.2013	03.07.2013

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Nuk aplikohet	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
<u>AFAT MESËM (2015 – 2016)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.4 Zbatimi i masave kufizuese dhe sanksioneve ekonomike

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni drejtues	Periodha e referuar
n/a	n/a	n/a

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Rregullorja e Këshillit (KE) Nr. 1167/2008	Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 106, datë 9.02.2011 “Për miratimin e listës së përditësuar të mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive, me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve”	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror i Eksporteve	I plotë	9.02.2011	24.02.2011
	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 43, datë 16.01.2008	Ministria e Mbrojtjes / AKSHE	I pjesshëm	30.01.2008	30.01.2008
	Ligji nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”	Ministria e Drejtësisë	I pjesshëm	10.10.2013	13.11.2013

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli	Institucioni kryesor	Periodha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi

<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
<u>AFAT MESEM (2015 – 2016)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.5 Lufta kundër terrorizmit

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia për Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Kundër Terrorizmit	Ministria e Punëve të Brendshme	2014-2020

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Vendimi I Këshillit 2002/475/DCB	Kodi Penal, i miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, të ndryshuar.	Ministria e Punëve të Brendshme	I pjesshëm.	26.02.2007	31.03.2007

Shih më tej Kapitullin 24 të Planit Kombëtar

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

<u>AFAT MESEM (2015 – 2016)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.6 Politika evropiane e sigurisë dhe mbrojtjes

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni drejtues	Periodha e referuar
n/a	n/a	n/a

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Vendim i Këshillit 2001/264/KE,	Ligji “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror””, nr. 8547, i 11.02.1999 i ndryshuar .	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	11.02.1999	13.03.1999
	VKM nr. 121 “Për rregullat e sigurimit fizik të informacionit të klasifikuar”	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	15.03.2001	31.03.2001
	VKM nr. 122 i 15.03.2001 “Për shqyrtimin e pastërtisë dhe për dhënien e “Certifikatës së Sigurisë” personave që do të njihen me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	15.03.2001	31.03.2001
	VKM nr. 377 i 31.05.2001	Drejtoria e Sigurimit të	I pjesshëm	31.05.2001	16.06.2001

	“Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” në marrëdhëniet ndërkombëtare”	Informacionit të klasifikuar			
	VKM nr. 922 i 19.12.2007 “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” që prodhohet, ruhet, përpunohet apo transmetohet në sistemet e komunikimit (INFOSEC)”	Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	19.12.2007	03.01.2008

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Vendimi 2001/844/KE	Ligji “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror””, nr. 8547, i 11.02.1999 i ndryshuar .	Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	11.02.1999	13.03.1999
	VKM nr. 121 “Për rregullat e sigurimit fizik të informacionit të klasifikuar”	Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	15.03.2001	31.03.2001
	VKM nr. 122 i 15.03.2001 “Për shqyrtimin e pastërtisë dhe për dhënien e “Certifikatës së Sigurisë” personave që do të njihen me informacionin e	Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	15.03.2001	31.03.2001

	klasifikuar “Sekret Shtetëror”				
	VKM nr. 377 i 31.05.2001 “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” në marrëdhëniet ndërkombëtare”	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	31.05.2001	16.06.2001
	VKM nr. 922 i 19.12.2007 “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” që prodhohet, ruhet, përpunohet apo transmetohet në sistemet e komunikimit (INFOSEC)”	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	19.12.2007	03.01.2008

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Direktiva 2009/81/KE	Ligji “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror””, nr. 8547, i 11.02.1999 i ndryshuar .	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	11.02.1999	13.03.1999
	VKM nr. 121 “Për rregullat e sigurimit fizik të informacionit të klasifikuar”	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	15.03.2001	31.03.2001
	VKM nr. 122 i 15.03.2001 “Për	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të	I pjesshëm	15.03.2001	31.03.2001

	shqyrtimin e pastërtisë dhe për dhënien e “Certifikatës së Sigurisë” personave që do të njihen me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”	klasifikuar			
	VKM nr. 377 i 31.05.2001 “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” në marrëdhëniet ndërkombëtare”	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	31.05.2001	16.06.2001
	VKM nr. 922 i 19.12.2007 “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret Shtetëror” që prodhohet, ruhet, përpunohet apo transmetohet në sistemet e komunikimit (INFOSEC)”	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të klasifikuar	I pjesshëm	19.12.2007	03.01.2008

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi

<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
<u>AFAT MESEM (2015 – 2016)</u>							
n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a

IV.7 Sistemi i vizave

Lutemi referohuni kapitullit 24 të PKIE

KAPITULLI 32: KONTROLLI FINANCIAR

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Acquis në këtë kapitull lidhet me zbatimin e parimeve ndërkombëtare të rëna dakord për përshtatjen e legjislacionit të BE-së, standardet dhe metodat e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP) që duhet të zbatohen për sistemet e kontrollit të brendshëm në të gjithë sektorin publik, duke përfshirë edhe shpenzimet e fondeve të BE-së. Në veçanti, *acquis* kërkon ekzistencën e një menaxhimi financiar dhe sisteme kontrolli transparente dhe efektive (duke përfshirë kontrollin e përshtatshëm ex-ante, kontrollin financiar në vazhdim dhe ex-post, apo inspektimin); sisteme të brendshme auditimi funksionale dhe të pavarura; struktura organizative përkatëse (duke përfshirë koordinimin në nivel qendror); organizim auditimi të jashtëm operativ dhe funksional për të vlerësuar mbi të gjitha, cilësinë e sistemeve të reja të KBFP. Ky kapitull përfshin gjithashtu *acquis* për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe luftën kundër mashtrimit duke përfshirë fondet e BE-së.

I.2 Situata aktuale e Shqipërisë

Auditimi i jashtëm realizohet nga Institucioni Suprem i Auditimit (KLSH), i quajtur Kontrolli i Lartë i Shtetit. Mandati i KLSH është i sanksionuar në Kushtetutën e vendit, nenet 141-145 dhe në ligjin nr 8270, datë 13 dhjetor 1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000.

Më 26 nëntor, 2012, KLSH ka dorëzuar në Parlament projekt-amendamentet për ligjin e tij, të përgatitur në bashkëpunim me ekspertët e DG-Buxhetit dhe SIGMA. Në mars 2014, Parlamenti i Shqipërisë filloi diskutimet për projekt-ndryshimet në ligjin e KLSH-së në Komisionin Parlamentar për Ekonominë dhe Financat. Aktualisht, projekt-amendamentet e ligjit të KLSH-së po diskutohen në Komisionin Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Kuadri ligjor për implementimin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (KBFP) është përcaktuar në Menaxhimin e Sistemit Buxhetor, Ligjin e Auditimit të Brendshëm 2007 dhe Ligjin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në 2010. Këto ligje krijojnë një kuadër të përshtatshëm ligjor për zbatimin e tri shtyllave të KBFP, përkatësisht, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), një funksionim të pavarur të Auditimit të Brendshëm dhe një Njësi Qendrore Harmonizimi (NJQH) për zhvillimin e metodologjive dhe standardeve për MFK dhe AB. Roli kryesor dhe përgjegjësitë për zhvillimin dhe implementimin e KBFP i mbeten Ministrisë së Financave, e cila përbush këtë rol nëpërmjet veprimtarisë së Njësisë Qendrore të harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (NJQH/MFK), Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (NJQH/AB) dhe Shërbimin e Inspektimit Financiar në marrëveshje me të gjithë institucionet buxhetore.

Si element përbërës i KBFP, Auditimi i Brendshëm ka tashmë kuadrin ligjor bazë, i cili rregullon veprimtarinë audituese si edhe veprimtarinë e Komitetit të Auditimit të Brendshëm e Komisionit Shtetëror të Certifikimit për audituesit e brendshëm. Ky kuadër ligjor është azhurnuar e përmirësuar gjatë viteve për të siguruar përputhje të plotë me Standardet e pranuar ndërkombëtare dhe praktikat më të mira në fushën e auditimit. Njësitë e auditimit të brendshëm të krijuara në zbatim të ligjit të auditimit, ushtrojnë veprimtarinë e tyre audituese brenda autoritetit, objektit dhe sipas përgjegjësiave e të drejtave të parashikuara në këtë ligj dhe sipas kuadrit rregullator në fuqi. Funksioni i auditimit të brendshëm si veprimtari e pavarur, mbështet menaxhimin e subjekteve publike për arritjen e objektivave të tyre, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka qenë kryesisht i fokusuar në kontrollet financiare të përputhshmërisë me rregullimet ligjore, dhënien e sigurisë se, fondet buxhetore janë përdorur vetëm për qëllimet e parashikuara nga ligji dhe në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. Kjo kërkesë

do të vazhdoje të mbetet e rëndësishme edhe në të ardhmen, por menaxherëve në të gjitha nivelet do t'ju duhet të tregojnë se, fondet publike janë përdorur në mënyrë eficiente dhe efektive.

Banka e Shqipërisë¹ ka krijuar pranë Departamentit të Emisionit, Zyrën e Qendrës Kombëtare të Analizës. Qëllimi kryesor i njësive është përqendrimi i integruar i aktiviteteve që kanë të bëjnë me parandalimin dhe zbulimin e falsifikimit, ekspertizën, përpunimin, mbajtjen dhe ruajtjen e të dhënave teknike dhe statistikore për paratë e falsifikuara në nivel kombëtar, duke bashkëpunuar për këtë qëllim me autoritetet kompetente brenda dhe jashtë vendit.

Banka e Shqipërisë² është autoriteti përgjegjës për sekuestrimin dhe konfiskimin e kartëmonedhave dhe monedhave false. Në përmbushjen e objektivit të mbrojtjes së euros nga falsifikimi, Banka e Shqipërisë ka marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e euros nga falsifikimi, nëpërmjet miratimit të rregulloreve të posaçme për kontrollin e autenticitetit të tyre, si dhe bërjen funksionale të Qendrës Kombëtare të Analizës. Kjo strukturë ka kapacitete teknike administrative të nevojshme dhe është e pajisur me kabinetin *forensic* për ekspertizën e kartëmonedhave. Aktualisht janë duke u instaluar pajisjet shtesë për ekspertizën e monedhave, në përputhje me kërkesat e dala nga rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 1338 e datës 28.06.2001 dhe Vendimit të Këshillit 2001/887/JHA mbi mbrojtjen e euros nga falsifikimi.

I.3 Struktura e kapitullit

1. AUDITIMI I JASHTËM (SHTETËROR)
2. AUDITIMI I BRENDSHËM
3. KONTROLI I BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK (KBFP)
4. INSPEKTIMI FINANCIAR PUBLIK
5. MBROJTJA E EURO-S NGA FALLSIFIKIMI

II. Situata Aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA dhe legjislacionit të BE

¹ Me vendimin nr. 57, datë 27.07.2011 të Këshillit Mbikëqyrës.

² Në bazë të ligjit për Bankën e Shqipërisë.

Detyrimet për të përafruar legjislacionin shqiptar për Kontrollin financiar me atë të BE-së rrjedhin nga Nenet 70 dhe 90 të MSA.

Legjislacioni i BE-së përfshin dispozita bazë mbi mbledhjen dhe analizën e të dhënave teknike dhe statistikore në lidhje me kartëmonedhat dhe monedhat e falsifikuara si dhe mbi bashkëpunimin midis autoriteteve kombëtare në vendet e BE-së, Komisionit, Bankës Qendrore Evropiane, vendeve jo anëtare të BE-së dhe organizatave ndërkombëtare.

- Rregullore 1338/2001/KE mbi mbrojtjen e euros nga falsifikimi në eurozonë dhe rregullorja amenduese 44/2009/KE.
- Rregullore 1339/2001 mbi mbrojtjen e euros nga falsifikimi jashtë eurozonës dhe rregullorja amenduese 45/2009/KE.
- Rregullorja e Këshillit Nr. 45/2009 datë 18 dhjetor 2008 amendon Rregulloren Nr. 1339/201 duke zgjeruar efektet e Rregullores Nr. 1338/2001 që përcakton masat e nevojshme mbi mbrojtjen e euros nga falsifikimi të shteteve anëtar të cilat nuk e kanë adoptuar euron;
- Vendimit të Këshillit 2001/887/JHA mbi mbrojtjen e euros nga falsifikimi
- Rregullore 1210/2010 e Parlamentit dhe e Këshillit datë 15 dhjetor 2010 mbi autenticitetin e monedhave euro dhe trajtimin e monedhave të papërshtatshme për qarkullim.
- Rregullore 2182/2004 mbi medaljonet dhe xhetonat me pamje të ngjashme me monedhat euro në eurozonë dhe rregullorja amenduese 46/2009.
- Rregullore 2183/2004 mbi medaljonet dhe xhetonat me pamje të ngjashme me monedhat euro jashtë eurozonës dhe rregullorja amenduese 47/2009.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Në përgjithësi, Shqipëria ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga MSA.

Aktiviteti i KLSH-së rregullohet nga:

- Nenet 158/5, 162 - 165 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë¹;
- Ligji nr. 8270, datë d 23.12.1997 "Mbi Kontrollin e Lartë të Shtetit"²; ndryshuar nga Ligji nr. 8599, datë 01.06.2000³;
- Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 212, datë 29.10.2002¹.

¹ Fletorja Zyrtare e Shqipërisë, Nr. 28, fq. 1073, 07/12/1998.

² Fletorja Zyrtare e Shqipërisë, Nr. 20, fq. 503, 07/01/1998.

³ Fletorja Zyrtare e Shqipërisë, Nr. 15, fq. 699, 21/06/2000.

Në 26 Nëntor, 2012, KLSH i dërgoi Parlamentit projekt-amendimet për Ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 "Mbi Kontrollin e Lartë të Shtetit", duke përfshirë rekomandimet përkatëse dhe komentet e SIGMA-s dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Komisionit Evropian (DG Budget). Këto amendime synojnë të rregullojnë përfundimisht pavarësinë e institucionit, konceptin modern të të drejtave dhe detyrimeve të KLSH-së, rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve, kapacitetin administrativ, vërtetësinë e të drejtës së KLSH-së për të audituar fondet e BE-së në Shqipëri, deri tek përdoruesi i fundit, si dhe përcaktimin e të drejtës për të certifikuar llogaritë financiare.

Kuadri ligjor për **auditimin e brendshëm**, reflekton standardet evropiane në këtë fushë dhe përbëhet nga:

- Ligji Nr. 9720 datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, ndryshuar me ligjin Nr. 10318, datë 16.09.2010 “Për disa ndryshime në ligjin për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 806 datë 6.12.2006 “Për miratimin e metodologjisë së auditimit financiar publik”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 886, datë 19.12.2007 “Për krijimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Komisionit të Kualifikimit për Certifikimin e Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 640, datë 11.6.2009, “Për miratimin e letërpolitikave për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik dhe të Planit të Veprimit 2009-2014”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 212, datë 30.03.2012, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”;
- Urdhri i Ministrit të Financave Nr. 69, datë 29.09.2010 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”;
- Udhëzim i Ministrisë së Financave Nr. 12, datë 05.06.2012, “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”;
- Urdhri i Ministrit të Financave Nr. 71, datë 26.12.2012 “Për miratimin e kuadrit rregullator të procesit të kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik” ku përfshihen:
 - Rregullorja mbi zhvillimin e vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik;
 - Rregullorja për procedurat e certifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik;
 - Rregullorja mbi veprimtarinë e komisionit të kualifikimit për certifikimin e audituesve të brendshëm në sektorin publik.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 5, datë 29.01.2013 “Për tarifat e aplikuara në procesin e kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik”.

¹ Fletorja Zyrtare e Shqipërisë, Nr. 69, fq. 1923, 08/11/2002.

Ky kuadër, është në përputhje me modelin Committee of Sponsoring Organizations dhe praktikat më të mira të EU-së, dhe ka një shkallë përafrimi të plotë.

Kuadri ligjor për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit nuk ka acquis të detyrueshme. Megjithatë, të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në këtë fushë, janë hartuar duke u bazuar në direktivat e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Komisionit Evropian, Bruksel.

Në përgjithësi dhe duke ju referuar rekomandimeve të Komisionit Evropian sipas Raport Progresit 2010, Shqipëria ka përafruar pjesërisht kuadrin e saj ligjor dhe rregullativ me dispozitat kryesore ligjore të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së monedhave dhe kartëmonedhave nga falsifikimi.

Ngritja e strukturës së posaçme Qendra Kombëtare e Analizës, përgjegjëse për mbledhjen, analizën dhe përpunimin teknik dhe statistikor të të dhënave të parasë së falsifikuar përbën një arritje në përputhje me praktikën e ndjekur nga Bankat Qendrore të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, sipas rregullores së Këshillit të BE-së nr. 1338/2001 e 28 Qershorit 2001 mbi përcaktimin e masave të nevojshme për mbrojtjen e euros nga falsifikimi. Po në përputhje me këtë rregullore, ku parashikohet bashkëpunimi i Qendrës Kombëtare të Analizës me Bankën Qendrore Evropiane, Banka e Shqipërisë aktualisht po negocion një memorandum mirëkuptimi me Bankën Qendrore Evropiane mbi çështjet e mbrojtjes së euros nga falsifikimi.

Kodi Penal i Shqipërisë në dispozitat në lidhje me sanksionet e parashikuara ndaj veprës penale të falsifikimit të parave nuk është i përafruar me Direktivën Kuadër të Këshillit të BE-së 2000/383/JHA mbi rritjen e mbrojtjes së parave nga falsifikimi nëpërmjet vendosjes së sanksioneve përkatëse. Në Direktivën e sipërpërmendur parashikohet një dënim minimal kundrejt veprës penale të falsifikimit të parave prej minimumi tetë vjet burg. Ndërkohë, në Kodin Penal të Shqipërisë dënimi i kësaj vepre penale arrin në pesë vjet burg. Gjithashtu, Kodi Penal i Shqipërisë duhet të përafrohet me dispozitat e Direktivës 2000/383/JHA edhe në përcaktimin e veprës penale të importit, eksportit, transportit të parave të falsifikuara.

Bazuar në ligjin e Bankës së Shqipërisë, neni 40 - sipas të cilit Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për sekuestrimin dhe konfiskimin e kartëmonedhave dhe monedhave metalike false - Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë ka miratuar dy rregullore¹ gjatë vitit 2013 të cilat kanë si qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave në trajtimin e parave të dyshuara të falsifikuara, si shqiptare dhe të huaja. Këto dy rregullore janë pjesërisht të përafruara me rregulloren e Këshillit të BE-së nr. 1338/2001 e 28 Qershorit 2001 mbi përcaktimin e masave të nevojshme për mbrojtjen e euros nga falsifikimi dhe rregulloren 45/2009/EC e cila ndryshon rregulloren e BE-së 1339/2001/EC. Institucionet bankare dhe jo-bankare të licencuara nga Banka e Shqipërisë kanë detyrimin të tërheqin dhe të dorëzojnë pranë Qendrës Kombëtare të Analizës kartëmonedhat dhe monedhat e dyshuara si të falsifikuara, shqiptare dhe të huaja, duke përfshirë euron.

II.3. Institucionet përgjegjëse

- Ministria e Financave,
- Kontrolli i Lartë i Shtetit
- Banka e Shqipërisë.

Grupi Ndër-institucional i Punës për Integrimin Evropian, i krijuar me Urdhrin e Kryeministrit me nr. 107, datë 28.02.2014, “Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e Grupeve Ndër-institucionale të Punës”, për Kapitullin 32 “Kontrolli financiar” kryesohet nga Ministria e Financave

Institucioni i Auditit Suprem (Kontrolli i Lartë i Shtetit apo ALSAI), është institucion kontribuues në Grupin Ndër-institucional të Punës për këtë Kapitull në lidhje me pjesën e Auditit të Jashtëm Shtetëror.

Njësia Qendrore e Harmonizimit (NJQH/MFK dhe NJQH/AB) në Ministrinë e Financave kontribuon në Grupin Ndër-institucional të Punës për të përmirësuar sistemin e kontrollit të brendshëm financiar publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.

¹ Vendimi nr 41, datë 26.06.2013 për miratimin e rregullores “PËR TRAJTIMIN E KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE SHQIPTARE TË DYSHUARA SI TË FALSIFIKUARA” dhe vendimi nr.49, datë 31.07.2013 për miratimin e rregullores “PËR TRAJTIMIN E KARTËMONEDHAVE DHE MONEDHAVE EURO E TË TJERA TË HUAJA TË DYSHUARA TË FALSIFIKUARA”.

Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik në Ministrinë e Financave kontribuon në pjesën e inspektimit financiar, bazuar në ligjin me nr. 10294, të datës 01/07/2010, “Për Inspektimin financiar publik”, për të mbrojtur interesat financiare të enteve publike ndaj keq menaxhimit financiar, mashtrimit dhe korrupsionit.

Banka e Shqipërisë është gjithashtu institucion kontribuues për mbrojtjen e EURO-s ndaj falsifikimit.

II.4 Sqarimi në lidhje me parashikimet financiare

KLSH do të përfitojë për periudhën 2015-2016, 2.11 milion euro nga Projekti i Binjakëzimit IPA 2013, mbi ngritjen e kapaciteteve audituese. Aktualisht, për periudhën afat-mesme, nuk janë të parashikuara kontribute nga donatorë të tjerë për KLSH-në.

Për Auditimin e Brendshëm

<i>3.32.2 Auditimi i brendshëm</i>	2012	2013	2014	2015
Kosto gjithsej	430,470	443,384	456,685	470,386
Të mbuluara nga buxheti i shtetit	430,470	443,384	456,685	470,386
Të mbuluara nga asistenca e huaj	0	0	0	0
Të pambuluara	0	0	0	0

Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Në Euro

	2012	2013	2014	2015	2016
Kosto gjithsej nga buxheti i shtetit			100.000 (Projekti "Zbatimi i një sistemi modern për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe inspektimin financiar publik në Shqipëri")		
Kosto gjithsej nga asistenca e huaj	900.000 (Projekti "Mbështetje për Ministrinë e Financave të Shqipërisë për zhvillimin e menaxhimit dhe kontrollit për fondet publike"). Projekti është shtyrë deri në shtator 2014		2.000.000 (Projekti "Zbatimi i një sistemi modern për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe inspektimin financiar publik në Shqipëri")		

Për Inspektimin financiar Publik

Në milionë lekë

Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik	2014	2015	2016
Kosto gjithsej	70	0	0
Të mbuluara nga buxheti	0	0	0
Të mbuluara nga asistenca e huaj	70	0	0
Të pambuluara	0	0	0

III. Prioritetet

Në fushën e kontrollit financiar ka pasur progres. Ekziston kuadri ligjor për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik, por nevojiten përpjekje të mëtejshme për rritjen e kapaciteteve për zbatimin e tij. Në fushën e auditimit të jashtëm, nevojitet të bëhen amendimet e Ligjit për KLSH. Në përgjithësi, po ecet në mënyrë të moderuar me përgatitjet për amendimin e këtij ligji.

Në fushën e **auditimit të jashtëm**, janë bërë ndryshime organizative dhe janë futur procedura të reja për të rritur efikasitetin e KLSH. Është në fazën e hartimit Planit Strategjik 2013-2017. Megjithatë, amendimet për Ligjin për KLSH janë që prej vitit 2012 për shqyrtim në Parlament dhe mbetet të miratohen me një shumicë prej 3/5. Aktualisht, nuk ka një ndjekje sistematike nga parlamenti të raporteve të KLSH-së.

Në fushën e **mbrojtjes së interesave financiare të BE-së**, nuk është plotësuar akoma rekrutimi i stafit për Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik, e cila shërben si pikë kontakti për bashkëpunimin me Komisionin Evropian. Nevojitet zhvillimi i kapaciteteve administrative.

Prioritetet afat-mesme të KLSH-së, të përfshira në Planin Strategjik 2013-2017, janë:

- Thellimi dhe konsolidimi i auditimit financiar;
- Zhvillimi dhe rritja e numrit të auditimeve të performancës;
- Zhvillimi i auditimit të IT;
- Përputhshmëria e plotë me standardet e INTOSAI-t;
- Përmirësimi i qeverisjes publike, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Progres Raporti i KE-së për 2013, vëzhgon dhe rekomandon se:

- “Amendimet në Kuvend ndaj Ligjit organik të KLSH janë në pritje dhe po ashtu pritet të zbatohet një auditim i qëndrueshëm i performancës”. (Faqe 8 e Raportit), ndërsa në faqen 56, vëzhgon dhe rekomandon se:
- “Amendimet në Ligjin e KLSH-së janë që prej vitit 2012 nën shqyrtim nga Parlamenti dhe mbeten për t’u miratuar me shumicën e 3/5-ve”.

Aktualisht, nuk ka një ndjekje sistematike nga parlamenti të raporteve të KLSH-së.

Për Auditimin e Brendshëm

- Të gjitha reformat në fushën e Kontrollit të Brendshëm që nuk do të finalizohen në fund të kësaj periudhe, do të bëhen pjesë e Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020.
- Mbikëqyrja dhe menaxhimi i politikës së trajnimeve si edhe cilësia e kontrollit të jashtëm dhe vlerësimi i njësive të auditit të brendshëm në institucionet publike, do të jetë në fokus të CHU/IA.
- Rishikimi i procesit të certifikimit të Auditëve të Brendshëm, duke i klasifikuar auditet në nivele të ndryshme, në përputhje me rekomandimet e SIGMA, OECD.
- Hartimi i një udhëzimi më praktik për të ndihmuar njësitë e auditimit të brendshëm për të bërë punën e tyre më efektive.
- Sigurimi që, implikimet e auditimit të brendshëm për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe politikën e kontrollit janë reflektuar në trajnimin e audituesve të brendshëm.

Duke qenë se koncepti i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit ka marrë përparësi gjatë viteve të fundit, procesi i menaxhimi të riskut është në fillimet e tij dhe për momentin, institucionet janë të fokusuara në identifikimin e risqeve dhe ndërtimin e regjistrave të riskut. Prioritet për të ardhmen do të jenë:

- futja e procesit të vlerësimit të riskut dhe menaxhimi i tij në drejtim të minimizimit;
- rritja e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale e njësive të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe departamenteve të financave të institucioneve publike.

Për Inspektimin Financiar Publik

- Rishikimi i Ligjit Nr. 10294, datë 01.07.2010 “Për inspektimin financiar publik”, në bashkëpunim me Projektin IPA 2012;
- Trajnimi i punonjësve të Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik si edhe i inspektorëve financiarë publikë ad-hoc.

Për Bankën e Shqipërisë

Në lidhje me **mbrojtjen e euro-s ndaj falsifikimit**, Banka e Shqipërisë ka zbatuar rregulloren mbi sigurimin e autencitetit të kartëmonedhave dhe ka krijuar një laborator *forensic* që do të ekzaminojë të gjitha kartëmonedhat e falsifikuara, duke përfshirë kartëmonedhat euro.

- Rritja e kapaciteteve të punonjësve të Zyrës së Qendrës Kombëtare të Analizës;
- Ngritja pranë Zyrës së Qendrës Kombëtare të Analizës të laboratorit për analizimin e kartëmonedhave dhe monedhave metalike të dyshuara si të falsifikuara;
- Pjesëmarrje në programin Pericles të Bashkimit Evropian;
- Miratimi i ndryshimeve të ligjit për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, në lidhje me sanksionet e parashikuara në rast të falsifikimit të kartëmonedhave dhe monedhave;
- Përafrim i mëtjeshëm i legjislacionit shqiptar me atë të BE-së në fushën e mbrojtjes së parasë nga falsifikimi.

IV. Plani i veprimeve për periudhën 2014 – 2016

IV.1 Auditimi i jashtëm

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia e zhvillimit të KLSH 2013-2017 dhe Plani i veprimit 2013-2017	KLSH	2013-2017

Inventari i masave ligjore ekzistuese

Acquis e BE	Legjislacioni shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm /mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni shqiptar)
Neni 287 i Traktatit për Funksionimin e BE	Neni 158/5, 162 - 165 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë	KLSH	Përputhshmëri e pjesshme me Standardet e INTOSAI	21.10. 1998	Tetor 1998
Neni 287 i Traktatit për Funksionimin e BE	Ligji nr. 8270, dt. 23.12.1997 "Ligji për Kontrollin e Lartë të Shtetit";	KLSH	Përputhshmëri e pjesshme me Standardet e INTOSAI	23.12. 1997	15.01.1998
Neni 287 i Traktatit për Funksionimin e BE	Amenduar me Ligjin nr. 8599, dt. 01.06.2000	KLSH	Përputhshmëri e pjesshme me Standardet e INTOSAI	01.06.2000	Qershor 2000

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategjia ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja ne fuqi
Strategjia e Komunikimit e KLSH	KLSH	2015-2017	Qershor 2014	Qershor 2015

Masat ligjore te parashikuara për periudhën 2014 – 2016

Acquis e BE	Statusi i përkthimit ne shqip (po/jo)	Legjislacioni shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Statusi i përkthimit në anglisht (po/jo)	Institucioni përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhshmëri e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja ne fuqi
AFAT SHKURTËR (2014)							
Standardet e INTOSAI	Po	Amendimet e ligjit aktual nr. 8270, dt. 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit"; amenduar me ligjin nr. 8599, dt. 01.06.2000	Përkthyer si draft	KLSH	Përputhshmëri e plotë me Standardet e INTOSAI.	T2 2014	T2 2014

IV.2 Auditimi i brendshëm

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Letërpolitikat për kontrollin e brendshëm financiar publik dhe plani i veprimit 2009-2014, aprovuar me VKM 640, datë 11.06.2009	Ministria e Financave	Në proces

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
Praktikat profesionale ndërkombëtare (IPPF)	Ligji Nr. 9720, datë 23.04.2007, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.	Ministria e Financave NJQH/AB	I plotë	23.04.2007	08.08.2007
(IPPF)	Ligji Nr. 10318, datë 16.09.2010 “Për disa ndryshime në ligjin për auditimin e brendshëm në sektorin publik”	Ministria e Financave NJQH/AB	I plotë	16.09.2010	7.10.2010
IPPF	VKM nr. 806 datë 06.12.2006, “Për miratimin e metodologjisë së auditimit financiar publik”	Ministria e Financave NJQH/AB	I plotë	06.12.2006	28.12.2006
IPPF	VKM nr. 886, datë 19.12.2007, “Për krijimin, funksionimin dhe shpërblimin e anëtarëve të Komisionit të Kualifikimit për Certifikimin e Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar.	Ministria e Financave NJQH/AB	I plotë	19.12.2007	31.12.2007
	VKM, nr 640, datë 11.06.2009 "Për miratimin e letër politikave për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik dhe Planin e Veprimit 2009-2014".	Ministria e Financave NJQH/AB	I plotë	11.06.2009	17.07.2009
IPPF	VKM me nr. 680, datë 05.10.2011 "Për miratimin e masës së kompensimit për anëtarët e menaxhimit të bordit për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik dhe Komitetin e Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar"	Ministria e Financave NJQH/AB	I plotë	05.10.2011	01.11.2011
IPPF	VKM nr. 212, datë 30.03.2012, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik ”.	Ministria e Financave NJQH/AB	I plotë	30.03.2012	29.04.2012
IPPF	Urdhri i Ministrisë të Financave Nr. 69, datë 29.09.2010 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.	Ministria e Financave NJQH/AB	I plotë	29.09.2010	29.09.2010

IPPF	Udhëzim i Ministrisë së Financave Nr. 12, datë 05.06.2012, "Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik"	Ministria e Financave NJQH/AB	I plotë	05.06.2012	05.06.2012
IPPF	Urdhri i Ministrit të Financave Nr. 71, datë 26.12.2012 "Për miratimin e kuadrit rregullator të procesit të kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik"	Ministria e Financave NJQH/AB	I plotë	26.12.2012	26.12.2012
IPPF	Udhëzimi i Ministrisë së Financave Nr. 5, datë 29.01.2013 "Për tarifat e aplikuar në procesin e kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik"	Ministria e Financave NJQH/AB	I plotë	29.01.2013	29.01.2013
IPPF	Urdhri i Ministrit të Financave me nr. 22, datë 05.03.2013 "Për miratimin për vazhdimin e programit për trajnimin për auditët e brendshëm në sektorin publik"	Ministria e Financave, NJQH/AB	I plotë	05.03.2013	05.03.2013

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli (Strategji ose PV ose dokument politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Hartimi i Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020.	Ministria e Financave	2014	T4 2014	T4 2014
Strategjia e trajnimit të Auditëve të Brendshëm	Ministria e Financave (NJQH/AB)	2015	T4 2015	T4 2015

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014-2016

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafritimit (i plotë/i pjesshëm/mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)		
<u>AFAT -SHKURTËR (2014)</u>							
IPPF të zhvilluara nga Instituti i Auditëve të	Po	Rishikimi i Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditin e brendshëm në sektorin	Jo	Ministria e Financave NJQH/AB	I plotë	T4 2014	T4 2014

Brendshëm		publik", i ndryshuar.					
-----------	--	-----------------------	--	--	--	--	--

AFAT-MESËM (2015 – 2016)

IPPF të zhvilluara nga Instituti i Auditëve të Brendshëm	Jo	Rishikimi i VKM Nr. 212, datë 30.03.2012 "Për miratimin e kriterëve për krijimin e njësive të auditit të brendshëm në sektorin publik"	Jo	Ministria e Financave NJQH/AB	I plotë	T1 2015	T1 2015
IPPF të zhvilluara nga Instituti i Auditëve të Brendshëm	Jo	Dërgimi për miratim me urdhër të Ministrit të Financave i "Metodologjisë për cilësinë e kontrollit të brendshëm dhe vlerësimin e njësive/strukturave të Auditit të brendshëm në sektorin publik.	Jo	Ministria e Financave NJQH/AB	I plotë	T4 2015	T1 2016

Plani i veprimeve për periudhën 2014 – 2016

IV.3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Për miratimin e letërpolitikave për kontrollin e brendshëm financiar publik dhe të planit të veprimit 2009-2014"	Ministria e Financave	Vazhdon të jetë në fuqi

Plani 5 vjeçar nr. 11841, datë 10.06.2011 “Për implementimin e një sistemi modern të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Republikën e Shqipërisë”	Ministria e Financave	Vazhdon të jetë në fuqi

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
N/A	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”	Ministria e Financave	N/A	26.06.2008	06.08.2008
N/A	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”	Ministria e Financave	N/A	08.07.2010	01.01.2011
N/A	Udhëzim nr. 8, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike”	Ministria e Financave	N/A	15.12.2011	15.12.2011
N/A	Udhëzim nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, së	Ministria e Financave	N/A	27.12.2011	27.12.2011

	bashku me gjurmët e auditit”				
N/A	Udhëzim nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, së bashku me gjurmët e auditit”	Ministria e Financave	N/A	06.02.2012	06.02.2012
N/A	Udhëzimi nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afat-mesëm”, së bashku me gjurmët e auditit	Ministria e Financave	N/A	29.03.2012	29.03.2012
N/A	Urdhër nr. 5759, datë 10.04.2013 “Për miratimin e metodologjisë për monitorimin e performancës së njësive publike”	Ministria e Financave	N/A	10.04.2013	10.04.2013
N/A	Urdhër nr. 33, datë 11.07.2013 “Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”	Ministria e Financave	N/A	11.07.2013	11.07.2013
N/A	Shkresa nr. 15900, datë 21.10.2013 lidhur me njohjen dhe përgjegjësitë kryesore të Ministrave dhe	Ministria e Financave	N/A	21.10.2013	21.10.2013

	Sekretarëve të Përgjithshëm në procesin e menaxhimit të fondeve publike				
N/A	Udhëzimi nr. 29, datë 24.12.2013 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2013”	Ministria e Financave	N/A	24.12.2013	24.12.2013
N/A	Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 50, datë 05.02.2014 “Strategjia për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit	Ministria e Financave	N/A	05.02.2014	21.02.2014
N/A	Udhëzimi nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”	Ministria e Financave	N/A	27.02.2014	27.02.2014

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
Draft-Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike në Shqipëri ku menaxhimi financiar dhe kontrolli janë përfshirë si nënkomponent i Kontrollit të brendshëm.	Ministria e Financave	2014-2020	Qershor 2014	Shtator 2014

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesëshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
N/A	po	Rishikimi i Ligjit për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë	jo	Ministria e Financave NJQH/MFK	N/A	T4 2014	
N/A	po	Rishikimi i Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”	jo	Ministria e Financave NJQH/MFK	N/A	T4 2014	
<u>AFAT MESEM (2015 – 2016)</u>							
N/A	po	Rishikimi i akteve nënligjore të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”	jo	Ministria e Financave NJQH/MFK		T4 2015	Menjëherë pas përshtatjes
N/A	Po	Manuali Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin	jo	Ministria e Financave NJQH/MFK		T4 2015	Menjëherë pas përshtatjes

IV.4 Inspektimi financiar publik

Plani i veprimeve për periudhën 2014 – 2016

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
N/A	N/A	N/A

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni Shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/i pjesshëm/ mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni Shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni Shqiptar)
N/A	Ligji Nr. 10294, datë 01.07.2010 “Për inspektimin financiar publik.	Ministria e Financave	N/A	01.07.2010	26.07.2010
N/A	VKM Nr. 492, datë 06.07.2011 “Për shpërblimin e inspektorit financiar publik.	Ministria e Financave	N/A	06.07.2011	17.08.2011
N/A	VKM Nr. 850, datë 14.12.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 23, datë 12.01.2011 “Për përcaktimin e funksioneve të përgjegjëseve dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve të strukturave të menaxhimit të decentralizuar të	Ministria e Financave	N/A	14.12.2011	Dhjetor 2011

	asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të instrumentit të parazgjerimit (IPA), komponenti I, Asistenca e tranzicionit dhe forcimi institucional.				
N/A	Urdhër Nr. 36, datë 16.05.2011 “Për kriteret e përzgjedhjes së inspektorëve financiarë publikë”.	Ministria e Financave	N/A	16.05.2011	
N/A	Udhëzim Nr. 11, datë 16.05.2011 “Për kriteret për fillimin e inspektimit financiar publik	Ministria e Financave	N/A	16.05.2011	26.08.2011
N/A	Udhëzim Nr. 17, datë 25.07.2011 “Për përmbushjen e inspektimit financiar publik dhe kontrollin e cilësisë”.	Ministria e Financave	N/A	25.07.2011	26.08.2011

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli politikash)	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Statusi i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data planifikuar e përshtatjes	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
N/A	Po	Mbi disa ndryshime në Ligjin nr. 10294, datë 01.07.2010 “Për inspektimin financiar publik”.	Jo	Ministria e Financave	N/A	T4 2015	
<u>AFAT MESËM (2015 – 2016)</u>							
N/A	Po	Hartimi i akteve nënligjore për ligjin e Inspektimit Financiar publik. Hartimi i manualit të inspektimit financiar publik.	Jo	Ministria e Financave	N/A	Tre-mujori i katërt 2015	

IV.5 Mbrojtja e euros nga falsifikimi

Plani i veprimit 2014 – 2016

Kuadri i Politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
Strategjia afatmesme e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë për periudhën 2013-2015.	Banka e Shqipërisë	2013 - 2015

Inventari i Masave Ligjore Ekzistuese

EU <i>acquis</i>	Legjislacioni shqiptar	Institucioni kryesor	Niveli i përafrimit (i plotë/pjesshëm/mospërputhje)	Data e përshtatjes (Legjislacioni shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni shqiptar)
Vendimi Kuadër 2000/383/JHA mbi sanksionet ndaj falsifikimit dhe vendimi kuadër amendues 2001/888/JHA	Kodi Penal	Ministria e Drejtësisë	Mos-përputhje	27.01. 1995	1.6.1995
Rregullore 1338/2001/KE mbi mbrojtjen e euros nga falsifikimi në eurozonë dhe rregullorja amenduese 44/2009/EC.	Vendimi nr. 49, datë 31.07.2013 për miratimin e rregullores “Për trajtimin e kartëmonedhave dhe monedhave euro e të tjera të huaja të dyshuara të falsifikuara.	Banka e Shqipërisë	I pjesshëm	31.07.2013	2013

Kuadri i politikave të planifikuara për periudhën 2014 – 2016

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar	Data e përshtatjes	Hyrja në fuqi
N/A	• N/A	• N/A	• N/A	• N/A

Masat ligjore të parashikuara për periudhën 2014 – 2016

EU <i>acquis</i>	Status i përkthimit në Shqip (po/jo)	Legjislacioni Shqiptar (ligjet dhe aktet nënligjore)	Status i përkthimit në Anglisht (po/jo)	Institucioni Përgjegjës dhe pika e kontaktit	Niveli i synuar i përafrimit (i plotë/përputhje e pjesshme)	Data e planifikuar për përshtatjen	Hyrja në fuqi
<u>AFAT SHKURTËR (2014)</u>							
N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
<u>AFAT MESEM (2015 – 2016)</u>							
Rregullore 2182/2004 KE	Jo	Rregullat e Bordit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë mbi medaljonet dhe xhetonat me pamje të ngjashme me monedhat euro”	Jo	Banka e Shqipërisë (Qendra Kombëtare e Analizës)	Plotë	T2 2015	T2 2015

KAPITULLI 33: DISPOZITAT FINANCIARE DHE BUXHETORE

I. Hyrje

I.1 Përmbajtja e kapitullit

Ky kapitull përfshin rregulloret në lidhje me burimet financiare të nevojshme për financimin e buxhetit të BE-së („burimet vetjake“). Këto burime përbëhen nga të ashtuquajturat burimet tradicionale vetjake nga detyrimet doganore dhe taksat për sheqerin. Një burim i bazuar në tatimin mbi vlerën e shtuar; dhe më në fund, një burim bazuar në të ardhurat bruto kombëtare (GNI) të çdo shteti. Duhet pasur kapacitet të nevojshme administrative për t'u bashkërenduar në mënyrë adekuate dhe për të siguruar llogaritjen e saktë, mbledhjen, pagesën dhe kontrollin e kontributeve të burimeve të tyre vetjake.

Për më shumë informacion lutemi referohuni kapitullit 16 “Tatimet” dhe 29 “Bashkimi doganor”.

I.2 Situata në Shqipëri

Shqipëria ka një sistem kombëtar të TVSH-së, tarifatat doganore për importet zbatohen dhe përdoret metodologjia ESA 95 për llogaritjen e PBB-së. INSTAT ka krijuar një version zyrtar për të ardhurat të brendshme bruto.

Në bazë të nenit 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë "Taksat, tatimet dhe detyrimet e tjera financiare, kombëtare dhe lokale, reduktimi i tarifave doganore dhe dhënia e përjashtimeve për disa kategori të caktuara taksapaguesish, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre", përcaktohen me ligj. Në raste të tilla, ligji nuk mund t'i jepet fuqi prapavepruese". Ky përkufizim përfshin edhe detyrimet e importit (detyrimet doganore dhe detyrat e prodhimeve bujqësore).

Sistemi i TVSH është zbatuar në Shqipëri që nga viti 1995. Aktualisht është i rregulluar me Ligjin Nr. 7928, të datës 27 prill 1995, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar. Tatimi mbi vlerën e shtuar, siç aplikohet në Shqipëri, është një taksë e thjeshtë me një bazë të gjerë tatimpaguesish dhe me një normë të veçantë tatimore prej 20% për të dyja, si për mallrat e importuara ashtu dhe për ato të prodhuara në vend. Kjo taksë ka një prag përjashtimi prej 5 milion lekë shqiptar (38 168 Euro), e cila është tipike për vendet në zhvillim dhe, ka hyrë në fuqi që prej datës 1 Janar 2010. Për mallrat dhe eksportet e shërbimeve aplikohet norma zero përqind. Neni 19 i Ligjit për TVSH-në konsideron furnizime të përjashtuara ato që përcaktohen në nenet 20-25, si edhe në nenet 25.1, 25.2, 25.3, 25.5, 25.6, 25.7, 25.8, 25.9, 25.10 e 26.1 të këtij ligji. TVSH e

paguar për furnizime të blera brenda vendit ose për qëllime importi, të cilat janë në shërbim të furnizimeve të përjashtuara, nuk është TVSH e zbritshme.

Për informacione të mëtejshme për TVSH, lutemi referohuni Kapitullit 16.

Procedurat e mbledhjes, të kontabilitetit dhe të kontrollit për detyrimet doganore dhe taksat e importit kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD). Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është nën autoritetin e funksioneve të Ministrisë së Financave, në bazë të Ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë". Administrata doganore ka përparuar në përafrimin e legjislacionit doganor me legjislacionin e BE-së. Ajo ka finalizuar draftin e ri të Kodit Doganor, në përafrim të plotë me Rregulloren (BE) nr. 952/2013 të datës 9 tetor 2013 që përcakton Kodin Doganor të BE-së, si edhe disa akte të tjera të BE-së.

Në kuadër të programimit të buxhetit, qëllimi i Qeverisë është të përmirësojë procesin e planifikimit afatmesëm dhe përafrimin e tij të plotë me dokumentet strategjike, si pjesë e koncepteve thelbësore të Sistemit të Planifikimit të Integruar. Kjo reformë synon shpërndarjen strategjike të fondeve buxhetore në përputhje me politikat dhe objektivat e Qeverisë, përmirësimin e lidhjes ndërmjet objektivave vjetorë dhe afatmesëm, si edhe forcimin e programimit të buxhetit mbi bazë programi dhe performance. Buxhetimi në Shqipëri rregullohet me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i cili përcakton procedurat bazë buxhetore si dhe rolin specifik të secilit institucion në procesin buxhetor. Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 është formuluar në përputhje me praktikën më të mira të sistemit të menaxhimit të buxhetit. Sipas këtij ligji, duke filluar nga viti 2010, programimi buxhetor afatmesëm (PBA) është zbatuar nga të gjitha institucionet e qeverisjes qendrore si dhe për fondet e tyre të veçanta. Qëllimi kryesor i ligjit mbetet përmirësimi i procedurave të buxhetimit, përmes forcimit të lidhjes ndërmjet politikave dhe buxheteve, si edhe rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në përdorimin e fondeve buxhetore.

Në këtë kontekst, bazuar në Udhëzimin nr. 8, datë 29.3.2012, "Për procedurat standard për përgatitjen e PBA-së", Ministria e Financave synon ta disiplinojë më tej alokimet buxhetore shumëvjeçare, si edhe të shmangë akumulimin e detyrimeve të prapambetura në të ardhmen. Për këtë qëllim, është krijuar një databazë e posaçme (me bazë Excel) që do të pasqyrojë të gjitha të dhënat e përmendura më lart, që dërgohen nga secila ministri linje / institucion qendror.

Procesi i raportimit në lidhje me këtë databazë do të administrohet nga Njësia e Posaçme e Administrimit dhe Monitorimit të Detyrimeve të Prapambetura (NjPAMDP) pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, në Ministrinë e Financave.

II. Situata aktuale

II.1 Përmbledhje e kërkesave të MSA-së dhe *acquis* të BE-së

Neni 70 i MSA-së kërkon përafrimin e legjislacionit të brendshëm të Shqipërisë me *acquis* të BE-së, që përfshin edhe këtë kapitull.

II.2 Përmbledhje e arritjeve kryesore në legjislacion

Aktet ligjore kryesor relevante për këtë Kapitull përfshijnë:

- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- Udhëzimi nr. 8, datë 29.3.2012, “Për procedurat standard për përgatitjen e PBA-së”
- Udhëzimi nr. 2, datë 6.2.2012, “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”
- Ligji nr. 7928, datë 27.4.1995, “Për TVSH-në”
- Ligji nr. 8449, datë 27.1.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”
- VKM nr. 205, datë 13.4.1999, "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor"
- Ligji nr. 9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”
- Ligji nr. 9461, datë 21.12.2005, “Për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore”.

II.3 Institucionet përgjegjëse

Institucioni Kryesor për këtë kapitull është Ministria e Financave. Strukturat kontribuuese janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Fiskale dhe Të Ardhurave Publike;
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

IV. Plani

Kuadri i politikave ekzistuese

Titulli	Institucioni kryesor	Periudha e referuar
n/a	n/a	n/a

Inventari i masave ligjore ekzistuese

Acquis e BE-së	Legjislacioni shqiptar	Institucioni kryesor	Shkalla e përafrimit (e plotë/e pjesshme/mospërputhje)	Data e miratimit (legjislacioni shqiptar)	Hyrja në fuqi (Legjislacioni shqiptar)
Rregullorja 2913/92/KEE	Ligji nr. 8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”,	DPD	E pjesshme	27.01.1999	06.03.1999
Rregullorja 2658/87/KEE	Ligji nr. 9461, datë 21.12.2005 “Për Nomenklaturën e Mallrave dhe Tarifën Doganore“, i ndryshuar	DPD	E plotë	21.12.2005	01.01.2006
Rregullorja (KEE) 2454/93	VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor“, i ndryshuar	DPD	E pjesshme	13.04.1999	06.03.1999
Rregullorja 1383/2003/KE	VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor“, i ndryshuar	DPD	E plotë	1.05.2008	1.5.2008
Direktiva 2008/118/KE	Ligji nr. 7928, datë 27.04.1995 "Për TVSH-në", i ndryshuar	Ministria e Financave	E papërafruar	27.4.1995	27.4.1995

Masat ligjore të planifikuara *

Acquis e BE-së	Statusi i përkthimit në shqip (po/jo)	Legjislacioni shqiptar	Statusi i përkthimit në anglisht (po/jo)	Institucioni përgjegjës dhe Pika e kontaktit	Shkalla e synuar e përafrimit	Data e planifikuar për miratimin	Hyrja në fuqi
----------------	---------------------------------------	------------------------	--	--	-------------------------------	----------------------------------	---------------

* Ndryshimet në legjislacionit tatimor dhe doganor janë planifikuar përkatësisht në Kapitujt 16 dhe 29.

AFAT SHKURTËR (2014)							
n/a	n/a	Hartimi dhe miratimi i ndryshimeve në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”,		Ministria e Financave	E papërafuar	3 muajori i katërt 2014	3 muajori i parë 2015
n/a	n/a	Hartimi dhe miratimi i Ligjit për Buxhetin Vjetor 2015		Ministria e Financave	n/a	3 muajori i katërt 2014	3 muajori i katërt 2014
n/a	n/a	Hartimi dhe miratimi i VKM-së "Për miratimin e dokumentit të PBA-së 2015-2017".		Ministria e Financave	n/a	3 muajori i dytë 2014	3 muajori i dytë 2014
n/a	n/a	Hartimi dhe miratimi i Udhëzimit Vjetor për PBA 2015-2017.		Ministria e Financave	n/a	3 muajori i parë 2014	3 muajori i parë 2014
n/a	n/a	Hartimi dhe miratimi i Udhëzimit Suplementar për PBA 2015-2017.		Ministria e Financave	n/a	3 muajori i tretë 2014	3 muajori i tretë 2014
AFAT MESËM (2015 – 2016)							
n/a	n/a	Hartimi dhe miratimi i Ligjit për Buxhetin Vjetor 2016		Ministria e Financave	n/a	3 muajori i tretë 2015	3 muajori i katërt 2015
n/a	n/a	Hartimi dhe miratimi i Ligjit për Buxhetin Vjetor 2017		Ministria e Financave	n/a	3 muajori i katërt 2016	3 muajori i katërt 2016

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë)

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2014

Çmimi 752 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006